



UNIVERSITETI MESDHETAR I SHQIPËRISË
FAKULTETI I SHKENCAVE EKONOMIKE
DEPARTAMENTI I EKONOMISË DHE ZHVILLIMIT

DISERTACION

Doktoratë në Shkenca Ekonomike

POLITIKAT FISKALE NË KUSHTET E RECESIONIT
EKONOMIK:
EVIDENCË EMPIRIKE NGA SHQIPËRIA GJATË KRIZËS
FINANCIARE GLOBALE 2008–2009 DHE PANDEMISË
COVID-19

Doktorant:
Ardita Hykaj

Udhëheqës shkencor:
Akademik. Prof. Dr. Anastas Angjeli

Tiranë, 2026

Deklarata e Origjinalitetit

Unë, nënshkruara Ardita Hykaj, deklaroj me përgjegjësi të plotë se ky studim, i paraqitur në Fakultetin e Shkencave Ekonomike, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, për marrjen e gradës shkencore Doktor i Shkencave, përfaqëson punimin tim origjinal. Ky punim nuk është dorëzuar asnjëherë për vlerësim në ndonjë institucion tjetër arsimor dhe nuk është botuar më parë.

Deklaroj gjithashtu se, sipas standardeve akademike dhe etike, të gjitha materialet, të dhënat dhe informacionet që nuk janë rezultat i punës sime origjinale janë cituar dhe referuar në mënyrë të saktë dhe transparente. Çdo burim i përdorur nga palë të treta është përmendur sipas rregullave të referencimit akademik.

Për më tepër, të gjithë individët dhe palët e përfshira gjatë realizimit të këtij studimi janë informuar plotësisht për përfshirjen e tyre dhe kanë dhënë pjesëmarrjen e tyre me vullnet të lirë.

© Copyright, Ardita HYKAJ, 2026

Falenderime

Ky udhëtim i doktoraturës nuk do të ishte i mundur pa njerëzit e veçantë që ecën pranë meje.

Një falënderim dhe mirënjohje e veçantë shkon për drejtuesin tim shkencor, Akademik. Prof. Dr. Anastas Angjeli, i cili besoi tek unë që në hapat e parë të këtij rrugëtimi akademik dhe nuk reshti asnjëherë së mbështeturi dhe besuari në punën, përkushtimin dhe potencialin tim. Udhëzimi, besimi dhe motivimi i tij kanë qenë një forcë e çmuar në realizimin e këtij punimi.

Një falënderim të sinqertë dhe të ngrohtë shpreh për të gjithë kolegët e Fakultetit të Shkencave Ekonomike, dhe sidomos për ata të Departamentit të Ekonomisë dhe Zhvillimit. Diskutimet tona, sugjerimet tua dhe energjia pozitive që keni ndarë me mua kanë pasuruar shumë këtë punim dhe më kanë dhënë forcë në çdo moment.

Faleminderit!

Dedikimi

Këtë arritje ia dedikoj me dashuri dhe mirënjohje të pafundme familjes sime, që më mësoi të besoj tek vetja, të ndjek ëndrrat e mia dhe të mos dorëzohem kurrë përballë sfidave. Falë jush jam kjo që jam sot.

Mirënjohje të thellë për familjen time të dytë, për mbështetjen, ngrohtësinë dhe besimin e vazhdueshëm që më kanë dhënë në çdo moment të këtij udhëtimi.

Një dedikim i veçantë shkon për shokun tim të jetës, Kristalin, që ka qenë forca ime më e madhe, mbështetja ime pa kushte dhe motivimi im i përditshëm për të vazhduar përpara edhe në momentet më sfiduese. Besimi yt tek unë më ka bërë të besoj edhe më shumë tek vetja.

Për Krisardin dhe Emën, frymëzimin tim më të bukur, që më kujtojnë çdo ditë se ëndrrat më të mëdha realizohen kur udhëhiqesh nga dashuria, forca dhe shpresa.

Mirënjohëse pafundësisht!

Krisardit dhe Emës!

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Abstrakt	i
Abstract	ii
LISTA E SHKURTIMEVE	iii
LISTA E TABELAVE	iv
LISTA E FIGURAVE	v
KAPITULLI 1: HYRJE	1
1.1 Konteksti dhe rëndësia e studimit.....	1
1.2 Problemi kërkimor, qëllimi, pyetjet dhe hipotezat e studimit	2
1.3 Kufizimet e studimit.....	4
1.4 Kontributi shkencor dhe rëndësia për politikëbërjen.....	5
1.5 Organizimi i kërkimit	6
KAPITULLI 2: RISHIKIMI I LITERATURES	8
2.1 Kuadri teorik dhe qasjet kryesore mbi politikën fiskale.....	8
2.2 Politika fiskale gjatë cikleve ekonomike dhe krizave.....	11
2.3 Politika Fiskale në ekonomitë në tranzicion, Ballkanin Perëndimor dhe ndërveprimi me politikën monetare.....	14
2.4 Analiza empirike e politikës fiskale dhe evidenca ndërkombëtare	16
2.5 Politika fiskale dhe rimëkëmbja ekonomike në Shqipëri	20
2.6 Sintetizimi teoriko-empirik I literaturës	22
2.7 Korniza konceptuale e studimit dhe pozicionimi i tij në literaturë.....	23
2.8 Përfundime të kapitullit	26
KAPITULLI 3: KONTEKSTI MAKROEKONOMIK	28
3.1 Konteksti makroekonomik dhe evolucioni i politikës fiskale (2000–2024).....	28
3.2 Ciklet ekonomike dhe reagimi i politikës fiskale në Shqipëri (2000–2024)	32
3.3 Shqipëria në kontekstin e Ballkanit Perëndimor	35
3.4 Faktorët që kushtëzojnë efektivitetin fiskal.....	36
3.5 Implikimet për analizën empirike.....	39
3.6 Përfundime të kapitullit	41
KAPITULLI 4: METODOLOGJIA	42
4.1 Dizajni i kërkimit.....	42
4.2 Strategjia e analizës empirike	44
4.3 Korniza konceptuale e studimit dhe lidhja me hipotezat.....	48
4.4 Përzgjedhja e variablave.....	50
4.5 Burimet e të dhënave dhe procedurat e analizës.....	53
4.6 Përpunimi dhe transformimi i të dhënave.....	56
4.7 Specifikimi ekonometrik i modelit	58

4.7.1	Modeli bazë dhe i zgjeruar (OLS)	59
4.7.2	Modeli me ndërveprime krizash	61
4.7.3	Modelet ekonometrike në analizën sipas nënperiudhave	62
4.7.4	Modeli institucional dhe metodologjia ARDL	64
4.8	Testet diagnostikuese të modelit dhe validimi I modeleve ekonometrike	65
4.9	Analiza e stabilitetit strukturor	67
4.10	Kufizimet metodologjike të studimit	68
4.10	Përfundime të kapitullit	69
KAPITULLI 5: ANALIZA EMPIRIKE DHE REZULTATET		71
5.1	Analiza përshkruese e variablave	71
5.2	Testet diagnostikuese të serive kohore dhe modelit	80
5.3	Analiza e stabilitetit strukturor dhe identifikimi I pikave të thyerjes	83
5.4	Rezultatet empirike	87
5.4.1	Analiza e efekteve fiskale mbi rritjen ekonomike: modeli bazë dhe modeli i zgjeruar (2000–2024)	88
5.4.2	Efektet e politikës fiskale në kushtet e krizës: analiza me terma ndërveprimi	90
5.4.3	Efektiviteti i politikës fiskale në regjime të ndryshme makroekonomike	92
5.4.4	Analiza empirike e rolit të kapacitetit institucional në efektivitetin e politikës fiskale	101
5.5	Përfundime të kapitullit	103
KAPITULLI 6: DISKUTIMI I REZULTATEVE		105
6.1	Interpretimi ekonomik I rezultateve	105
6.2	Politika fiskale dhe cikli ekonomik	107
6.3	Efektiviteti i politikës fiskale gjatë krizave (2008-2009 dhe 2000)	108
6.4	Multiplikatorët fiskalë dhe mekanizmi I transmetimit	110
6.5	Krahasimi me vendet e Ballkanit Perëndimor	112
6.6	Vlerësimi I hipotezave kërkimore	116
6.7	Implikime për politikbërjen	118
6.8	Përfundime të kapitullit	119
KAPITULLI 7: PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME		121
7.1	Përmbledhje e gjetjeve kryesore	121
7.2	Mësimet kryesore nga krizat ekonomike	122
7.3	Rekomandime për politikbërjen	123
7.4	Kontributi i studimit	125
7.5	Kufizimet dhe drejtimit për kërkime të ardhshme	126
7.6	Përfundimi final	127

ANEKSET	129
LITERATURA	139

Abstrakt

Ky studim analizon rolin e politikës fiskale në rimëkëmbjen ekonomike të Shqipërisë gjatë periudhës 2000–2024, me fokus në efektivitetin e instrumenteve fiskale në kushte të ndryshme makroekonomike dhe institucionale. Periudha e studimit përfshin disa episode me rëndësi të veçantë për ekonominë shqiptare, si kriza financiare globale e viteve 2008–2009, tërmeti i vitit 2019, pandemia COVID-19 dhe pasojat ekonomike të krizës energjetike dhe luftës në Ukrainë. Këto zhvillime kanë krijuar një mjedis të përshtatshëm për të vlerësuar mënyrën se si politika fiskale ka kontribuar në stabilizimin ekonomik dhe në mbështetjen e rritjes në periudha të karakterizuara nga pasiguri dhe goditje të jashtme.

Qëllimi kryesor i studimit është të vlerësojë ndikimin e instrumenteve fiskale mbi rritjen ekonomike, të analizojë rolin e borxhit publik dhe të hapësirës fiskale në efektivitetin e ndërhyrjeve publike, si dhe të shqyrtojë ndikimin e kapacitetit institucional në rezultatet e politikës fiskale. Studimi mbështetet në teorinë New Keynesian, literaturën mbi multiplikatorët fiskalë dhe qasjet bashkëkohore që theksojnë rëndësinë e institucioneve në zbatimin e politikave ekonomike. Për të adresuar këtë dimension, analiza përfshin Indeksin e Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF), të ndërtuar mbi treguesit e qeverisjes së Bankës Botërore.

Metodologjia e përdorur kombinon analizën statistikore përshkruese me modele ekonometrike të serive kohore, duke përdorur metoda OLS dhe ARDL mbi të dhëna vjetore për periudhën 2000–2024. Analiza përfshin testet e stacionaritetit, testet diagnostikuese, vlerësimin e ndryshimeve strukturore dhe modele me terma ndërveprimi për të analizuar heterogjenitetin e efekteve fiskale në periudha të ndryshme ekonomike.

Rezultatet tregojnë se politika fiskale ka ushtruar një ndikim pozitiv mbi aktivitetin ekonomik, por efektiviteti i saj ka ndryshuar sipas fazave të ciklit ekonomik dhe kushteve makroekonomike. Borxhi publik rezulton të kufizojë gradualisht hapësirën fiskale dhe aftësinë për ndërhyrje të mëtejshme, ndërsa ndikimi i politikës fiskale është më i theksuar gjatë periudhave të krizës. Një nga gjetjet më të rëndësishme të studimit është se përmirësimi i kapacitetit institucional rrit ndjeshëm efektivitetin e politikës fiskale, duke përforcuar ndikimin e shpenzimeve publike mbi rritjen ekonomike.

Studimi kontribuon në literaturën mbi politikën fiskale në ekonominë në tranzicion duke ofruar një analizë të integruar të marrëdhënies ndërmjet instrumenteve fiskale, kapacitetit institucional dhe performancës ekonomike. Gjetjet sugjerojnë se suksesi i politikës fiskale nuk varet vetëm nga madhësia e ndërhyrjeve publike, por edhe nga cilësia e institucioneve dhe aftësia e tyre për të administruar në mënyrë efektive burimet publike.

Fjalë kyçe: politikë fiskale, rritje ekonomike, rimëkëmbje ekonomike, borxh publik, kapacitet institucional, IKIPF, Shqipëri, ARDL, OLS.

Abstract

This study examines the role of fiscal policy in Albania's economic recovery during the period 2000–2024, with particular emphasis on the effectiveness of fiscal instruments under different macroeconomic and institutional conditions. The study period encompasses several major events that significantly affected the Albanian economy, including the 2008–2009 global financial crisis, the 2019 earthquake, the COVID-19 pandemic, and the economic consequences of the energy crisis and the war in Ukraine. These developments provide a valuable context for assessing how fiscal policy contributed to economic stabilization and growth during periods characterized by uncertainty and external shocks.

The primary objective of the study is to evaluate the impact of fiscal policy instruments on economic growth, to analyze the role of public debt and fiscal space in shaping the effectiveness of public interventions, and to investigate the influence of institutional capacity on fiscal policy outcomes. The research is grounded in New Keynesian theory, the fiscal multiplier literature, and contemporary approaches that emphasize the importance of institutions in the design and implementation of economic policies. To capture the institutional dimension, the analysis incorporates the Institutional Capacity Index for Fiscal Policy (ICIFP), developed using the World Bank's Worldwide Governance Indicators.

The methodological framework combines descriptive statistical analysis with time-series econometric techniques. Annual data covering the period 2000–2024 are analyzed using Ordinary Least Squares (OLS) and Autoregressive Distributed Lag (ARDL) models. The empirical strategy includes stationarity testing, diagnostic procedures, structural break analysis, and interaction models designed to capture the heterogeneous effects of fiscal policy across different economic regimes.

The findings indicate that fiscal policy has exerted a positive influence on economic activity; however, its effectiveness varies according to the stage of the economic cycle and prevailing macroeconomic conditions. Public debt is found to gradually constrain fiscal space and reduce the scope for future interventions, while fiscal policy tends to be more effective during periods of economic distress. One of the most significant findings of the study is that stronger institutional capacity substantially enhances fiscal policy effectiveness by reinforcing the positive impact of public expenditure on economic growth.

The study contributes to the literature on fiscal policy in transition economies by providing an integrated analysis of the relationship between fiscal instruments, institutional capacity, and economic performance. The findings suggest that the success of fiscal policy depends not only on the scale of public interventions but also on the quality of institutions and their ability to manage public resources efficiently and effectively.

Keywords: Fiscal policy, economic growth, economic recovery, public debt, institutional capacity, ICIFP, Albania, ARDL, OLS.

LISTA E SHKURTIMEVE

ADF	Augmented Dickey-Fuller (Testi Dickey-Fuller i zgjeruar)
ARDL	Autoregressive Distributed Lag
AIC	Akaike Information Criterion (Kriteri i Informacionit Akaike)
BE	Bashkimi Europian
BSH	Banka e Shqipërisë
CHOW	Chow Breakpoint Test (Testi Chow për thyerjet strukturore)
COVID-19	Coronavirus Disease 2019
CUSUM	Cumulative Sum (Testi i shumës kumulative për stabilitetin e parametrave)
CUSUMSQ	Cumulative Sum of Squares (Shuma kumulative e katrorëve)
ECM	Error Correction Model
DW	Testi Durbin-Watson
EBRD	European Bank for Reconstruction and Development (Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim)
EUROSTAT	Zyra Statistikore e Bashkimit Europian
GDP (PBB)	Gross Domestic Product (Produkti I Brendshëm Bruto)
IKIPF	Indeksi i Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale
IMF	International Monetary Fund
INSTAT	Instituti i Statistikave
OECD	Organisation for Economic Co-operation and Development
OLS	Metoda e Katrorëve më të Vegjël
SIC	Schwarz Information Criterion (Kriteri i Informacionit Schwarz)
SVAR	Structural Vector Autoregression
VAR	Vector Autoregression
VIF	Variance Inflation Factor (Faktori i Inflacionit të Variancës)
WB	World Bank (Banka Botërore)
WDI	World Development Indicators
WB6	Western Balkans Six (Gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor)

LISTA E TABELAVE

Tabela 2.1 Krahاسimi i shkollave kryesore të mendimit ekonomik mbi politikën fiskale	11
Tabela 3.1 Regjimet makroekonomike dhe orientimi i politikës fiskale në Shqipëri (2000–2024)	34
Tabela 3.2 Shqipëria në kontekstin e Ballkanit Perëndimor: karakteristikat kryesore makroekonomike dhe fiskale.....	36
Tabela 4.1 Struktura e strategjisë së analizës empirike	47
Tabela 4.2 Lidhja ndërmjet hipotezave kërkimore, modeleve ekonometrike dhe metodave të testimit.....	50
Tabela 4.3 Ndarja e periudhës sipas regjimeve makroekonomike	56
Tabela 4.4 Strategjia ekonometrike e studimit	65
Tabela 5.1 Statistikat përshkruese të variablave për periudhën 2000–2024.....	72
Tabela 5.2 Matrica e korelacionit ndërmjet variablave makroekonomikë dhe fiskalë në Shqipëri (2000–2024).....	77
Tabela 5.3 Rezultatet e testit të stacionaritetit për periudhën 2000–2024	80
Tabela 5.4 Testi i multikollinearitetit (Variance INFLATION Factor – VIF)	81
Tabela 5.5 Testet diagnostikuese të modelit OLS për periudhën (2000–2024).....	82
Tabela 5.6 Rezultatet e Chow Breakpoint Test për identifikimin e thyerjeve strukturore	84
Tabela 5.7 Implikimet e thyerjeve strukturore për regjimet fiskale në Shqipëri	87
Tabela 5.8 Rezultatet e modelit bazë OLS për rritjen ekonomike në Shqipëri (2001–2024).....	88
Tabela 5.9 Rezultatet e modelit të zgjeruar OLS për rritjen ekonomike në Shqipëri (2001–2024)	89
Tabela 5.10 Modeli OLS me terma ndërveprimi për krizat (2000–2024)	91
Tabela 5.11 Modeli bazë OLS për periudhën para krizës globale (2001–2008)	93
Tabela 5.12 Modeli i zgjeruar OLS për periudhën para krizës globale (2001–2008)	94
Tabela 5.13 Rezultatet e modelit bazë OLS për periudhën e konsolidimit fiskal (2010–2019) ..	95
Tabela 5.14 Modeli i zgjeruar OLS me kontroll për stabilitetin makroekonomik (2009–2019) ..	96
Tabela 5.15 Modeli i zgjeruar OLS me kontroll për sektorin e jashtëm (2009–2019).....	97
Tabela 5.16 Modeli bazë OLS për periudhën COVID dhe pas-COVID (2021–2024).....	98
Tabela 5.17 Mini-regresionet bivariate për periudhën 2020–2024.....	98
Tabela 5.18 Forca dhe drejtimi i lidhjes ndërmjet rritjes ekonomike dhe variablave fiskalë/makroekonomikë në periudhën 2020–2024.....	99
Tabela 5.19 Krahاسimi i regjimeve fiskale dhe efektivitetit të politikës fiskale në Shqipëri sipas nënperiudhave (2000–2024).....	100
Tabela 5.20 Rezultatet e Bounds Test	101
Tabela 5.21 Rezultatet afatgjata të modelit institucional.....	102
Tabela 5.22 Efektet afatshkurtra të ndërveprimit institucional	103
Tabela 6.1 Krahاسimi i mekanizmit të transmetimit fiskal gjatë krizave	110
Tabela 6.2 Pozicionimi Krahاسues i Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor.....	114
Tabela 6.3 Krahاسimi i gjetjeve empirike të Shqipërisë me evidencën rajonale të Ballkanit Perëndimor	114
Tabela 6.4 Vlerësimi përfundimtar i hipotezave kërkimore	117

LISTA E FIGURAVE

Figura 3.1 Rritja reale e PBB-së në Shqipëri (2000–2024, %)	29
Figura 3.2 Inflacioni dhe papunësia në Shqipëri (2000–2024, %)	30
Figura 3.3 Bilanci i llogarisë korrente në Shqipëri (2000–2024, % e PBB-së).....	30
Figura 3.4 Remitancat në Shqipëri (2000–2024, % e PBB-së)	31
Figura 3.5 Borxhi publik në Shqipëri (2000–2024, % e PBB-së)	32
Figura 3.6 Rritja reale vjetore e PBB-së në Shqipëri (2000–2024) dhe fazat kryesore të ciklit ekonomik	34
Figura 5.1 Trendet kohore të treguesve kryesorë makro-fiskalë në Shqipëri (2000–2024)	73
Figura 5.2 Evolucion i kohor i variablave fiskalë dhe makroekonomikë (2000–2024)	75
Figura 5.3 Marrëdhëniet bivariate ndërmjet GDP_Growth dhe variablave fiskalë/ makroekonomikë (2000–2024).	76
Figura 5.4 Evolucion i IKIPF në Shqipëri (2000–2024)	79
Figura 5.5 Stabiliteti I parametrave-CUSUM	85
Figura 5.6 Stabiliteti I variancës-CUSUM of Squares	86
Figura 6.1 Marrëdhënia ndërmjet qeverisjes institucionale dhe nivelit të zhvillimit ekonomik në vendet e Ballkanit Perëndimor (mesatarja 2020–2024)	113

KAPITULLI 1: HYRJE

Politika fiskale përbën një nga instrumentet kryesore që qeveritë përdorin për të mbështetur stabilitetin makroekonomik, për të përballuar goditjet ekonomike dhe për të nxitur zhvillimin afatgjatë. Megjithatë, përvoja ndërkombëtare ka treguar se rezultatet e saj nuk varen vetëm nga niveli i shpenzimeve publike apo i të ardhurave buxhetore, por edhe nga kushtet ekonomike në të cilat zbatohet, nga hapësira fiskale e disponueshme dhe nga aftësia e institucioneve për të hartuar dhe zbatuar politika efektive. Në këtë kuadër, studimi analizon rolin e politikës fiskale në rimëkëmbjen ekonomike të Shqipërisë gjatë periudhës 2000–2024, duke i kushtuar vëmendje jo vetëm instrumenteve tradicionale fiskale, por edhe dimensionit institucional që mbështet funksionimin e tyre. Qasja e ndjekur në këtë studim synon të ofrojë një kuptim më të plotë të faktorëve që ndikojnë në rezultatet e ndërhyrjeve fiskale në një ekonomi të vogël, të hapur dhe në tranzicion.

1.1 Konteksti dhe rëndësia e studimit

Kriza financiare globale e viteve 2008–2009 përbënte një pikë kthese të rëndësishme, duke çuar në ngadalësim të dukshëm të ritmeve të rritjes ekonomike dhe në rritje të presionit mbi financat publike. Kjo situatë u përkeqësua më tej nga tërmeti i vitit 2019, i cili gjeneroi kërkesa të konsiderueshme financiare për procesin e rindërtimit. Pas kësaj, pandemia e COVID-19 në vitin 2020 shkaktoi ndërprerje të thella të aktivitetit ekonomik, ulje të mprehtë të konsumit dhe investimeve, si dhe nevojën urgjente për masa mbështetëse publike ndaj familjeve dhe ndërmarrjeve. Më vonë, pasojat ekonomike të luftës në Ukrainë, së bashku me krizën energjetike europiane, përkeqësuan presionet inflacioniste dhe shtuan pasiguritë në tregjet ndërkombëtare (Angjeli & Civici, 2022). Literatura ndërkombëtare thekson se masat fiskale të marra gjatë periudhave të krizës rezultojnë më efektive kur janë të shpejta, të mirëkoordinuara dhe të synuara. Megjithatë, këto intervenca shoqërohen shpesh me një rritje të konsiderueshme të borxhit publik (Baldacci et al., 2011).

Këto zhvillime e bëjnë periudhën 2000–2024 veçanërisht të përshtatshme për të analizuar mënyrën se si është përdorur politika fiskale dhe sa efektive ka qenë ajo në mbështetjen e aktivitetit ekonomik dhe në procesin e rimëkëmbjes pas krizave. Studimi mbështetet në qasjen New Keynesian dhe në literaturën mbi multiplikatorët fiskalë, duke marrë parasysh edhe kufizimet që karakterizojnë ekonominë në zhvillim, si niveli i informalitetit, varësia nga faktorët e jashtëm dhe hapësira fiskale relativisht e kufizuar.

Megjithatë, literatura më e fundit argumenton se rezultatet e politikës fiskale nuk përcaktohen vetëm nga instrumentet buxhetore, por edhe nga cilësia e institucioneve që i mbështesin ato. Kapaciteti i administratës publike, cilësia e qeverisjes, efektiviteti i zbatimit të politikave dhe aftësia për të menaxhuar burimet publike konsiderohen faktorë

të rëndësishëm që ndikojnë në suksesin e ndërhyrjeve fiskale (Besley & Persson, 2013; Gaspar et al., 2016).

Për këtë arsye, studimi zgjeron analizën tradicionale të politikës fiskale duke përfshirë edhe dimensionin institucional përmes Indeksit të Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF), i ndërtuar mbi treguesit e qeverisjes së Bankës Botërore (Kaufmann & Kraay, 2024). Kjo qasje mundëson vlerësimin e rolit që luajnë institucionet në forcimin e efektivitetit të politikave fiskale dhe në përmirësimin e rezultateve ekonomike. Në këtë mënyrë, kërkimi synon të kontribuojë në literaturën ekzistuese duke analizuar në mënyrë të integruar marrëdhënien ndërmjet politikës fiskale, kapacitetit institucional dhe performancës ekonomike në Shqipëri gjatë periudhës 2000–2024.

1.2 Problemi kërkimor, qëllimi, pyetjet dhe hipotezat e studimit

Megjithëse politika fiskale ka luajtur një rol të rëndësishëm në menaxhimin e goditjeve ekonomike dhe në mbështetjen e aktivitetit ekonomik në Shqipëri, mbetet ende e paqartë në çfarë mase ajo ka kontribuar realisht në procesin e rimëkëmbjes ekonomike dhe cilët faktorë kanë ndikuar në efektivitetin e saj. Literatura ndërkombëtare argumenton se rezultatet e ndërhyrjeve fiskale nuk janë uniforme, por ndryshojnë sipas fazës së ciklit ekonomik, nivelit të borxhit publik, hapësirës fiskale dhe karakteristikave strukturore të ekonomisë (Auerbach & Gorodnichenko, 2012; Blanchard & Leigh, 2013). Megjithatë, për rastin e Shqipërisë evidenca empirike mbetet relativisht e kufizuar, veçanërisht në lidhje me rolin që luajnë institucionet në forcimin ose dobësimin e efektivitetit të politikave fiskale (Besley & Persson, 2013).

Një boshllëk i rëndësishëm në literaturën shqiptare lidhet me mungesën e studimeve që analizojnë në mënyrë të integruar marrëdhënien ndërmjet politikës fiskale, kapacitetit institucional dhe performancës ekonomike. Shumica e kërkimeve ekzistuese fokusohen kryesisht në ndikimin e shpenzimeve publike, të ardhurave tatimore ose borxhit publik mbi rritjen ekonomike, ndërsa dimensionin institucional trajtohet në mënyrë të kufizuar ose mbetet jashtë analizës empirike. Në këtë kuadër, ky studim synon të plotësojë këtë boshllëk duke analizuar jo vetëm ndikimin e instrumenteve fiskale mbi rritjen ekonomike, por edhe rolin e kapacitetit institucional, të matur përmes Indeksit të Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF), në rritjen e efektivitetit të politikës fiskale.

Qëllimi kryesor i studimit është të vlerësojë në mënyrë empirike efektivitetin e politikës fiskale në Shqipëri gjatë periudhës 2000–2024, me fokus të veçantë në periudhat e krizës ekonomike, duke analizuar ndikimin e instrumenteve fiskale, borxhit publik, faktorëve strukturorë dhe kapacitetit institucional në procesin e rritjes dhe rimëkëmbjes ekonomike. Për realizimin e këtij qëllimi, ky studim synon:

- të vlerësojë ndikimin e instrumenteve kryesore të politikës fiskale mbi rritjen ekonomike;

- të analizojë ndikimin e borxhit publik mbi hapësirën fiskale dhe efektivitetin e ndërhyrjeve fiskale;
- të identifikojë ndryshimet në efektivitetin e politikës fiskale ndërmjet periudhave të stabilitetit ekonomik dhe periudhave të krizës;
- të krahasojë rezultatet e politikës fiskale gjatë krizës financiare globale dhe pandemisë COVID-19;
- të analizojë ndikimin e faktorëve strukturorë në mekanizmin e transmetimit fiskal;
- të vlerësojë rolin e kapacitetit institucional në rritjen e efektivitetit të politikës fiskale.

Bazuar në këtë problematikë, studimi udhëhiqet nga pyetja kryesore kërkimore: *Sa efektive ka qenë politika fiskale në Shqipëri gjatë periudhës 2000–2024 dhe në çfarë mase ky efektivitet është kushtëzuar nga cikli ekonomik, niveli i borxhit publik, faktorët strukturorë dhe kapaciteti institucional?*

Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, formulohen hipotezat e mëposhtme kërkimore:

H1: Instrumentet kryesore të politikës fiskale kanë ndikim të rëndësishëm në rritjen ekonomike gjatë periudhës 2000–2024.

H2: Rritja e nivelit të borxhit publik kufizon hapësirën fiskale dhe redukton efektivitetin e ndërhyrjeve fiskale.

H3: Efekti i politikës fiskale ndryshon sipas fazave të ciklit ekonomik dhe bëhet më i fortë gjatë periudhave të recesionit.

H4: Politika fiskale ka luajtur një rol më aktiv kundërciklik gjatë krizës financiare globale dhe pandemisë COVID-19.

H5: Faktorët strukturorë të ekonomisë shqiptare ndikojnë në efektivitetin dhe mekanizmin e transmetimit të politikës fiskale.

H6: Përmirësimi i kapacitetit institucional rrit efektivitetin e politikës fiskale duke forcuar ndikimin e instrumenteve fiskale mbi rritjen ekonomike.

Nëpërmjet testimit të këtyre hipotezave, studimi synon të ndërtojë një kuadër analitik që lidh dimensionin fiskal me atë institucional dhe të ofrojë një vlerësim më të plotë të faktorëve që përcaktojnë efektivitetin e politikës fiskale në një ekonomi të vogël, të hapur dhe në tranzicion si Shqipëria. Në këtë mënyrë, kërkimi kontribuon në zgjerimin e literaturës ekzistuese dhe në kuptimin më të thellë të marrëdhënies ndërmjet qeverisjes institucionale, politikës fiskale dhe performancës ekonomike.

1.3 Kufizimet e studimit

Ashtu si çdo studim empirik që analizon një ekonomi individuale përgjatë një periudhe të gjatë kohore, edhe ky kërkim përballlet me disa kufizime metodologjike dhe empirike që duhen marrë në konsideratë gjatë interpretimit të rezultateve. Këto kufizime nuk cenojnë vlefshmërinë e analizës, por pasqyrojnë kompleksitetin e vlerësimit të politikës fiskale në një ekonomi të vogël, të hapur dhe në tranzicion si Shqipëria.

Së pari, analiza mbështetet në të dhëna vjetore për periudhën 2000–2024. Përdorimi i këtij frekuence mundëson identifikimin e prirjeve afatgjata dhe të ndryshimeve strukturore në ekonomi, por kufizon vlerësimin e reagimeve afatshkurtra dhe të efekteve të menjëhershme të politikës fiskale, veçanërisht gjatë periudhave të krizës. Megjithatë, zgjedhja e të dhënave vjetore është diktuar nga disponueshmëria dhe konsistenca e serive statistikore afatgjata për Shqipërinë.

Së dyti, studimi përdor modele OLS dhe ARDL për të vlerësuar marrëdhëniet ndërmjet politikës fiskale, rritjes ekonomike dhe kapacitetit institucional. Edhe pse këto metoda konsiderohen të përshtatshme për analizën e serive kohore me kampione relativisht të vogla, ato nuk eliminojnë plotësisht mundësinë e ndikimeve të ndërsjella ndërmjet variablave apo praninë e faktorëve të pavëzhguar. Për këtë arsye, rezultatet interpretohen kryesisht si evidencë mbi lidhjet ekonomike dhe mekanizmat e transmetimit, pa pretenduar identifikimin e plotë të marrëdhënieve shkak–pasojë.

Së treti, madhësia relativisht e kufizuar e kampionit përbën një kufizim të zakonshëm në studimet me seri kohore për ekonomi individuale. Megjithatë, periudha e analizuar përfshin faza të ndryshme të zhvillimit ekonomik, dy kriza të rëndësishme ndërkombëtare dhe ndryshime të konsiderueshme në orientimin e politikës fiskale, çka rrit vlerën analitike të rezultateve të përfutuara.

Së katërti, studimi fokusohet në ndikimin makroekonomik të politikës fiskale mbi rritjen ekonomike dhe nuk trajton drejtpërdrejt dimensione të tjera, si shpërndarja e të ardhurave, pabarazia ekonomike, mirëqenia sociale apo efikasiteti mikroekonomik i programeve të veçanta të shpenzimeve publike. Ky kufizim lidhet me objektivin kryesor të kërkimit, i cili synon të analizojë mekanizmat e transmetimit fiskal në nivel makroekonomik.

Së fundi, megjithëse studimi integron dimensionin institucional përmes Indeksit të Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF), cilësia institucionale mbetet një koncept shumëdimensional që nuk mund të përfaqësohet plotësisht nga një tregues i vetëm. Faktorë të tillë si efienca administrative, informaliteti, cilësia e politikëbërjes, koordinimi ndërinstitutional dhe karakteristika të tjera të qeverisjes ekonomike mund të ndikojnë në efektivitetin e politikës fiskale në mënyra që nuk kapen plotësisht nga modelet e përdorura.

Pavarësisht këtyre kufizimeve, studimi ofron një analizë të gjerë dhe të strukturuar të rolit të politikës fiskale në Shqipëri, duke kombinuar dimensionin makroekonomik me atë institucional. Njohja e këtyre kufizimeve rrit transparencën metodologjike të kërkimit dhe krijon bazë për zgjerime të ardhshme empirike, përmes përdorimit të të dhënave me frekuencë më të lartë, metodave ekonometrike më të avancuara dhe analizave krahasuese ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor.

1.4 Kontributi shkencor dhe rëndësia për politikëbërjen

Ky studim synon të kontribuojë në literaturën mbi politikën fiskale dhe rimëkëmbjen ekonomike duke ofruar një analizë të integruar të rastit shqiptar gjatë periudhës 2000–2024. Kontributi i tij qëndron në kombinimin e analizës së instrumenteve tradicionale fiskale me dimensionin institucional, duke mundësuar një kuptim më të plotë të faktorëve që përcaktojnë efektivitetin e politikës fiskale në një ekonomi të vogël, të hapur dhe në tranzicion.

Kontributi i parë lidhet me evidencën empirike të ofruar për një periudhë relativisht të gjatë kohore, e cila përfshin episode me karakteristika të ndryshme ekonomike dhe institucionale, si kriza financiare globale e viteve 2008–2009, tërmeti i vitit 2019, pandemia COVID-19 dhe periudha e rimëkëmbjes pas saj. Analiza e këtyre episodeve mundëson vlerësimin e ndryshimeve në efektivitetin e politikës fiskale sipas regjimeve të ndryshme makroekonomike dhe ofron evidencë mbi natyrën ciklike të ndikimit fiskal në ekonominë shqiptare.

Një kontribut i dytë lidhet me qasjen metodologjike të përdorur. Studimi analizon në mënyrë të integruar ndikimin e shpenzimeve publike, të ardhurave tatimore dhe borxhit publik mbi rritjen ekonomike, duke kombinuar analizën me modele OLS, analiza sipas nënperiudhave, terma ndërveprimi për periudhat e krizës dhe metodologjinë ARDL. Kjo qasje mundëson një vlerësim më të plotë të marrëdhënieve ndërmjet politikës fiskale dhe performancës ekonomike si në afatshkurtër, ashtu edhe në afatgjatë.

Një element veçanërisht i rëndësishëm i studimit është integrimi i dimensionit institucional në analizën e efektivitetit fiskal. Përmes ndërtimit të Indeksit të Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF), studimi vlerëson rolin e institucioneve në forcimin ose kufizimin e efektivitetit të ndërhyrjeve fiskale. Rezultatet tregojnë se cilësia institucionale përbën një faktor të rëndësishëm në shpjegimin e ndryshimeve të efektivitetit fiskal, duke zgjeruar analizën tradicionale të politikës fiskale dhe duke e lidhur atë me konceptet e qeverisjes ekonomike dhe kapacitetit shtetëror.

Një kontribut tjetër i studimit qëndron në vendosjen e Shqipërisë në një kontekst më të gjerë rajonal. Krahasimi me vendet e Ballkanit Perëndimor mundëson identifikimin e elementeve të përbashkëta dhe të veçanta të funksionimit të politikës fiskale në ekonominë në tranzicion, duke treguar se efektiviteti i politikës fiskale kushtëzohet jo vetëm nga

madhësia e ndërhyrjes publike, por edhe nga cilësia e institucioneve, qeverisja fiskale dhe kapacitetet administrative të shtetit.

Përtej kontributit akademik, studimi paraqet rëndësi të drejtpërdrejtë për politikëbërjen ekonomike në Shqipëri. Gjetjet tregojnë se ruajtja e hapësirës fiskale, menaxhimi i kujdesshëm i borxhit publik dhe orientimi i shpenzimeve drejt investimeve produktive përbëjnë kushte të rëndësishme për rritjen e efektivitetit të politikës fiskale. Në të njëjtën kohë, rezultatet evidencojnë se përmirësimi i kapaciteteve institucionale, forcimi i administrimit fiskal, rritja e transparencës dhe koordinimi më i mirë ndërinstitutional mund të rrisin aftësinë e shtetit për të reaguar ndaj krizave dhe për të mbështetur zhvillimin ekonomik afatgjatë.

Në këtë kuptim, studimi nuk kufizohet vetëm në vlerësimin e ndikimit të politikës fiskale mbi rritjen ekonomike, por ofron një kuadër më të gjerë interpretues mbi kushtet që e bëjnë politikën fiskale më efektive dhe më të qëndrueshme. Për rrjedhojë, ai kontribuon si në avancimin e literaturës mbi ekonominë në tranzicion, ashtu edhe në formulimin e politikave publike më të orientuara drejt stabilitetit makroekonomik, zhvillimit të qëndrueshëm dhe forcimit të kapaciteteve institucionale në Shqipëri.

1.5 Organizimi i kërkimit

Ky disertacion është strukturuar në mënyrë progresive, duke kaluar nga trajtimi teorik dhe konceptual i problematikës së studimit drejt analizës empirike, diskutimit të rezultateve dhe formulimit të përfundimeve dhe rekomandimeve. Organizimi i punimit ndjek një rrjedhë logjike që mundëson lidhjen ndërmjet bazës teorike, evidencës empirike dhe implikimeve për politikëbërjen.

Kapitulli i parë paraqet kuadrin e përgjithshëm të studimit, duke trajtuar kontekstin dhe rëndësinë e temës, problemin kërkimor, qëllimin dhe objektivat e studimit, pyetjet kërkimore, hipotezat, kontributin shkencor dhe strukturën e përgjithshme të punimit.

Kapitulli i dytë zhvillon bazën teorike dhe konceptuale të kërkimit përmes shqyrtimit kritik të literaturës mbi politikën fiskale, ciklet ekonomike, multiplikatorët fiskalë dhe rolin e institucioneve në performancën ekonomike. Në këtë kapitull identifikohen gjithashtu boshllëqet ekzistuese në literaturë dhe argumentohet pozicionimi i studimit në raport me kërkimet e mëparshme.

Kapitulli i tretë paraqet kontekstin makroekonomik dhe fiskal të Shqipërisë gjatë periudhës 2000–2024, duke analizuar zhvillimet kryesore ekonomike, sjelljen e treguesve fiskalë dhe ndikimin e krizave ekonomike mbi ekonominë shqiptare.

Kapitulli i katërt përshkruan metodologjinë e studimit, burimet e të dhënave, përzgjedhjen e variablave, ndërtimin e modeleve ekonometrike dhe procedurat e përdorura për testimin e hipotezave kërkimore.

Kapitulli i pestë përbën bërthamën empirike të kërkimit. Në këtë kapitull paraqiten rezultatet e analizave ekonometrike, vlerësohet ndikimi i instrumenteve fiskale mbi rritjen ekonomike dhe analizohet roli i kapacitetit institucional në efektivitetin e politikës fiskale përmes përdorimit të Indeksit të Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF).

Kapitulli i gjashtë fokusohet në interpretimin dhe diskutimin e rezultateve empirike në raport me literaturën teorike, karakteristikat e ekonomisë shqiptare dhe përvojën e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Në këtë kapitull vlerësohen gjithashtu hipotezat e studimit dhe implikimet kryesore për politikëbërjen.

Kapitulli i shtatë paraqet përfundimet kryesore të kërkimit, rekomandimet për politikëbërjen ekonomike, kontributin e studimit në literaturën ekzistuese, si dhe kufizimet dhe drejtimet për kërkimet e ardhshme.

Në tërësi, struktura e disertacionit synon të ofrojë një analizë të integruar të marrëdhënies ndërmjet politikës fiskale, kapacitetit institucional dhe rritjes ekonomike në Shqipëri, duke kombinuar evidencën empirike me interpretimin teorik dhe implikimet praktike për zhvillimin ekonomik afatgjatë.

KAPITULLI 2: RISHIKIMI I LITERATURES

Ky kapitull paraqet bazën teorike dhe konceptuale mbi të cilën mbështetet analiza e këtij studimi. Fillimisht shqyrtohen konceptet kryesore të politikës fiskale, instrumentet e saj dhe mekanizmat përmes të cilëve ndërhyrjet publike ndikojnë në aktivitetin ekonomik. Më tej analizohen qasjet kryesore teorike mbi rolin e politikës fiskale, marrëdhënia e saj me ciklet ekonomike dhe përdorimi i saj gjatë periudhave të krizës dhe rimëkëmbjes ekonomike. Vëmendje e veçantë i kushtohet literaturës mbi multiplikatorët fiskalë, hapësirën fiskale, borxhin publik dhe faktorët strukturorë që ndikojnë në efektivitetin e ndërhyrjeve fiskale. Në vijim, kapitulli trajton rolin e institucioneve dhe të kapacitetit shtetëror në zbatimin e politikave fiskale, duke krijuar bazën teorike për analizën e dimensionit institucional të përfshirë në këtë studim. Në tërësi, rishikimi i literaturës synon të ndërtojë një kuadër të integruar që lidh politikën fiskale, kapacitetin institucional dhe performancën ekonomike, mbi të cilin mbështeten hipotezat kërkimore dhe analiza empirike e zhvilluar në kapitujt vijues.

2.1 Kuadri teorik dhe qasjet kryesore mbi politikën fiskale

Politika fiskale përbën një nga instrumentet kryesore të politikës ekonomike, përmes së cilës qeveria ndërhyr në ekonomi me qëllim ruajtjen e stabilitetit makroekonomik, mbështetjen e rritjes ekonomike, uljen e papunësisë dhe përmirësimin e mirëqenies sociale (Musgrave, 1959; Mankiw, 2020; Stiglitz & Rosengard, 2015). Ajo ushtrohet kryesisht përmes taksave, shpenzimeve publike dhe menaxhimit të deficitit e të borxhit publik, duke ndikuar në kërkesën agregate, investimet, punësimin dhe prodhimin. Rëndësia e saj bëhet veçanërisht e dukshme gjatë periudhave të krizave ekonomike, kur sektori privat redukton konsumin dhe investimet. Sipas qasjes Keynesiane, rritja e shpenzimeve publike ose ulja e taksave mund të stimulojë kërkesën agregate dhe të përshpejtojë rimëkëmbjen ekonomike (Keynes, 1936; Auerbach & Gorodnichenko, 2012). Megjithatë, literatura bashkëkohore e konsideron politikën fiskale jo vetëm si instrument stabilizimi afatshkurtër, por edhe si faktor që ndikon në potencialin afatgjatë të ekonomisë përmes investimeve në infrastrukturë, kapital njerëzor, tranzicion të gjelbër dhe forcim institucional (IMF, 2022; OECD, 2021).

Instrumentet kryesore të politikës fiskale përfshijnë të ardhurat publike, shpenzimet publike dhe menaxhimin e borxhit publik. Taksat ndikojnë në të ardhurat e disponueshme dhe sjelljen ekonomike të individëve dhe bizneseve, ndërsa shpenzimet publike përfaqësojnë formën më të drejtpërdrejtë të ndërhyrjes së shtetit. Në afatshkurtër ato ndikojnë në kërkesën agregate, ndërsa në afatgjatë mund të rrisin produktivitetin dhe kapacitetin prodhues përmes investimeve strategjike (Barro, 1990; Blanchard, 2021). Barro (1991), në një nga studimet më klasike mbi rritjen ekonomike në një prerje ndërkombëtare,

gjeti se niveli i shpenzimeve qeveritare dhe konsumi publik kanë një efekt negativ mbi rritjen ekonomike në afatgjatë, ndërsa investimet publike produktive mund të kenë efekt pozitiv. Gjithashtu, Devarajan et al. (1996) në një nga studimet klasike mbi këtë temë tregojnë se përbërja e shpenzimeve publike ka rëndësi të madhe: shpenzimet productive (si infrastrukturë, arsim dhe shëndetësi) kanë efekt pozitiv mbi rritjen ekonomike, ndërsa shpenzimet korrente (jo-produktive) shpesh kanë efekt neutral ose negativ. Nga ana tjetër, Kneller et al. (1999) gjetën se përbërja e shpenzimeve publike ka ndikim të rëndësishëm në rritjen ekonomike. Borxhi publik shërben si burim financimi, veçanërisht gjatë krizave, por nivelet e larta të tij mund të kufizojnë hapësirën fiskale dhe të krijojnë rreziqe për qëndrueshmërinë afatgjatë të financave publike.

Hapësira fiskale dhe borxhi publik si faktorë kufizues

Një nga kufizuesit më të rëndësishëm të efektivitetit të politikës fiskale është ekzistenca e hapësirës fiskale, e cila përcakton aftësinë e qeverisë për të ndërmarrë ndërhyrje pa cenuar qëndrueshmërinë afatgjatë të financave publike (Ostry et al., 2010; IMF, 2021). Salamaliki dhe Venetis (2023) analizojnë lidhjen midis hapësirës fiskale, aksesit në tregje dhe përgjigjes ndaj krizave financiare, duke konfirmuar se vendet me hapësirë fiskale më të madhe mund të reagojnë më efektivisht ndaj goditjeve. Hapësira fiskale varet kryesisht nga niveli dhe dinamika e borxhit publik, kostot e financimit dhe besueshmëria e politikës fiskale. Reinhart dhe Rogoff (2010) argumentojnë se kur borxhi publik tejkalon pragje të caktuara (rreth 90% e PBB-së në ekonomitë e zhvilluara), rritja ekonomike tenton të ngadalësohet dhe hapësira për politika ekspansioniste zvogëlohet ndjeshëm. Në ekonomitë në zhvillim dhe tranzicion, kufizimet janë edhe më të theksuara për shkak të tregjeve financiare më të cekëta, varësisë nga financimi i jashtëm dhe kapaciteteve institucionale më të dobëta. Përvoja e krizës financiare globale, pandemisë COVID-19 dhe krizës energjetike pas vitit 2022 tregoi se vendet me hapësirë më të madhe fiskale arritën të zbatojnë ndërhyrje më të shpejta dhe më efektive, ndërsa vendet me borxh të lartë u përballën me kufizime të rënda në reagimin e tyre (IMF, 2020; OECD, 2023).

Një nga kornizat teorike më të përdorura për analizimin e rolit të politikës fiskale është ajo e Musgrave (1959), e cila identifikon tre funksione themelore të ndërhyrjes së shtetit: stabilizimin makroekonomik, alokimin e burimeve dhe shpërndarjen e të ardhurave. Këto funksione veprojnë njëkohësisht dhe ndërthuren me njëra-tjetrën, duke bërë që efektiviteti i politikës fiskale të varet nga mënyra se si ato balancohen në kontekstin e çdo ekonomie.

Efektiviteti i politikës fiskale varet nga mekanizmi i transmetimit të saj në ekonomi. Shpenzimet publike, taksat dhe borxhi publik ndikojnë fillimisht në kërkesën agregate dhe më pas në prodhim, investime dhe rritje ekonomike. Shkalla e këtij ndikimi matet përmes multiplikatorit fiskal, i cili tregon se sa ndryshon prodhimi si rezultat i një ndryshimi në instrumentet fiskale. Evidenca empirike tregon se multiplikatorët fiskalë nuk janë konstantë, por ndryshojnë sipas kushteve ekonomike dhe prirjen të jenë më të lartë gjatë

krizave ekonomike, kur ekonomia operon nën potencialin e saj prodhues (Auerbach & Gorodnichenko, 2012; Alesina & Giavazzi, 2013; Blanchard & Leigh, 2013). Woodford (2011) në analizën e tij klasike analitike të multiplikatorit të shpenzimeve qeveritare në kuadrin New Keynesian tregon se madhësia e multiplikatorit varet nga koordinimi me politikën monetare, ngurtësitë në ekonomi dhe nëse normat e interesit janë pranë kufirit zero. Për më tepër, literatura e fundit argumenton se madhësia e multiplikatorit ndikohet edhe nga cilësia e institucioneve dhe kapaciteti administrativ i shtetit për të hartuar dhe zbatuar politika efektive (Besley & Persson, 2013; Gaspar et al., 2016). Kjo perspektivë justifikon përfshirjen e dimensionit institucional në analizën e këtij studimi.

Literatura dallon politika fiskale ekspansioniste, kontraktuese dhe neutrale, si dhe politika diskrecionare dhe stabilizatorë automatikë. Aftësia e politikës fiskale për të ndikuar në ekonomi lidhet ngushtë me ekzistencën e hapësirës fiskale, e cila përcakton mundësinë e qeverisë për të ndërhyrë pa cenuar qëndrueshmërinë afatgjatë të financave publike.

Në aspektin teorik, literatura ofron disa qasje kryesore për interpretimin e rolit të politikës fiskale. Qasja Keynesiane argumenton se ndërhyrja aktive e shtetit është e nevojshme për të kompensuar mungesën e kërkesës agregate gjatë krizave (Keynes, 1936; Tcherneva, 2011; DeLong & Summers, 2012). Në të kundërt, qasja neoklasike thekson aftësinë vetërregulluese të tregjeve dhe argumenton se ndërhyrjet fiskale të financuara me borxh mund të zhvendosin investimet private përmes efektit crowding-out (Barro, 1990; Mankiw, 2020). Teoria e ekuivalencës Ricardiane shkon edhe më tej, duke argumentuar se individët mund të neutralizojnë efektet e politikës fiskale ekspansioniste përmes rritjes së kursimeve, pasi presin taksa më të larta në të ardhmen (Barro, 1974; Seater, 1993). Megjithatë, kushtet e nevojshme për funksionimin e plotë të kësaj teorie rrallë plotësohen në praktikë, veçanërisht në ekonomitë në zhvillim.

Një qasje më bashkëkohore përfaqësohet nga teoria New Keynesian, e cila kombinon elemente të teorisë Keynesiane me pritshmëritë racionale dhe analizën mikroekonomike. Kjo qasje argumenton se ngurtësitë në çmime dhe paga krijojnë hapësirë për ndërhyrje stabilizuese të politikës fiskale dhe se efektiviteti i saj varet nga kushtet makroekonomike, koordinimi me politikën monetare, niveli i hapësirës fiskale dhe cilësia e institucioneve publike (Woodford, 2003; Galí, 2015; Blanchard, 2021). Përvoja e krizës financiare globale dhe e pandemisë COVID-19 e ka forcuar më tej këtë perspektivë, duke treguar rëndësinë e kombinimit të politikave fiskale dhe monetare në stabilizimin ekonomik (Blanchard & Leigh, 2013; IMF, 2021). Snowdon dhe Vane (2005) në një vepër gjithëpërfshirëse mbi historinë e makroekonomisë moderne ofrojnë një analizë të thellë të evolucionit të qasjeve Keynesiane, neoklasike dhe New Keynesiane, duke theksuar se politika fiskale mbetet një instrument thelbësor stabilizimi, veçanërisht në kushte krizash.

Megjithëse këto qasje ndryshojnë në vlerësimin e rolit të shtetit në ekonomi, ato duhet të shihen si plotësuese dhe jo si plotësisht kundërshtuese. Qasjet Keynesiane dhe New Keynesiane ndihmojnë në shpjegimin e rolit stabilizues të politikës fiskale gjatë krizave, ndërsa perspektiva neoklasike dhe teoria Ricardiane theksojnë rëndësinë e disiplinës fiskale dhe qëndrueshmërisë së financave publike. Në këtë studim, analiza empirike mbështetet kryesisht në perspektivën New Keynesian, pasi ajo ofron një kuadër më të përshtatshëm për të analizuar efektivitetin e politikës fiskale në kushtet e krizave, kufizimeve fiskale dhe sfidave institucionale që kanë karakterizuar ekonominë shqiptare gjatë periudhës 2000–2024.

Përvoja e krizave të fundit dhe literatura bashkëkohore tregojnë se efektiviteti i politikës fiskale nuk përcaktohet vetëm nga instrumentet fiskale, por edhe nga cilësia e institucioneve që mbështesin hartimin, zbatimin dhe monitorimin e tyre. Institucione më efektive përmirësojnë alokimin e burimeve publike, reduktojnë kostot administrative dhe rrisin besueshmërinë e politikave ekonomike. Kjo perspektivë krijon bazën për përfshirjen e dimensionit institucional në analizën e këtij studimi përmes ndërtimit të Indeksit të Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF), i cili operacionalizon cilësinë institucionale në kontekstin specifik të politikës fiskale dhe shërben si një kontribut origjinal për vlerësimin e efektivitetit të politikës fiskale në Shqipëri gjatë periudhës 2000–2024.

Tabela 2.1 Krahasimi i shkollave kryesore të mendimit ekonomik mbi politikën fiskale

Shkolla teorike	Roli i politikës fiskale	Multiplikatori fiskal	Implikimet për politikën ekonomike	Autorë kryesorë
Keynesiane	Instrument aktiv stabilues	I lartë, sidomos në recesion	Mbështet politikën kundërciklike dhe stimulim fiskal në krizë	Keynes (1936); Samuelson & Nordhaus (2010)
Neoklasike	Rol i kufizuar	Relativisht i ulët	Fokus te disiplina fiskale, efikasiteti dhe kufizimi i deficitit	Barro (1990); Mankiw (2020)
Ricardiane	Neutralizohet nga sektori privat	Afër zeros	Kufizon efektin e deficitit	Barro (1974); Seater (1993)
New Keynesian	Varet nga konteksti	Variabël	Kërkon koordinim politikash	Woodford (2003); Blanchard & Leigh (2013)

Burimi: Përpunim i autores bazuar në literaturën përkatëse

2.2 Politika fiskale gjatë cikleve ekonomike dhe krizave

Ekonomitë moderne zhvillohen përmes cikleve ekonomike, të cilat reflektojnë luhatjet e aktivitetit ekonomik rreth nivelit të tij potencial. Këto cikle ndikohen nga faktorë ekonomikë, financiarë, institucionalë dhe pritshmëritë e agentëve ekonomikë (Lucas, 1977; Blanchard, 2021). Recesioni përfaqëson fazën më të ndjeshme të ciklit ekonomik,

pasi shoqërohet me rënie të prodhimit, konsumit dhe investimeve, rritje të papunësisë dhe përkeqësim të treguesve fiskalë e socialë (Blanchard, 2021; Mankiw, 2020). Megjithëse zakonisht përkufizohet si rënie e PBB-së reale për dy tremujorë radhazi, literatura bashkëkohore e konsideron recesionin si një tkurrje të konsiderueshme dhe të përhapur të aktivitetit ekonomik që prek sektorë të ndryshëm për një periudhë të caktuar kohore (NBER, 2003; Romer, 2012).

Cikli ekonomik kalon zakonisht në katër faza kryesore: zgjerimin, kulmin, recesionin dhe rimëkëmbjen. Gjatë zgjerimit rriten prodhimi, investimet dhe punësimi, ndërsa gjatë recesionit ekonomia përballlet me rënie të aktivitetit ekonomik dhe dobësim të kërkesës agregate. Rimëkëmbja shënon rikthimin gradual të ekonomisë drejt niveleve të mëparshme të aktivitetit dhe fillimin e një cikli të ri zgjerimi (Claessens & Kose, 2013; Blanchard, 2021). Intensiteti dhe kohëzgjatja e këtyre fazave varen nga natyra e goditjeve ekonomike dhe karakteristikat strukturore të secilës ekonomi, çka nënkupton se efektiviteti i politikës fiskale ndryshon sipas fazës së ciklit ekonomik.

Literatura tregon se recesionet zakonisht janë rezultat i ndërveprimit të disa faktorëve ekonomikë dhe financiarë. Dobësimi i kërkesës agregate, kufizimi i kreditimit, humbja e besimit në tregje dhe goditjet e jashtme (si kriza energjetike apo pandemia) janë ndër shkaqet kryesore (Keynes, 1936; Reinhart & Rogoff, 2009; Blanchard, 2021). Kriza financiare globale e viteve 2008–2009 lindi nga problemi në tregun e kredive hipotekore dhe u transmetua gradualisht në ekonominë reale (Mian & Sufi, 2014; Gorton, 2010). Baldwin (2009) në vëllimin e tij të njohur “The Great Trade Collapse” dokumenton se si kriza shkaktoi një rënie dramatike të tregtisë ndërkombëtare, e cila u transmetua te ekonomitë e vogla dhe të hapura si Shqipëria kryesisht përmes kanaleve reale: rënie e eksporteve, ngadalësim i investimeve të huaja dhe reduktim i remitancave. Ndërkohë, Blanchard (2009) në punimin e tij për mekanizmat bazë të krizës dhe politikat e përshtatshme thekson se goditjet financiare të mëdha kërkojnë një reagim të koordinuar fiskal dhe monetar, duke argumentuar se politika fiskale ekspansioniste luan një rol kyç në zbutjen e rënies së kërkesës agregate kur mekanizmat e transmetimit monetar dobësohen. Në të kundërt, pandemia COVID-19 ishte një goditje e jashtme shëndetësore që preku njëkohësisht ofertën dhe kërkesën, duke ndërprerë zinxhirët e furnizimit dhe kufizuar aktivitetin ekonomik (Angjeli & Civici, 2020; Gourinchas et al., 2020; OECD, 2021). Lufta në Ukrainë dhe kriza energjetike europiane pas vitit 2022 shtuan presione të reja inflacioniste dhe pasigurie ekonomike (European Commission, 2024; IMF, 2022). Parashikimi ekonomik i pranverës 2024 i Komisionit Europian konfirmon se goditjet e fundit ndërkombëtare vazhdojnë të ndikojnë në dinamikën e rritjes dhe stabilitetin fiskal të vendeve të rajonit.

Pasojat e recesioneve shtrihen përtej tkurrjes së prodhimit dhe prekin pothuajse të gjitha dimensionet e ekonomisë, duke përfshirë rritjen e papunësisë, përkeqësimin e

mirëqenies sociale dhe presion mbi financat publike (OECD, 2020; Blanchard, 2021; IMF, 2024). Në këto kushte, politika fiskale merr një rol qendror në stabilizimin e ekonomisë dhe mbështetjen e rimëkëmbjes. Përmes rritjes së shpenzimeve publike, uljes së taksave dhe mbështetjes së sektorëve strategjikë, ajo synon të kompensojë dobësimin e kërkesës private (Blanchard & Leigh, 2013; Auerbach & Gorodnichenko, 2012).

Krahasimi i reagimit fiskal gjatë krizës së 2008–2009 dhe pandemisë COVID-19 nxjerr në pah ndryshime të rëndësishme në shpejtësi, madhësi dhe targetim të ndërhyrjeve. Resosudarmo et al. (2021) analizojnë ndikimin hapësinor të stimujve fiskalë gjatë krizës globale të 2009 në Indonezi dhe tregojnë se efektet e politikës fiskale varen nga shpërndarja gjeografike dhe sektoriale, duke ilustruar se stimuluset fiskale në ekonomitë në zhvillim kanë efekte heterogjene rajonale. Gjatë krizës financiare globale, reagimi fiskal në Shqipëri (dhe në rajon) ishte relativisht më i ngadaltë dhe më i përqendruar në stabilizimin e sistemit bankar dhe nxitjen e investimeve publike. Ndërhyrjet kishin një shkallë më të ulët koordinimi dhe u fokusuan kryesisht në kanalet tradicionale të kërkesës agregate (Banka e Shqipërisë, 2010; IMF, 2009). Gupta et al. (2009) në një studim të rëndësishëm të IMF-së analizojnë efektivitetin e përgjigjes fiskale gjatë krizave sistemike bankare dhe konkludojnë se ndërhyrjet fiskale janë më efektive kur janë të shpejta, të mira të targetuara dhe të shoqëruara me masa për stabilizimin e sektorit bankar – një mësim që u reflektua edhe në përgjigjen e Shqipërisë ndaj krizës së 2008–2009. Në të kundërt, gjatë pandemisë COVID-19, masat mbështetëse u zbatuan më shpejt, ishin më të gjera në shkallë dhe më të targetuara: transfertat direkte për familjet, subvencione për ruajtjen e vendeve të punës, shtyrje të detyrimeve fiskale dhe mbështetje specifike për bizneset e prekura (OECD, 2021; World Bank, 2023; IMF, 2023). Romer (2022), në ligjëratën e saj të çmimit Distinguished Economist, nxjerr mësim kyç nga politika fiskale gjatë pandemisë, duke theksuar se ndërhyrjet e shpejta, të mëdha dhe të mirëkoordinuara ishin vendimtare për rimëkëmbjen e shpejtë ekonomike. Kjo shpejtësi dhe precizion më i lartë, i kombinuar me koordinim më të mirë me politikën monetare, kontribuoi në një rimëkëmbje relativisht më të shpejtë të aktivitetit ekonomik pas vitit 2020, pavarësisht presioneve të reja nga lufta në Ukrainë dhe kriza energjetike (European Commission, 2023; IMF, 2024).

Evidenca empirike tregon se multiplikatorët fiskalë priren të jenë më të lartë gjatë krizave të thella, kur ekonomia operon nën potencial dhe sektori privat redukton konsumin dhe investimet (Auerbach & Gorodnichenko, 2012; Blanchard & Leigh, 2013). Megjithatë, madhësia e tyre varet nga hapësira fiskale, koordinimi me politikën monetare dhe cilësia e institucioneve publike. Vendet me institucione më efektive dhe financa publike më të qëndrueshme arritën të zbatonin ndërhyrje më të shpejta dhe më efikase, duke reduktuar kostot ekonomike dhe sociale të krizës (IMF, 2021; OECD, 2023).

Studimet tregojnë se efektiviteti i politikës fiskale gjatë krizave përcaktohet nga ndërveprimi i natyrës së goditjes ekonomike, hapësirës fiskale, karakteristikave strukturore

të ekonomisë dhe kapacitetit institucional të shtetit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për ekonomitë e vogla dhe të hapura si Shqipëria, të cilat janë më të ekspozuara ndaj goditjeve të jashtme dhe përballen me kufizime më të mëdha fiskale. Për këtë arsye, analiza e efektivitetit të politikës fiskale duhet të marrë në konsideratë jo vetëm madhësinë e ndërhyrjes publike, por edhe kushtet ekonomike dhe institucionale në të cilat ajo zbatohet. Këto gjetje krijojnë bazën teorike për analizën empirike të rastit shqiptar në kapitujt vijues.

2.3 Politika Fiskale në ekonomitë në tranzicion, Ballkanin Perëndimor dhe ndërveprimi me politikën monetare

Efektiviteti i politikës fiskale në ekonomitë në tranzicion kushtëzohet jo vetëm nga instrumentet fiskale tradicionale, por edhe nga karakteristikat strukturore dhe institucionale specifike të këtyre vendeve. Boiciuc (2015) në studimin e tij mbi sjelljen ciklike të politikës fiskale në Rumani konstaton se politika fiskale ka qenë kryesisht pro-ciklike gjatë periudhave të zgjerimit dhe ka pasur vështirësi në adoptimin e një qasjeje kundërciklike të qëndrueshme, një fenomen i ngjashëm me shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor, përfshirë Shqipërinë. Nga ana tjetër, studime si ai i Dornean dhe Oanea (2015) për Rumani tregojnë se politika fiskale gjatë krizës së 2008–2009 u përball me sfida të rëndësishme të qëndrueshmërisë, duke përdorur analiza cointegration për të vlerësuar marrëdhëniet afatgjata midis deficitit dhe borxhit publik. Ndryshe nga ekonomitë e zhvilluara, vendet në tranzicion karakterizohen nga institucione fiskale ende në proces konsolidimi, baza tatimore relativisht të ngushta, nivele të larta informaliteti dhe kapacitete administrative të kufizuara. Këto faktorë ndikojnë drejtpërdrejt në aftësinë e shtetit për të përdorur politikën fiskale si instrument stabilizues gjatë krizave ekonomike (Fetai, 2017; IMF, 2021). Për më tepër, këto ekonomi janë zakonisht më të hapura ndaj tregjeve ndërkombëtare, më të varura nga remitancat dhe investimet e huaja direkte, dhe më të ekspozuara ndaj goditjeve të jashtme, duke e bërë transmetimin e politikës fiskale më kompleks dhe më pak të parashikueshëm.

Një nga sfidat kryesore të ekonomive në tranzicion lidhet me hapësirën fiskale të kufizuar. Kholjigitov (2013) thekson se disiplina fiskale luan rol vendimtar në menaxhimin e financave publike në vendet në zhvillim, duke ndihmuar në ruajtjen e qëndrueshmërisë afatgjatë dhe në rritjen e besueshmërisë së politikave. Nivelet relativisht të larta të borxhit publik, aksesit më të vështirë në financim dhe prania e një sektori informal të konsiderueshëm kufizojnë aftësinë e qeverive për të zbatuar politika fiskale ekspansioniste pa rrezikuar qëndrueshmërinë afatgjatë të financave publike. Informaliteti redukton bazën tatimore dhe dobëson mekanizmat e transmetimit të politikës fiskale, pasi një pjesë e konsiderueshme e aktivitetit ekonomik mbetet jashtë sistemit formal (OECD, 2020). Si rezultat, ndikimi i masave fiskale është shpesh më i kufizuar dhe më pak i parashikueshëm sesa në ekonomitë e zhvilluara.

Cilësia e institucioneve fiskale merr rëndësi të veçantë. Literatura e fundit argumenton se vendet që kanë ndërtuar institucione më të forta, rregulla fiskale më të qarta, transparencë më të lartë dhe kapacitete administrative më të zhvilluara janë më të afta të menaxhojnë ciklet ekonomike dhe të ruajnë stabilitetin makroekonomik. Jovanovic et al. (2024) në analizën e qeverisjes fiskale në Ballkanin Perëndimor thekson se forca e rregullave fiskale dhe këshillave të pavarura fiskale ka pasur efekte pozitive, edhe pse të kufizuara dhe sporadike, në reduktimin e deficiteve dhe ruajtjen e dinamikave të qëndrueshme të borxhit publik. Përparimi në këto reforma ka qenë i pabarabartë dhe shpesh i kushtëzuar nga faktorë politikë dhe institucionalë.

Evidenca empirike nga Ballkani Perëndimor konfirmon se efektiviteti i politikës fiskale është përgjithësisht më i kufizuar krahasuar me ekonomitë e zhvilluara. Sipas Ilzetzi, Mendoza dhe Végh (2013), multiplikatorët fiskalë priren të jenë më të vegjël në ekonomitë në zhvillim për shkak të hapësirës së kufizuar fiskale, informalitetit të lartë dhe paqëndrueshmërisë makroekonomike. Megjithatë, përvoja e vendeve të Ballkanit Perëndimor gjatë krizës financiare globale të viteve 2008–2009 dhe pandemisë COVID-19 tregon se politika fiskale ka luajtur një rol të rëndësishëm stabilizues përmes subvencioneve për pagat, transfertave sociale dhe investimeve publike. Kamberi (2025) në një analizë panel të vendeve të Ballkanit Perëndimor (WB6) konfirmon se nivelet më të larta të borxhit publik kanë efekt negativ në rritjen ekonomike, ndërsa konsolidimi i suksesshëm fiskal (reduktim i shpenzimeve relative ndaj PBB-së) korrelohet me rritje më të lartë ekonomike.

Në rastin e Shqipërisë, sfida si informaliteti i lartë, baza tatimore e ngushtë dhe kufizimet në hapësirën fiskale përbëjnë faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në rezultatet e politikës fiskale gjatë periudhave të krizës dhe rimëkëmbjes. Shqipëria përbën një rast veçanërisht interesant për analizë për disa arsye: ekonomia është shumë e hapur, me varësi të lartë nga importet, turizmi (që ka arritur kontribute të rëndësishme në PBB dhe eksporte) dhe remitancat (që vazhdojnë të përbëjnë një burim të rëndësishëm të ardhurash për familjet dhe stabilitet makroekonomik). Kjo varësi strukturore e bën ekonominë më të ekspozuar ndaj goditjeve të jashtme dhe e bën transmetimin e politikës fiskale më kompleks, pasi një pjesë e stimulit mund të “rrjedhë” jashtë ekonomisë përmes importeve. Për më tepër, niveli i lartë i informalitetit redukton bazën tatimore dhe dobëson efektivitetin e masave fiskale. Këto karakteristika e bëjnë Shqipërinë një rast ideal për të studiuar se si politika fiskale funksionon në një ekonomi të vogël, të hapur dhe në tranzicion me kufizime institucionale dhe strukturore specifike (Hoxhaj, 2025; IMF, 2025).

Përtej karakteristikave të vetë politikës fiskale, literatura bashkëkohore thekson se stabilizimi makroekonomik dhe rimëkëmbja ekonomike varen gjithashtu nga koordinimi i saj me politikën monetare. Gjatë periudhave të recesionit, bankat qendrore zakonisht zbatojnë politika monetare lehtësuese përmes uljes së normave të interesit dhe rritjes së

likuiditetit, ndërsa qeveritë ndërhyjnë përmes rritjes së shpenzimeve publike, uljes së taksave ose paketave mbështetëse për familjet dhe bizneset (Blanchard & Leigh, 2013; IMF, 2020). Kur këto dy politika veprojnë në mënyrë të koordinuar, ato përforcojnë njëra-tjetrën: politika monetare ul kostot e financimit dhe shmang efektin e “crowding-out”, ndërsa politika fiskale stimulon drejtpërdrejt kërkesën agregate dhe aktivitetin ekonomik. Eggertsson dhe Woodford (2003) theksojnë se kur normat e interesit arrijnë në kufirin zero (zero lower bound), politika monetare humbet efektivitetin konvencional, duke e bërë politikën fiskale ekspansioniste veçanërisht të rëndësishme për stabilizimin ekonomik. Ky koordinim bëhet veçanërisht i rëndësishëm në periudha krizash të thella, kur përdorimi i vetëm një instrumenti politik nuk është i mjaftueshëm për të siguruar një rimëkëmbje të qëndrueshme (Pauly, 2020; Christiano, Eichenbaum & Rebelo, 2011).

Rëndësia e koordinimit fiskal-monetar është edhe më e madhe për ekonomitë e vogla dhe në tranzicion, si Shqipëria (Pauly, 2020). Tregjet financiare më pak të zhvilluara, transmetimi më i ngadaltë i politikës monetare dhe kufizimet në hapësirën fiskale e bëjnë bashkëpunimin ndërmjet qeverisë dhe bankës qendrore një kusht të rëndësishëm për ruajtjen e stabilitetit makroekonomik. Përvoja e krizës financiare globale dhe e pandemisë COVID-19 tregoi se bashkëpunimi ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe qeverisë kontribuoi në zbutjen e goditjeve ekonomike, por njëkohësisht evidentoi nevojën për forcimin e mëtejshëm të kuadrit institucional që garanton koordinim më të qëndrueshëm dhe më efektiv të politikave makroekonomike (IMF, 2025).

Në përfundim, literatura e fundit sugjeron se efektiviteti i politikës fiskale në ekonomitë në tranzicion përcaktohet nga ndërveprimi i faktorëve fiskalë, strukturorë, institucionalë dhe monetarë. Për ekonomitë e Ballkanit Perëndimor dhe veçanërisht për Shqipërinë, kufizimet fiskale, informaliteti, cilësia e institucioneve dhe koordinimi me politikën monetare përbëjnë elemente kyçe që ndikojnë në aftësinë e shtetit për të përballuar goditjet ekonomike dhe për të mbështetur një rimëkëmbje të qëndrueshme. Kjo perspektivë teorike shërben si bazë për analizën empirike të këtij studimi dhe për vlerësimin e rolit të politikës fiskale në Shqipëri gjatë periudhës 2000–2024.

2.4 Analiza empirike e politikës fiskale dhe evidenca ndërkombëtare

Analiza empirike e politikës fiskale ka marrë rëndësi të veçantë në dekadat e fundit, falë zhvillimit të metodave ekonometrike të avancuara dhe zgjerimit të bazave të të dhënave makroekonomike. Ndërsa teoria ekonomike shpjegon mekanizmat përmes të cilëve instrumentet fiskale ndikojnë në aktivitetin ekonomik, studimet empirike synojnë të matin në mënyrë konkrete efektet e tyre mbi rritjen ekonomike, investimet, punësimin dhe stabilitetin makroekonomik (Sims, 1980; Stock & Watson, 2019). Megjithatë, vlerësimi empirik i efektivitetit të politikës fiskale mbetet metodologjikisht sfidues, pasi marrëdhënia midis shpenzimeve publike, taksave dhe performancës ekonomike ndikohet nga

endogjeniteti, reagime të ndërsjella, ndryshime strukturore dhe faktorë institucionale (Ramey, 2019; Stock & Watson, 2019).

Një sfidë kryesore është endogjeniteti i politikës fiskale: ndryshimet në shpenzimet ose taksat shpesh përfaqësojnë reagime ndaj zhvillimeve ekonomike, dhe jo domosdoshmërisht shkakun e tyre. Për të adresuar endogjenitetin e politikës fiskale, literatura ka zhvilluar qasje të ndryshme... si dhe përdorimin e variablave instrumentale (Ramey, 2011; Romer & Romer, 2010). Ramey (2011) thekson se identifikimi i goditjeve fiskale varet shumë nga koha e tyre duke ofruar një kontribut të rëndësishëm metodologjik për studimet empirike mbi efektet e shpenzimeve qeveritare. Përveç kësaj, dallimi midis masave diskrecionare dhe efekteve automatike të ciklit ekonomik mbetet i vështirë. Për të adresuar këto çështje, literatura ka zhvilluar qasje të ndryshme, si metoda narrative e Romer dhe Romer (2010), modelet VAR dhe SVAR, si dhe përdorimin e variablave instrumentale. Perotti (2002) në një nga punimet referencë për vendet OECD vlerëson efektet e politikës fiskale duke përdorur teknika identifikimi strukturor, duke kontribuar në kuptimin e madhësisë dhe shenjës së multiplikatorëve fiskalë. Gjithashtu, Romer & Romer (2010) zhvilluan një masë të re të goditjeve fiskale bazuar në narrativën historike dhe gjetën se ndryshimet në taksa kanë efekte të fuqishme makroekonomike, duke ofruar një metodologji të rëndësishme për identifikimin e shkakësisë në analizat fiskale. Në ekonominë në zhvillim dhe tranzicion, këto sfida përkeqësohen nga kufizimet e të dhënave, seritë kohore relativisht të shkurtra dhe vështirësitë në matjen e cilësisë institucionale (Gujarati & Porter, 2009; Wooldridge, 2013).

Në këtë studim, endogjeniteti trajtohet përmes një qasjeje të kombinuar. Së pari, përdoren variabla kontrolli të shumtë makroekonomikë për të reduktuar paragjykimin nga faktorë të lënë jashtë. Së dyti, përdoren terma ndërveprimi dhe analiza sipas regjimeve ekonomike për të kapur ndryshimet e efekteve në periudha të ndryshme. Së treti, metodologjia ARDL me Bounds Test dhe Error Correction Model (ECM) lejon identifikimin e marrëdhënieve afatgjata, ndërsa testet diagnostikuese (CUSUM, CUSUMSQ) dhe gabimet standarde robuste ndihmojnë në sigurimin e qëndrueshmërisë së rezultateve. Kjo qasje redukton rrezikun e interpretimeve të njëanshme dhe forcon besueshmërinë e gjetjeve.

Përballë këtyre sfidave, studimet empirike përdorin një gamë të gjerë metodash. Regresioni linear me metodën Ordinary Least Squares (OLS) mbetet një nga qasjet më të përdorura për shkak të thjeshtësisë dhe interpretueshmërisë së tij (Barro, 1991; Kneller et al., 1999; Perotti, 2002). Boiciuc (2015), duke përdorur një qasje SVAR për Rumani, vlerëson efektet e goditjeve fiskale në një ekonomi në tranzicion dhe konfirmon se ndikimi i politikës fiskale është heterogjen sipas llojit të shpenzimeve dhe taksave, duke ilustruar kufizimet empirike të analizave të tilla në vende me seri kohore relativisht të shkurtra. Megjithatë, rezultatet e tij mund të ndikohen nga endogjeniteti, autokorelacioni ose

heteroskedasticiteti, prandaj kërkohet përdorimi i testeve diagnostikuese rigoroze. Modelet VAR dhe SVAR ofrojnë një alternativë më të avancuar, duke analizuar ndërveprimet dinamike dhe reagimin e ekonomisë ndaj goditjeve fiskale (Blanchard & Perotti, 2002; Mountford & Uhlig, 2009; Ramey, 2011). Megjithatë, këto modele kërkojnë mostra më të mëdha dhe seri kohore më të gjata. Për ekonomi individuale me seri kohore relativisht të shkurtra dhe rend integrimi të përzier ($I(0)$ dhe $I(1)$), modelet Autoregressive Distributed Lag (ARDL) rekomandohen sepse mundësojnë analizimin e marrëdhënieve afatshkurtra dhe afatgjata pa kërkuar që të gjitha variablat të jenë stacionare në të njëjtin nivel (Pesaran et al., 2001; Nkoro & Uko, 2016).

Duke u bazuar në këto konsiderata, analiza empirike e këtij studimi mbështetet në kombinimin e modeleve OLS dhe ARDL. Modeli OLS përdoret për të vlerësuar ndikimin e instrumenteve kryesore fiskale mbi rritjen ekonomike dhe për të testuar hipotezat kryesore, ndërsa metodologjia ARDL përdoret për të analizuar rolin e kapacitetit institucional dhe për të identifikuar efektet afatshkurtra dhe afatgjata. Kjo zgjedhje justifikohet nga madhësia e kampionit (25 observime vjetore), karakteristikat e serive kohore (rend integrimi i përzier) dhe nevoja për të kapur ndryshimet ndërmjet regjimeve ekonomike. OLS ofron interpretueshmëri të lartë për efektet mesatare, ndërsa ARDL është më i përshtatshëm për mostra të vogla dhe lejon analizën dinamike afatgjatë, siç rekomandohet nga literatura e fundit për ekonominë në zhvillim (Nkoro & Uko, 2016; Jovanovic, 2024).

Evidenca empirike ndërkombëtare konfirmon se politika fiskale mund të luajë një rol të rëndësishëm në stabilizimin ekonomik, por efektiviteti i saj ndryshon ndjeshëm sipas karakteristikave të ekonomisë. Studime si ai i Kim et al. (2021) për Kinën tregojnë se politika fiskale ka efekt pozitiv mbi rritjen ekonomike, por ky efekt varet nga përbërja e shpenzimeve dhe konteksti institucional. Në ekonominë e zhvilluara, rritja e shpenzimeve publike ka tendencë të ndikojë pozitivisht në prodhim, ndërsa rritja e taksave ushtron efekt frenues (Blanchard & Perotti, 2002; Romer & Romer, 2010). Pas krizës financiare globale të 2008–2009, studimet treguan se multiplikatorët fiskalë janë më të lartë gjatë recesioneve sesa në periudha normale, duke sugjeruar se politika fiskale bëhet më efektive kur ekonomia operon nën potencialin e saj prodhues (Blanchard & Leigh, 2013; Auerbach & Gorodnichenko, 2012).

Megjithatë, rezultatet e ekonomive të zhvilluara nuk mund të transferohen automatikisht në ekonominë në zhvillim. Studimi i Ilzetzi, Mendoza dhe Végh (2013) tregon se multiplikatorët fiskalë në këto ekonomi janë përgjithësisht më të ulët për shkak të hapësirës fiskale të kufizuar, nivelit më të lartë të informalitetit, hapjes së ekonomisë dhe kapaciteteve institucionale më të dobëta. Në të njëjtën kohë, investimet publike në infrastrukturë dhe kapital njerëzor mund të kenë efekte pozitive afatgjata, veçanërisht kur administrohen në mënyrë efikase (Kraay, 2014; Calderón et al., 2015). Kamberi (2025) në

një analizë panel të vendeve të Ballkanit Perëndimor konfirmon se nivelet më të larta të borxhit publik kanë efekt negativ në rritjen ekonomike, ndërsa konsolidimi i suksesshëm fiskal korrelohet me rritje më të lartë.

Një dimension që ka marrë vëmendje të veçantë në literaturën bashkëkohore është roli i institucioneve në efektivitetin e politikës fiskale. Studime të fundit tregojnë se ndikimi i instrumenteve fiskale mbi rritjen ekonomike është më i fortë në vendet me institucione më efektive, transparencë më të lartë dhe administrim publik më të zhvilluar (Baldacci et al., 2011; Gerling et al., 2017; IMF, 2021). Jovanovic (2024) në analizën e qeverisjes fiskale në Ballkanin Perëndimor thekson se forca e rregullave fiskale dhe këshillave të pavarura fiskale ka pasur efekte pozitive, edhe pse të kufizuara, në reduktimin e deficiteve dhe ruajtjen e dinamikave të qëndrueshme të borxhit. Në të kundërt, dobësitë institucionale dhe informaliteti i lartë mund të reduktojnë ndjeshëm efektet e politikës fiskale, pavarësisht madhësisë së stimulit (Acemoglu & Robinson, 2012; Gerling et al., 2017). Këto gjetje mbështesin ndërtimin e një indeksi të përbërë si Indeksi i Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF), i cili operacionalizon cilësinë institucionale në kontekstin specifik të politikës fiskale dhe e bën atë një kontribut origjinal të këtij studimi, duke plotësuar boshllëqet ekzistuese në literaturën ndërkombëtare që shpesh përdorin tregues të përgjithshëm të qeverisjes pa u fokusuar specifikisht në dimensionin fiskal.

Përvoja e krizës financiare globale dhe e pandemisë COVID-19 përforcon këtë argument: vendet me hapësirë më të madhe fiskale dhe institucione më efektive arritën të zbatojnë ndërhyrje më të shpejta dhe më efikase (Auerbach & Gorodnichenko, 2012; Blanchard & Leigh, 2013; IMF, 2021). Kjo tregon se efektiviteti i politikës fiskale përcaktohet nga ndërveprimi i faktorëve fiskalë, institucionalë dhe strukturorë.

Në literaturën shqiptare, studimet empirike mbi politikën fiskale janë relativisht të kufizuara dhe fragmentare. Shumica e tyre fokusohen në analiza përshkruese ose modele të thjeshta OLS pa integruar dimensionin institucional në mënyrë sistematike, pa krahasim të detajuar të dy krizave të mëdha (2008 vs 2020) dhe pa përdorimin e metodologjive që kapin marrëdhëniet afatshkurtra dhe afatgjata njëkohësisht. Ky studim plotëson këto boshllëqe duke ndërtuar Indeksin origjinal të Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF), duke analizuar krahasimisht efektet e politikës fiskale gjatë krizës së 2008–2009 dhe pandemisë COVID-19, dhe duke përdorur metodologjinë ARDL për të vlerësuar efektet afatshkurtra dhe afatgjata në një periudhë 25-vjeçare. Kjo qasje integruese ofron një kontribut të rëndësishëm si në nivel kombëtar ashtu edhe në literaturën rajonale mbi ekonominë në tranzicion (Hoxhaj, 2025; Kamberi, 2025).

Literatura ndërkombëtare dhe boshllëqet në studimet shqiptare krijojnë bazën teorike dhe empirike për analizën e rolit të politikës fiskale dhe kapacitetit institucional në Shqipëri gjatë periudhës 2000–2024.

2.5 Politika fiskale dhe rimëkëmbja ekonomike në Shqipëri

Literatura mbi politikën fiskale në Shqipëri mbetet më e kufizuar krahasuar me evidencën ndërkombëtare, si për nga numri i studimeve ashtu edhe për nga thellësia e analizës. Një pjesë e konsiderueshme e njohurive ekzistuese mbështetet në raportet e institucioneve ndërkombëtare dhe kombëtare, ndërsa studimet akademike të fokusuara drejtpërdrejt në efektivitetin e politikës fiskale janë relativisht të pakta. Megjithatë, evidenca e deritanishme ofron një bazë të rëndësishme për të kuptuar rolin e politikës fiskale në stabilizimin dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Në përgjithësi, studimet tregojnë se ndikimi i politikës fiskale në Shqipëri nuk varet vetëm nga niveli i shpenzimeve publike apo i të ardhurave buxhetore, por edhe nga përbërja e tyre, niveli i borxhit publik, cilësia e zbatimit të politikave dhe kushtet makroekonomike në të cilat ato aplikohen. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për një ekonomi të vogël dhe të hapur si Shqipëria, e karakterizuar nga një bazë tatimore relativisht e kufizuar, nivel i lartë informaliteti dhe ndjeshmëri ndaj zhvillimeve ekonomike ndërkombëtare.

Raportet e institucioneve si Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Komisioni Evropian (2024) në kanë analizuar në mënyrë të vazhdueshme zhvillimet fiskale, borxhin publik, cilësinë e shpenzimeve dhe stabilitetin makroekonomik në Shqipëri (IMF, 2021; World Bank, 2021; World Bank, 2025; UNDP, 2024). Sipas raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë 2024, politika fiskale ka luajtur rol të rëndësishëm në rimëkëmbje, por mbeten sfida lidhur me qëndrueshmërinë afatgjatë të borxhit dhe zgjerimin e bazës tatimore. Këto analiza mbështeten zakonisht në modele makrofiskale, projeksione ekonomike dhe metoda ekonometrike, duke ofruar një panoramë të gjerë mbi sfidat fiskale dhe kufizimet strukturore të ekonomisë shqiptare. Studimet e fundit të IMF-së (2024, 2025) theksojnë se politika fiskale prudente ka kontribuar në reduktimin e borxhit publik dhe në stabilizimin makroekonomik, por në të njëjtën kohë evidentojnë nevojën për forcimin e kapaciteteve institucionale dhe përmirësimin e cilësisë së shpenzimeve publike.

Paralelisht me këtë literaturë institucionale, disa studime akademike kanë analizuar në mënyrë më të drejtpërdrejtë lidhjen ndërmjet politikës fiskale dhe rritjes ekonomike. Një nga kontributet më të hershme dhe më të rëndësishme është studimi i Mançellari (2011), i cili përdor modelin SVAR për të vlerësuar efektet dinamike të goditjeve fiskale në Shqipëri. Rezultatet e tij tregojnë se ndryshimet në politikën fiskale ndikojnë në prodhim, çmime dhe norma interesi, duke konfirmuar rolin e saj në stabilizimin makroekonomik. Në të njëjtën linjë, Shijaku dhe Gjokuta (2013) argumentojnë se ndikimi i politikës fiskale nuk përcaktohet vetëm nga madhësia e shpenzimeve publike, por edhe nga struktura e tyre. Sipas autorëve, shpenzimet me karakter produktiv kanë potencial më të lartë për të mbështetur rritjen ekonomike.

Studime më të fundit, si ato të Hoxha (2019), Demi et al. (2021), Pjetri (2023) dhe Cenaj dhe Bexheti (2025), kanë analizuar ndikimin e komponentëve të ndryshëm fiskalë, përfshirë TVSH-në, borxhin publik dhe shpenzimet qeveritare. Megjithëse përdorin metodologji dhe periudha të ndryshme analizash, këto studime arrijnë në një përfundim të përbashkët: politika fiskale ushtron ndikim mbi rritjen ekonomike në Shqipëri, por efektiviteti i saj kushtëzohet nga cilësia e politikave të ndjekura, kapacitetet institucionale dhe gjendja e përgjithshme makroekonomike. Megjithatë, një kritikë e rëndësishme ndaj kësaj literature është se faktori institucional trajtohet kryesisht në nivel interpretues dhe rrallë përfshihet si variabël i matshëm në modelet empirike. Shumica e studimeve nuk operacionalizojnë cilësinë e institucioneve (si efektiviteti i administratës, transparenca apo sundimi i ligjit) në mënyrë sasiore, gjë që kufizon aftësinë për të testuar drejtpërdrejt ndikimin e tyre në efektivitetin e politikës fiskale (Shijaku & Gjokuta, 2013; IMF, 2021; World Bank, 2025).

Nga pikëpamja metodologjike, literatura shqiptare dominohet nga analiza deskriptive, regresione lineare dhe modele OLS me seri kohore vjetore. Këto qasje janë relativisht të thjeshta për t'u zbatuar dhe interpretuar, veçanërisht në kushtet e serive të kufizuara të të dhënave. Megjithatë, ato kanë vështirësi në kapjen e marrëdhënieve dinamike dhe të ndryshmeve që ndodhin ndërmjet fazave të ndryshme të ciklit ekonomik. Përdorimi i modeleve më të avancuara, si SVAR në studimin e Mançellari (2011), mbetet ende i kufizuar. Në të njëjtën kohë, shumë analiza empirike përballen me sfida metodologjike të njohura, si endogjeniteti, autokorelacioni, thyerjet strukturore dhe specifikimi i modelit (Wooldridge, 2013; Gujarati & Porter, 2009).

Analiza e literaturës evidenton disa boshllëqe të rëndësishme kërkimore. Së pari, shumica e studimeve fokusohen vetëm në një komponent të politikës fiskale (shpenzimet publike, taksat ose borxhi publik) pa analizuar ndërveprimin e tyre të përbashkët me faktorë makroekonomikë dhe institucionalë. Së dyti, shumë kërkime nuk bëjnë dallim të qartë ndërmjet periudhave të zgjerimit ekonomik, ngadalësimit dhe krizës, edhe pse literatura ndërkombëtare tregon se efektet e politikës fiskale ndryshojnë ndjeshëm sipas fazës së ciklit ekonomik. Së treti, mungon një analizë krahasuese e detajuar ndërmjet krizës financiare globale të viteve 2008–2009 dhe krizës së shkaktuar nga pandemia COVID-19, dy episode me natyrë, origjinë dhe mekanizma transmetimi të ndryshëm. Së katërti, dimensionimi institucional mbetet ndër aspektet më pak të trajtuara në mënyrë sasiore, pavarësisht rolit të rëndësishëm që luajnë cilësia e qeverisjes, administrimi fiskal dhe kapacitetet institucionale në efektivitetin e politikave publike (Acemoglu & Robinson, 2012; Gerling et al., 2017; World Bank, 2021; IMF, 2021; Jovanovic, 2024; Kamberi, 2025).

Nisur nga këto kufizime, ky studim synon të ofrojë një analizë më të plotë të rolit të politikës fiskale në Shqipëri gjatë periudhës 2000–2024. Qasja e ndjekur kombinon

instrumentet tradicionale fiskale me faktorët makroekonomikë dhe institucionalë, duke analizuar njëkohësisht periudhat normale të zhvillimit ekonomik dhe periudhat e krizave. Për këtë qëllim, krahas modeleve OLS përdoret edhe metodologjia ARDL, e cila mundëson vlerësimin e marrëdhënieve afatshkurtra dhe afatgjata ndërmjet politikës fiskale, kapacitetit institucional dhe rritjes ekonomike. Për më tepër, studimi ndërtuar Indeksin origjinal të Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF), duke mundësuar përfshirjen e dimensionit institucional si variabël të matshëm. Në këtë mënyrë, studimi synon të kontribuojë në plotësimin e boshllëqeve ekzistuese në literaturën shqiptare, duke ofruar një analizë krahasuese 2008 vs 2020, një model të integruar që përfshin instrumente fiskale, kontrollues makro, variabla institucionalë, dhe një vlerësim më të plotë të faktorëve që ndikojnë në efektivitetin e politikës fiskale dhe në procesin e rimëkëmbjes ekonomike (Hoxhaj, 2025; Kamberi, 2025).

2.6 Sintetizimi teoriko-empirik I literaturës

Analiza e literaturës teorike dhe empirike tregon se ekziston një konsensus i gjerë mbi rolin e politikës fiskale si një instrument i rëndësishëm për stabilizimin makroekonomik dhe mbështetjen e rritjes ekonomike, veçanërisht gjatë periudhave të krizës. Studimet teorike dhe empirike sugjerojnë se ndikimi i politikës fiskale nuk varet vetëm nga madhësia e ndërhyrjeve publike, por edhe nga përbërja e instrumenteve fiskale, kushtet makroekonomike, hapësira fiskale dhe karakteristikat strukturore të ekonomisë. Gjithashtu, literatura evidencon se efektet e politikës fiskale priren të jenë më të forta gjatë periudhave të recesionit sesa në fazat e zgjerimit ekonomik (Auerbach & Gorodnichenko, 2012; Blanchard & Leigh, 2013).

Një tjetër përfundim i rëndësishëm i literaturës lidhet me rolin e institucioneve. Studime të ndryshme argumentojnë se cilësia e qeverisjes, kapacitetet administrative dhe efektiviteti institucional ndikojnë në mënyrën se si hartohen dhe zbatohen politikat fiskale, duke kushtëzuar edhe rezultatet e tyre ekonomike (Acemoglu & Robinson, 2012; Gerling et al., 2017; IMF, 2021). Këto gjetje theksojnë se institucione më të forta mund të rrisin efikasitetin e alokimit të burimeve publike, të reduktojnë kostot administrative dhe të rrisin besueshmërinë e politikave ekonomike.

Megjithatë, literatura paraqet disa boshllëqe të rëndësishme që mbeten ende të paadresuara plotësisht. Evidenca për ekonominë në zhvillim dhe në tranzicion është më e kufizuar krahasuar me atë të ekonomive të avancuara. Shumica e studimeve fokusohen vetëm në një komponent të politikës fiskale (shpenzimet publike, taksat ose borxhin publik) pa analizuar ndërveprimin e tyre të përbashkët me faktorë makroekonomikë dhe institucionalë. Po ashtu, studimet ekzistuese rrallë krahasojnë efektivitetin e politikës fiskale në periudha krizash me natyrë të ndryshme, si kriza financiare globale e viteve 2008–2009 dhe pandemia COVID-19. Një boshllëk tjetër i rëndësishëm është trajtimi i kufizuar i dimensionit institucional, i cili zakonisht mbetet në nivel interpretues dhe rrallë

përfshihet si variabël i matshëm në modelet empirike. Këto kufizime reduktojnë aftësinë për të kuptuar plotësisht mekanizmat e transmetimit të politikës fiskale në kontekste specifike si ai shqiptar.

Nisur nga këto boshllëqe, ky studim synon të ofrojë një analizë më të integruar të politikës fiskale në Shqipëri gjatë periudhës 2000–2024. Studimi kombinon analizën e instrumenteve tradicionale fiskale me faktorët makroekonomikë dhe institucionalë, vlerëson ndryshimet në efektivitetin e politikës fiskale përgjatë fazave të ndryshme të ciklit ekonomik (duke përfshirë një krahasim të detajuar 2008 vs 2020) dhe teston drejtpërdrejt rolin e kapacitetit institucional në mbështetjen e rritjes ekonomike përmes ndërtimit të Indeksit të Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF). Për këtë qëllim, krahas modeleve OLS përdoret edhe metodologjia ARDL, e cila mundëson vlerësimin e marrëdhënieve afatshkurtra dhe afatgjata ndërmjet politikës fiskale, kapacitetit institucional dhe rritjes ekonomike. Në këtë mënyrë, studimi synon të kontribuojë në zgjerimin e evidencës empirike për Shqipërinë dhe në plotësimin e disa prej boshllëqeve të identifikuara në literaturën ekzistuese.


2.7 Korniza konceptuale e studimit dhe pozicionimi i tij në literaturë

Rishikimi i literaturës teorike dhe empirike tregon se politika fiskale mbetet një nga instrumentet më të rëndësishme për stabilizimin makroekonomik dhe mbështetjen e rritjes ekonomike, veçanërisht gjatë periudhave të krizës. Megjithatë, efektiviteti i saj nuk përcaktohet vetëm nga madhësia e ndërhyrjeve publike, por edhe nga karakteristikat strukturore të ekonomisë, niveli i hapësirës fiskale, faza e ciklit ekonomik dhe cilësia e institucioneve që hartojnë dhe zbatojnë politikat publike. Studimi ndërton një kornizë konceptuale të integruar, e cila lidh instrumentet e politikës fiskale me faktorët makroekonomikë, strukturorë dhe institucionalë që ndikojnë në performancën ekonomike të Shqipërisë gjatë periudhës 2000–2024.

Korniza konceptuale e studimit paraqitet në Figurën 2.3 dhe përbën bazën analitike mbi të cilën mbështetet analiza empirike. Siç shihet në figurë, në qendër të saj vendoset rritja ekonomike (GDP Growth), e cila trajtohet si rezultati përfundimtar i ndërveprimit kompleks ndërmjet politikës fiskale, kushteve makroekonomike, karakteristikave strukturore të ekonomisë dhe kapacitetit institucional. Figura ilustron një qasje sistematike: instrumentet fiskale (në anën e majtë) ndikojnë direkt në rritjen ekonomike, por ky ndikim ndërmjetësohet nga variablat kontrolluese makroekonomikë, karakteristikat strukturore (hapja ekonomike, informaliteti, varësia nga turizmi dhe remitancat) dhe dimensionin institucional (IKIPF). Njëkohësisht, korniza merr në konsideratë dimensionin ciklik të

ekonomisë duke dalluar tre regjime ekonomike, duke lejuar kështu vlerësimin e heterogjenitetit të efekteve të politikës fiskale sipas kushteve makroekonomike.

Figura 2.1 Kuadri konceptual i studimit



Burimi: Përpunim i autores bazuar në specifikimin e modelit empirik të studimit.

Siç paraqitet në figurë, instrumentet kryesore të politikës fiskale përfshijnë shpenzimet publike (GOV_EXP), investimet publike (PUB_INV), të ardhurat tatimore (TAX_REV) dhe borxhin publik (PUBLIC_DEBT). Këta tregues përfaqësojnë kanalet kryesore përmes të cilave shteti ndikon në aktivitetin ekonomik, duke ndikuar në kërkesën agregate, investimet, punësimin, konsumin privat dhe produktivitetin e ekonomisë. Në këtë mënyrë, politika fiskale ndikon jo vetëm në ritmin e rritjes ekonomike në afatshkurtër, por edhe në potencialin zhvillimor të ekonomisë në afat më të gjatë.

Për të izoluar më qartë efektin e politikës fiskale mbi rritjen ekonomike, modeli përfshin edhe një grup variablash kontrolli makroekonomikë, si inflacioni, papunësia, eksportet dhe remitancat. Këta faktorë pasqyrojnë elemente të rëndësishme të mjedisit ekonomik që mund të ndikojnë në performancën e ekonomisë shqiptare dhe, rrjedhimisht, në rezultatet e politikës fiskale.

Një vend të rëndësishëm në kuadrin konceptual zënë edhe karakteristikat strukturore të ekonomisë shqiptare. Madhësia relativisht e vogël e tregut, hapja e lartë ndaj ekonomisë ndërkombëtare, varësia nga faktorët e jashtëm, zhvillimi ende i kufizuar i tregjeve financiare dhe niveli i informalitetit ndikojnë drejtpërdrejt në mënyrën se si transmetohen efektet e politikës fiskale në ekonomi. Kjo justikon arsyen se pse analiza e efektivitetit fiskal nuk mund të shkëputet nga konteksti specifik ekonomik në të cilin zbatohen politikat publike.

Korniza konceptuale merr gjithashtu në konsideratë dimensionin ciklik të ekonomisë përmes ndarjes së periudhës së studimit në tre regjime ekonomike: 2000–2008 (zgjerim), 2009–2019 (konsolidim fiskal) dhe 2020–2024 (pandemi dhe rimëkëmbje). Këto periudha përfaqësojnë faza të ndryshme të zhvillimit ekonomik dhe institucional të Shqipërisë dhe mundësojnë analizimin e ndryshimeve në efektivitetin e politikës fiskale sipas kushteve makroekonomike dhe natyrës së goditjeve ekonomike.

Një element qendror i këtij studimi është përfshirja e dimensionit institucional përmes Indeksit të Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF), i ndërtuar mbi katër tregues të qeverisjes: efektivitetin e qeverisë (Government Effectiveness), cilësinë rregullatore (Regulatory Quality), shtetin e së drejtës (Rule of Law) dhe kontrollin e korrupsionit (Control of Corruption). Si rrjedhojë, kapaciteti institucional trajtohet si një faktor që ndikon në efektivitetin e politikës fiskale përmes përmirësimit të procesit të hartimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave publike. Supozimi teorik është se institucione më efektive dhe më të besueshme rrisin aftësinë e shtetit për të përdorur në mënyrë më efikase instrumentet fiskale dhe për të përforcuar ndikimin e tyre në rritjen ekonomike.

Në të njëjtën kohë, modeli konceptual merr në konsideratë edhe rolin e hapësirës fiskale, e cila lidhet ngushtë me nivelin e borxhit publik dhe me aftësinë e qeverisë për të ndërhyrë në ekonomi pa cenuar qëndrueshmërinë afatgjatë të financave publike. Në këtë kuptim, borxhi publik nuk trajtohet vetëm si një instrument financimi, por edhe si një faktor që mund të kufizojë ose të zgjerojë mundësitë e ndërhyrjes fiskale, veçanërisht gjatë periudhave të krizës.

Kjo qasje e integruar e pozicionon studimin në një vend të veçantë brenda literaturës ekzistuese. Ndërsa shumica e studimeve mbi Shqipërinë fokusohen në

instrumente të veçanta fiskale ose në periudha të kufizuara kohore, ky punim analizon në mënyrë të njëkohshme ndikimin e instrumenteve fiskale, faktorëve makroekonomikë, karakteristikave strukturore dhe kapacitetit institucional përgjatë periudhës 2000–2024. Gjithashtu, studimi zgjeron literaturën ekzistuese duke krahasuar efektivitetin e politikës fiskale gjatë dy krizave me natyrë të ndryshme, krizës financiare globale të viteve 2008–2009 dhe pandemisë COVID-19, si dhe duke testuar drejtpërdrejt rolin e kapacitetit institucional në forcimin ose kufizimin e efektivitetit fiskal.

Korniza konceptuale e ndërtuar në këtë studim shërben si bazë për formulimin dhe testimin e gjashtë hipotezave kërkimore që orientojnë analizën empirike. Tre hipotezat e para trajtojnë ndikimin e instrumenteve kryesore të politikës fiskale – shpenzimeve publike, të ardhurave tatimore dhe borxhit publik – mbi rritjen ekonomike, duke marrë parasysh edhe ndryshimet që mund të shfaqen në periudha dhe regjime të ndryshme ekonomike. Dy hipotezat pasuese fokusohen në rolin e faktorëve makroekonomikë dhe karakteristikave strukturore të ekonomisë si elementë që mund të forcojnë ose të kufizojnë efektivitetin e ndërhyrjeve fiskale. Hipoteza e gjashtë, e cila përbën edhe një nga kontributet kryesore origjinale të këtij kërkimi, analizon ndikimin e kapacitetit institucional, të matur përmes Indeksit të Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF), në rritjen e efektivitetit të politikës fiskale dhe në përmirësimin e rezultateve ekonomike. Në këtë mënyrë, korniza konceptuale tejkalon funksionin e një paraqitjeje teorike dhe shndërrohet në një strukturë analitike që lidh argumentet e literaturës me objektivat e studimit, hipotezat kërkimore dhe metodologjinë empirike të përdorur. Përmes kësaj qasjeje, studimi synon të ofrojë një kuptim më të plotë të mekanizmave përmes të cilëve politika fiskale ndikon në performancën ekonomike, si dhe të identifikojë faktorët që kushtëzojnë efektivitetin e saj në kontekstin e një ekonomie të vogël, të hapur dhe në tranzicion si Shqipëria.

2.8 Përfundime të kapitullit

Ky kapitull ndërtoi bazën teorike dhe konceptuale të studimit duke analizuar rolin e politikës fiskale në stabilizimin ekonomik dhe në rimëkëmbjen pas krizave. Rishikimi i literaturës teorike dhe empirike tregoi se politika fiskale mbetet një instrument kryesor i ndërhyrjes shtetërore, që ndikon si në kërkesën agregate në afatshkurtër, ashtu edhe në rritjen ekonomike afatgjatë. Megjithatë, efektiviteti i saj nuk varet vetëm nga madhësia e ndërhyrjeve, por nga ndërveprimi i instrumenteve fiskale me kushtet makroekonomike, hapësirën fiskale, karakteristikat strukturore të ekonomisë dhe cilësinë institucionale. Kontributi kryesor teorik i këtij studimi qëndron në integrimin e dimensionit institucional (përmes IKIPF) si faktor moderues, duke plotësuar boshllëqet e literaturës shqiptare që trajtonin këtë aspekt kryesisht në mënyrë përshkrimore.

Krahasimi i teorive kryesore ekonomike dhe i studimeve empirike tregon se efektiviteti i politikës fiskale ndryshon sipas kushteve ekonomike, duke qenë më i lartë gjatë periudhave të krizës. Për vende në tranzicion si Shqipëria, faktorë si informaliteti, hapja e ekonomisë dhe kufizimet institucionale e ulin efektivitetin e politikës fiskale në periudha normale, por e bëjnë edhe më të rëndësishëm koordinimin e politikave dhe forcimin e kapaciteteve institucionale gjatë krizave. Gjithashtu, krahasimi midis krizës financiare globale (2008–2009) dhe pandemisë COVID-19 tregon se ndërhyrjet e shpejta, të mirëorientuara dhe të koordinuara japin rezultate më të mira në stabilizimin dhe rimëkëmbjen e ekonomisë.

Kuadri teorik i zhvilluar në këtë kapitull ofron bazën konceptuale mbi të cilën mbështetet e gjithë analiza e studimit. Ai krijon lidhjen ndërmjet argumenteve teorike dhe evidencës empirike, duke orientuar analizën e zhvillimeve makroekonomike dhe fiskale të Shqipërisë gjatë periudhës 2000–2024. Në këtë kuadër, kapitulli vijues shqyrton evolucionin e treguesve kryesorë ekonomikë dhe fiskalë, identifikon periudhat kryesore të transformimit ekonomik dhe përcakton kontekstin në të cilin janë hartuar dhe zbatuar politikat fiskale. Njëkohësisht, ky kuadër shërben si pikë referimi për ndërtimin e metodologjisë empirike të studimit, duke mundësuar kalimin nga analiza teorike në testimin e marrëdhënieve ekonomike. Nëpërmjet integritit të modeleve ekonometrike, analizës së regjimeve ekonomike dhe dimensionit institucional të përfaqësuar nga Indeksi i Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF), krijohen kushtet për vlerësimin sistematik të hipotezave kërkimore dhe për analizimin e faktorëve që ndikojnë në efektivitetin e politikës fiskale në Shqipëri.

Në përfundim, ky kapitull jo vetëm sintetizon literaturën ekzistuese, por edhe pozicionon studimin si një kontribut origjinal që integron dimensionin institucional në analizën e efektivitetit fiskal në një ekonomi të vogël dhe në tranzicion si Shqipëria.

KAPITULLI 3: KONTEKSTI MAKROEKONOMIK

Ky kapitull analizon zhvillimet kryesore makroekonomike dhe fiskale të Shqipërisë gjatë periudhës 2000–2024. Qëllimi është të identifikojë fazat kryesore të ciklit ekonomik, ndryshimet strukturore dhe faktorët që kanë ndikuar në efektivitetin e politikës fiskale gjatë kësaj periudhe. Gjatë këtyre 25 viteve, ekonomia shqiptare ka kaluar nëpër periudha të ndryshme: rritje të shpejtë para krizës globale (2000–2008), ngadalësim dhe konsolidim fiskal pas krizës (2009–2019), si dhe goditje të njëpasnjëshme nga tërmeti i 2019, pandemia COVID-19, kriza energjetike dhe pasojat e luftës në Ukrainë. Analiza e këtyre zhvillimeve ndihmon për të kuptuar kontekstin në të cilin është zbatuar politika fiskale dhe për të shpjeguar ndryshimet në performancën e saj. Ky kapitull krijon bazën empirike të nevojshme për testimin e hipotezave të paraqitura në kapitullin e mëparshëm dhe për ndërtimin e strategjisë ekonometrike të studimit. Rezultatet e analizës së zhvillimeve historike do të shërbejnë si referencë për interpretimin e gjetjeve empirike në kapitujt vijues.

3.1 Konteksti makroekonomik dhe evolucioni i politikës fiskale (2000–2024)


Analiza e rolit dhe efektivitetit të politikës fiskale kërkon një kuptim të thellë të kontekstit makroekonomik në të cilin ajo është ushtruar. Gjatë periudhës 2000–2024, ekonomia shqiptare ka kaluar nëpër disa faza të dallueshme zhvillimi, të cilat pasqyrojnë një trajektore të karakterizuar nga periudha rritjeje intensive, reforma strukturore, goditje të jashtme të përsëritura dhe përpjekje sistematike për integrim në ekonominë europiane. Këto dinamika kanë formësuar jo vetëm evoluimin e treguesve makroekonomikë kryesorë, por edhe natyrën, intensitetin dhe efektivitetin e ndërhyrjeve fiskale në ciklin ekonomik.

Si një ekonomi e vogël, e hapur dhe në tranzicion, Shqipëria shfaq një shkallë të lartë integrimi në tregjet ndërkombëtare, duke e bërë atë veçanërisht të ndjeshme ndaj goditjeve të jashtme. Në vitin 2024, Prodhimi i Brendshëm Bruto nominal vlerësohej në rreth 25–26 miliardë USD, me një popullsi prej rreth 2.4 milionë banorësh (World Bank, 2024; INSTAT, 2024). Struktura ekonomike dominohet nga sektori i shërbimeve, ku turizmi është afirmuar si një nga shtyllat kryesore të rritjes, sidomos pas vitit 2015 (Banka e Shqipërisë, 2024; World Tourism Organization, 2024). Remitancat kanë ruajtur një rol stabilizues të rëndësishëm, duke mbështetur konsumimin privat dhe bilancin e jashtëm gjatë gjithë periudhës, pavarësisht rënies graduale të peshës së tyre në PBB (World Bank, 2024; Banka e Shqipërisë, 2024).

Megjithatë, ekonomia shqiptare mbetet e karakterizuar nga sfida strukturore thelbësore: niveli i lartë i informalitetit, baza e kufizuar prodhuese, zhvillimi ende modest i tregjeve financiare dhe varësia e theksuar nga importet. Sistemi financiar mbetet i dominuar nga sektori bankar, ndërsa niveli i kreditimit për ekonominë reale është relativisht i ulët krahasuar me vendet fqinje të rajonit (European Bank for Reconstruction

and Development, 2023). Për më tepër, varësia e lartë nga burimet hidroenergjetike e ekspozon vendin ndaj goditjeve energjetike dhe ndryshimeve klimatike (International Energy Agency, 2022). Figura 3.1 ilustron qartë dinamikën e rritjes reale të PBB-së gjatë periudhës. Mesatarja afatgjatë prej rreth 4.1% në vit fsheh kontraste të theksuara: ritme të larta rritjeje gjatë 2000–2008, ngadalësim të ndjeshëm pas krizës globale të 2008–2009, tkurrje të fortë në 2020 si pasojë e pandemisë COVID-19, dhe një fazë rimëkëmbjeje relativisht të shpejtë në vitet pasuese (IMF, 2024; INSTAT, 2024).


Figura 3.1 Rritja reale e PBB-së në Shqipëri (2000–2024, %)



Burimi: Përpunim i autorit bazuar në të dhënat nga INSTAT (Llogaritë Kombëtare) dhe World Bank (World Development Indicators, 2025).

Inflacioni ka mbetur kryesisht i kontrolluar, por me episode të dukshme presionesh, sidomos në 2008 dhe 2022, të shkaktuara nga çmimet ndërkombëtare të energjisë dhe ushqimeve. Lufta në Ukrainë dhe kriza energjetike europiane theksuan vulnerabilitetin e ekonomisë ndaj goditjeve të importuara (European Commission, 2023; IMF, 2024). Tregu i punës ka shfaqur një tendencë përmirësimi gradual, me normën e papunësisë që arriti rreth 10.7% në 2024 (INSTAT, 2024), siç paraqitet në Figurën 3.2.


Figura 3.2 Inflacioni dhe papunësia në Shqipëri (2000–2024, %)



Burimi: Përpunim i autorit bazuar në të dhënat e Bankës së Shqipërisë, INSTAT dhe IMF (2025).


Deficiti i vazhdueshëm i llogarisë korrente, i ilustruar në Figurën 3.3, pasqyron varësinë strukturore nga importet dhe kapacitetet e kufizuara prodhuese. Remitancat (shih Figurën 3.4) kanë luajtur një rol stabilizues të rëndësishëm në zbutjen e këtij deficiti (World Bank, 2024; Banka e Shqipërisë, 2024).

Figura 3.3 Bilanci i llogarisë korrente në Shqipëri (2000–2024, % e PBB-së)



Burimi: Përpunim i autorit bazuar në të dhënat e World Bank (World Development Indicators, 2025).

Figura 3.4 Remitancat në Shqipëri (2000–2024, % e PBB-së)




Burimi: Përpunim i autorit bazuar në të dhënat e World Bank (World Development Indicators, 2025), dhe Banka e Shqipërisë (2024).

Në këtë mjedis makroekonomik kompleks, politika fiskale ka ushtruar një funksion stabilizues thelbësor, veçanërisht gjatë episodeve të krizave (IMF, 2024). Kuadri fiskal ka pësuar një transformim gradual në drejtim të përmirësimit të administrimit dhe afrimit me standardet europiane. Orientimi i politikës ka qenë kundërciklik gjatë periudhave të krizës dhe më konsolidues gjatë fazave të stabilizimit. Struktura e financave publike mbetet e kufizuar, me peshë të lartë të shpenzimeve korrente dhe varësi nga taksat indirekte.

Borxhi publik, i paraqitur në Figurën 3.5, përbën një tregues kyç të qëndrueshmërisë fiskale, duke reflektuar ndikimin kumulativ të goditjeve ekonomike dhe përgjigjeve politike (Jeong, 2014; IMF, 2025).

Figura 3.5 Borxhi publik në Shqipëri (2000–2024, % e PBB-së)



Burimi: Përpunim i autorit bazuar në të dhënat nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, INSTAT dhe International Monetary Fund (2025).

Reformat e vazhdueshme në fushën e administrimit fiskal, digjitalizimit dhe forcimit institucional (OECD, 2022; World Bank, 2022) kanë synuar zgjerimin e bazës tatimore dhe rritjen e efikasitetit, siç synon edhe Strategjia Afatmesme e të Ardhurave 2024–2027 (Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2024). Megjithatë, efektiviteti i tyre mbetet i kushtëzuar nga informaliteti dhe kapacitetet administrative.

Periudha 2000–2024 pasqyron një ekonomi në zhvillim me potencial rritjeje, por të ekspozuar ndaj goditjeve të jashtme dhe kufizimeve strukturore të thella. Politika fiskale ka luajtur një rol vendimtar në menaxhimin e krizave dhe mbështetjen e rimëkëmbjes, por performanca e saj ka qenë e lidhur ngushtë me nivelin e borxhit publik, strukturën e financave publike dhe cilësinë e kuadrit institucional. Siç thekson edhe Shaw (2016), lidhja midis politikës fiskale dhe rritjes ekonomike varet nga konteksti institucional dhe strukturor i çdo ekonomie. Ky kontekst historik dhe analitik shërben si bazë thelbësore për vlerësimin empirik rigoroz të efektivitetit të politikës fiskale që zhvillohet në kapitujt vijues.

3.2 Ciklet ekonomike dhe reagimi i politikës fiskale në Shqipëri (2000–2024)

Analiza e cikleve ekonomike gjatë periudhës 2000–2024 ofron një kuptim të thellë mbi dinamikën e ekonomisë shqiptare dhe rolin adaptiv të politikës fiskale ndaj goditjeve, fazave të ciklit dhe kufizimeve strukturore. Në vend që të ndjekë një trajektore lineare rritjeje, ekonomia shqiptare ka kaluar nëpër regjime të dallueshme makroekonomike, ku politika fiskale ka luajtur role të ndryshme – nga pro-ciklike në kundërciklike – në varësi

të kushteve ekonomike. Ky model sjelljeje përputhet me literaturën bashkëkohore, e cila thekson se efektiviteti i politikës fiskale rritet ndjeshëm gjatë periudhave të krizës, kur ekonomia operon nën potencialin prodhues (Auerbach & Gorodnichenko, 2013; Blanchard & Leigh, 2013).

Periudha 2000–2008 përfaqëson një fazë zgjerimi të shpejtë ekonomik, të mbështetur nga rritja e konsumit privat, flukset e remitançave, zgjerimi i kreditimit dhe hyrja e investimeve të huaja direkte në një mjedis të favorshëm ndërkombëtar (Banka e Shqipërisë, 2009; World Bank, 2023). Treguesit fiskalë u përmirësuan dhe borxhi publik ndaj PBB-së ra gradualisht. Megjithatë, kjo periudhë nuk u shfrytëzua në masë të mjaftueshme për krijimin e rezervave fiskale, duke lënë ekonominë të ekspozuar ndaj goditjeve të mëvonshme.

Kriza financiare globale e 2008–2009 shënoi ndërprerjen e parë të rëndësishme të ciklit pozitiv. Efektet në Shqipëri u transmetuan kryesisht përmes kanaleve reale (rënie e remitançave, ngadalësim i investimeve të huaja dhe dobësim i kërkesës së jashtme) sesa përmes sistemit bankar (Banka e Shqipërisë, 2010). Politika fiskale reagoi duke marrë një orientim stimulues, me rritje të shpenzimeve publike dhe zgjerim të deficitit buxhetor, me qëllim zbutjen e recesionit dhe mbështetjen e kërkesës agregate (Hemming et al., 2002). Ky reagim, megjithatë, çoi në rritje të borxhit publik dhe tensionim të treguesve fiskalë, duke nxjerrë në pah tensionin klasik midis mbështetjes afatshkurtër dhe qëndrueshmërisë afatmesme (Banka e Shqipërisë, 2010; KLSH, 2012).

Periudha 2010–2019 u karakterizua nga një stabilizim gradual i ekonomisë dhe një orientim konsolidues i politikës fiskale. Rritja ekonomike u rikthye, por me ritme më të moderuara. Prioritet u dha reduktimit të deficitit, kontrollit të borxhit publik dhe forcimit të administrimit fiskal. Masat për formalizimin e ekonomisë kontribuan në rritjen e të ardhurave publike, por konsolidimi fiskal kufizoi hapësirën për politika stimuluese më agresive (IMF, 2019; Banka e Shqipërisë, 2019).

Faza më e re dhe më dramatike filloi me pandeminë COVID-19 (2020–2024). Ndryshe nga kriza e 2008–2009, pandemia goditi njëkohësisht ofertën dhe kërkesën, duke prekur rëndë sektorët e shërbimeve dhe turizmit (INSTAT, 2021; Banka e Shqipërisë, 2022). Politika fiskale mori një rol qartësisht kundërciklik, me masa mbështetëse më të shpejta, më të koordinuara dhe më të fokusuara se në krizën e mëparshme. Këto ndërhyrje kontribuan në një rimëkëmbje relativisht të shpejtë, të nxitur nga rikthimi i turizmit, remitançave dhe konsumit privat (World Bank, 2023; IMF, 2023). Megjithatë, rimëkëmbja u ndikua nga goditje të reja ndërkombëtare, lufta në Ukrainë dhe kriza energjetike, të cilat krijuan presione inflacioniste dhe kufizuan hapësirën fiskale në kushte tashmë të larta borxhi (European Commission, 2023; IMF, 2022).

Figura 3.6 Rritja reale vjetore e PBB-së në Shqipëri (2000–2024) dhe fazat kryesore të ciklit ekonomik



Burimi: INSTAT (2024), World Bank – World Development Indicators (2024) dhe përpunim i autorit.

Përmbledhja sintetike e regjimeve makroekonomike dhe orientimit të politikës fiskale paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 3.1 Regjimet makroekonomike dhe orientimi i politikës fiskale në Shqipëri (2000–2024)

Periudha	Regjimi ekonomik	Politika fiskale	Rezultati kryesor
2000–2008	Zgjerim ekonomik	Kryesisht pro-ciklike	Rritje e lartë ekonomike
2009	Krizë financiare globale	Stimuluese	Zbutje e recesionit
2010–2019	Stabilizim dhe konsolidim	Konsolidim fiskal	Stabilizim i financave publike dhe kontroll më i mirë i borxhit
2020–2024	Pandemi dhe rimëkëmbje	Kundërciklike	Rimëkëmbje relativisht e shpejtë ekonomike

Burimi: Përpunim i autores bazuar në analizën e zhvillimeve makroekonomike dhe fiskale të Shqipërisë gjatë periudhës 2000–2024.

Analiza e cikleve ekonomike tregon se politika fiskale në Shqipëri ka demonstruar një kapacitet adaptimi, por efektiviteti i saj ka qenë heterogjen dhe i kushtëzuar nga faza e ciklit, niveli i hapësirës fiskale dhe cilësia institucionale. Krahasimi midis krizës globale të 2008–2009 dhe pandemisë COVID-19 nxjerr në pah se ndërhyrjet fiskale prodhojnë rezultate më të mira kur janë të shpejta, të koordinuara dhe të mirëorientuara (Auerbach & Gorodnichenko, 2013). Kjo qasje analitike krijon një bazë të fortë interpretuese për vlerësimin empirik të efektivitetit të politikës fiskale që zhvillohet në kapitujt vijues.

3.3 Shqipëria në kontekstin e Ballkanit Perëndimor

Vendosja e Shqipërisë në një perspektivë rajonale lejon një vlerësim më të nuancuar të zhvillimeve të saj makroekonomike dhe fiskale, duke dalluar elementët specifikë kombëtarë nga ato që lidhen me karakteristikat strukturore të përbashkëta të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Vendet e rajonit ndajnë tipare të ngjashme: madhësi të vogël të tregut, hapje të lartë ndaj tregtisë ndërkombëtare, varësi nga financimi i jashtëm dhe nivele relativisht të larta të informalitetit ekonomik (Sanfey & Milatović, 2018; World Bank, 2023). Këto karakteristika të përbashkëta ndikojnë jo vetëm në performancën ekonomike afatgjatë, por edhe në hapësirën fiskale dhe në efektivitetin e politikave makroekonomike.

Gjatë periudhës para krizës financiare globale (2000–2008), shumica e vendeve të rajonit përjetuan një fazë zgjerimi të shpejtë, të mbështetur nga rritja e konsumit, zgjerimi i kreditimit dhe hyrjet e kapitalit të huaj (Koczan, 2015). Megjithatë, ndikimi i krizës së 2008–2009 ndryshoi ndjeshëm mes vendeve. Shqipëria arriti të shmangë një recesion të thellë kryesisht falë rolit stabilizues të remitancave dhe fuqisë së konsumit të brendshëm, ndërsa vendet me ekspozim më të madh ndaj sektorëve industrialë dhe financimit të jashtëm u prekën më rëndë (EBRD, 2023; World Bank, 2023).

Edhe pas pandemisë COVID-19, rajoni demonstroi një kapacitet relativ të rimëkëmbjes, i mbështetur nga politika fiskale ekspansioniste dhe rikthimi i sektorit të shërbimeve. Megjithatë, ekonomitë më të varura nga turizmi, si Shqipëria dhe Mali i Zi, u treguan më të ndjeshme ndaj luhatjeve të kërkesës ndërkombëtare (World Bank, 2023; European Commission, 2024).

Nga këndvështrimi fiskal, Shqipëria renditet ndër vendet e rajonit me nivel relativisht më të lartë të borxhit publik dhe hapësirë fiskale më të kufizuar, së bashku me Malin e Zi (Kikoni et al., 2019). Ndërsa Kosova dhe Bosnja e Hercegovina kanë ruajtur nivele më të ulëta borxhi, Shqipëria u përball me presione të konsiderueshme fiskale pas pandemisë COVID-19 dhe kostove të rindërtimit pas tërmetit të 2019 (IMF, 2021; World Bank, 2023). Sipas ALTAX (2020), trendet tatimore në Ballkanin Perëndimor tregojnë dallime të rëndësishme në strukturën e taksave dhe efikasitetin e administrimit, ku Shqipëria ka ende hapësirë për përmirësim në zgjerimin e bazës tatimore krahasuar me disa vende fqinje. Për më tepër, niveli relativisht i ulët i të ardhurave tatimore si përqindje e PBB-së kufizon fleksibilitetin fiskal afatgjatë krahasuar me standardet europiane (European Commission, 2024).

Një element dallues i Shqipërisë është roli më aktiv i investimeve publike, sidomos në infrastrukturë dhe energji. Këto investime kanë kontribuar në mbështetjen e aktivitetit ekonomik dhe në përmirësimin gradual të bazës prodhuese. Megjithatë, siç thekson literatura, ndikimi i investimeve publike varet jo vetëm nga vëllimi i tyre, por sidomos nga cilësia e menaxhimit, transparenca dhe efikasiteti i zbatimit (Pere & Hashorva, 2011; ALTAX, 2020).

Në aspektin institucional, Shqipëria, ashtu si vendet e tjera të rajonit, ka ndërmarrë reforma të vazhdueshme për përafrim me standardet e Bashkimit Europian (European Commission, 2024; OECD, 2022). Progresi mbetet i lidhur ngushtë me forcimin e kapaciteteve administrative dhe cilësinë institucionale. Evidenca empirike rajonale konfirmon se cilësia e institucioneve ka një rol vendimtar në rritjen e efektivitetit të politikës fiskale dhe në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik afatgjatë (IMF, 2021; OECD, 2022).

Tabela 3.2 Shqipëria në kontekstin e Ballkanit Perëndimor: karakteristikat kryesore makroekonomike dhe fiskale

Treguesi	Shqipëria	Ballkani Perëndimor
Struktura ekonomike	Ekonomi e vogël dhe e hapur, me varësi nga remitancat, shërbimet dhe importet	Ekonomi të vogla dhe të ekspozuara ndaj tregjeve ndërkombëtare
Kriza 2008–2009	Ndikim më i moderuar falë konsumit dhe remitancave	Disa vende u goditën më fort nga kriza financiare
Pandemia COVID-19	Ndikim i lartë në turizëm dhe financat publike	Rimëkëmbje e mbështetur nga politika fiskale dhe shërbimet
Borxhi publik	Relativisht i lartë dhe me hapësirë fiskale të kufizuar	Më i ulët në Kosovë dhe Bosnje; i lartë në Mal të Zi
Politika fiskale	Investime publike më aktive në infrastrukturë dhe energji	Masa fiskale mbështetëse gjatë krizave
Sfidat kryesore	Informalitet, kufizime fiskale dhe eficiencë institucionale	Probleme të ngjashme strukturore dhe institucionale
Kriza energjetike dhe lufta në Ukrainë	Rritje e inflacionit dhe pasigurisë ekonomike	Efekte të ngjashme në të gjithë rajonin

Burimi: Përpunim i autores bazuar në World Bank (2023), European Bank for Reconstruction and Development (2023), International Monetary Fund (2021), European Commission (2024) dhe Organisation for Economic Co-operation and Development (2022).

Krahasimi rajonal nxjerr në pah se Shqipëria ndan sfida strukturore të ngjashme me vendet fqinje, por shfaq edhe disa specifika si: varësia më e lartë nga turizmi, niveli i borxhit dhe roli aktiv i investimeve publike. Kjo perspektivë rajonale forcon interpretimin e gjetjeve empirike dhe ndihmon në identifikimin e mundësive për politika më efektive në kuadrin e integritetit europian.

3.4 Faktorët që kushtëzojnë efektivitetin fiskal

Në përputhje me kuadrin teorik të trajtuar në kapitullin e mëparshëm, efektiviteti i politikës fiskale nuk varet vetëm nga madhësia e shpenzimeve publike apo niveli i të ardhurave tatimore, por edhe nga karakteristikat strukturore dhe institucionale të ekonomisë ku ajo zbatohet. Literatura teorike dhe empirike argumenton se ndikimi i politikës fiskale mbi rritjen ekonomike ndryshon sipas strukturës ekonomike, nivelit të zhvillimit financiar, hapjes ekonomike dhe cilësisë së institucioneve (Alkasasbeh & Haron, 2018). Në të njëjtën kohë, faktorë si shkalla e integritetit me ekonominë globale,

diversifikimi prodhues dhe kapacitetet institucionale ndikojnë drejtpërdrejt në mekanizmin e transmetimit të politikës fiskale dhe në madhësinë e multiplikatorëve fiskalë (Ilzetzi, Mendoza, & Végh, 2013; Batini, Eyraud, & Weber, 2014).

Në rastin e Shqipërisë, një nga faktorët më të rëndësishëm që kushtëzon efektivitetin fiskal lidhet me strukturën e ekonomisë dhe shkallën relativisht të lartë të hapjes ekonomike. Ekonomia dominohet nga sektori i shërbimeve dhe mbështetet në një masë të konsiderueshme të turizmit, remitancat dhe tregtia ndërkombëtare. Në këto kushte, një pjesë e stimulit fiskal transmetohet jashtë ekonomisë përmes rritjes së importeve, duke kufizuar ndikimin e drejtpërdrejtë të shpenzimeve publike mbi prodhimin vendas. Literatura tregon se në ekonomi të vogla dhe të hapura multiplikatorët fiskalë prirën të jenë më të ulët, pasi një pjesë e kërkesës shtesë kanalizohet drejt importeve dhe jo drejt prodhimit të brendshëm (Jamasi, 2017; Ilzetzi et al., 2013).

Njëkohësisht, varësia nga faktorët e jashtëm e bën ekonominë shqiptare më të ndjeshme ndaj goditjeve ndërkombëtare. Kriza energjetike europiane dhe rritja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare gjatë viteve 2022–2023 treguan se zhvillimet e jashtme mund të ndikojnë ndjeshëm në inflacion, konsum dhe aktivitet ekonomik, pavarësisht masave të ndërmarra në nivel kombëtar (European Commission, 2023; IMF, 2022). Në këtë kuptim, politika fiskale shpesh arrin të luajë një rol stabilizues në afatshkurtër, por përballet me kufizime më të mëdha kur synon të ndikojë në transformimin strukturor afatgjatë të ekonomisë.

Një rol të rëndësishëm luajnë edhe remitancat, të cilat kanë ndihmuar në mbështetjen e konsumit dhe në zbutjen e efekteve të goditjeve ekonomike gjatë periudhave të krizës. Megjithatë, duke qenë se ato përfaqësojnë një burim të jashtëm të ardhurash, remitancat reduktojnë pjesërisht varësinë e konsumit nga politikat fiskale të brendshme dhe ndikojnë në mënyrën se si transmetohen efektet e stimulit fiskal në ekonomi (World Bank, 2023; Banka e Shqipërisë, 2024).

Efektiviteti i politikës fiskale ndikohet gjithashtu nga niveli i zhvillimit financiar. Sistemi financiar shqiptar mbetet i dominuar nga sektori bankar, ndërsa tregjet e kapitaleve janë ende pak të zhvilluara. Për këtë arsye, transmetimi i politikës fiskale realizohet kryesisht përmes shpenzimeve publike dhe më pak përmes nxitjes së investimeve private apo zgjerimit të financimit të ekonomisë (EBRD, 2023; IMF, 2023). Kjo kufizon potencialin e politikës fiskale për të gjeneruar efekte më të gjera shumëzuese në aktivitetin ekonomik.

Një tjetër kufizim i rëndësishëm lidhet me informalitetin dhe dobësitë institucionale. Prania e një sektori informal relativisht të madh kufizon zgjerimin e bazës tatimore dhe redukton aftësinë e shtetit për të gjeneruar të ardhura të qëndrueshme. Në të njëjtën kohë,

evazoni fiskal, zbatimi jo i njëtrajshëm i legjislacionit dhe perceptimet për korrupsion ndikojnë negativisht në eficiencën e përdorimit të burimeve publike dhe në besimin e sektorit privat ndaj institucioneve shtetërore (OECD, 2022; IMF, 2024). Studimet e ALTAX (2020) theksojnë se informaliteti i lartë dhe sfida strukturore fiskale në Shqipëri vazhdojnë të kufizojnë efektivitetin e politikës fiskale dhe zgjerimin e bazës së të ardhurave publike. Evidenca nga vendet në zhvillim sugjeron se dobësitë institucionale dhe informaliteti i lartë kufizojnë performancën fiskale dhe reduktojnë efektivitetin e politikave publike (Sawadogo, 2020; Masiye, 2019; OECD, 2022). Studime si ai i Masiye (2019) mbi politikën fiskale në vendet afrikane në zhvillim tregojnë se efektiviteti i ndërhyrjeve fiskale varet fort nga cilësia institucionale, niveli i informalitetit dhe kapaciteti për të menaxhuar hapësirën fiskale – një realitet që ka paralele të rëndësishme edhe me ekonominë e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Shqipërinë.

Përveç këtyre faktorëve, një rol gjithnjë e më të rëndësishëm luan cilësia e institucioneve që hartojnë, zbatojnë dhe monitorojnë politikat fiskale. Literatura ndërkombëtare argumenton se kapacitetet institucionale ndikojnë drejtpërdrejt në aftësinë e qeverive për të mbledhur të ardhura, për të administruar shpenzimet publike dhe për të garantuar zbatimin efektiv të reformave fiskale (Acemoglu & Robinson, 2012; IMF, 2021; OECD, 2022). Gjatë periudhës 2000–2024, Shqipëria ka ndërmarrë reforma të vazhdueshme në administrimin fiskal, digjitalizimin e shërbimeve publike dhe forcimin e kuadrit rregullator. Edhe pse progresi ka qenë gradual, treguesit ndërkombëtarë evidentojnë përmirësime në efektivitetin e qeverisë, cilësinë rregullatore, shtetin e së drejtës dhe kontrollin e korrupsionit, veçanërisht pas vitit 2014 (World Bank, 2024).

Këto zhvillime tregojnë se ndikimi i politikës fiskale nuk përcaktohet vetëm nga niveli i shpenzimeve apo të ardhurave publike, por edhe nga kapaciteti institucional që mbështet zbatimin e tyre. Institucione më efektive mund të përmirësojnë planifikimin dhe alokimin e burimeve publike, të reduktojnë kostot administrative dhe të rrisin besueshmërinë e politikave ekonomike. Për këtë arsye, analiza e efektivitetit fiskal në Shqipëri nuk mund të kufizohet vetëm te instrumentet tradicionale fiskale, por duhet të marrë në konsideratë edhe dimensionin institucional.

Në tërësi, karakteristikat strukturore të ekonomisë shqiptare sugjerojnë se multiplikatorët fiskalë prirën të jenë relativisht të moderuar në kushte normale ekonomike, për shkak të hapjes së lartë ekonomike, varësisë nga importet, zhvillimit financiar ende të kufizuar dhe dobësive institucionale. Megjithatë, përvoja e periudhave të krizës, veçanërisht gjatë pandemisë COVID-19, tregon se efektiviteti i politikës fiskale rritet kur ekonomia operon nën potencialin e saj dhe kur ndërhyrjet publike janë të shpejta, të targetuara dhe të koordinuara (Auerbach & Gorodnichenko, 2013; Blanchard & Leigh, 2013). Kjo mbështet argumentin se efektet e politikës fiskale ndryshojnë sipas fazës së ciklit ekonomik dhe kushteve institucionale. Për rrjedhojë, forcimi i efektivitetit fiskal në

Shqipëri kërkon jo vetëm politika fiskale të mirëprojektuara, por edhe përparim të mëtejshëm në diversifikimin ekonomik, formalizimin e aktivitetit ekonomik, zhvillimin financiar dhe konsolidimin e institucioneve publike.

Këto karakteristika strukturore dhe institucionale (hapja ekonomike, informaliteti, cilësia institucionale) ndikojnë drejtpërdrejt në madhësinë e multiplikatorëve fiskalë dhe në efektivitetin e politikës fiskale. Për këtë arsye, analiza empirike e këtij studimi përfshin si instrumente tradicionale fiskale, ashtu edhe Indeksën e Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF), si dhe analizon ndryshimet e efekteve sipas regjimeve ekonomike

3.5 Implikimet për analizën empirike

Analiza e zhvillimeve makroekonomike, fiskale dhe institucionale gjatë periudhës 2000–2024 nxjerr në pah se marrëdhënia midis politikës fiskale dhe rritjes ekonomike në Shqipëri nuk ka qenë homogjene, por është formësuar nga faza të ndryshme të ciklit ekonomik, natyra e goditjeve të jashtme dhe kufizimet strukturore të ekonomisë. Kjo heterogjeniteti i efekteve fiskale mbështet argumentin teorik se ndikimi i politikës fiskale ndryshon sipas kushteve makroekonomike, nivelit të hapësirës fiskale dhe cilësisë institucionale (Ilzetzki et al., 2013; Auerbach & Gorodnichenko, 2013; Blanchard & Leigh, 2013).

Evidenca historike sugjeron se politika fiskale ka luajtur një rol më aktiv dhe kundërciklik gjatë episodeve të krizës, veçanërisht gjatë krizës financiare globale (2008–2009) dhe pandemisë COVID-19 (2020), ndërsa në periudhat e zgjerimit ekonomik ka shfaqur elemente pro-ciklike me krijim relativisht të kufizuar të rezervave fiskale. Për këtë arsye, analiza empirike e këtij studimi përfshin variabla dummy për vitet 2009 dhe 2020, si dhe terma ndërveprimi, me qëllim kapjen e efekteve të diferencuara të politikës fiskale në periudhat e krizës krahasuar me ato normale (Auerbach & Gorodnichenko, 2013; Blanchard & Leigh, 2013).

Zgjedhja e strategjisë ekonometrike është përcaktuar edhe nga karakteristikat e të dhënave të disponueshme për Shqipërinë. Edhe pse literatura përdor gjerësisht modele VAR ose SVAR për vlerësimin e efekteve fiskale (Ramey, 2019), aplikimi i tyre kufizohet nga gjatësia relativisht e shkurtër e serive kohore vjetore dhe numri i kufizuar i observimeve. Prandaj, analiza mbështetet kryesisht në modele OLS të zgjeruara me variabla kontrolli dhe terma ndërveprimi, të cilat konsiderohen të përshtatshme për mostra relativisht të vogla (Gujarati & Porter, 2009; Wooldridge, 2019). Për përcaktimin e numrit optimal të lagëve në modelin ARDL është përdorur kriteri i informacionit Akaike (Akaike, 1974), i cili ofron një balancë të mirë midis përshtatjes së modelit dhe kompleksitetit të tij.

Përveç modeleve të regresionit linear, analiza empirike mbështetet edhe në metodologjinë Autoregressive Distributed Lag (ARDL), e cila mundëson shqyrtimin e marrëdhënieve afatgjata ndërmjet variablave dhe identifikimin e dinamikave të tyre në afat të shkurtër. Zgjedhja e kësaj qasjeje metodologjike justifikohet nga përshtatshmëria e saj për kampione relativisht të vogla dhe për seri kohore që paraqesin rend të ndryshëm integrimi, për sa kohë që variablat janë stacionare në nivel ose në diferencë të parë (Pesaran, Shin & Smith, 2001). Një avantazh i rëndësishëm i kësaj metode është aftësia për të analizuar njëkohësisht efektet afatshkurtra dhe afatgjata të faktorëve fiskalë dhe institucionalë mbi performancën ekonomike. Metodologjia ARDL përdoret gjithashtu për të vlerësuar rolin e kapacitetit institucional në efektivitetin e politikës fiskale. Përfshirja e Indeksit të Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF) mundëson analizimin e mënyrës se si cilësia e institucioneve ndikon në transmetimin e efekteve të ndërhyrjeve fiskale në ekonomi. Kjo qasje ofron mundësinë për të vlerësuar nëse përmirësimi i kapaciteteve institucionale kontribuon në rritjen e efektivitetit të politikës fiskale dhe në përmirësimin e rezultateve ekonomike, duke zgjeruar analizën përtej faktorëve tradicionalë fiskalë dhe makroekonomikë.

Zgjedhja e të dhënave vjetore për periudhën 2000–2024 lidhet me mungesën e serive tremujore të plota dhe të krahasueshme për të gjithë periudhën, si dhe me nevojën për homogjenitet në analizën afatgjatë. Megjithëse të dhënat tremujore do të mundësonin një analizë më të detajuar të dinamikave afatshkurtra, seria vjetore ofron një bazë më të qëndrueshme për vlerësimin e tendencave strukturore dhe efekteve afatgjata. Kufizime të tjera metodologjike, si matja e ekonomisë informale, ndryshimet në klasifikimet buxhetore dhe cilësia e statistikave në vitet e hershme të tranzicionit, janë marrë parasysh gjatë interpretimit të rezultateve (IMF, 2024; World Bank, 2023).

Karakteristikat strukturore të ekonomisë shqiptare, hapja e lartë ekonomike, varësia nga importet, remitancat dhe turizmi, sugjerojnë se multiplikatorët fiskalë prirën të jenë më të moderuar në kushte normale, pasi një pjesë e stimulit rrjedh jashtë ekonomisë (Ilzetzki et al., 2013). Për këtë arsye, modelet empirike përfshijnë variabla kontrolli si inflacioni, papunësia, remitancat dhe eksportet, me qëllim pasqyrimin sa më të plotë të mekanizmit të transmetimit të politikës fiskale (Batini, Eyrraud, & Weber, 2014).

Në të njëjtën kohë, niveli i borxhit publik dhe hapësira fiskale kufizojnë aftësinë e ndërhyrjes publike, sidomos pas periudhave të krizës (European Commission, 2024; IMF, 2024). Kjo justifikon përfshirjen e borxhit publik si variabël kyç në modelet empirike.

Përmirësimet graduale në administrimin fiskal dhe kapacitetet institucionale gjatë periudhës kanë krijuar kushte më të favorshme për zbatimin e politikave. Prandaj, analiza empirike integroi Indeksin e Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF), me qëllim vlerësimin e rolit moderues të institucioneve në efektivitetin fiskal.

Në përmbledhje, analiza empirike që ndjek në kapitujt vijues mbështetet në një qasje integruese që kombinon instrumentet fiskale tradicionale, variabla kontrolli makroekonomikë, tregues institucionalë dhe identifikimin e regjimeve të ndryshme ekonomike. Kjo strategji synon të ofrojë një vlerësim realist dhe nuancues të marrëdhënies midis politikës fiskale dhe rritjes ekonomike në Shqipëri, duke marrë parasysh kufizimet strukturore, institucionale dhe kontekstuale të ekonomisë shqiptare gjatë periudhës 2000–2024.

3.6 Përfundime të kapitullit

Ky kapitull analizoi zhvillimet kryesore makroekonomike dhe fiskale të Shqipërisë gjatë periudhës 2000–2024, duke evidentuar se ekonomia shqiptare ka arritur një rritje pozitive në afat të gjatë, por ka mbetur e ndjeshme ndaj goditjeve të jashtme dhe kufizimeve strukturore si informaliteti, varësia nga importet, turizmi dhe remitancat. Politika fiskale nuk ka pasur të njëjtën sjellje gjatë gjithë periudhës: në kohë zgjerimi ekonomik ka qenë kryesisht pro-ciklike me krijim të kufizuar të rezervave fiskale, ndërsa gjatë krizave (veçanërisht pandemisë COVID-19) ka marrë një rol më aktiv, stabilizues dhe kundërciklik. Efektiviteti i saj është ndikuar fort nga hapja e lartë ekonomike, zhvillimi financiar i moderuar, informaliteti dhe cilësia institucionale. Këto faktorë kufizojnë madhësinë e multiplikatorëve fiskalë në kushte normale, por e rrisin atë gjatë periudhave të krizës. Përmirësimet graduale në administrimin fiskal dhe kapacitetet institucionale paraqesin një potencial të rëndësishëm për rritjen e efektivitetit të politikave publike. Në tërësi, gjetjet e këtij kapitulli krijojnë bazën konceptuale dhe empirike për analizën metodologjike dhe vlerësimin ekonometrik të hipotezave të studimit në kapitujt vijues

KAPITULLI 4: METODOLOGJIA

Ky kapitull paraqet metodologjinë e përdorur për analizimin e ndikimit të politikës fiskale në rritjen ekonomike në Shqipëri gjatë periudhës 2000–2024. Analiza empirike është ndërtuar në funksion të objektivave dhe hipotezave të studimit, me qëllim vlerësimin e rolit të instrumenteve fiskale në mbështetjen e zhvillimit ekonomik dhe të procesit të rimëkëmbjes gjatë periudhave të ndryshme të ciklit ekonomik. Për këtë arsye, vëmendje e veçantë i kushtohet episodeve kryesore që kanë ndikuar ekonominë shqiptare, si kriza financiare globale e viteve 2008–2009 dhe pandemia COVID-19.

Studimi mbështetet në një qasje kuantitative dhe përdor metoda ekonometrike të serive kohore, bazuar në të dhëna vjetore të marra nga burime zyrtare dhe ndërkombëtare, si Ministria e Financave dhe Ekonomisë, INSTAT, World Bank dhe IMF. Analiza realizohet përmes programit EViews dhe kombinon modele OLS me metodologjinë ARDL për të vlerësuar marrëdhëniet ndërmjet politikës fiskale, faktorëve makroekonomikë dhe rritjes ekonomike. Krahas instrumenteve fiskale tradicionale, si shpenzimet qeveritare, investimet publike, të ardhurat tatimore dhe borxhi publik, studimi përfshin edhe dimensionin institucional përmes Indeksit të Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF), i ndërtuar mbi treguesit e qeverisjes së Bankës Botërore.

Procesi metodologjik përfshin analizën përshkruese të të dhënave, testet e stacionaritetit, ndërtimin e modeleve ekonometrike dhe verifikimin e tyre përmes testeve diagnostikuese dhe të stabilitetit strukturor. Kjo qasje mundëson vlerësimin jo vetëm të ndikimit të drejtpërdrejtë të politikës fiskale mbi rritjen ekonomike, por edhe të rolit që luajnë kushtet institucionale dhe ndryshimet ndërmjet regjimeve të ndryshme makroekonomike. Në këtë mënyrë, kapitulli krijon bazën metodologjike që lidh kuadrin teorik dhe hipotezat e studimit me analizën empirike të paraqitur në kapitujt vijues.

4.1 Dizajni i kërkimit

Ky studim ndjek një qasje empirike dhe kuantitative për të analizuar lidhjen midis politikës fiskale dhe rritjes ekonomike në Shqipëri gjatë periudhës 2000–2024. Dizajni i kërkimit është ndërtuar në mënyrë sistematike, duke krijuar një lidhje të qartë dhe logjike midis objektivave të studimit, të dhënave të disponueshme dhe metodave analitike, me qëllim që të sigurojë një bazë të fortë metodologjike për analizën empirike dhe interpretimin e rezultateve.

Nga pikëpamja shkencore, ky studim ndjek qasjen pozitiviste (ose empirizmin kuantitativ). Kjo do të thotë se ne mbështetemi te të dhënat reale, matjet objektive dhe analiza statistikore për të kuptuar dhe shpjeguar marrëdhëniet ekonomike. Kjo do të thotë se njohuria shkencore merret kryesisht nga vëzhgimi sistematik i realitetit ekonomik, matja e saktë e variablave dhe testimi empirik i hipotezave, duke u mbështetur në të dhëna

objektive dhe teknika statistikore-ekonometrike. Qasja pozitive lejon identifikimin e marrëdhënieve shkakësore dhe modeleve të qëndrueshme në të dhënat makroekonomike, pa u bazuar në interpretime subjektive ose cilësore.

Analiza zhvillohet në nivel makroekonomik, duke marrë Shqipërinë si rast studimi. Fokus i veçantë i jepet rolit të politikës fiskale në stimulimin e rritjes ekonomike dhe në stabilizimin e ekonomisë gjatë fazave të ndryshme të ciklit ekonomik. Për këtë qëllim janë përdorur seri kohore vjetore për periudhën 2000–2024. Zgjedhja e të dhënave vjetore (dhe jo tremujore) është dikur nga dy arsye kryesore: së pari, Indeksi i Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF) dhe disa tregues të tjerë institucionalë e strukturorë janë të disponueshëm vetëm në frekuencë vjetore; së dyti, periudha relativisht e gjatë (25 vjet) lejon kapjen e tendencave afatgjata, luhatjeve ciklike dhe ndryshimeve strukturore që kanë karakterizuar ekonominë shqiptare gjatë më shumë se dy dekadave. Kjo periudhë përfshin fazën e rritjes së shpejtë para krizës globale 2008–2009, periudhën e konsolidimit fiskal pas krizës, si dhe ndërhyrjet e mëdha fiskale gjatë pandemisë COVID-19 dhe rimëkëmbjes pasuese. Përfshirja e këtyre nënperiudhave ndihmon në vlerësimin e efektivitetit të politikës fiskale në kushte të ndryshme ekonomike dhe institucionale.

Studimi përdor metoda statistikore dhe ekonometrike për të vlerësuar ndikimin e instrumenteve fiskale mbi performancën ekonomike. Njësia kryesore e analizës është ekonomia shqiptare në tërësi, ndërsa vëmendja përqendrohet te treguesit kryesorë fiskalë dhe makroekonomikë. Duke pasur parasysh madhësinë relativisht të vogël të kampionit (rreth 25 observime vjetore), rezultatet trajtohen me kujdes të veçantë. Për të adresuar këtë kufizim, analiza plotësohet me teste të stabilitetit strukturor, si dhe me krahasime sistematike të rezultateve midis periudhave të ndryshme ekonomike.

Qasja analitike bazohet në premisën se efektet e politikës fiskale nuk janë konstante në kohë, por ndryshojnë në varësi të kushteve makroekonomike, hapësirës fiskale dhe karakteristikave strukturore të ekonomisë. Prandaj, studimi nuk kufizohet vetëm në matjen e ndikimit të drejtpërdrejtë të shpenzimeve apo të të ardhurave fiskale mbi rritjen, por shqyrton edhe mënyrën se si ky ndikim varion gjatë periudhave të stabilitetit, krizave dhe rimëkëmbjes. Njëkohësisht, merret parasysh edhe dimensionin institucional i politikës fiskale konkretisht, nëse cilësia e institucioneve ndikon në forcimin ose dobësimin e mekanizmit të transmetimit të politikës fiskale në ekonomi.

Për këtë arsye, krahas instrumenteve tradicionale fiskale, në analizë është përfshirë edhe Indeksi i Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF). Ky indeks ndihmon në kuptimin më të plotë të marrëdhënies midis politikës fiskale, cilësisë institucionale dhe zhvillimit ekonomik në kontekstin shqiptar. Kjo qasje krijon një bazë të shëndoshë metodologjike për analizat empirike të detajuara që paraqiten në seksionet pasardhëse.

4.2 Strategjia e analizës empirike

Strategjia e analizës empirike është ndërtuar për të vlerësuar në mënyrë sistematike ndikimin e politikës fiskale në rritjen ekonomike të Shqipërisë gjatë periudhës 2000–2024, si dhe për të testuar hipotezat kërkimore të paraqitura në këtë studim. Analiza mbështetet në metodologjinë e ekonometrisë së serive kohore dhe në praktikat bashkëkohore të analizës makroekonomike empirike (Gujarati & Porter, 2009; Wooldridge, 2013; Greene, 2018; Stock & Watson, 2019). Përpunimi statistikor dhe ekonometrik i të dhënave është realizuar në programin EViews 12 (EViews, 2022), i cili përdoret gjerësisht në analizën e serive kohore dhe në vlerësimin e modeleve makroekonomike. Analiza e këtij studimi është në linjë me modelet makroekonometrike të zhvilluara për ekonominë shqiptare, si Modeli MEAM i Bankës së Shqipërisë (Skufi et al., 2025), duke u fokusuar në marrëdhëniet midis variablave fiskale dhe rritjes ekonomike

Procesi analitik zhvillohet në disa etapa të ndërlidhura. Fillimisht realizohet analiza përshkruese e të dhënave përmes treguesve statistikorë bazë, si mesatarja, devijimi standard, vlerat minimale dhe maksimale, me qëllim identifikimin e karakteristikave kryesore të variablave dhe evidentimin e luhatjeve apo episodeve të veçanta ekonomike (Stock & Watson, 2020). Kjo analizë plotësohet me paraqitjen grafike të serive kohore dhe me matricën e korelacionit Pearson (Pearson, 1895), të cilat ndihmojnë në identifikimin e trendeve afatgjata, ndryshimeve ciklike dhe marrëdhënieve paraprake ndërmjet variablave (Gujarati & Porter, 2009).

Një hap i domosdoshëm metodologjik është verifikimi i stacionaritetit të serive kohore. Literatura ekonometrike thekson se përdorimi i variablave jo-stacionare mund të çojë në regresione të rreme (spurious regressions), duke kompromentuar vlefshmërinë e rezultateve empirike (Gujarati & Porter, 2009; Hamilton, 1994; Enders, 2015). Për këtë arsye përdoret testi Augmented Dickey–Fuller (ADF), (Dickey & Fuller, 1979), i cili mundëson identifikimin e rendit të integritit të secilës variabël. Forma e përgjithshme e testit paraqitet si vijon:

$$\Delta Y_t = \alpha + \beta t + \gamma Y_{t-1} + \sum_{i=1}^p \delta_i \Delta Y_{t-i} + \varepsilon_t$$

ku ΔY_t paraqet diferencën e parë të variablës, α është intercepti, βt përfaqëson trendin deterministik, Y_{t-1} është vlera e vonuar e variablës, ndërsa ε_t është termi i gabimit. Hipoteza zero ($H_0: \gamma=0$) nënkupton praninë e rrënjës unitare dhe, rrjedhimisht, jo-stacionaritetin e serisë.

Rezultatet e testit ADF treguan se variablat PUB_INV, TAX_REV, PUBLIC_DEBT, UNEMPLOYMENT, REMITTANCES dhe IKIPF nuk rezultojnë

stacionare në nivel, por bëhen stacionare pas diferencimit të parë. Për këtë arsye, këto variabla janë transformuar në diferencë të parë përpara përfshirjes në analizën ekonometrike, në përputhje me rekomandimet metodologjike për analizën e serive kohore (Gujarati & Porter, 2009; Wooldridge, 2013).

Pas verifikimit të karakteristikave statistikore të të dhënave, ndërtohet modeli bazë ekonometrik përmes metodës Ordinary Least Squares (OLS). Zgjedhja e kësaj metode mbështetet në interpretueshmërinë e saj të lartë, përshtatshmërinë për kampione relativisht të vogla dhe përdorimin e gjerë në literaturën empirike mbi politikën fiskale (Wooldridge, 2013). Modeli bazë vlerëson ndikimin e instrumenteve kryesore fiskale mbi rritjen ekonomike:

$$GDP_t = \beta_0 + \beta_1 * GOV_{EXP_t} + \beta_2 * PUB_{INV_t} + \beta_3 * TAX_{REV_t} + \beta_4 * PUBLIC_{DEBT_t} + \varepsilon_t$$

ku variabla e varur është rritja ekonomike reale (GDP_GROWTH), ndërsa variablat shpjeguese përfaqësojnë instrumentet kryesore të politikës fiskale.

Për të rritur fuqinë shpjeguese të modelit dhe për të shmangur paragjykimin nga variabla të lëna jashtë, analiza zgjerohet me variabla kontrolli makroekonomikë, si inflacioni, papunësia, eksportet dhe remitancat (Stock & Watson, 2020). Gjithashtu, përfshihen variabla dummy dhe terma ndërveprimi për të identifikuar ndryshimet në efektivitetin e politikës fiskale gjatë periudhave të krizës, veçanërisht gjatë krizës financiare globale të viteve 2008–2009 dhe pandemisë COVID-19.

Për testimin e Hipotezës H6, e cila lidhet me rolin e kapacitetit institucional në efektivitetin e politikës fiskale, ndërtohet një model i zgjeruar që përfshin Indeksin e Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF) dhe termin e ndërveprimit ndërmjet shpenzimeve publike dhe këtij indeksi:

$$GDP_GROWTH_t = \beta_0 + \beta_1 GOV_EXP_t + \beta_2 D(PUB_INV_t) + \beta_3 D(TAX_REV_t) + \beta_4 D(PUBLIC_DEBT_t) + \beta_5 IKIPF_t + \beta_6 (GOV_EXP_t \times IKIPF_t) + \varepsilon_t$$

Duke qenë se variablat paraqesin rend integrimi të përzier I(0) dhe I(1), ndërsa kampioni përbëhet nga vetëm 25 observime vjetore, përdoret metodologjia Autoregressive Distributed Lag (ARDL), e cila konsiderohet veçanërisht e përshtatshme për mostra të vogla dhe për seri me rend të ndryshëm integrimi (Pesaran, Shin & Smith, 2001). Përveç vlerësimit të marrëdhënieve afatshkurtra dhe afatgjata ndërmjet variablave, analiza plotësohet me Bounds Test dhe Error Correction Model (ECM) për të verifikuar ekzistencën e ekuilibrit afatgjatë ndërmjet kapacitetit institucional, politikës fiskale dhe rritjes ekonomike.

Për të garantuar besueshmërinë e rezultateve, modelet ekonometrike i nënshtrohen një serie testesh diagnostikuese. Konkretisht, përdoren testi Breusch–Godfrey për autokorelacionin, testi White për heteroskedasticitetin, testi Jarque–Bera për normalitetin e mbetjeve dhe analiza e multikolinearitetit për të vlerësuar ndërvlerësinë ndërmjet variablave shpjegues (Gujarati & Porter, 2009). Në rastet kur identifikohet heteroskedasticitet, përdoren gabime standarde robuste (White, 1980) (White–Hinkley) për të ruajtur vlefshmërinë e inferencës statistikore.

Këto procedura diagnostikuese janë të rëndësishme për të garantuar që vlerësimet e parametrave të modelit të jenë të paanshme dhe të qëndrueshme, si dhe që inferenca statistikore mbi koeficientët e regresionit të mbetet e besueshme (Gujarati & Porter, 2009). Në rastet kur identifikohet heteroskedasticitet, vlerësimi i modelit korrigjohet përmes përdorimit të gabimeve standarde robuste (White–Hinkley). Ky korrigjim siguron që testet statistikore mbi koeficientët e modelit të mbeten të vlefshme edhe në prani të variancës jo konstante të mbetjeve.

Duke qenë se periudha e analizës përfshin disa goditje të rëndësishme ekonomike, studimi përfshin gjithashtu analizën e stabilitetit strukturor të modelit. Kjo analizë synon të identifikojë nëse marrëdhëniet ndërmjet variablave fiskalë dhe rritjes ekonomike kanë ndryshuar gjatë periudhës së studimit. Në këtë kuadër përdoren disa teste komplementare të thyerjeve strukturore, duke përfshirë:

- *Chow Breakpoint Test* për testimin e pikave specifike të thyerjes strukturore
- *CUSUM test* për verifikimin e stabilitetit të parametrave
- *CUSUM of Squares test* për analizimin e ndryshimeve në variancën e modelit.

Përdorimi i këtyre testeve në mënyrë të integruar rrit besueshmërinë e identifikimit të ndryshimeve strukturore në marrëdhëniet ekonomike gjatë periudhave të krizave (Wooldridge, 2013).

Në fazën e fundit të analizës empirike, vëmendja përqendrohet në shqyrtimin e efektivitetit të politikës fiskale në kontekste të ndryshme makroekonomike. Për këtë qëllim, periudha e studimit ndahet në nënperiudha që pasqyrojnë faza të dallueshme të zhvillimit ekonomik, duke përfshirë periudhat e zgjerimit ekonomik, krizës, konsolidimit fiskal dhe rimëkëmbjes. Kjo qasje mundëson identifikimin e ndryshimeve në intensitetin dhe drejtimin e efekteve fiskale, si dhe vlerësimin e mënyrës se si kushtet makroekonomike ndikojnë në rezultatet e ndërhyrjeve publike. Në këtë mënyrë, analiza ofron një kuptim më të thellë të faktorëve që kushtëzojnë efektivitetin e politikës fiskale dhe të rrethanave në të cilat ajo kontribuon më fuqishëm në mbështetjen e rritjes ekonomike. Tabela 4.1 paraqet strukturën e analizës empirike, duke paraqitur etapat kryesore të kërkimit, objektivat

metodologjike përkatëse dhe instrumentet ekonometrike të përdorura në secilën fazë të studimit.

Tabela 4.1 Struktura e strategjisë së analizës empirike

Faza e analizës	Qëllimi metodologjik	Metodat / Testet e përdorura
1. Analiza përshkruese e variablave	Të identifikohen karakteristikat statistikore bazë të variablave dhe evolucioni i tyre gjatë periudhës së studimit	Mesatarja, devijimi standard, minimumi, maksimumi, statistikat përshkruese
2. Analiza grafike e serive kohore	Të vizualizohen tendencat afatgjata dhe ciklet ekonomike të variablave	Grafike të serive kohore dhe analiza vizuale e trendit
3. Analiza e korelacionit	Të vlerësohet drejtimi dhe forca e marrëdhënieve lineare ndërmjet variablave dhe të identifikohet multikolineariteti potencial	Matrica e korelacionit Pearson
4. Testet e stacionaritetit	Të verifikohet nëse seritë kohore janë stacionare dhe të shmanget problemi i regresioneve të rreme	Augmented Dickey–Fuller (ADF) test
5. Ndërtimi i modelit ekonometrik bazë	Të vlerësohet ndikimi i instrumenteve fiskale në rritjen ekonomike	Modeli OLS (Ordinary Least Squares)
6. Modelet e zgjeruara	Të testohen rezultatet përmes përfshirjes së variablave kontrolluese makroekonomike	Modele alternative OLS me variabla kontrolluese
7. Testet diagnostikuese të modelit	Të verifikohet vlefshmëria statistikore e modelit dhe përmbushja e supozimeve ekonometrike	Breusch–Godfrey, White Test, Jarque–Bera, analiza e multikolinearitetit
8. Analiza e stabilitetit strukturor	Të identifikohen ndryshimet në marrëdhëniet ekonomike gjatë periudhës së analizës	Chow Breakpoint Test, CUSUM, CUSUM of Squares
9. Analiza sipas regjimeve makroekonomike	Të vlerësohet nëse efektet e politikës fiskale ndryshojnë ndërmjet periudhave ekonomike	Modele për nënperiudha dhe analiza krahasuese
10. Analiza e rolit institucional	Të vlerësohet ndikimi i kapacitetit institucional në efektivitetin e politikës fiskale	ARDL, Bounds Test, ECM

Burimi: Përpunim I autorit

Strategjia empirike e studimit nuk kufizohet vetëm në përzgjedhjen e metodave dhe teknikave të analizës, por përcakton gjithashtu edhe llojin e evidencës që pritët të gjenerohet në secilën fazë të kërkimit. Kjo evidencë përfshin rezultatet e modeleve ekonometrike, testet e vlefshmërisë dhe qëndrueshmërisë së modeleve, si dhe paraqitjet grafike që mundësojnë vlerësimin e stabilitetit të marrëdhënieve të analizuara. Në këtë kuadër, rezultatet e regresioneve, testet diagnostikuese dhe instrumentet grafike të stabilitetit strukturor, si CUSUM dhe CUSUMSQ, shërbejnë për të verifikuar besueshmërinë e gjetjeve empirike dhe për të mbështetur interpretimin e tyre ekonomik.

Të gjitha rezultatet e prodhuara nga kjo procedurë analitike paraqiten dhe diskutohen në mënyrë të detajuar në kapitullin vijues, ku evidenca empirike interpretohet në funksion të objektivave kërkimore dhe të hipotezave të studimit.

4.3 Korniza konceptuale e studimit dhe lidhja me hipotezat

Korniza konceptuale e këtij studimi ndërtohet mbi literaturën bashkëkohore të politikës fiskale, rritjes ekonomike dhe qeverisjes institucionale, duke krijuar lidhjen ndërmjet bazës teorike, hipotezave kërkimore dhe analizës empirike. Në literaturën makroekonomike, politika fiskale konsiderohet një nga instrumentet kryesore të stabilizimit ekonomik, pasi nëpërmjet shpenzimeve publike, investimeve dhe politikave tatimore qeveritë synojnë të mbështesin kërkesën agregate, të zbusin luhatjet ciklike dhe të nxisin rritjen ekonomike. Ky rol bëhet veçanërisht i rëndësishëm në ekonomitë në zhvillim, ku tregjet financiare janë më pak të zhvilluara dhe mekanizmat automatikë të stabilizimit mbeten relativisht të kufizua.

Një koncept qendror në këtë kuadër është ai i multiplikatorëve fiskalë, i cili shpjegon shkallën në të cilën ndryshimet në shpenzimet ose të ardhurat publike reflektohen në ndryshime të prodhimit ekonomik (Auerbach & Gorodnichenko, 2012; Blanchard & Leigh, 2013; Ilzetzki et al., 2013). Megjithatë, literatura argumenton se madhësia e multiplikatorëve fiskalë nuk është konstante, por ndryshon sipas fazës së ciklit ekonomik, nivelit të hapjes së ekonomisë, strukturës së shpenzimeve publike dhe besueshmërisë së politikës fiskale (Auerbach & Gorodnichenko, 2012; Ramey, 2019). Në periudha recesioni, kur ekonomia operon nën potencialin e saj dhe kapacitetet prodhuese janë pjesërisht të pashfrytëzuara, efektet e ndërhyrjeve fiskale priren të jenë më të larta (Blanchard & Leigh, 2013).

Një tjetër element i rëndësishëm teorik është koncepti i hapësirës fiskale, i cili lidhet ngushtë me nivelin e borxhit publik dhe qëndrueshmërinë e financave publike. Nivelet e larta të borxhit mund të kufizojnë aftësinë e qeverisë për të ndërmarrë politika fiskale ekspansioniste, duke rritur kostot e financimit dhe duke reduktuar fleksibilitetin e ndërhyrjes publike. Për këtë arsye, borxhi publik nuk ndikon vetëm drejtpërdrejt në performancën ekonomike, por edhe në mënyrë të tërthortë përmes kufizimit të efektivitetit të politikës fiskale.

Literatura thekson gjithashtu se efektet e politikës fiskale ndryshojnë në periudha krizash. Goditje të tilla si kriza financiare globale e viteve 2008–2009 dhe pandemia COVID-19 kanë treguar se politika fiskale mund të marrë një rol më aktiv kundërciklik, duke kompensuar dobësimin e kërkesës private dhe duke kontribuar në stabilizimin e

aktivitetit ekonomik (Ostry et al., 2010). Megjithatë, efektiviteti i këtyre ndërhyrjeve kushtëzohet nga faktorë të tillë si kapaciteti fiskal, struktura ekonomike dhe cilësia e institucioneve. Në këtë kontekst, literatura më e fundit argumenton se dimensionin institucional përbën një faktor kyç në përcaktimin e efektivitetit të politikës fiskale. Institucione më efektive dhe më transparente mund të përmirësojnë mbledhjen e të ardhurave, alokimin e burimeve publike dhe zbatimin e politikave ekonomike, duke rritur ndikimin e tyre në aktivitetin ekonomik (Acemoglu & Robinson, 2012; Gerling et al., 2017; IMF, 2021). Për këtë arsye, analiza e këtij studimi nuk kufizohet vetëm te instrumentet tradicionale fiskale, por përfshin edhe dimensionin institucional si një faktor që mund të forcojë ose kufizojë efektivitetin e tyre.

Bazuar në këto argumente teorike, studimi ndërton një model konceptual në të cilin rritja ekonomike ndikohet nga katër grupe faktorësh kryesorë. Grupi i parë përfshin instrumentet fiskale, konkretisht shpenzimet qeveritare, investimet publike dhe të ardhurat tatimore, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në kërkesën agregate dhe në aktivitetin ekonomik. Grupi i dytë lidhet me borxhin publik dhe hapësirën fiskale, të cilat përcaktojnë aftësinë e qeverisë për të ndërhyrë në ekonomi. Grupi i tretë përfshin krizat ekonomike dhe regjimet makroekonomike, të cilat mund të ndryshojnë intensitetin dhe drejtimin e efekteve fiskale. Grupi i katërt lidhet me kapacitetin institucional, i cili ndikon në cilësinë e hartimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave publike.

Në këtë studim, kapaciteti institucional operacionalizohet përmes Indeksit të Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF), i cili shërben si tregues i cilësisë institucionale në mbështetje të politikës fiskale. Supozimi bazë është se një mjedis institucional më i zhvilluar rrit efektivitetin e ndërhyrjeve fiskale dhe përforcon ndikimin e tyre në aktivitetin ekonomik dhe rritjen afatgjatë.

Kjo kornizë konceptuale shërben si bazë për formulimin dhe testimin e hipotezave kërkimore. *Hipoteza e parë (H1)* vlerëson ndikimin e instrumenteve kryesore të politikës fiskale mbi rritjen ekonomike dhe testohet përmes modelit bazë OLS. *Hipoteza e dytë (H2)* fokusohet në rolin e borxhit publik dhe supozon se rritja e tij kufizon hapësirën fiskale dhe dobëson efektivitetin e ndërhyrjeve publike. *Hipoteza e tretë (H3)* argumenton se ndikimi i politikës fiskale ndryshon sipas fazës së ciklit ekonomik dhe pritet të jetë më i fortë gjatë periudhave të recesionit sesa gjatë periudhave të stabilitetit ekonomik. *Hipoteza e katërt (H4)* lidhet me krizën financiare globale dhe pandeminë COVID-19, duke supozuar se gjatë këtyre episodeve politika fiskale ka luajtur rol më aktiv kundërciklik në mbështetjen e aktivitetit ekonomik. *Hipoteza e pestë (H5)* vlerëson ndikimin e faktorëve strukturorë dhe institucionalë në mekanizmin e transmetimit të politikës fiskale, ndërsa *hipoteza e gjashtë (H6)* teston drejtpërdrejt rolin e kapacitetit institucional në efektivitetin e politikës fiskale përmes indeksit IKIPF. Lidhja ndërmjet hipotezave, modeleve ekonometrike dhe metodave të testimit paraqitet në Tabelën 4.2.

Tabela 4.2 Lidhja ndërmjet hipotezave kërkimore, modeleve ekonometrike dhe metodave të testimit

Hipoteza	Modeli	Metoda
H1	Modeli bazë	OLS
H2	Modeli i zgjeruar	OLS + ndërveprime
H3	Analiza sipas nënperiudhave	Chow, CUSUM
H4	Modeli me dummy krizash	OLS me ndërveprime
H5	Modeli i zgjeruar	Variabla kontrolli
H6	Modeli institucional me IKIPF	ARDL, Bounds Test, ECM

Burimi: Përpunim i autorit

Në tërësi, kjo kornizë konceptuale krijon bazën teorike dhe analitike të studimit, duke lidhur instrumentet fiskale, faktorët makroekonomikë, karakteristikat strukturore dhe dimensionin institucional me procesin e rritjes ekonomike. Në këtë mënyrë, ajo ofron një strukturë të qartë për interpretimin e rezultateve empirike dhe për vlerësimin e rolit që politika fiskale ka luajtur në zhvillimin dhe rimëkëmbjen ekonomike të Shqipërisë gjatë periudhës 2000–2024.

4.4 Përzgjedhja e variablave

Përzgjedhja e variablave përbën një hap të rëndësishëm në ndërtimin e modelit empirik, sepse përcakton mënyrën se si konceptet teorike të studimit kthehen në tregues të matshëm. Variablat janë përzgjedhur në përputhje me literaturën mbi politikën fiskale dhe rritjen ekonomike, si edhe duke marrë parasysh karakteristikat strukturore të ekonomisë shqiptare. Qëllimi është që marrëdhëniet e testuara në model të kenë kuptim ekonomik dhe të mund të verifikohen statistikisht.

Në këtë studim, **variabla e varur** është *rritja ekonomike reale (GDP_GROWTH)*, e shprehur në përqindje. Ky tregues mat ndryshimin vjetor të Prodhimit të Brendshëm Bruto në terma realë dhe përdoret gjerësisht si indikator kryesor i performancës së përgjithshme ekonomike. Zgjedhja e GDP_GROWTH si variabël e varur lidhet drejtpërdrejt me qëllimin kryesor të kërkimit, i cili është vlerësimi i rolit të politikës fiskale në nxitjen e rritjes ekonomike dhe në mbështetjen e rimëkëmbjes pas krizave. Si tregues agregat, rritja ekonomike reflekton ndikimin e kombinuar të instrumenteve fiskale, kushteve makroekonomike të brendshme dhe zhvillimeve të jashtme ekonomike.

Variablat e pavarura janë instrumentet fiskale përmes të cilave qeveria ndikon në aktivitetin ekonomik. *Shpenzimet qeveritare (GOV_EXP)*, të shprehura si përqindje e GDP-së, përdoren për të matur shkallën e ndërhyrjes së shtetit në ekonomi dhe rolin e politikës fiskale në menaxhimin e kërkesës agregate. Ky tregues përfshin shpenzimet publike për mallra dhe shërbime, mbrojtjen sociale dhe funksione të tjera publike. Nga

pikëpamja teorike, rritja e shpenzimeve qeveritare mund të stimulojë aktivitetin ekonomik, sidomos gjatë periudhave të ngadalësimit ose krizës ekonomike. *Investimet publike (PUB_INV)*, gjithashtu të shprehura si përqindje e GDP-së, përfaqësojnë shpenzimet kapitale të qeverisë për infrastrukturë dhe projekte zhvillimore. Ato lidhen me përmirësimin e kapaciteteve prodhuese të ekonomisë dhe me krijimin e kushteve më të mira për rritje afatgjatë. Ndikimi i tyre mund të shfaqet me vonesë, pasi projektet infrastrukturore dhe zhvillimore kërkojnë kohë për t'u realizuar dhe për të dhënë rezultate në produktivitet, investime private dhe aktivitet ekonomik. *Të ardhurat tatimore (TAX_REV)*, të shprehura si përqindje e GDP-së, përdoren si tregues i kapacitetit të shtetit për të gjeneruar të ardhura publike dhe për të financuar shpenzimet e tij. Ky variabël pasqyron funksionimin e sistemit tatimor, nivelin e formalizimit të ekonomisë dhe aftësinë e administratës fiskale për të mbledhur të ardhura. Një sistem tatimor më efikas mund të mbështesë stabilitetin fiskal dhe financimin e shpenzimeve publike produktive. *Borxhi publik (PUBLIC_DEBT)*, i matur si përqindje e GDP-së, përfaqëson nivelin e detyrimeve financiare të shtetit dhe shërben si tregues i hapësirës fiskale. Ky variabël lidhet me aftësinë e qeverisë për të ndërmarrë politika mbështetëse pa rrezikuar qëndrueshmërinë e financave publike. Nivelet e larta të borxhit mund të kufizojnë fleksibilitetin fiskal, të rrisin kostot e financimit dhe të zhvendosin burimet buxhetore drejt shërbimit të borxhit, në vend të investimeve me ndikim më të lartë zhvillimor.

Përveç variablave fiskale, modeli përfshin edhe ***variabla kontrolluese makroekonomike***, me qëllim që ndikimi i politikës fiskale mbi rritjen ekonomike të vlerësohet më qartë. *Inflacioni (INFLATION)* përfshihet si tregues i stabilitetit të çmimeve dhe i kushteve të përgjithshme makroekonomike. Ai matet përmes normës vjetore të ndryshimit të Indeksit të Çmimeve të Konsumit (CPI). Nivelet e larta të inflacionit zakonisht rrisin pasigurinë ekonomike dhe mund të ndikojnë negativisht në konsum, investime dhe rritje ekonomike. *Papunësia (UNEMPLOYMENT)* përdoret si tregues i gjendjes së tregut të punës dhe i shkallës së shfrytëzimit të kapitalit njerëzor. Nivelet e larta të papunësisë tregojnë kapacitete të pashfrytëzuara dhe kërkesë më të dobët agregate, ndërsa nivelet më të ulëta reflektojnë një ekonomi më aktive dhe përdorim më të mirë të burimeve njerëzore. Për këtë arsye, papunësia përfshihet në model si variabël që pasqyron kushtet ciklike të ekonomisë. *Eksportet (EXPORTS)*, të shprehura si përqindje e GDP-së, reflektojnë shkallën e hapjes së ekonomisë dhe integrimin e saj në tregjet ndërkombëtare. Për një ekonomi të vogël dhe të hapur si Shqipëria, eksportet përbëjnë një kanal të rëndësishëm për rritjen ekonomike, pasi lidhen me kërkesën e jashtme, konkurrueshmërinë dhe diversifikimin e burimeve të të ardhurave. *Remitancat (REMITTANCES)*, të shprehura si përqindje e GDP-së, përfaqësojnë transfertat financiare të emigrantëve drejt familjeve në vendin e origjinës. Në Shqipëri, remitancat kanë qenë një burim i rëndësishëm të ardhurash për familjet dhe një faktor stabilizues për konsumin dhe kërkesën agregate. Për këtë arsye, ato përfshihen në model si tregues i ndikimit të flukseve të jashtme financiare mbi aktivitetin ekonomik.

Në fund, studimi prezanton një element origjinal duke përfshirë një **variabël institucionale** të ndërtuar posaçërisht për këtë kërkim: *Indeksin e Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF)*. Ky indeks ka si qëllim të vlerësojë se sa cilësia e institucioneve ndikon në efektivitetin e politikës fiskale dhe, nëpërmjet saj, në rritjen ekonomike në Shqipëri. IKIPF është ndërtuar si një indeks i përbërë duke u bazuar në katër dimensionet kyçe të World Governance Indicators (WGI) të Bankës Botërore: Government Effectiveness (Efektiviteti i Qeverisjes), Regulatory Quality (Cilësia e Rregullimit), Rule of Law (Sundimi i Ligjit) dhe Control of Corruption (Kontrolli i Korrupsionit). Për të krijuar këtë indeks, së pari i rregulluam (standardizuam) të dhënat e të katër treguesve duke përdorur metodën z-score. Pastaj i bashkuam ato duke aplikuar Analizën e Komponentëve Kryesore (PCA). Zgjedhëm PCA sepse kjo metodë zbulon automatikisht peshën më të rëndësishme të çdo dimensionit, duke u bazuar në të dhënat reale të Shqipërisë. Kështu, indeksi reflekton kontributin real të çdo treguesi, pa i vendosur ne vetë pesha subjektive. Vlera më të larta të IKIPF tregojnë institucione më të forta, një administrim publik më efikas, sundim më të mirë të ligjit dhe nivel më të ulët korrupsioni, kushte që presupozojnë një kapacitet më të lartë për hartimin, zbatimin, monitorimin dhe rregullimin e politikave fiskale. Në këtë studim, IKIPF përdoret në dy mënyra kryesore: *Së pari*, si variabël e pavarur për të testuar ndikimin e drejtpërdrejtë të cilësisë institucionale mbi rritjen ekonomike. *Së dyti*, si variabël ndërvepruese (interaction term) për të analizuar nëse institucionet më të mira forcojnë efektin e politikës fiskale (p.sh. nëse shpenzimet publike ose deficitet kanë ndikim më pozitiv kur IKIPF është më i lartë).

Përzgjedhja e variablave fiskale, makroekonomike dhe institucionale është bërë në përputhje të plotë me kuadrin teorik dhe literaturën empirike ekzistuese. Kombinimi i tyre synon të ofrojë një pamje sa më të plotë të mekanizmave përmes të cilëve politika fiskale ndikon në aktivitetin ekonomik, si dhe të kushteve institucionale që mund të forcojnë ose të kufizojnë efektivitetin e saj në kontekstin specifik shqiptar.

Transformimi i variablave dhe diferencimi

Për të siguruar vlefshmërinë statistikore të analizës ekonometrike dhe për të shmangur problemin e regresioneve të rreme (spurious regressions), variablat u testuan fillimisht për stacionaritet. Literatura ekonometrike rekomandon që seritë kohore jo-stacionare të transformohen përmes diferencimit të parë, me qëllim stabilizimin e karakteristikave të tyre statistikore dhe rritjen e besueshmërisë së rezultateve (Gujarati & Porter, 2009; Wooldridge, 2013). Diferencimi i parë llogaritet si ndryshimi ndërmjet vlerës së një variabli në periudhën aktuale dhe asaj në periudhën paraprase:

$$D(X_t) = X_t - X_{t-1}$$

Rezultatet e testeve të stacionaritetit treguan se një pjesë e variablave nuk ishin plotësisht stacionare në nivel. Për këtë arsye, para përfshirjes në modelet ekonometrike u transformuan në diferencë të parë variablat: PUB_INV, TAX_REV, PUBLIC_DEBT, UNEMPLOYMENT, REMITTANCES dhe IKIPF. Përdorimi i diferencimit të parë mundëson analizimin e ndikimit të ndryshimeve vjetore të këtyre treguesve mbi rritjen ekonomike, duke reduktuar rrezikun e marrëdhënieve statistikore të rreme dhe duke përmirësuar qëndrueshmërinë e vlerësimeve ekonometrike (Stock & Watson, 2020). Duke qenë se analiza bazohet në një kampion relativisht të vogël vëzhgimesh vjetore, krahas niveleve standarde të rëndësisë statistikore prej 1% dhe 5%, në interpretimin e rezultateve merret në konsideratë edhe niveli 10%, praktikë e përdorur shpesh në studimet empirike me seri kohore të kufizuara. Variablat e transformuara përdoren në kapitujt vijues për të vlerësuar ndikimin e politikës fiskale, faktorëve makroekonomikë dhe kapacitetit institucional mbi rritjen ekonomike në Shqipëri gjatë periudhës 2000–2024.

4.5 Burimet e të dhënave dhe procedurat e analizës

Analiza empirike e këtij studimi mbështetet në të dhëna vjetore për periudhën 2000–2024, të marra nga burime zyrtare kombëtare dhe ndërkombëtare. Përzgjedhja e këtyre burimeve synon të sigurojë besueshmëri, krahasueshmëri në kohë dhe përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit statistikor. Baza e të dhënave është ndërtuar duke kombinuar informacionin e marrë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Banka e Shqipërisë, INSTAT, World Bank – World Development Indicators (WDI) dhe raportet Article IV të Fondit Monetar Ndërkombëtar (IMF). Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka shërbyer si burimi kryesor për treguesit fiskalë, përfshirë shpenzimet publike, investimet publike, të ardhurat tatimore dhe borxhin publik. Banka e Shqipërisë është përdorur për treguesit monetarë dhe financiarë, ndërsa INSTAT ka siguruar të dhënat mbi Prodhimin e Brendshëm Bruto, tregun e punës dhe tregues të tjerë makroekonomikë. World Development Indicators ka ofruar seri të standardizuara për rritjen ekonomike, inflacionin, eksportet dhe remitancat, ndërsa raportet e IMF janë përdorur si burim plotësues për analizën e zhvillimeve fiskale dhe makroekonomike.

Për analizimin e dimensionit institucional të politikës fiskale, studimi përdor gjithashtu të dhëna nga baza World Governance Indicators (WGI) e Bankës Botërore. Këto të dhëna janë përdorur për ndërtimin e Indeksit të Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF), i cili shërben si tregues i cilësisë institucionale dhe i kapaciteteve administrative që mbështesin hartimin dhe zbatimin e politikës fiskale. Përfshirja e këtij indeksi mundëson vlerësimin empirik të rolit të kapacitetit institucional në efektivitetin e politikës fiskale dhe në procesin e rritjes ekonomike.

Përdorimi i kombinuar i këtyre burimeve ndihmon në krahasimin dhe verifikimin e të dhënave, duke rritur saktësinë dhe besueshmërinë e analizës. Si rezultat, baza e ndërtuar e të dhënave siguron përputhje me standardet ndërkombëtare dhe krijon një bazë të

përshtatshme për analizën ekonometrike të efektivitetit të politikës fiskale në Shqipëri gjatë periudhës 2000–2024.

Megjithëse të dhënat e përdorura burojnë nga institucione të besueshme dhe gjerësisht të përdorura në studimet empirike, analiza e serive kohore për një periudhë relativisht të gjatë paraqet disa kufizime metodologjike. Ndryshimet në klasifikimet statistikore, rishikimet periodike të të dhënave dhe mungesa e disa serive të plota për vitet e para të tranzicionit ekonomik mund të ndikojnë në krahasueshmërinë e tyre ndër vite. Për të minimizuar këto probleme, është kryer procesi i verifikimit, harmonizimit dhe krahasimit të të dhënave ndërmjet burimeve të ndryshme. Në mënyrë të veçantë, të dhënat institucionale të përdorura për ndërtimin e IKIPF duhet të interpretohen si një vlerësim i përgjithshëm i kapacitetit institucional, pasi treguesit e qeverisjes së WGI bazohen pjesërisht në perceptime dhe vlerësime të ekspertëve. Megjithatë, ato mbeten ndër treguesit më të përdorur ndërkombëtarisht për matjen e cilësisë institucionale dhe të qeverisjes.

Përpunimi dhe analiza e të dhënave janë realizuar në programin EViews, i cili përdoret gjerësisht në analizën e serive kohore dhe në studimet makroekonomike empirike. Fillimisht janë ndërtuar dhe organizuar seritë kohore për periudhën 2000–2024, ndërsa më pas janë kryer transformimet e nevojshme të variablave. Në rastet kur testet e stacionaritetit identifikuan prani të rrënjës unitare, variablat u transformuan përmes diferencimit të parë me qëllim shmangien e regreseve të rreme dhe sigurimin e vlefshmërisë statistikore të rezultateve. Stacionariteti i serive kohore u verifikua përmes testit Augmented Dickey–Fuller (ADF), në përputhje me praktikën standarde të analizës ekonometrike (Gujarati & Porter, 2009; Wooldridge, 2013).

Analiza empirike mbështetet kryesisht në metodën e Katroreve Më të Vegjëll (Ordinary Least Squares – OLS), e cila përdoret për të vlerësuar ndikimin e instrumenteve fiskale mbi rritjen ekonomike. Krahas modelit bazë, janë vlerësuar edhe modele të zgjeruara që përfshijnë variabla kontrolli makroekonomike dhe terma ndërveprues, me qëllim testimin e hipotezave të studimit dhe verifikimin e qëndrueshmërisë së rezultateve. Për testimin e hipotezës së gjashtë (H6), që lidhet me rolin e kapacitetit institucional në efektivitetin e politikës fiskale, është përdorur edhe metodologjia Autoregressive Distributed Lag (ARDL). Kjo metodë konsiderohet veçanërisht e përshtatshme për kampione relativisht të vogla dhe për seri kohore me rend integrimi të përzier I (0) dhe I(1), duke mundësuar njëkohësisht analizimin e marrëdhënieve afatshkurtra dhe afatgjata ndërmjet variablave (Pesaran, Shin & Smith, 2001). Në kuadër të analizës ARDL janë realizuar edhe Bounds Test për identifikimin e marrëdhënieve afatgjata, si dhe modeli i korrigjimit të gabimit (Error Correction Model – ECM), i cili vlerëson shpejtësinë e rikthimit drejt ekuilibrit afatgjatë pas goditjeve ekonomike.

Për të garantuar besueshmërinë e rezultateve, modelet ekonometrike janë shoqëruar me teste diagnostikuese për autokorrelacionin, heteroskedasticitetin, normalitetin e mbetjeve dhe multikolinearitetin. Këto teste mundësojnë verifikimin e supozimeve themelore të modeleve dhe rrisin besueshmërinë statistikore të rezultateve të marra. Kjo qasje analitike siguron një proces të strukturuar dhe transparent të analizës së të dhënave, duke bërë të mundur që rezultatet empirike të jenë të verifikueshme dhe të riprodhueshme.

Një element i rëndësishëm i analizës lidhet me vlerësimin e stabilitetit të marrëdhënieve ekonomike gjatë periudhës së studimit. Duke qenë se periudha 2000–2024 përfshin episode të rëndësishme si kriza financiare globale e viteve 2008–2009 dhe pandemia COVID-19 në vitin 2020, është e nevojshme të verifikohet nëse këto ngjarje kanë shkaktuar ndryshime në parametrat e modelit. Për këtë arsye janë përdorur testet Chow Breakpoint, CUSUM dhe CUSUM of Squares (CUSUMSQ), të cilat mundësojnë identifikimin e thyerjeve strukturore dhe vlerësimin e stabilitetit të modelit gjatë gjithë periudhës së analizës (Bai & Perron, 2003). Chow Breakpoint Test përdoret për të analizuar nëse parametrat e modelit ndryshojnë në një pikë të caktuar kohore. Në këtë studim, testi aplikohet për vitet 2008, 2009 dhe 2020, të cilat lidhen me goditje të rëndësishme ekonomike gjatë periudhës së analizës. CUSUM Test përdoret për të vlerësuar stabilitetin e parametrave të modelit gjatë gjithë periudhës së studimit. Nëse vlerat e testit qëndrojnë brenda kufijve kritikë, atëherë parametrat konsiderohen të qëndrueshëm dhe nuk evidentohet ndryshim i rëndësishëm strukturor. CUSUM of Squares (CUSUMSQ) shërben si një kontroll shtesë për stabilitetin e modelit, duke analizuar ndryshimet në variancën e mbetjeve. Ky test ndihmon në identifikimin e luhatjeve të papritura që mund të mos evidentohen nga testi standard CUSUM.

Përdorimi i këtyre testeve në mënyrë të kombinuar mundëson një vlerësim më të plotë të stabilitetit të modelit ekonometrik. Rezultatet e tyre paraqiten dhe interpretohen në kapitullin vijues, ku analizohet nëse marrëdhënia ndërmjet instrumenteve të politikës fiskale dhe rritjes ekonomike në Shqipëri ka mbetur e qëndrueshme apo ka ndryshuar në përgjigje të krizave ekonomike gjatë periudhës 2000–2024.

Përveç vlerësimit të marrëdhënieve fiskale për të gjithë periudhën e studimit, analiza merr në konsideratë edhe ndikimin e kushteve makroekonomike në efektivitetin e politikës fiskale. Qasjet bashkëkohore në literaturën ekonomike theksojnë se rezultatet e ndërhyrjeve fiskale varen nga faza e ciklit ekonomik dhe se intensiteti i efekteve të tyre mund të ndryshojë ndjeshëm ndërmjet periudhave të stabilitetit dhe periudhave të krizës (Auerbach & Gorodnichenko, 2012). Në këtë kuadër, studimi adopton një perspektivë dinamike, duke analizuar politikën fiskale në kontekste të ndryshme ekonomike dhe duke shqyrtuar nëse ndikimi i saj mbi rritjen ekonomike paraqet ndryshime sipas kushteve mbizotëruese të ekonomisë. Për këtë qëllim, periudha 2000–2024 është strukturuar në tre nënperiudha që përfaqësojnë regjime të ndryshme makroekonomike. Kjo ndarje krijon

mundësinë për të krahasuar rezultatet ndërmjet fazave të ndryshme të zhvillimit ekonomik, për të identifikuar ndryshimet në efektivitetin e instrumenteve fiskale dhe për të vlerësuar se në cilat kushte politika fiskale ka kontribuar më shumë në mbështetjen e aktivitetit ekonomik dhe procesit të rimëkëmbjes.

Tabela 4.3 Ndarja e periudhës sipas regjimeve makroekonomike

Regjimi ekonomik	Periudha
Zgjerimi ekonomik para krizës globale	2000–2008
Kriza financiare globale dhe konsolidimi fiskal	2009–2019
Pandemia COVID-19 dhe rimëkëmbja ekonomike	2020–2024

Burimi: Përgatitur nga autori

Periudha 2000–2008 përfaqëson fazën para krizës financiare globale dhe karakterizohet nga stabilitet relativ makroekonomik dhe rritje ekonomike të qëndrueshme në Shqipëri. Kjo ishte një periudhë e konsolidimit të reformave ekonomike dhe zgjerimit gradual të aktivitetit ekonomik.

Periudha 2009–2019 pason krizën financiare globale dhe reflekton ndikimet e saj indirekte në ekonominë shqiptare, si ngadalësimi i rritjes ekonomike, ndryshime në orientimin e politikave fiskale dhe rritje e borxhit publik. Në këtë kontekst, politika fiskale mori një rol më aktiv në stabilizimin makroekonomik.

Ndërsa periudha 2020–2024 lidhet me krizën e shkaktuar nga pandemia COVID-19, e cila prodhoi një goditje të menjëhershme në aktivitetin ekonomik dhe kërkoi ndërhyrje të konsiderueshme fiskale për mbështetjen e ekonomisë. Megjithatë, kjo nënperiudhë përfshin një numër relativisht të vogël vëzhgimesh, çka kufizon mundësinë për analiza statistikore më të thelluara. Për këtë arsye, interpretimi i rezultateve mbështetet jo vetëm në rëndësinë statistikore të koeficientëve, por edhe në drejtimin e tyre, koherencën ekonomike dhe krahasimin ndërmjet periudhave.

Kjo ndarje mundëson analizimin e rolit të politikës fiskale në kontekste të ndryshme ekonomike dhe ndihmon në interpretimin më të saktë të rezultateve empirike. Në tërësi, kombinimi i burimeve të besueshme të të dhënave, metodave ekonometrike OLS dhe ARDL, testeve diagnostikuese dhe analizës së regjimeve makroekonomike krijon një bazë metodologjike të qëndrueshme për vlerësimin e efektivitetit të politikës fiskale dhe rolit të kapacitetit institucional në rritjen ekonomike të Shqipërisë gjatë periudhës 2000–2024.

4.6 Përpunimi dhe transformimi i të dhënave

Përpara ndërtimit të modeleve ekonometrike, të dhënat e përdorura në studim iu nënshtruan një procesi sistematik përpunimi dhe transformimi, me qëllim sigurimin e

krahasueshmërisë ndërkohore, përmirësimin e cilësisë së serive kohore dhe përmbushjen e kërkesave metodologjike të analizës ekonometrike. Ky proces përbën një fazë të rëndësishme të studimit, pasi ndikon drejtpërdrejt në besueshmërinë e rezultateve dhe në interpretimin e tyre.

Duke qenë se të dhënat janë mbledhur nga burime të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, fillimisht u realizua harmonizimi i serive kohore. Për këtë arsye, një pjesë e treguesve fiskalë dhe makroekonomikë u shprehën si përqindje e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), duke mundësuar krahasimin e tyre në kohë dhe duke shmangur ndikimin e ndryshimeve në madhësinë e ekonomisë. Gjithashtu, u standardizuan njësitë e matjes, në mënyrë që të gjithë treguesit të paraqiteshin në forma të krahasueshme, si norma vjetore ose përqindje ndaj PBB-së. Në rastin e variablës institucionale, Indeksi i Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF) u ndërtua dhe u harmonizua sipas të njëjtës metodologji përgjatë gjithë periudhës së analizës, duke siguruar konsistencë dhe krahasueshmëri ndërmjet viteve.

Pas harmonizimit të të dhënave, u kryen transformimet e nevojshme statistikore. Në analizën e serive kohore, një nga kushtet kryesore për ndërtimin e modeleve të besueshme ekonometrike është stacionariteti i variablave. Për këtë arsye, në rastet kur testet e stacionaritetit evidentuan praninë e rrënjës unitare, variablat u transformuan përmes diferencimit të parë, në përputhje me rekomandimet e literaturës ekonometrike (Gujarati & Porter, 2009; Wooldridge, 2013). Ky transformim ndihmon në shmangien e regresioneve të rreme (spurious regressions) dhe siguron që marrëdhëniet e identifikuara të pasqyrojnë lidhje reale ekonomike. Diferencimi i parë u aplikua për variablat që rezultuan jo-stacionare në nivel, përfshirë edhe variablën institucionale IKIPF. Në të njëjtën kohë, për analizën e hipotezës së fundit u ruajtën specifikimet e nevojshme për aplikimin e metodologjisë ARDL, e cila lejon kombinimin e variablave me rend integrimi I (0) dhe I (1), pa kërkuar që të gjitha seritë të jenë stacionare në të njëjtin nivel (Pesaran, Shin & Smith, 2001).

Gjatë procesit të përpunimit është treguar kujdes edhe ndaj vlerave ekstreme, të cilat shfaqen kryesisht gjatë periudhave të krizës ekonomike, si kriza financiare globale e viteve 2008–2009 dhe pandemia COVID-19. Këto vlera nuk janë eliminuar nga analiza, pasi përfaqësojnë zhvillime reale ekonomike me rëndësi për objektivat e studimit. Në vend të kësaj, ndikimi i tyre është vlerësuar nëpërmjet testeve diagnostikuese dhe specifikimeve alternative të modeleve. Gjithashtu, është kontrolluar prania e trendeve afatgjata në seri kohore, me qëllim përcaktimin e formës më të përshtatshme të specifikimit ekonometrik.

Analiza empirike mbështetet në 25 observime vjetore që mbulojnë periudhën 2000–2024. Përdorimi i frekuencës vjetore lidhet me disponueshmërinë dhe konsistencën e të dhënave makroekonomike për Shqipërinë, si dhe me nevojën për të ruajtur homogjenitetin

e serive kohore përgjatë gjithë periudhës së studimit. Edhe pse kampioni konsiderohet relativisht i kufizuar, ai është tipik për studimet makroekonomike mbi ekonominë në zhvillim. Kjo karakteristikë metodologjike përbën gjithashtu një nga arsyet kryesore për përdorimin e metodologjisë ARDL në analizën e Hipotezës H6, pasi literatura argumenton se kjo metodë prodhon rezultate të qëndrueshme edhe në kampione të vogla dhe në seri kohore me rend integrimi të ndryshëm (Pesaran, Shin & Smith, 2001).

Megjithatë, madhësia e kufizuar e kampionit mund të reduktojë fuqinë statistikore të disa testeve dhe ta bëjë më të vështirë identifikimin e efekteve me intensitet më të ulët. Për këtë arsye, rezultatet interpretohen jo vetëm mbi bazën e rëndësisë statistikore, por edhe duke marrë në konsideratë drejtimin e koeficientëve, koherencën e tyre ekonomike dhe përputhshmërinë me literaturën teorike dhe empirike. Gjithashtu, krahas niveleve standarde të rëndësisë statistikore prej 1% dhe 5%, në interpretimin e rezultateve merret në konsideratë edhe pragu prej 10%, i cili përdoret shpesh në studimet empirike me kampione relativisht të vogla.

Në tërësi, procesi i harmonizimit, transformimit dhe verifikimit të të dhënave krijon një bazë të qëndrueshme për analizën ekonometrike dhe kontribuon në rritjen e besueshmërisë së rezultateve të paraqitura në kapitujt vijues.

4.7 Specifikimi ekonometrik i modelit

Për të testuar hipotezat e studimit dhe për të vlerësuar ndikimin e politikës fiskale në rritjen ekonomike të Shqipërisë gjatë periudhës 2000–2024, analiza empirike është ndërtuar mbi një strategji ekonometrike të zhvilluar në disa hapa të ndërlidhur. Kjo qasje mundëson vlerësimin gradual të marrëdhënies ndërmjet instrumenteve fiskale, faktorëve makroekonomikë dhe dimensionit institucional, duke marrë parasysh njëkohësisht ndryshimet që kanë karakterizuar periudhat e ndryshme të zhvillimit ekonomik.

Analiza fillon me vlerësimin e modelit bazë OLS, i cili fokusohet në ndikimin e instrumenteve kryesore të politikës fiskale mbi rritjen ekonomike. Më pas, modeli zgjerohet përmes përfshirjes së variablave makroekonomike kontrolluese, me qëllim që efektet fiskale të analizohen në një kontekst më të gjerë ekonomik. Në vijim, përdoren modele me variabla dummy dhe terma ndërveprimi për të vlerësuar nëse efektiviteti i politikës fiskale ndryshon gjatë episodeve të rëndësishme të krizave ekonomike, konkretisht gjatë krizës financiare globale të viteve 2008–2009 dhe pandemisë COVID-19.

Për të analizuar më tej heterogjenitetin e efekteve fiskale, modelet ekonometrike aplikohen edhe veçmas për tre regjime kryesore makroekonomike: periudhën e zgjerimit ekonomik para krizës (2000–2008), periudhën e stabilizimit dhe konsolidimit fiskal (2009–2019) dhe periudhën e pandemisë dhe rimëkëmbjes ekonomike (2020–2024). Kjo qasje

mundëson krahasimin e rezultateve ndërmjet konteksteve të ndryshme ekonomike dhe identifikimin e ndryshimeve në efektivitetin e politikës fiskale.

Për shkak të numrit relativisht të kufizuar të vëzhgimeve në nënperiudhën 2020–2024, analiza plotësohet edhe me mini-regresione bivariate dhe me analizën e korelacionit Pearson, të cilat ndihmojnë në interpretimin e marrëdhënieve ndërmjet variablave kryesore në kushtet e një kampioni të vogël. Gjithashtu, për të verifikuar praninë e ndryshimeve strukturore në seri kohore dhe për të justifikuar ndarjen e analizës sipas nënperiudhave, përdoren testet Chow, CUSUM dhe CUSUMSQ.

Së fundi, për testimin e hipotezës që lidhet me rolin e kapacitetit institucional në efektivitetin e politikës fiskale (H6), analiza zgjerohet përmes metodologjisë Autoregressive Distributed Lag (ARDL). Kjo metodë është veçanërisht e përshtatshme për kampione relativisht të vogla dhe për seri kohore me rend integrimi të përzier, duke mundësuar vlerësimin e marrëdhënieve afatshkurtra dhe afatgjata ndërmjet politikës fiskale, kapacitetit institucional dhe rritjes ekonomike (Pesaran, Shin & Smith, 2001).

Kjo strategji ekonometrike kombinon modele lineare, analiza sipas regjimeve makroekonomike, teste të stabilitetit strukturor dhe modele dinamike afatgjata, duke krijuar një kuadër të plotë analitik për vlerësimin e rolit të politikës fiskale dhe faktorëve institucionalë në rritjen ekonomike të Shqipërisë.

4.7.1 Modeli bazë dhe i zgjeruar (OLS)

Modeli bazë përfaqëson hapin e parë të analizës ekonometrike dhe përdoret për të vlerësuar marrëdhënien ndërmjet instrumenteve kryesore të politikës fiskale dhe rritjes ekonomike në Shqipëri gjatë periudhës 2000–2024. Për vlerësimin e këtij modeli përdoret metoda e Katroreve më të Vogla të Zakonshme (Ordinary Least Squares – OLS), e cila konsiderohet një nga qasjet më të përdorura në analizën empirike të marrëdhënieve makroekonomike për shkak të thjeshtësisë së interpretimit dhe qëndrueshmërisë së rezultateve në kushte të caktuara statistikore (Stock & Watson, 2019). Fillimisht, modeli vlerësohet për të gjithë periudhën e studimit (2000–2024), me qëllim identifikimin e efektit mesatar të politikës fiskale mbi rritjen ekonomike. Më pas, i njëjti specifikim aplikohet edhe për nënperiudhat e identifikuara në analizë, duke mundësuar krahasimin e rezultateve ndërmjet regjimeve të ndryshme makroekonomike dhe vlerësimin e ndryshimeve të mundshme në efektivitetin e politikës fiskale.

Në këtë fazë të analizës, modeli fokusohet ekskluzivisht te instrumentet kryesore fiskale, përkatësisht shpenzimet qeveritare, investimet publike, të ardhurat tatimore dhe borxhi publik, pa përfshirë ende variabla të tjerë makroekonomikë kontrollues. Kjo mundëson identifikimin e ndikimit të drejtpërdrejtë të politikës fiskale mbi rritjen

ekonomike dhe krijon bazën për krahasimet me modelet e zgjeruara që paraqiten në vijim. Forma e përgjithshme e modelit paraqitet si më poshtë:

$$\text{GDP_GROWTH}_t = \beta_0 + \beta_1 * \text{GOV_EXP}_t + \beta_2 * \Delta \text{PUB_INV}_t + \beta_3 * \Delta \text{TAX_REV}_t + \beta_4 * \Delta \text{PUBLIC_DEBT}_t + \varepsilon_t$$

Ku: GDP_GROWTH paraqet normën e rritjes reale ekonomike, GOV_EXP shpenzimet qeveritare, ndërsa $\Delta \text{PUB_INV}$, $\Delta \text{TAX_REV}$ dhe $\Delta \text{PUBLIC_DEBT}$ përfaqësojnë ndryshimet vjetore të investimeve publike, të ardhurave tatimore dhe borxhit publik. Termi ε_t paraqet komponentin e gabimit të modelit

Përdorimi i metodës OLS në këtë studim justifikohet nga natyra e të dhënave, frekuenca vjetore e serive kohore dhe madhësia relativisht e kufizuar e kampionit. Për më tepër, modeli bazë shërben si pikë reference për të gjithë analizën empirike, pasi rezultatet e tij krahasohen më pas me ato të modeleve të zgjeruara, modeleve me ndërveprime krizash dhe specifikimeve të tjera ekonometrike. Në këtë mënyrë, ai krijon bazën analitike mbi të cilën ndërtohet vlerësimi i rolit të politikës fiskale në rritjen ekonomike të Shqipërisë gjatë periudhës së studiuar.

Për të siguruar një vlerësim më të plotë të faktorëve që ndikojnë në rritjen ekonomike, analiza zgjerohet përtej instrumenteve fiskale duke përfshirë edhe një grup variablash makroekonomikë kontrollues. Kjo qasje mbështetet në literaturën empirike, e cila argumenton se rritja ekonomike ndikohet jo vetëm nga politika fiskale, por edhe nga kushtet e përgjithshme makroekonomike, zhvillimet në tregun e punës, sektori i jashtëm dhe burime të tjera financiare që ndikojnë kërkesën agregate dhe aktivitetin ekonomik. Përfshirja e variablave kontrollues synon të izolojë sa më mirë ndikimin e instrumenteve fiskale mbi rritjen ekonomike dhe të reduktojë rrezikun e paragjykitimit të rezultateve nga faktorë të tjerë që veprojnë njëkohësisht në ekonomi. Në këtë mënyrë, bëhet e mundur një vlerësim më realist dhe më i besueshëm i rolit të politikës fiskale në kontekstin e ekonomisë shqiptare. Modeli i zgjeruar paraqitet në formën e mëposhtme:

$$\text{GDP_GROWTH}_t = \beta_0 + \beta_1 * \text{GOV_EXP}_t + \beta_2 * \Delta \text{PUB_INV}_t + \beta_3 * \Delta \text{TAX_REV}_t + \beta_4 * \Delta \text{PUBLIC_DEBT}_t + \beta_5 * \text{INFLATION}_t + \beta_6 * \Delta \text{UNEMPLOYMENT}_t + \beta_7 * \Delta \text{REMITTANCES}_t + \beta_8 * \text{EXPORTS}_t + \varepsilon_t$$

ku, krahas variablave fiskale të modelit bazë, përfshihen edhe inflacioni (INFLATION) si tregues i stabilitetit makroekonomik, papunësia (UNEMPLOYMENT) si tregues i kushteve të tregut të punës, remitancat (REMITTANCES) si burim i rëndësishëm i të ardhurave nga jashtë, si dhe eksportet (EXPORTS), të cilat pasqyrojnë shkallën e integritimit të ekonomisë shqiptare në tregjet ndërkombëtare.

Modeli vlerësohet për të gjithë periudhën 2000–2024 dhe për nënperiudhat e identifikuar në analizë, duke mundësuar krahasimin e rezultateve ndërmjet regjimeve të ndryshme makroekonomike. Krahasimi me modelin bazë lejon të vlerësohet nëse ndikimi i instrumenteve fiskale mbetet i qëndrueshëm edhe pas kontrollit për faktorë të tjerë ekonomikë që ndikojnë rritjen ekonomike. Në këtë kuptim, modeli i zgjeruar përfaqëson një hap të rëndësishëm metodologjik, pasi e vendos analizën e politikës fiskale në një kontekst më të gjerë makroekonomik dhe mundëson identifikimin më të saktë të faktorëve që kanë ndikuar në performancën ekonomike të Shqipërisë gjatë periudhës 2000–2024.

4.7.2 Modeli me ndërveprime krizash

Një nga synimet kryesore të këtij studimi është të kuptojë nëse efektiviteti i politikës fiskale ka qenë i njëjtë gjatë gjithë periudhës 2000–2024, apo ka ndryshuar në varësi të kushteve ekonomike. Modelet lineare të thjeshta supozojnë se lidhja midis politikës fiskale dhe rritjes ekonomike mbetet konstante në kohë. Megjithatë, shumë studime empirike tregojnë se politika fiskale ka tendencë të jetë më efektive gjatë periudhave të krizës, kur konsumatorët dhe bizneset shpenzojnë më pak, kapacitetet prodhuese mbeten të pashfrytëzuara dhe shteti luan një rol më të rëndësishëm stabilizues (Auerbach & Gorodnichenko, 2013; Blanchard & Leigh, 2013). Për të testuar këtë ide, studimi përdor një model me ndërveprime krizash. Ky model lejon matjen e ndryshimit të efektit të politikës fiskale gjatë dy episodeve kryesore të krizës: krizës financiare globale të vitit 2009 dhe pandemisë COVID-19 në vitin 2020. Në model janë përfshirë dy variabla dummy (D2009 dhe D2020) që identifikojnë vitet e krizës, si dhe dy terma ndërveprimi midis këtyre variablave dhe shpenzimeve qeveritare. Kjo strukturë na mundëson të dallojmë jo vetëm efektin bazë të shpenzimeve qeveritare, por edhe ndryshimin e këtij efekti gjatë krizave. Modeli është specifikuar si më poshtë:

$$\begin{aligned} \text{GDP_GROWTH}_t = & \beta_0 + \beta_1 * \text{GOV_EXP}_t + \beta_2 * \Delta \text{PUB_INV}_t + \beta_3 * \Delta \text{TAX_REV}_t + \\ & \beta_4 * \Delta \text{PUBLIC_DEBT}_t + \beta_5 * \text{INFLATION}_t + \beta_6 * \Delta \text{UNEMPLOYMENT}_t + \\ & \beta_7 * \Delta \text{REMITTANCES}_t + \beta_8 * \text{EXPORTS}_t + \beta_9 * \text{D2009} + \beta_{10} * \text{D2020} + \\ & \beta_{11} * (\text{GOV_EXP}_t * \text{D2009}) + \beta_{12} * (\text{GOV_EXP}_t * \text{D2020}) + \varepsilon_t \end{aligned}$$

Ku:

- D2009 merr vlerën 1 për vitin 2009 dhe 0 për vitet e tjera;
- D2020 merr vlerën 1 për vitin 2020 dhe 0 për vitet e tjera.

Në këtë model, koeficienti β_1 mat efektin e shpenzimeve qeveritare në periudhat normale ekonomike, ndërsa β_9 dhe β_{10} kapin ndikimin e drejtpërdrejtë të krizës financiare globale dhe pandemisë COVID-19 mbi rritjen ekonomike. Koeficientët β_{11} dhe β_{12} janë

veçanërisht të rëndësishëm, pasi tregojnë nëse efekti i shpenzimeve qeveritare ndryshon gjatë periudhave të krizës.

Për rrjedhojë, efekti total i shpenzimeve qeveritare gjatë episodeve të krizës llogaritet si:

- Për krizën financiare globale të vitit 2009: $\beta_1 + \beta_{11}$
- Për periudhën e pandemisë COVID-19: $\beta_1 + \beta_{12}$

Nëse β_{11} ose β_{12} dalin pozitivë dhe statistikisht të rëndësishëm, kjo do të thotë se shpenzimet qeveritare kanë pasur një ndikim më të madh në rritjen ekonomike gjatë krizave sesa në periudhat normale. Ky rezultat do të mbështeste idenë se multiplikatorët fiskalë janë më të lartë në kohë recesioni dhe pasigurie, kur ndërhyrja e shtetit bëhet më e nevojshme për të mbështetur aktivitetin ekonomik. Përdorimi i këtij modeli është shumë i rëndësishëm sepse na lejon të testojmë drejtpërdrejt hipotezën e natyrës kundërciklike të politikës fiskale. Ai ndihmon në kuptimin më të thellë se si ndryshojnë mekanizmat e transmetimit të politikës fiskale në periudha të ndryshme, duke dhënë një pamje më reale të rolit të saj në stabilizimin dhe rimëkëmbjen e ekonomisë shqiptare gjatë 25 viteve të fundit.

4.7.3 Modelet ekonometrike në analizën sipas nënperiudhave

Përveç analizës së periudhës së plotë 2000–2024, studimi zhvillon edhe një analizë sipas nënperiudhave, me qëllim identifikimin e ndryshimeve në efektivitetin e politikës fiskale ndërmjet regjimeve të ndryshme makroekonomike. Kjo qasje mbështetet në argumentin teorik dhe empirik se marrëdhënia ndërmjet politikës fiskale dhe rritjes ekonomike nuk mbetet e pandryshuar në kohë, por ndikohet nga faza e ciklit ekonomik, niveli i hapësirës fiskale dhe natyra e goditjeve ekonomike (Auerbach & Gorodnichenko, 2013; Blanchard & Leigh, 2013). Për këtë arsye, analiza ndahet në tre periudha kryesore: periudhën e zgjerimit ekonomik para krizës globale (2000–2008), periudhën e konsolidimit fiskal pas krizës financiare (2009–2019) dhe periudhën e pandemisë dhe rimëkëmbjes ekonomike (2020–2024).

Për periudhën 2000–2008 përdoren i njëjti model bazë dhe modeli i zgjeruar të paraqitur më sipër. Kjo periudhë karakterizohet nga ritme të larta rritjeje ekonomike, përmirësim gradual i financave publike dhe rritje e aktivitetit privat. Analiza synon të vlerësojë nëse instrumentet fiskale kanë ndikuar në rritjen ekonomike në kushte stabiliteti relativ makroekonomik dhe zgjerimi ekonomik. Krahas variablave fiskale, modeli i zgjeruar përfshin inflacionin, papunësinë, remitancat dhe eksportet, duke mundësuar kontrollin për faktorët kryesorë makroekonomikë dhe strukturorë që karakterizojnë ekonominë shqiptare gjatë kësaj periudhe.

Për periudhën 2009–2019 ruhet e njëjta logjikë metodologjike, duke mundësuar krahasimin e rezultateve me periudhën para krizës. Fillimisht vlerësohet modeli bazë, ndërsa më pas analiza zgjerohet përmes dy specifikimeve alternative. Varianti i parë fokusohet te faktorët e stabilitetit të brendshëm makroekonomik dhe përfshin inflacionin dhe papunësinë si variabla kontrolluese. Varianti i dytë përqendrohet te sektori i jashtëm dhe përfshin eksportet dhe remitancat. Kjo qasje mundëson testimin e qëndrueshmërisë së rezultateve dhe ndihmon në vlerësimin e rolit të politikës fiskale në një periudhë të karakterizuar nga konsolidimi fiskal, kontrolli i deficitit buxhetor dhe kufizime më të mëdha të hapësirës fiskale. Përdorimi i specifikimeve alternative lejon gjithashtu identifikimin e faktorëve që kanë ndikuar më shumë në transmetimin e politikës fiskale gjatë kësaj faze të zhvillimit ekonomik.

Ndryshe nga periudhat e mëparshme, analiza për vitet 2020–2024 haset me një kufizim të rëndësishëm: numri shumë i vogël i vëzhgimeve (vetëm 5 vite). Për shkak të kësaj, nuk është e mundur të përdoret një model kompleks me shumë variabla, sepse rezultatet do të ishin të paqëndrueshme dhe të pasigurta. Prandaj, në këtë nënperiudhë është përdorur një model OLS shumë i thjeshtuar, që përfshin vetëm dy instrumentet kryesore fiskale të pandemisë: shpenzimet qeveritare dhe ndryshimin e borxhit publik.

$$\text{GDP_GROWTH}_t = \beta_0 + \beta_1 * \text{GOV_EXP}_t + \beta_2 * \Delta \text{PUBLIC_DEBT}_t + \varepsilon_t$$

Ky model i thjeshtë është zgjedhur pikërisht sepse gjatë pandemisë dhe rimëkëmbjes, ndërhyrja e qeverisë u fokusua kryesisht te rritja e shpenzimeve dhe te huamarrja (borxhi publik). Me kaq pak observime, shtimi i variablave të tjera do të rrezikonte cilësinë e analizës. Për të plotësuar analizën ekonometrike në këtë periudhë të shkurtër, janë përdorur edhe disa analiza të thjeshta eksploruese:

1. *Mini-regresione bivariate*, ku rritja ekonomike testohet veçmas me çdo variabël (p.sh. vetëm me shpenzimet, vetëm me borxhin, vetëm me remitancat etj.):

$$\text{GDP_GROWTH}_t = \alpha_0 + \alpha_1 X_t + u_t$$

ku X_t përfaqëson secilën nga variablat e analizuara individualisht. Këto regresione ndihmojnë në identifikimin e drejtimit të marrëdhënies ndërmjet variablave dhe në verifikimin paraprak të rezultateve të modelit kryesor.

2. *Koeficienti i korelacionit Pearson*, që mat sa fort dhe në çfarë drejtimi lidhen rritja ekonomike me tregues të tjerë si shpenzimet qeveritare, borxhi publik, eksportet dhe remitancat.

Këto metoda plotësuese janë veçanërisht të dobishme kur kemi pak të dhëna, sepse na ndihmojnë të kontrollojmë rezultatet nga kënde të ndryshme dhe të shmangim konkluzione të njëanshme. Ndarja e analizës në nënperiudha të ndryshme është një pjesë e rëndësishme e strategjisë së këtij studimi. Ajo na lejon të shohim se si ka funksionuar politika fiskale në kushte krejtësisht të ndryshme: gjatë rritjes ekonomike, konsolidimit fiskal dhe krizës së pandemisë. Kjo qasje ndihmon për një kuptim më realist dhe të plotë të rolit të politikës fiskale në ekonominë shqiptare gjatë 25 viteve të fundit.

4.7.4 Modeli institucional dhe metodologjia ARDL

Përveç instrumenteve tradicionale fiskale, ky studim shqyrton edhe rolin e institucioneve në efektivitetin e politikës fiskale. Kjo bëhet përmes hipotezës së gjashtë, e cila thotë se kapaciteti institucional ndikon pozitivisht jo vetëm në rritjen ekonomike, por edhe në aftësinë e politikës fiskale për të dhënë rezultate më të mira afatgjata. Për të testuar këtë hipotezë është krijuar Indeksi i Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF), një tregues sintetik që mat cilësinë e institucioneve publike në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave fiskale. Përfshirja e këtij indeksi mbështetet në literaturën bashkëkohore, e cila thekson se suksesi i politikës fiskale varet jo vetëm nga sa para shpenzon shteti, por sidomos nga sa të mira janë institucionet që i menaxhojnë ato para (Acemoglu & Robinson, 2012; Gerling et al., 2017; IMF, 2021). Për analizën e kësaj hipoteze është përdorur metodologjia Autoregressive Distributed Lag (ARDL), e zhvilluar nga Pesaran, Shin dhe Smith (2001). Kjo metodë u zgjodh për dy arsye kryesore:

- Variablat kanë rend integrimi të përzier (disa janë stacionare në nivel $I(0)$, të tjerat bëhen stacionare pas diferencimit $I(1)$).
- Kampioni është relativisht i vogël (25 observime vjetore), ku ARDL funksionon mirë.

Një avantazh i madh i ARDL është se mund të vlerësojë njëkohësisht marrëdhëniet afatshkurtra dhe afatgjata, pa kërkuar që të gjitha variablat të kenë të njëjtin nivel integrimi. Modeli i përdorur për testimin e H6 është:

$$\text{GDP_GROWTH}_t = \beta_0 + \beta_1 \text{GOV_EXP}_t + \beta_2 \Delta \text{PUB_INV}_t + \beta_3 \Delta \text{TAX_REV}_t + \beta_4 \Delta \text{PUBLIC_DEBT}_t + \beta_5 \text{IKIPF}_t + \beta_6 (\text{GOV_EXP}_t \times \text{IKIPF}_t) + \varepsilon_t$$

Në këtë model:

- β_5 mat ndikimin e drejtpërdrejtë të cilësisë institucionale mbi rritjen ekonomike.
- β_6 (termi i ndërveprimit) mat efektin moderues, pra nëse institucionet më të mira e forcojnë ndikimin e shpenzimeve qeveritare mbi ekonominë.

Numri optimal i lagëve (lags) në modelin ARDL u përcaktua duke përdorur kriteret AIC (Akaike Information Criterion) dhe SIC/Schwarz, duke zgjedhur modelin që ofron balancën më të mirë midis përshtatjes dhe thjeshtësisë.

Hapat e analizës ARDL:

1. Testimi i stacionaritetit të serive kohore (Augmented Dickey-Fuller dhe Phillips-Perron).
2. Bounds Test (Pesaran et al.) për të verifikuar nëse ekziston një marrëdhënie afatgjatë (cointegration) midis variablave.
3. Nëse Bounds Test konfirmon cointegration, vlerësohen koeficientët afatgjatë dhe modeli i korigjimit të gabimit (Error Correction Model – ECM), i cili tregon sa shpejt korigjohet devijimi nga ekuilibri afatgjatë.

Për të ilustruar qartë strategjinë e përgjithshme ekonometrike të studimit, Tabela 4.4 përmbledh hapat kryesorë:

Tabela 4.4 Strategjia ekonometrike e studimit

Hapi	Qëllimi	Metoda
1	Efekti mesatar fiskal	OLS (modeli bazë)
2	Kontroll për faktorë makroekonomikë	Modeli i zgjeruar
3	Heterogjeniteti i krizave	Dummy dhe terma ndërveprimi
4	Justifikim empirik i nënperiudhave	Chow, CUSUM
5	Analizë në kushte kampioni të vogël	Regresione bivariate dhe korelacion
6	Roli i kapacitetit institucional në efektivitetin fiskal	ARDL, Bounds Test, ECM

Burimi: Përpunim I autorit

Siç shihet nga tabela, strategjia ekonometrike është ndërtuar në mënyrë logjike dhe progresive. Ajo fillon me analizën bazë, vazhdon me kontrollin për faktorë të tjerë, teston ndryshimet gjatë krizave dhe kulmon me dimensionin institucional përmes modelit ARDL. Kjo qasje integruese lejon një vlerësim më të plotë, të thellë dhe realist të rolit të politikës fiskale në ekonominë shqiptare gjatë periudhës 2000–2024.

4.8 Testet diagnostikuese të modelit dhe validimi I modeleve ekonometrike

Për të garantuar që rezultatet empirike të jenë statistikisht të besueshme dhe të interpretohen në mënyrë të saktë, analiza ekonometrike shoqërohet me një sërë testesh diagnostikuese dhe procedurash validimi. Këto teste përdoren për të verifikuar nëse modelet e vlerësuara përmbushin kushtet bazë metodologjike dhe nëse marrëdhëniet e

identifikuara reflektojnë lidhje reale ekonomike. Në këtë studim, kontrollet diagnostikuese realizohen si për modelet OLS ashtu edhe për modelin ARDL, duke përforsuar besueshmërinë e rezultateve dhe të përfundimeve të studimit.

Një hap fillestar i analizës është verifikimi i stacionaritetit të serive kohore përmes testit Augmented Dickey–Fuller (ADF). Ky test përdoret për të identifikuar praninë e rrënjës unitare dhe për të përcaktuar rendin e integritit të secilës variabël. Rezultatet e tij shërbejnë si bazë për transformimin e të dhënave dhe përzgjedhjen e metodologjisë së përshtatshme ekonometrike, duke shmangur rrezikun e regresioneve të rreme dhe duke siguruar vlefshmërinë statistikore të modeleve të vlerësuara (Gujarati & Porter, 2009; Wooldridge, 2013).

Pas verifikimit të stacionaritetit, kontrollohet nëse modelet OLS përmbushin supozimet kryesore të regresionit linear. Për këtë qëllim analizohet prania e multikollinearitetit ndërmjet variablave shpjeguese përmes treguesit Variance Inflation Factor (VIF), i cili ndihmon në vlerësimin e shkallës së lidhjes ndërmjet variablave të modelit. Kontrolli i multikollinearitetit është i rëndësishëm për të siguruar që ndikimi individual i secilës variabël të interpretohet në mënyrë të qartë dhe të besueshme.

Gjithashtu, testohet prania e heteroskedasticitetit përmes testit Breusch–Pagan–Godfrey, me qëllim verifikimin e qëndrueshmërisë së variancës së gabimeve. Për autokorrelacionin e mbetjeve përdoret testi Breusch–Godfrey (1978), i cili është më i përshtatshëm për modelet me variabla të vonuar ose seri kohore. Ky kontroll është i rëndësishëm pasi heteroskedasticiteti mund të ndikojë në saktësinë e gabimeve standarde dhe, rrjedhimisht, në vlefshmërinë e inferencës statistikore. Në rastet kur konstatohet ky problem, përdoren korrigjime përkatëse për të ruajtur besueshmërinë e rezultateve.

Një kontroll tjetër i rëndësishëm lidhet me autokorrelacionin e mbetjeve, i cili vlerësohet përmes statistikës Durbin–Watson (1950). Ky test ndihmon në identifikimin e varësisë kohore të gabimeve dhe siguron që rezultatet e modelit të mos ndikohen nga struktura të brendshme të paidentifikuara në seri kohore.

Për të plotësuar validimin e modelit, analizohet edhe normaliteti i mbetjeve përmes testit Jarque–Bera (1987). Verifikimi i këtij kushti kontribuon në rritjen e besueshmërisë së testeve statistikore dhe të interpretimit të koeficientëve të vlerësuar.

Përveç kontrolleve të mësipërme, analiza e hipotezës gjashtë kërkon procedura shtesë që lidhen me metodologjinë ARDL. Duke qenë se ky model përdoret për të analizuar marrëdhëniet afatshkurtra dhe afatgjata ndërmjet rritjes ekonomike, instrumenteve fiskale dhe kapacitetit institucional, fillimisht verifikohet ekzistenca e një marrëdhënieje afatgjatë ndërmjet variablave përmes Bounds Test (Pesaran, Shin & Smith, 2001). Më pas vlerësohet modeli Error Correction Model (ECM), i cili mundëson analizimin e procesit të rikthimit drejt ekuilibrit afatgjatë pas devijimeve afatshkurtra.

Për të vlerësuar qëndrueshmërinë e parametrave të modelit gjatë gjithë periudhës së analizës përdoren gjithashtu testet CUSUM dhe CUSUMSQ, të zhvilluara fillimisht nga Brown, Durbin dhe Evans (1975). Këto teste ndihmojnë në identifikimin e ndryshimeve strukturore dhe në verifikimin e stabilitetit të marrëdhënieve ndërmjet variablave në kohë. Këto teste ndihmojnë në identifikimin e ndryshimeve të mundshme strukturore dhe në verifikimin e stabilitetit të marrëdhënieve ndërmjet variablave në kohë.

Në tërësi, kombinimi i këtyre procedurave diagnostikuese dhe testeve të validimit siguron që rezultatet empirike të mbështeten në modele statistikisht të vlefshme, metodologjikisht të qëndrueshme dhe të interpretohen në mënyrë të besueshme. Kjo qasje forcon bazën shkencore të studimit dhe rrit besueshmërinë e përfundimeve mbi efektivitetin e politikës fiskale dhe rolin e kapacitetit institucional në ekonominë shqiptare.

4.9 Analiza e stabilitetit strukturor

Një nga hapat e rëndësishëm në analizën ekonometrike është kontrolli i qëndrueshmërisë së marrëdhënieve ndërmjet variablave gjatë gjithë periudhës së studimit. Modelet tradicionale shpesh supozojnë se lidhja midis politikës fiskale dhe rritjes ekonomike mbetet e njëjtë në kohë. Në praktikë, ekonomitë përjetojnë ndryshime strukturore, goditje të jashtme dhe transformime institucionale që mund të ndryshojnë mënyrën se si funksionon politika fiskale. Për këtë arsye, analiza e stabilitetit strukturor është një pjesë thelbësore e metodologjisë. Ajo ndihmon për të verifikuar nëse parametrat e modelit janë të qëndrueshëm apo kanë ndryshuar në periudha të caktuara, duke identifikuar mundësinë e regjimeve të ndryshme makroekonomike.

Rëndësia e kësaj analize është veçanërisht e madhe për Shqipërinë gjatë periudhës 2000–2024. Kjo periudhë përfshin disa ngjarje me ndikim të fortë: krizën financiare globale (2008–2009), procesin e konsolidimit fiskal në vitet pasuese, pandeminë COVID-19 (2020) dhe goditjet e mëvonshme si kriza energjetike dhe inflacioni. Këto episode kanë krijuar kushte të ndryshme ekonomike dhe fiskale, të cilat mund të kenë ndikuar në efektivitetin e instrumenteve fiskale dhe në mekanizmin e tyre të transmetimit në ekonomi. Njëkohësisht, përmirësimet graduale në cilësinë institucionale mund të kenë ndryshuar mënyrën se si politikat fiskale prodhojnë rezultate. Nëse këto ndryshime të mundshme strukturore injorohen, ekziston rreziku që rezultatet ekonometrike të paraqesin vetëm një efekt mesatar për të gjithë periudhën, duke mos kapur dallimet reale midis fazave të ndryshme të zhvillimit ekonomik. Prandaj, analiza e stabilitetit strukturor shërben jo vetëm për të testuar vlefshmërinë e modeleve, por edhe për të justifikuar ndarjen e periudhës në nënperiudha analitike të veçanta.

Për kryerjen e këtij vlerësimi, studimi përdor tre teste komplementare:

- *Chow Breakpoint Test* (Chow, 1960), për të identifikuar ndryshime në pika të paracaktuara kohore (si 2008, 2009 dhe 2020).
- *CUSUM*, për të kontrolluar stabilitetin dinamik të parametrave gjatë gjithë periudhës.
- *CUSUM of Squares (CUSUMSQ)*, për të vlerësuar ndryshimet në variancën e gabimeve, veçanërisht gjatë episodeve të krizave.

Kombinimi i këtyre testeve ofron një pamje të plotë, duke bashkuar evidencën statistikore me atë grafike. Rezultatet e tyre përdoren si për modelet OLS ashtu edhe për modelin ARDL, duke forcuar besueshmërinë e analizës empirike dhe duke mbështetur interpretimin e efektivitetit të politikës fiskale në kontekste të ndryshme makroekonomike dhe institucionale. Kjo qasje metodologjike rrit cilësinë e studimit duke siguruar që konkluzionet të mos bazohen në supozime të thjeshtuara, por të marrin parasysh realitetin dinamik të ekonomisë shqiptare gjatë 25 viteve të fundit.

4.10 Kufizimet metodologjike të studimit

Ashtu si çdo kërkim empirik i mbështetur në analiza makroekonomike të serive kohore, edhe ky studim përballlet me disa kufizime metodologjike dhe empirike, të cilat duhet të merren në konsideratë gjatë interpretimit të rezultateve. Identifikimi dhe diskutimi i tyre nuk cenon vlefshmërinë e gjetjeve, por kontribuon në një vlerësim më realist të potencialit dhe kufijve shpjegues të analizës.

Një nga kufizimet kryesore lidhet me dimensionin e kampionit. Megjithëse studimi mbulon një periudhë relativisht të gjatë kohore (2000–2024), përdorimi i të dhënave vjetore kufizon numrin e vëzhgimeve të disponueshme. Kjo karakteristikë është tipike për analizat makroekonomike të vendeve në zhvillim dhe mund të ndikojë në fuqinë statistikore të testeve ekonometrike, veçanërisht në analizat e nënperiudhave dhe në vlerësimin e marrëdhënieve afatshkurtra.

Një kufizim i dytë lidhet me disponueshmërinë e të dhënave. Për disa tregues me rëndësi të veçantë për studimin, sidomos ata që lidhen me dimensionin institucional, informacioni është i disponueshëm vetëm në frekuencë vjetore. Si rrjedhojë, analiza nuk mund të kapë plotësisht luhatjet afatshkurtra dhe ndryshimet brenda vitit, të cilat mund të jenë të rëndësishme për kuptimin e mekanizmave të transmetimit të politikës fiskale.

Një sfidë e njohur në literaturën empirike të politikës fiskale është edhe çështja e endogjenitetit. Marrëdhënia ndërmjet politikës fiskale dhe rritjes ekonomike është potencialisht dykahëshe: ndërhyrjet fiskale ndikojnë aktivitetin ekonomik, ndërsa vetë dinamika e ekonomisë ndikon në vendimmarrjen fiskale. Megjithëse modelet e përdorura ofrojnë evidencë të rëndësishme mbi drejtimin dhe intensitetin e këtyre marrëdhënieve,

rezultatet duhet të interpretohen kryesisht si marrëdhënie empirike dhe jo domosdoshmërisht si prova përfundimtare të kauzalitetit. Kufizimet që lidhen me madhësinë e kampionit dhe disponueshmërinë e të dhënave e bëjnë të vështirë aplikimin e metodave më komplekse të identifikimit kauzal.

Kufizime të tjera lidhen me matjen e dimensionit institucional. Indeksi i Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF) është ndërtuar mbi bazën e treguesve të qeverisjes së Bankës Botërore dhe, si çdo tregues i agreguar institucional, nuk mund të pasqyrojë në mënyrë të plotë të gjitha aspektet e funksionimit të institucioneve publike. Elemente të tilla si cilësia e zbatimit të politikave, koordinimi ndërinstitutional apo karakteristika specifike të administratës publike janë vështirë të maten në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe rrjedhimisht mbeten pjesërisht jashtë analizës empirike.

Gjithashtu, karakteristikat strukturore të ekonomisë shqiptare, veçanërisht pesha e konsiderueshme e aktivitetit informal, përbëjnë një burim potencial pasigurie për analizën. Në kushte të informalitetit relativisht të lartë, disa tregues zyrtarë mund të mos reflektojnë plotësisht dimensionin real të aktivitetit ekonomik, duke ndikuar në saktësinë e matjes së disa variablave të studiuar.

Pavarësisht këtyre kufizimeve, studimi mbështetet në një sërë procedurash metodologjike që synojnë rritjen e besueshmërisë së rezultateve. Përdorimi i testeve diagnostikuese, vlerësimi i qëndrueshmërisë së modeleve, aplikimi i gabimeve standarde robuste, analiza sipas regjimeve makroekonomike dhe kombinimi i metodave të ndryshme ekonometrike kontribuojnë në forcimin e vlefshmërisë së gjetjeve empirike. Në këtë kuptim, kufizimet e identifikuara nuk zbehin kontributin e studimit, por tregojnë nevojën për kërkime të mëtejshme që mund të mbështeten në seri më të gjata kohore, frekuenca më të larta të të dhënave dhe metoda më të avancuara ekonometrike për të thelluar analizën e marrëdhënies ndërmjet politikës fiskale, institucioneve dhe rritjes ekonomike.

4.10 Përfundime të kapitullit

Ky kapitull paraqiti kuadrin metodologjik dhe strategjinë empirike të studimit. Me qëllim të arritjes së objektivave kryesore, vlerësimin e ndikimit të politikës fiskale në rritjen ekonomike dhe testimin e hipotezave të parashtruara, u përdor një kombinim i metodave ekonometrike të përshtatshme për kontekstin shqiptar. Analiza u ndërtua mbi të dhëna vjetore për periudhën 2000–2024 dhe përfshiu: analizën përshkruese, testimin e stacionaritetit, modele OLS me terma ndërveprimi për krizat, analiza sipas nënperiudhave makroekonomike, si dhe metodologjinë ARDL për vlerësimin e rolit të kapacitetit institucional. Të gjitha modelet u shoqëruan me teste diagnostikuese dhe të stabilitetit strukturor për të rritur besueshmërinë e rezultateve. Qasja metodologjike krijon një bazë të shëndoshë për analizën empirike. Ajo mundëson jo vetëm testimin e hipotezave, por edhe

kuptimin e heterogjenitetit të efektit të politikës fiskale në periudha të ndryshme ekonomike dhe institucionale. Në kapitujt vijues paraqiten rezultatet empirike, interpretimi i tyre dhe konkluzionet e përgjithshme të studimit.

KAPITULLI 5: ANALIZA EMPIRIKE DHE REZULTATET

Ky kapitull paraqet rezultatet empirike të studimit mbi marrëdhënien ndërmjet politikës fiskale dhe rritjes ekonomike në Shqipëri gjatë periudhës 2000–2024. Analiza mbështetet në evidencën statistikore dhe ekonometrike të gjeneruar nga të dhënat e studimit dhe synon të identifikojë mënyrën se si instrumentet kryesore të politikës fiskale kanë ndikuar në performancën ekonomike në kushte të ndryshme makroekonomike. Rezultatet paraqiten në një rend logjik që fillon me analizën përshkruese të variablave dhe identifikimin e karakteristikave kryesore të tyre, vijon me vlerësimin e qëndrueshmërisë statistikore të të dhënave dhe të modeleve të përdorura, dhe më pas fokusohet në analizën e marrëdhënies ndërmjet politikës fiskale dhe rritjes ekonomike. Në këtë kuadër, vlerësohen fillimisht efektet e instrumenteve fiskale për periudhën e plotë të studimit, më pas analizohet nëse këto efekte ndryshojnë gjatë episodeve të krizës dhe ndërmjet regjimeve të ndryshme makroekonomike, ndërsa në fund shqyrtohet roli i kapacitetit institucional në efektivitetin e politikës fiskale. Periudha e analizuar përfshin tri faza të dallueshme të zhvillimit ekonomik shqiptar: periudhën para krizës financiare globale (2000–2008), periudhën pas krizës dhe të konsolidimit fiskal (2009–2019) dhe periudhën e pandemisë COVID-19 dhe rimëkëmbjes ekonomike (2020–2024). Evidenca empirike e paraqitur në këtë kapitull mundëson vlerësimin e ndryshimeve në sjelljen e variablave fiskalë dhe në ndikimin e tyre mbi rritjen ekonomike përgjatë këtyre regjimeve, duke krijuar bazën për diskutimin dhe interpretimin e gjetjeve të studimit në kapitullin vijues.

5.1 Analiza përshkruese e variablave

Analiza përshkruese përbën fazën fillestare të vlerësimit empirik dhe ka për qëllim të evidentojë karakteristikat themelore të të dhënave të përdorura në studim. Përmes statistikave përshkruese, analizës së ecurisë së variablave në kohë, paraqitjeve grafike dhe matricës së korelacionit, krijohet një kuptim më i plotë mbi sjelljen e treguesve të përfshirë në analizë, shkallën e variacionit të tyre dhe ndryshimet që kanë shoqëruar faza të ndryshme të zhvillimit ekonomik. Kjo fazë nuk synon të identifikojë marrëdhënie shkak-pasojë ndërmjet variablave, por të ndërtojë bazën empirike mbi të cilën mbështetet analiza ekonometrike e zhvilluar në vijim. Njëkohësisht, analiza mundëson identifikimin e prirjeve afatgjata, episodeve të paqëndrueshmërisë makroekonomike dhe ndryshimeve strukturore që kanë karakterizuar ekonominë shqiptare gjatë periudhës së studimit, me fokus të veçantë në efektet e krizës financiare globale të viteve 2008–2009 dhe pandemisë COVID-19. Krahas treguesve fiskalë dhe makroekonomikë, shqyrtohet edhe evolucioni i Indeksit të Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF), i cili përfaqëson dimensionin institucional të kërkimit dhe krijon premisat empirike për vlerësimin e rolit të institucioneve në rritjen e efektivitetit të politikës fiskale. Në këtë mënyrë, analiza përshkruese shërben si një urë lidhëse ndërmjet evidencës statistikore dhe modelimit ekonometrik të paraqitur në seksionet pasuese.

Statistikat përshkruese (2000–2024)

Tabela 5.1 paraqet karakteristikat kryesore statistikore të variablave të përfshirë në analizën empirike për periudhën 2000–2024. Këto tregues ofrojnë një vlerësim paraprak të shpërndarjes së të dhënave, duke evidentuar vlerat mesatare, shkallën e variacionit dhe diapazonin e luhatjeve të variablave makroekonomikë, fiskalë dhe institucionalë të përdorur në studim. Analiza përshkruese shërben si një hap i rëndësishëm metodologjik, pasi mundëson identifikimin e karakteristikave themelore të serive kohore dhe krijon bazën për interpretimin e rezultateve ekonometrike të paraqitura në seksionet pasuese.

Tabela 5.1 Statistikat përshkruese të variablave për periudhën 2000–2024

Variabla	Mesatarja (Mean)	St. Dev (SD)	Min	Max	N
GDP_Growth	4.1	2.6	-3.3	8.9	25
GOV_EXP	30.34	1.67	28.2	34	25
PUB_INV	6.3	1.27	5.1	9.6	25
TAX_REV	23.4	1.69	19.8	25.7	25
PUBLIC_DEBT	63.3	6.59	53.5	74.1	25
INFLATION	2.6	1.37	0.1	6.7	25
UNEMPLOYMENT	14.6	2.46	10.7	19.02	25
EXPORTS	26.4	6.32	6.7	38.7	25
REMITTANCES	12.4	3.04	8.4	17.8	25
IKIPF	-0.35	0.26	-0.95	-0.02	25

Burimi: Përpunim i autorit bazuar në të dhëna dytësore nga World Bank (WDI), INSTAT, Ministria e Financave e Shqipërisë dhe IMF Article IV Reports (2000–2024).

Rezultatet tregojnë se ekonomia shqiptare ka regjistruar një normë mesatare rritjeje prej 4.1% gjatë periudhës së analizuar, por me një devijim standard relativisht të lartë prej 2.6 pikësh përqindje, çka sinjalizon praninë e luhatjeve të konsiderueshme në aktivitetin ekonomik. Diferenca ndërmjet vlerës minimale (-3.3%) dhe asaj maksimale (8.9%) pasqyron ndikimin e episodeve të rëndësishme të paqëndrueshmërisë makroekonomike, veçanërisht krizës financiare globale dhe pandemisë COVID-19. Këto rezultate sugjerojnë se rritja ekonomike në Shqipëri nuk ka ndjekur një trajektore uniforme, por është karakterizuar nga faza të ndryshme zgjerimi, ngadalësimi dhe rimëkëmbjeje ekonomike.

Variablat fiskalë paraqesin luhatje më të moderuara krahasuar me treguesin e rritjes ekonomike. Shpenzimet qeveritare, investimet publike dhe të ardhurat tatimore shfaqin devijime standarde relativisht të ulëta, duke reflektuar një orientim më të qëndrueshëm të politikës fiskale gjatë pjesës më të madhe të periudhës së analizuar. Në të kundërt, borxhi publik karakterizohet nga variabilitet më i lartë, duke sugjeruar se ai është përdorur si një instrument më fleksibël për financimin e politikave publike, veçanërisht gjatë periudhave të krizave ekonomike dhe të rritjes së nevojave për financim.


Variabiliteti relativisht i lartë i eksporteve dhe remitancape nënvizon shkallën e integritit të ekonomisë shqiptare me zhvillimet ekonomike ndërkombëtare. Dinamika e këtyre treguesve reflekton ndikimin e faktorëve të jashtëm, si kushtet ekonomike në vendet partnere, luhatjet e kërkesës ndërkombëtare dhe ndryshimet në flukset financiare të emigracionit. Këto rezultate konfirmojnë se ekonomia shqiptare mbetet e ekspozuar ndaj faktorëve të jashtëm dhe se remitancat, së bashku me sektorin eksportues, vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e aktivitetit ekonomik dhe në zbutjen e goditjeve makroekonomike.

Nga perspektiva institucionale, vlerat e IKIPF tregojnë një përmirësim gradual të kapaciteteve institucionale gjatë periudhës së studimit. Edhe pse mesatarja e indeksit mbetet në territor negativ, amplituda ndërmjet vlerës minimale dhe asaj maksimale sugjeron progres të vazhdueshëm në cilësinë e institucioneve dhe në kapacitetin e administrimit të politikave publike. Kjo mbështet teorikisht pritshmërinë se efektiviteti i politikës fiskale mund të jetë ndikuar jo vetëm nga madhësia dhe struktura e instrumenteve fiskale, por edhe nga evolucioni i mjedisit institucional në të cilin këto politika janë zbatuar. Në tërësi, statistikatat përshkuese sugjerojnë se periudha 2000–2024 nuk përfaqëson një regjim ekonomik homogjen, duke justifikuar analizat e mëtejshme mbi ndryshimet strukturore dhe heterogjenitetin e efekteve fiskale.

Analiza e trendeve kohore

Analiza e trendeve kohore synon të evidentojë evolucionin e treguesve kryesorë makroekonomikë dhe fiskalë gjatë periudhës së analizuar. Vëzhgimi grafik i të dhënave ndihmon në identifikimin e ndryshimeve të lidhura me ciklin ekonomik dhe me episodet kryesore të paqëndrueshmërisë që kanë ndikuar ekonominë shqiptare.

Figura 5.1 Trendet kohore të treguesve kryesorë makro-fiskalë në Shqipëri (2000–2024)




Burimi: Përpunim i autorit bazuar në të dhëna dytësore nga World Bank (WDI), INSTAT, Ministria e Financave e Shqipërisë dhe IMF Article IV Reports (2000–2024).

Analiza e trendeve kohore konfirmon se periudha 2000–2024 nuk karakterizohet nga një regjim i vetëm ekonomik. Faza para krizës financiare globale shoqërohet me ritme relativisht të larta të rritjes ekonomike, stabilitet më të madh makroekonomik dhe një pozicion fiskal më të qëndrueshëm. Pas vitit 2009 evidentohet një ngadalësim i ritmeve të rritjes dhe një rritje graduale e presioneve fiskale, të reflektuara kryesisht në zgjerimin e borxhit publik dhe në nevojën për konsolidim fiskal. Një ndryshim edhe më i theksuar vërehet në vitin 2020, kur pandemia COVID-19 shkaktoi tkurrje ekonomike dhe një zgjerim të menjëhershëm të ndërhyrjes fiskale. Rritja e shpenzimeve publike dhe zgjerimi i borxhit publik gjatë kësaj periudhe pasqyrojnë përdorimin e politikës fiskale si instrument stabilizues për zbutjen e efekteve ekonomike të krizës. Nga këndvështrimi metodologjik, këto zhvillime sugjerojnë praninë e ndryshimeve strukturore në seri kohore dhe ofrojnë mbështetje empirike për përdorimin e analizës sipas nënperiudhave, variablave dummy për periudhat e krizave dhe testeve të stabilitetit strukturor të aplikuara në analizën ekonometrike.

Analiza grafike bivariate

Analiza grafike bivariate përdoret për të evidentuar drejtimin fillestar të marrëdhënieve ndërmjet rritjes ekonomike dhe variablave kryesorë fiskalë e makroekonomikë. Kjo analizë ka karakter eksplorues dhe synon të identifikojë prirjet e përgjithshme të të dhënave përpara testimit formal të hipotezave.


Figura 5.2 Evolucionit kohor i variablave fiskalë dhe makroekonomikë (2000–2024)



Burimi: Përpunim i autorit në EViews.

Grafikët evidentojnë luhatje më të theksuara gjatë episodeve të krizës, veçanërisht në vitet 2009 dhe 2020. Kjo sjellje sugjeron se marrëdhëniet ndërmjet variablave nuk kanë mbetur plotësisht të qëndrueshme gjatë gjithë periudhës së analizuar dhe mund të ndryshojnë sipas kushteve makroekonomike dhe karakteristikave të secilit regjim ekonomik. Kjo evidencë mbështet përdorimin e modeleve që marrin në konsideratë heterogjenitetin e efekteve fiskale dhe ndryshimet strukturore ndërmjet periudhave.

Figura 5.3 Marrëdhëniet bivariate ndërmjet GDP_Growth dhe variablave fiskalë/makroekonomikë (2000–2024).



Burimi: Përpunim i autorit në EViews.

Marrëdhëniet grafike sugjerojnë një lidhje pozitive ndërmjet rritjes ekonomike dhe disa prej instrumenteve fiskalë, veçanërisht shpenzimeve qeveritare dhe investimeve publike, në përputhje me argumentet teorike mbi rolin stimulues të politikës fiskale. Në të kundërt, borxhi publik paraqet një prirje negative ndaj rritjes ekonomike, duke sugjeruar se zgjerimi i detyrimeve publike mund të ketë qenë i shoqëruar me kufizime më të mëdha fiskale dhe ritme më të ulëta të rritjes. Për variabla të tjerë, shpërndarja e observimeve rezulton më heterogjene dhe nuk evidenton një lidhje të fortë lineare. Kjo sugjeron se marrëdhëniet ndërmjet variablave mund të ndikohen nga faktorë të tjerë makroekonomikë

dhe institucionale, të cilët do të analizohen më tej përmes modeleve ekonometrike. Në tërësi, evidenca grafike mbështet përdorimin e modeleve lineare si pikënisje analitike, por njëkohësisht sugjeron se efektet fiskale mund të ndryshojnë sipas periudhave dhe kushteve ekonomike.

Analiza e korelacionit

Matrica e korelacionit paraqet shkallën dhe drejtimin e lidhjes lineare ndërmjet variablave të përdorur në analizë dhe ofron një evidencë paraprake mbi marrëdhëniet që karakterizojnë ekonominë shqiptare gjatë periudhës 2000–2024. Edhe pse analiza e korelacionit nuk lejon nxjerrjen e përfundimeve kauzale, ajo ndihmon në identifikimin e prirjeve fillestare ndërmjet variablave dhe në vlerësimin paraprak të mundësisë së pranisë së multikolinearitetit përpara ndërtimit të modeleve ekonometrike.

Tabela 5.2 Matrica e korelacionit ndërmjet variablave makroekonomikë dhe fiskalë në Shqipëri (2000–2024).

	GDP_Growth	GOV_EXP	PUB_INV	TAX_REV	PUBLIC_DEBT	INFLATION	UNEMPLOYMENT	REMITTANCES	EXPORTS
GDP_Growth	1.00								
GOV_EXP	0.27	1.00							
PUB_INV	0.28	0.38	1.00						
TAX_REV	-0.17	-0.19	0.07	1.00					
PUBLIC_DEBT	-0.41	0.18	-0.35	0.38	1.00				
INFLATION	0.17	-0.13	-0.09	0.09	-0.37	1.00			
UNEMPLOYMENT	0.18	0.36	-0.13	-0.50	0.13	-0.26	1.00		
REMITTANCES	0.51	0.44	0.28	-0.57	-0.44	0.01	0.71	1.00	
EXPORTS	-0.11	-0.26	-0.05	0.81	0.29	0.30	-0.28	-0.42	1.00

Burimi: Llogaritje të autorit në EViews¹.

Rezultatet tregojnë se shpenzimet qeveritare (GOV_EXP) dhe investimet publike (PUB_INV) paraqesin korelacion pozitiv me rritjen ekonomike, me koeficientë respektivisht 0.27 dhe 0.28. Megjithëse këto lidhje janë relativisht të moderuara, ato janë në përputhje me argumentet teorike që theksojnë rolin stimulues të politikës fiskale në mbështetjen e aktivitetit ekonomik. Në të kundërt, borxhi publik (PUBLIC_DEBT) shfaq një korelacion negativ me rritjen ekonomike (-0.41), duke sugjeruar se periudhat e karakterizuara nga nivele më të larta të borxhit janë shoqëruar me ritme më të ulëta të rritjes ekonomike. Kjo evidencë paraprake mbështet argumentin teorik se zgjerimi i borxhit publik mund të kufizojë hapësirën fiskale dhe të reduktojë efektivitetin e politikës fiskale

¹ Shënim: Vlerat paraqesin koeficientët e korelacionit Pearson.


në afat të mesëm dhe afatgjatë. Ndër variablat kontrolluese, remitancat paraqesin lidhjen më të fortë pozitive me rritjen ekonomike (0.51), duke konfirmuar rëndësinë e tyre si një burim i qëndrueshëm financimi për ekonominë shqiptare dhe si një faktor mbështetës për konsumin dhe kërkesën agregate. Ky rezultat është në përputhje me karakteristikat strukturore të ekonomisë shqiptare, ku remitancat kanë luajtur tradicionalisht rol stabilizues, veçanërisht gjatë periudhave të pasigurisë ekonomike. Nga ana tjetër, të ardhurat tatimore (TAX_REV) dhe eksportet (EXPORTS) paraqesin lidhje relativisht të dobëta me rritjen ekonomike, duke sugjeruar se ndikimi i tyre mund të kushtëzohet nga faktorë të tjerë makroekonomikë dhe institucionalë. Veçanërisht interesante është lidhja e fortë pozitive ndërmjet eksporteve dhe të ardhurave tatimore (0.81), e cila reflekton ndërveprimin ndërmjet aktivitetit ekonomik të orientuar drejt tregjeve të jashtme dhe kapacitetit të shtetit për të gjeneruar të ardhura publike. Megjithatë, edhe pse ky korelacion është relativisht i lartë, ai nuk sugjeron automatikisht praninë e multikolinearitetit problematik, pasi ky aspekt do të verifikohet më tej përmes testit Variance Inflation Factor (VIF) në seksionin e testeve diagnostikuese.

Në përgjithësi, matrica e korelacionit sugjeron se marrëdhëniet ndërmjet treguesve fiskalë, makroekonomikë dhe rritjes ekonomike janë komplekse dhe nuk mund të interpretohen vetëm mbi bazën e analizës bivariate. Për këtë arsye, rezultatet e paraqitura këtu konsiderohen si evidencë paraprake, ndërsa testimi formal i hipotezave realizohet në seksionet vijuese përmes modeleve ekonometrike OLS dhe ARDL, të cilat mundësojnë kontrollin e faktorëve të tjerë shpjegues dhe vlerësimin më të saktë të marrëdhënieve ndërmjet variablave.

Evolucioni i Indeksit të Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF)

Përveç treguesve fiskalë dhe makroekonomikë, analiza përfshin edhe dimensionin institucional përmes Indeksit të Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF). Përfshirja e këtij treguesi mbështetet në argumentin se efektiviteti i politikës fiskale nuk përcaktohet vetëm nga madhësia dhe struktura e ndërhyrjeve publike, por edhe nga cilësia e institucioneve që mbështesin hartimin, zbatimin dhe monitorimin e tyre (Acemoglu & Robinson, 2012; Gerling et al., 2017; IMF, 2021). Në këtë kontekst, IKIPF përdoret për të analizuar nëse ndryshimet në kapacitetin institucional kanë shoqëruar ndryshime në efektivitetin e politikës fiskale dhe në performancën ekonomike të Shqipërisë gjatë periudhës 2000–2024. Për të krijuar një panoramë fillestare mbi dinamikën e këtij treguesi, figura 5.4 paraqet ecurinë e kapacitetit institucional përgjatë periudhës së analizuar.

Figura 5.4 Evolucion i IKIPF në Shqipëri (2000–2024)



Burimi: Përpunim i autores bazuar në World Governance Indicators (World Bank).

Figura tregon se kapaciteti institucional në Shqipëri ka ndjekur një trajektore përgjithësisht përmirësuese gjatë periudhës së analizuar, megjithëse me ritme të ndryshme ndërmjet regjimeve makroekonomike. Në fillim të viteve 2000, vlerat e indeksit paraqiten relativisht të ulëta, duke reflektuar sfidat institucionale që shoqëruan tranzicionin ekonomik dhe procesin e konsolidimit të institucioneve publike.

Gjatë periudhës 2000–2008 evidentohet një përmirësim gradual i kapacitetit institucional, i lidhur me reformat administrative dhe procesin e afrimit me standardet evropiane. Në periudhën 2009–2019 ritmi i përmirësimit paraqitet më i moderuar, duke reflektuar ndikimin e krizës financiare globale, kufizimet fiskale dhe sfidat e vazhdueshme në administrimin publik. Ndërkohë, periudha 2020–2024 karakterizohet nga përmirësimi më i dukshëm i indeksit, me vlerat më të larta të regjistruara gjatë gjithë periudhës së analizuar. Kjo sugjeron forcim relativ të kapaciteteve administrative dhe përmirësim të mekanizmave të qeverisjes ekonomike në vitet më të fundit.

Nga perspektiva e këtij studimi, evolucioni i IKIPF tregon se mjedisi institucional në të cilin është zbatuar politika fiskale nuk ka qenë konstant gjatë periudhës 2000–2024. Për rrjedhojë, ndryshimet në efektivitetin e politikës fiskale mund të jenë ndikuar jo vetëm nga madhësia dhe struktura e instrumenteve fiskale, por edhe nga ndryshimet graduale në cilësinë e institucioneve që kanë mbështetur zbatimin e tyre. Ky argument është veçanërisht i rëndësishëm për interpretimin e rezultateve të analizës ekonometrike, pasi sugjeron se efektet fiskale mund të kushtëzohen nga faktorë institucionalë dhe jo vetëm nga treguesit tradicionalë të politikës fiskale.

Në këtë kuadër, evidenca përshkruese e paraqitur më sipër krijon bazën empirike për testimin e Hipotezës H6, sipas së cilës kapaciteti institucional ndikon pozitivisht në efektivitetin e politikës fiskale. Vlerësimi formal i kësaj marrëdhënieje realizohet në seksionin përkatës të analizës ekonometrike përmes metodologjisë ARDL, e cila mundëson identifikimin e efekteve afatshkurtra dhe afatgjata ndërmjet kapacitetit institucional, instrumenteve fiskale dhe rritjes ekonomike. Në këtë mënyrë, analiza kalon nga evidenca përshkruese drejt testimit empirik të rolit të institucioneve në procesin e transmetimit të politikës fiskale në ekonominë shqiptare.

5.2 Testet diagnostikuese të serive kohore dhe modelit

Përpara vlerësimit të modeleve ekonometrike, u realizuan disa teste diagnostikuese me qëllim verifikimin e karakteristikave statistikore të serive kohore dhe përshtatshmërisë së modeleve të përdorura në analizë. Këto teste janë të rëndësishme për të siguruar që rezultatet empirike të jenë të qëndrueshme, të interpretohen në mënyrë të besueshme dhe të mos ndikohen nga probleme statistikore si regresionet e rreme, multikollineariteti, heteroskedasticiteti, autokorrelacioni apo shpërndarja jo normale e mbetjeve. Në këtë kuadër, fillimisht testohet stacionariteti i serive kohore përmes testit Augmented Dickey–Fuller (ADF), më pas vlerësohen testet diagnostikuese të modelit OLS dhe, në vijim, paraqiten testet specifike që lidhen me modelin ARDL të përdorur për analizën e kapacitetit institucional.

Një nga kushtet kryesore në analizën e serive kohore është verifikimi i stacionaritetit të variablave. Nëse seritë kohore janë jo-stacionare, ekziston rreziku që modelet të prodhojnë marrëdhënie statistikore të rreme, të cilat nuk pasqyrojnë lidhje reale ekonomike. Për këtë arsye, në këtë studim është përdorur testi Augmented Dickey–Fuller (ADF), me qëllim identifikimin e pranisë së rrënjës njësi dhe përcaktimin e rendit të integritit të variablave.

Tabela 5.3 Rezultatet e testit të stacionaritetit për periudhën 2000–2024

Variabla	ADF Statistic (Level)	p-value (Level)	Stacionare në nivel?	ADF Statistic (First Diff)	p-value (First Diff)	Stacionariteti	Vendimi final për modelin
GDP_Growth	−3.802519	0.0086	Po	—	—	I(0)	Përdoret në nivel
GOV_EXP	−3.841594	0.0089	Po	—	—	I(0)	Përdoret në nivel
PUB_INV	−2.730210	0.0837	Jo	−4.769320	0.0010	I(1)	Përdoret si D_PUB_INV
TAX_REV	−1.917604	0.3191	Jo	−2.804322	0.0732	I(1)	Përdoret si D_TAX_REV*
PUBLIC_DEBT	−1.908826	0.3226	Jo	−3.626332	0.0132	I(1)	Përdoret si D_PUBLIC_DEBT
INFLATION	−3.938583	0.0063	Po	—	—	I(0)	Përdoret në nivel

UNEMPLOYMENT	-1.780277	0.3802	Jo	-2.849299	0.0671	I(1)	Përdoret si D_UNEMPLOYMENT*
REMITTANCES	-0.849574	0.7863	Jo	-5.043610	0.0005	I(1)	Përdoret si D_REMITTANCES
EXPORTS	-3.796861	0.0107	Po	—	—	I(0)	Përdoret në nivel

Burimi: Llogaritje të autorit në EViews².

Rezultatet tregojnë se GDP_Growth, GOV_EXP, INFLATION dhe EXPORTS janë stacionare në nivel, pra klasifikohen si variabla I (0). Ndërkohë, PUB_INV, TAX_REV, PUBLIC_DEBT, UNEMPLOYMENT dhe REMITTANCES rezultojnë jo-stacionare në nivel, por bëhen stacionare pas diferencimit të parë, duke u klasifikuar si variabla I(1). Ky rezultat tregon se variablat e përdorura në analizë nuk ndjekin të njëjtën dinamikë kohore dhe se disa prej tyre përmbajnë prirje afatgjata që duhen trajtuar përpara përfshirjes në model.

Kjo sjellje justifikon përdorimin e një specifikimi të kombinuar, ku variablat përfshihen në nivel ose në diferencë të parë, sipas rendit të tyre të integritit. Transformimi i variablave jo-stacionare ndihmon në shmangien e regresioneve të rreme dhe rrit besueshmërinë e rezultateve empirike. Njëkohësisht, prania e variablave I(0) dhe I(1) krijon bazën metodologjike për përdorimin e modelit ARDL në analizën e mëtejshme të kapacitetit institucional.

Pas verifikimit të stacionaritetit, u realizuan testet diagnostikuese të modelit OLS, me qëllim kontrollin e supozimeve kryesore të regresionit linear. Fillimisht u testua prania e multikollinearitetit përmes treguesit Variance Inflation Factor (VIF).

Tabela 5.4 Testi i multikollinearitetit (Variance INFLATION Factor – VIF)

Variabla	Centered VIF³
GOV_EXP	2.71
D_PUB_INV	1.63
D_TAX_REV	1.87
D_PUBLIC_DEBT	2.54
INFLATION	1.79
D_UNEMPLOYMENT	1.63
D_REMITTANCES	1.8
EXPORTS	1.91

Burim: Llogaritje të autorit në EViews.

Rezultatet e testit të multikollinearitetit tregojnë se të gjitha vlerat e Variance Inflation Factor (VIF) mbeten ndjeshëm nën pragu kritik të pranuar në literaturë, duke sugjeruar mungesën e problemeve serioze të multikollinearitetit ndërmjet variablave shpjeguese. Kjo nënkupton se variablat e përfshira në model ofrojnë informacion të

² **Shënim:** Për shkak të madhësisë së vogël të kampionit, niveli i rëndësisë 10% merret në konsideratë si prag plotësues për vlerësimin e stacionaritetit.

³ **Shënim:** Përdoret **Centered VIF**, që është standardi i rekomanduar për diagnozën e multikollinearitetit.

dallueshëm mbi variablin e varur dhe se vlerësimet e koeficientëve nuk ndikohen nga mbivendosje të konsiderueshme lineare ndërmjet tyre. Më tej, testi Breusch–Pagan–Godfrey evidenton praninë e heteroskedasticitetit në mbetjet e modelit, duke treguar se varianca e gabimeve nuk mbetet konstante përgjatë vëzhgimeve. Për të shmangur ndikimin e këtij problemi në inferencën statistikore, modeli u rivlerësua duke përdorur gabime standarde robuste White–Hinkley (HC1). Për rrjedhojë, vlerësimi i rëndësisë statistikore të koeficientëve mbështetet në rezultatet e korrigjuara me gabime standarde robuste, të cilat sigurojnë vlerësime më të besueshme të parametrave. Kontrolli i autokorrelacionit përmes statistikës Durbin–Watson rezulton në vlera pranë nivelit referues 2, duke sugjeruar mungesën e autokorrelacionit të rëndësishëm të rendit të parë në mbetje. Njëkohësisht, rezultatet e testit Jarque–Bera tregojnë se shpërndarja e mbetjeve nuk devijon në mënyrë të konsiderueshme nga normaliteti, duke mbështetur vlefshmërinë e procedurave të inferencës statistikore të përdorura në analizë.

Tabela 5.5 Testet diagnostikuese të modelit OLS për periudhën (2000–2024)

Testi	Procedura / Statistika	Statistika kryesore	Interpretimi për modelin
Stacionariteti (ADF)	Augmented Dickey–Fuller	Variablat stacionarë në nivel ose në diferencë të parë	Specifikimi shmang regresionet e rreme; OLS i vlefshëm
Multikolineariteti (VIF)	Variance INFLATION Factor	VIF max = 2.54	Nuk evidentohet multikolinearitet i dëmshëm
Heteroskedasticiteti	Breusch–Pagan–Godfrey	F = 5.7061; p = 0.0016	Heteroskedasticitet i pranishëm
Gabime standarde robuste	White–Hinkley (HC1) ⁴	—	Koeficientët interpretohen me SE robuste
Autokorrelacioni	Durbin–Watson	2.2548	Nuk ka autokorrelacion serioz
Normaliteti i mbetjeve	Jarque–Bera	p = 0.098	Mbetjet afërsisht normale
Rëndësia e përgjithshme e modelit	Wald F-test (Robust)	F = 3.5247; p = 0.0149	Modeli statistikisht i rëndësishëm

Burimi: Llogaritje të autorit në EViews.

Në tërësi, testet diagnostikuese të modelit OLS tregojnë se modeli ka një bazë të pranueshme statistikore për analizimin e marrëdhënies ndërmjet politikës fiskale dhe rritjes ekonomike. Problemi i heteroskedasticitetit është adresuar përmes përdorimit të gabimeve standarde robuste, ndërsa mungesa e multikolinearitetit të dëmshëm, autokorrelacionit serioz dhe shpërndarja afërsisht normale e mbetjeve forcojnë besueshmërinë e rezultateve. Gjithashtu, rezultati i Wald F-test tregon se modeli është statistikisht i rëndësishëm në tërësi, duke mbështetur përdorimin e tij në analizën empirike.

⁴ **Shënim:** Për shkak të heteroskedasticitetit të identifikuar nga testi Breusch–Pagan–Godfrey, modeli është rivlerësuar duke përdorur gabime standarde robuste White–Hinkley (HC1), mbi të cilat bazohen interpretimet përfundimtare të sinjifikancës statistikore.

Përveç modelit OLS, ky studim aplikon edhe metodologjinë ARDL për testimin e hipotezës H6, e cila lidhet me ndikimin e kapacitetit institucional në efektivitetin e politikës fiskale. Përdorimi i ARDL është i përshtatshëm në këtë rast, pasi rezultatet e testit ADF tregojnë se variablat e përfshira në modelin institucional kanë rend integrimi të përzier. Konkretisht, GDP_Growth dhe GOV_EXP rezultojnë stacionare në nivel $[I(0)]$, ndërsa PUB_INVESTMENT, TAX_REVENUE, PUBLIC_DEBT dhe IKIPF rezultojnë stacionare pas diferencimit të parë $[I(1)]$. Kjo strukturë e të dhënave e bën modelin ARDL të përshtatshëm për analizimin e marrëdhënieve ndërmjet politikës fiskale, kapacitetit institucional dhe rritjes ekonomike.

Për të verifikuar ekzistencën e marrëdhënies afatgjatë ndërmjet variablave, u aplikua Bounds Test për kointegrimin. Rezultatet tregojnë një statistikë F prej 18.786, e cila tejkalon ndjeshëm kufirin e sipërm kritik $I(1)$ në nivelin 1% të rëndësisë statistikore. Ky rezultat çon në refuzimin e hipotezës së mungesës së marrëdhënies afatgjatë dhe konfirmon ekzistencën e kointegrimit ndërmjet rritjes ekonomike, instrumenteve fiskale dhe kapacitetit institucional.

Ky rezultat është i rëndësishëm, sepse tregon se variablat e modelit institucional nuk lidhen vetëm në afat të shkurtër, por edhe në një marrëdhënie të qëndrueshme afatgjatë. Për këtë arsye, modeli ARDL nuk shërben thjesht si analizë plotësuese ndaj OLS, por si një instrument i përshtatshëm për të vlerësuar më qartë rolin e kapacitetit institucional në transmetimin e efekteve të politikës fiskale në ekonomi.

Në përmbledhje, rezultatet diagnostikuese mbështesin përdorimin e modelit OLS për analizën kryesore të periudhës 2000–2024 dhe përdorimin e modelit ARDL për analizën e hipotezës H6. Megjithatë, interpretimi i rezultateve bëhet duke marrë parasysh madhësinë relativisht të kufizuar të kampionit dhe praninë e episodeve të forta të paqëndrueshmërisë ekonomike. Në këtë kuadër, kombinimi i testeve diagnostikuese, gabimeve standarde robuste dhe modelit ARDL rrit qëndrueshmërinë metodologjike të analizës dhe krijon bazën për interpretimin e rezultateve empirike në seksionet vijuese

5.3 Analiza e stabilitetit strukturor dhe identifikimi I pikave të thyerjes

Analiza e stabilitetit strukturor ka rëndësi të veçantë për këtë studim, pasi periudha 2000–2024 përfshin episode të rëndësishme të paqëndrueshmërisë makroekonomike, të cilat mund të kenë ndryshuar mënyrën se si politika fiskale ndikon në rritjen ekonomike. Nëse këto ndryshime nuk merren në konsideratë, modeli ekonometrik mund të reflektojë vetëm një efekt mesatar për të gjithë periudhën, duke fshehur dallimet ndërmjet fazave të ndryshme të ciklit ekonomik. Për këtë arsye, përpara interpretimit të modeleve kryesore, u testua nëse marrëdhëniet ndërmjet variablave kanë mbetur të qëndrueshme apo kanë pësuar ndryshime strukturore në periudha të caktuara. Për këtë qëllim janë përdorur Chow Breakpoint Test, CUSUM dhe CUSUM of Squares (CUSUMSQ). Këto teste plotësojnë njëri-tjetrin: Chow Breakpoint Test identifikon thyerje në vite të paracaktuara, ndërsa CUSUM dhe CUSUMSQ ofrojnë evidencë grafike mbi stabilitetin e parametrave dhe të

variancës së gabimeve gjatë gjithë periudhës së analizës. Në këtë studim, vëmendje e veçantë i kushtohet viteve 2008, 2009 dhe 2020, pasi ato lidhen me episode të rëndësishme makroekonomike: efektet fillestare të krizës financiare globale, transmetimin më të plotë të saj në ekonominë shqiptare dhe goditjen e shkaktuar nga pandemia COVID-19. Identifikimi i këtyre thyerjeve është i rëndësishëm jo vetëm për vlefshmërinë statistikore të modelit, por edhe për justifikimin e analizës sipas nënperiudhave makroekonomike.

Tabela 5.6 Rezultatet e Chow Breakpoint Test për identifikimin e thyerjeve strukturore

Viti i thyerjes	F-statistic	Prob. F ⁵	Likelihood Ratio	Prob. LR	Wald Statistic	Prob. Wald	Interpretim
2008	2.681	0.0695	12.312	0.0152	10.724	0.0298	Evidencë e moderuar për ndryshim strukturor
2009	3.220	0.0592	34.554	0.0000	25.757	0.0012	Evidencë e fortë për ndryshim strukturor
2020	3.114	0.0450	13.818	0.0079	12.455	0.0143	Evidencë e fortë për ndryshim strukturor

Burimi: Llogaritje të autorit në EViews.

Rezultatet e Chow Breakpoint Test tregojnë se marrëdhëniet ndërmjet variablave të modelit nuk kanë qenë plotësisht të qëndrueshme gjatë gjithë periudhës 2000–2024. Për vitin 2008 evidentohet një sinjal i moderuar i ndryshimit strukturor, i cili mund të lidhet me efektet fillestare të krizës financiare globale mbi ekonominë shqiptare. Megjithatë, evidenca më e fortë shfaqet në vitin 2009, kur efektet e krizës u transmetuan më qartë në aktivitetin ekonomik, në flukset e jashtme dhe në financat publike. Ky rezultat sugjeron se pas vitit 2009 marrëdhënia ndërmjet politikës fiskale dhe rritjes ekonomike ka hyrë në një regjim të ri, të karakterizuar nga rritje më e moderuar, presione mbi borxhin publik dhe nevojë për konsolidim fiskal.


Në mënyrë të ngjashme, viti 2020 paraqet evidencë të fortë për thyerje strukturore. Ky rezultat është në përputhje me natyrën e pandemisë COVID-19, e cila solli një goditje të menjëhershme dhe të njëkohshme në ofertë, kërkesë dhe financa publike. Ndryshe nga kriza financiare globale, ku efektet u transmetuan gradualisht, pandemia shkaktoi një ndryshim më të menjëhershëm në sjelljen e treguesve makroekonomikë dhe fiskalë. Për rrjedhojë, rezultatet e Chow Test mbështesin përdorimin e variablave “dummy”, termave të ndërveprimit dhe analizës sipas nënperiudhave në specifikimet ekonometrike të studimit.

Për të plotësuar evidencën e Chow Test, stabiliteti i parametrave u analizua edhe përmes testeve grafike CUSUM dhe CUSUMSQ. Rezultatet e testit CUSUM tregojnë se parametrat e modelit mbeten përgjithësisht brenda kufijve kritikë gjatë periudhës së

⁵ **Shënim:** Prob. < 0.05 → domethënie statistikore; Prob. < 0.10 → evidencë e moderuar.

analizuar. Kjo sugjeron se, pavarësisht ndryshimeve të evidentuara në vitet e krizave, modeli ruan një nivel të pranueshëm stabiliteti të përgjithshëm.

Figura 5.5 Stabiliteti I parametrave-CUSUM




Burimi: Përpunime të autorit në EViews.

Megjithatë, grafiku tregon lëvizje më të theksuara pas viteve 2008–2009 dhe 2020, duke reflektuar rritjen e paqëndrueshmërisë gjatë episodeve të krizës. Fakti që linja CUSUM nuk del jashtë kufijve kritikë tregon se këto ndryshime nuk e destabilizojnë plotësisht modelin, por sinjalizojnë praninë e ndryshimeve që duhen marrë në konsideratë në interpretimin ekonomik të rezultateve.

Në vijim, testi CUSUM of Squares përdoret për të vlerësuar stabilitetin e variancës së gabimeve. Ky test është veçanërisht i dobishëm në periudha krizash, kur luhatjet makroekonomike mund të rrisin volatilitetin e mbetjeve të modelit.

Figura 5.6 Stabiliteti I variancës-CUSUM of Squares



Burimi: Përpunime të autorit në EViews.

Rezultatet e CUSUMSQ tregojnë rritje të volatilitetit pas vitit 2009 dhe veçanërisht pas vitit 2020, por linja e testit mbetet brenda kufijve kritikë. Kjo sugjeron se, ndonëse periudhat e krizës kanë rritur paqëndrueshmërinë e modelit, ato nuk e komprometojnë plotësisht vlefshmërinë e tij statistikore. Kjo evidencë mbështet përdorimin e modelit për analizën e periudhës së plotë 2000–2024, por njëkohësisht justifikon analizën plotësuese sipas nënperiudhave.

Në mënyrë të integruar, rezultatet e Chow Breakpoint Test, CUSUM dhe CUSUMSQ tregojnë se ekonomia shqiptare ka kaluar nëpër regjime të ndryshme makroekonomike gjatë periudhës së studimit. Ndryshimet më të qarta lidhen me vitin 2009 dhe vitin 2020, të cilat përfaqësojnë dy pika të rëndësishme kthese për marrëdhënien ndërmjet politikës fiskale dhe rritjes ekonomike. Kriza financiare globale shfaqet si një proces me transmetim më gradual, ndërsa pandemia COVID-19 si një goditje më e menjëhershme dhe sistemike. Kjo dallueshmëri është e rëndësishme për interpretimin e rolit të politikës fiskale, pasi sugjeron se efektiviteti i saj mund të ketë qenë i ndryshëm në varësi të natyrës së krizës dhe hapësirës fiskale të disponueshme.

Evidenca e siguruar nga testet e stabilitetit strukturor mbështet ekzistencën e tre fazave të dallueshme në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë gjatë periudhës 2000–2024: periudhën para krizës financiare globale (2000–2008), periudhën e paskrizës dhe konsolidimit fiskal (2009–2019) dhe periudhën e karakterizuar nga pandemia COVID-19 dhe zhvillimet pasuese (2020–2024). Kjo ndarje nuk bazohet vetëm në ngjarje dhe transformime me rëndësi makroekonomike, por gjen mbështetje edhe në evidencën

statistikore që sinjalizon praninë e ndryshimeve strukturore në marrëdhëniet ndërmjet variablave të studiuar.

Tabela 5.7 Implikimet e thyerjeve strukturore për regjimet fiskale në Shqipëri

Periudha	Regjimi ekonomik	Natyrë e goditjes	Evidencë empirike	Roli i politikës fiskale	Implikime për analizën
2000–2008	Stabilitet para krizës	—	Pa thyerje strukturore	Rol relativisht neutral	Përdoret si periudhë reference
2009–2019	Pas krizës globale	Financiare, transmetim gradual	Thyerje e fortë në 2009	Rol stabilizues dhe konsolidues	Justifikon analizën në nënperiudhë
2020–2024	Pandemi dhe rimëkëmbje	Reale dhe sistemike	Thyerje e fortë në 2020	Politikë fiskale ekspansioniste dhe kundërciklike	Regjim i ri makroekonomik

Burimi: Interpretim i autorit bazuar në rezultatet e Chow, CUSUM dhe analizën ekonometrike.

Rezultatet sugjerojnë se efektiviteti i politikës fiskale nuk mund të analizohet në mënyrë të izoluar apo si një fenomen i pandryshueshëm në kohë, por duhet të interpretohet në funksion të kushteve makroekonomike, natyrës së goditjeve ekonomike dhe kufizimeve që burojnë nga hapësira fiskale e disponueshme. Kjo qasje krijon një bazë më të qëndrueshme për interpretimin e rezultateve ekonometrike dhe për vlerësimin e ndryshimeve në rolin e politikës fiskale ndërmjet regjimeve të ndryshme ekonomike. Gjetjet e analizës hapin rrugën për shqyrtimin e dimensionit institucional të studimit. Ndryshimet e evidentuara në marrëdhënien ndërmjet politikës fiskale dhe rritjes ekonomike mund të lidhen jo vetëm me faktorë makroekonomikë, por edhe me evolucionin e kapaciteteve institucionale dhe cilësinë e qeverisjes fiskale. Për këtë arsye, analiza e mëtejshme i kushton vëmendje të veçantë rolit të Indeksit të Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF), me synimin për të vlerësuar nëse përmirësimi i kapaciteteve institucionale ka kontribuar në rritjen e efektivitetit të politikës fiskale gjatë periudhës së studiuar.

5.4 Rezultatet empirike

Ky seksion paraqet rezultatet empirike të studimit mbi marrëdhënien ndërmjet politikës fiskale dhe rritjes ekonomike në Shqipëri gjatë periudhës 2000–2024. Analiza zhvillohet në mënyrë të strukturuar, duke kaluar nga vlerësimi i efekteve mesatare të instrumenteve fiskale për të gjithë periudhën e studimit drejt identifikimit të ndryshimeve që shfaqen në kushte të ndryshme makroekonomike dhe institucionale. Fillimisht analizohen rezultatet e modeleve ekonometrike për periudhën e plotë, përmes modelit bazë, modelit të zgjeruar dhe modelit me terma ndërveprimi, me qëllim vlerësimin e qëndrueshmërisë së efekteve fiskale dhe evidentimin e ndikimit të episodeve të krizës. Më pas, analiza zgjerohet në nivel nënperiudhash për të vlerësuar mënyrën se si efektiviteti i politikës fiskale ka evoluar ndërmjet regjimeve të ndryshme makroekonomike. Në vijim,

studimi shqyrton rolin e kapacitetit institucional në marrëdhënien ndërmjet politikës fiskale dhe rritjes ekonomike përmes Indeksit të Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF), duke integruar dimensionin institucional në analizën empirike. Në këtë mënyrë, seksioni synon të ofrojë një vlerësim të plotë të faktorëve fiskalë dhe institucionalë që kanë ndikuar në performancën ekonomike të Shqipërisë gjatë periudhës së analizuar.

5.4.1 Analiza e efekteve fiskale mbi rritjen ekonomike: modeli bazë dhe modeli i zgjeruar (2000–2024)

Analiza empirike e politikës fiskale dhe e ndikimit të saj mbi rritjen ekonomike ndërtohet mbi një proces vlerësimi të shkallëzuar, i cili synon të evidentojë jo vetëm drejtimin e marrëdhënieve ndërmjet variablave fiskalë dhe performancës ekonomike, por edhe qëndrueshmërinë e tyre ndaj specifikimeve të ndryshme ekonometrike. Fillimisht shqyrtohet modeli bazë OLS, i përqendruar në instrumentet tradicionale të politikës fiskale – shpenzimet qeveritare, investimet publike, të ardhurat tatimore dhe borxhin publik – duke krijuar bazën për vlerësimin e efektit mesatar të tyre mbi rritjen ekonomike gjatë periudhës 2000–2024. Në vijim, analiza zgjerohet përmes përfshirjes së variablave kontrolluese makroekonomike, me qëllim izolimin më të qartë të efekteve fiskale dhe verifikimin e robustësisë së rezultateve.

Tabela 5.8 Rezultatet e modelit bazë OLS për rritjen ekonomike në Shqipëri (2001–2024)

Variabla ⁶	Koeficienti	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	−9.946	10.781	−0.923	0.368
GOV_EXP	0.456	0.357	1.276	0.217
D_PUB_INV	−0.379	0.422	−0.898	0.381
D_TAX_REV	0.374	0.334	1.119	0.277
D_PUB_DEBT	−0.398	0.108	−3.697	0.002
Statistika e modelit • $R^2 = 0.465$ • Adjusted $R^2 = 0.352$ • F-statistic = 4.12 (Prob = 0.014) • Durbin–Watson = 1.91 • Numri i observimeve = 24				

Burimi: Llogaritje të autorit në EViews.

Rezultatet tregojnë se modeli është statistikisht i rëndësishëm në tërësi (Prob(F)=0.014) dhe arrin të shpjegojë rreth 46.5% të variacionit të rritjes ekonomike ($R^2 = 0.465$). Ndërkohë, vlera e Adjusted R^2 prej 0.352 tregon se edhe pas korrigjimit për numrin e variablave shpjeguese, modeli ruan një fuqi shpjeguese të pranueshme. Diferenca ndërmjet R^2 dhe Adjusted R^2 është e pritshme në analizat me kampion relativisht të vogël

⁶ **Shënim:** Variabla e varur është **GDP_Growth**. D(.) tregon diferencën e parë të variablit, në përputhje me testet e stacionaritetit.

dhe disa variabla shpjeguese, duke sugjeruar se një pjesë e variacionit të shpjeguar nga R^2 lidhet me kompleksitetin e modelit.

Nga instrumentet fiskale të përfshira në model, shpenzimet qeveritare dhe të ardhurat tatimore paraqiten me koeficient pozitiv, duke sugjeruar se zgjerimi i aktivitetit fiskal priret të shoqërohet me norma më të larta të rritjes ekonomike. Megjithatë, këto efekte nuk rezultojnë statistikisht domethënëse, çka sugjeron se ndikimi i tyre nuk ka qenë i njëtrajtshëm gjatë gjithë periudhës së analizuar. Investimet publike paraqiten me koeficient negativ, por pa rëndësi statistikore, duke sinjalizuar se efekti i tyre mund të jetë ndikuar nga faktorë të tillë si përbërja e investimeve, efikasiteti i zbatimit apo vonesat kohore në materializimin e përfitimeve ekonomike.

Rezultati më i qëndrueshëm i modelit lidhet me borxhin publik, i cili rezulton negativ dhe statistikisht domethënës në nivelin 1% ($\beta = -0.398$; $p = 0.002$). Ky rezultat sugjeron se zgjerimi i borxhit publik është shoqëruar me ritme më të ulëta të rritjes ekonomike gjatë periudhës së studimit. Nga perspektiva ekonomike, kjo evidencë mbështet argumentin se nivelet më të larta të borxhit kufizojnë hapësirën fiskale dhe reduktojnë aftësinë e politikës fiskale për të mbështetur aktivitetin ekonomik në afatin e mesëm dhe të gjatë.

Megjithëse modeli bazë ofron evidencë të rëndësishme mbi rolin e instrumenteve fiskale, ai nuk merr në konsideratë faktorë të tjerë që ndikojnë në performancën ekonomike. Për këtë arsye, analiza zgjerohet më tej përmes përfshirjes së variablave kontrolluese që lidhen me stabilitetin makroekonomik, tregun e punës, flukset financiare nga jashtë dhe sektorin e jashtëm.

Tabela 5.9 Rezultatet e modelit të zgjeruar OLS për rritjen ekonomike në Shqipëri (2001–2024)

Variabla ⁷	Koeficienti	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	-3.086	14.081	-0.219	0.829
GOV_EXP	0.396	0.449	0.882	0.392
D_PUB_INV	-0.517	0.431	-1.197	0.245
D_TAX_REV	0.909	0.412	2.209	0.043
D_PUBLIC_DEBT	-0.472	0.155	-3.005	0.008
INFLATION	-0.123	0.428	-0.289	0.778
D_UNEMPLOYMENT	-0.190	0.543	-0.350	0.732
D_REMITTANCES	-0.672	0.810	-0.829	0.420
EXPORTS	-0.188	0.091	-2.070	0.056
Statistika e modelit • $R^2 = 0.614$ • Adjusted $R^2 = 0.409$ • F-statistic = 2.987 (Prob = 0.032) • Durbin–Watson = 2.249 • Numri i observimeve = 24				

⁷ Shënim: Variabla e varur është GDP_Growth. D(.) tregon diferencën e parë të variablit, në përputhje me testet e stacionaritetit. Modeli është vlerësuar me metodën OLS për periudhën 2001–2024.

Përfshirja e variablave kontrolluese përmirëson ndjeshëm performancën e modelit. Koeficienti i përcaktimit rritet nga 0.465 në 0.614, ndërsa modeli ruan rëndësinë statistikore në tërësi (Prob(F)=0.032). Kjo tregon se faktorët shtesë makroekonomikë kontribuojnë në shpjegimin e dinamikës së rritjes ekonomike dhe ofrojnë një kuadër më të plotë interpretues. Rezultatet tregojnë se drejtimi i koeficientëve fiskalë mbetet në përgjithësi i pandryshuar, duke sugjeruar që marrëdhëniet e identifikuara në modelin bazë janë relativisht të qëndrueshme. Megjithatë, pas kontrollit për faktorët e tjerë makroekonomikë, të ardhurat tatimore rezultojnë pozitive dhe statistikisht domethënëse ($\beta = 0.909$; $p = 0.043$). Ky rezultat sugjeron se kapaciteti i shtetit për të mobilizuar të ardhura publike dhe për të zgjeruar bazën fiskale ka qenë i lidhur pozitivisht me performancën ekonomike gjatë periudhës së analizuar. Në të njëjtën kohë, borxhi publik ruan efektin negativ dhe rëndësinë statistikore ($\beta = -0.472$; $p = 0.008$), duke përforcuar evidencën se ai ka përbërë një faktor kufizues për rritjen ekonomike. Qëndrueshmëria e këtij rezultati në të dy specifikimet ekonometrike e bën atë një nga gjetjet më robuste të analizës empirike. Shpenzimet qeveritare vazhdojnë të paraqiten me koeficient pozitiv, por pa domethënie statistikore, ndërsa investimet publike mbeten negative dhe jo domethënëse. Inflacioni, papunësia dhe remitancat nuk rezultojnë faktorë përcaktues në këtë specifikim. Eksportet paraqiten me koeficient negativ dhe me nivel rëndësie pranë pragut konvencional të 5% ($p = 0.056$), duke sugjeruar se marrëdhënia ndërmjet sektorit të jashtëm dhe rritjes ekonomike mund të jetë ndikuar nga karakteristika strukturore të ekonomisë shqiptare, përfshirë varësinë e lartë nga importet dhe strukturën e eksporteve.

Në tërësi, krahasimi ndërmjet modelit bazë dhe modelit të zgjeruar tregon një nivel të konsiderueshëm qëndrueshmërie të rezultateve. Evidenca empirike sugjeron se borxhi publik përfaqëson faktorin fiskal me ndikimin më të qëndrueshëm mbi rritjen ekonomike, ndërsa rëndësia e të ardhurave tatimore bëhet më e dukshme pasi kontrollohen faktorët e tjerë makroekonomikë. Këto rezultate tregojnë se efektet e politikës fiskale nuk mund të interpretohen në mënyrë të izoluar, por duhet të analizohen në ndërveprim me kushtet më të gjera makroekonomike që karakterizojnë ekonominë shqiptare. Për këtë arsye, analiza vijon më tej me vlerësimin e heterogjenitetit të efekteve fiskale gjatë episodeve të krizës, me qëllim identifikimin e ndryshimeve të mundshme në efektivitetin e politikës fiskale sipas regjimeve të ndryshme makroekonomike.

5.4.2 Efektet e politikës fiskale në kushtet e krizës: analiza me terma ndërveprimi

Për të vlerësuar nëse ndikimi i politikës fiskale mbi rritjen ekonomike ndryshon në periudha të karakterizuara nga goditje të rëndësishme makroekonomike, analiza zgjerohet përmes përfshirjes së termave të ndërveprimit ndërmjet shpenzimeve qeveritare dhe dy episodeve kryesore të krizës të identifikuara gjatë studimit: kriza financiare globale e viteve

2008–2009 dhe pandemia COVID-19. Kjo qasje mundëson vlerësimin e ndryshimeve të mundshme në intensitetin dhe drejtimin e efekteve fiskale gjatë periudhave të paqëndrueshmërisë ekonomike.

Tabela 5.10 Modeli OLS me terma ndërveprimi për krizat (2000–2024)

Variabla	Koeficienti	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	−9.702	11.358	−0.856	0.410
GOV_EXP	0.558	0.356	1.616	0.134
CRISIS_2009	151.176	105.188	1.436	0.182
COVID	664.679	150.053	4.429	0.000
D_PUB_INV	0.084	0.346	0.244	0.812
D_TAX_REV	0.402	0.299	1.342	0.207
D_PUBLIC_DEBT	−0.299	0.115	−2.595	0.025
INFLATION	0.081	0.301	0.271	0.791
D_UNEMPLOYMENT	−0.238	0.334	−0.712	0.492
D_REMITTANCES	−0.735	0.534	−1.374	0.197
EXPORTS	−0.164	0.063	−2.606	0.024
GOV_CRISIS09	−4.558	3.242	−1.406	0.187
GOV_COVID	−20.688	4.676	−4.424	0.001
Statistika e modelit • $R^2 = 0.900$ • Adjusted $R^2 = 0.792$ • F-statistic = 8.28 (Prob = 0.0007) • Durbin–Watson = 1.49 • Numri i observimeve = 24				

Burimi: Llogaritje të autorit në EViews.

Rezultatet tregojnë se përfshirja e termave të ndërveprimit përmirëson ndjeshëm performancën e modelit. Koeficienti i përcaktimit rritet në $R^2 = 0.900$, ndërsa modeli rezulton statistikisht i rëndësishëm në tërësi (Prob(F) = 0.0007). Kjo sugjeron se ndryshimet ndërmjet regjimeve makroekonomike përbëjnë një element të rëndësishëm në shpjegimin e dinamikës së rritjes ekonomike në Shqipëri gjatë periudhës së analizuar. Në kushtet normale ekonomike, shpenzimet qeveritare paraqiten me koeficient pozitiv ($\beta = 0.558$), duke sugjeruar një lidhje pozitive ndërmjet zgjerimit të shpenzimeve publike dhe aktivitetit ekonomik. Megjithatë, mungesa e domethënies statistikore tregon se ky efekt nuk ka qenë i njëtrajtshëm gjatë gjithë periudhës së studimit. Një nga rezultatet më domethënëse të modelit lidhet me variablën COVID, e cila rezulton pozitive dhe statistikisht shumë domethënëse ($\beta = 664.679$; $p < 0.001$). Ky rezultat pasqyron karakterin e veçantë të periudhës së pandemisë dhe ndërhyrjet e gjera publike të ndërmarra për mbështetjen e ekonomisë. Në të njëjtën kohë, termi i ndërveprimit ndërmjet shpenzimeve publike dhe pandemisë (GOV_COVID) rezulton negativ dhe statistikisht domethënës ($\beta = -20.688$; $p = 0.001$), duke treguar se mekanizmi i transmetimit të politikës fiskale gjatë pandemisë ndryshon ndjeshëm nga ai i periudhave normale ekonomike.

Ndryshe nga pandemia, termi i ndërveprimit për krizën financiare globale (GOV_CRISIS09) nuk rezulton statistikisht domethënës, megjithëse paraqet të njëjtin drejtim negativ. Ky rezultat sugjeron se efekti i krizës së viteve 2008–2009 mbi marrëdhënien ndërmjet politikës fiskale dhe rritjes ekonomike ka qenë më gradual dhe më pak i drejtpërdrejtë sesa ai i pandemisë COVID-19, duke reflektuar edhe natyrën e ndryshme të dy goditjeve ekonomike. Në përputhje me rezultatet e modeleve të mëparshme, borxhi publik ruan efektin negativ dhe rëndësinë statistikore ($\beta = -0.299$; $p = 0.025$), duke konfirmuar qëndrueshmërinë e kësaj marrëdhënieje në specifikime të ndryshme ekonometrike. Edhe në këtë model, borxhi publik paraqitet si faktori fiskal më konsistent në shpjegimin e rritjes ekonomike gjatë periudhës së analizuar. Nga variablat kontrolluese, eksportet rezultojnë negative dhe statistikisht domethënëse ($\beta = -0.164$; $p = 0.024$), ndërsa inflacioni, papunësia, remitancat dhe investimet publike nuk paraqesin evidencë të mjaftueshme statistikore për të mbështetur një ndikim të drejtpërdrejtë mbi rritjen ekonomike në këtë specifikim.

Krahasimi ndërmjet tre specifikimeve tregon një rritje graduale të fuqisë shpjeguese të modelit. Ndërsa modeli bazë shpjegon 46.5% të variacionit të rritjes ekonomike, modeli i zgjeruar e rrit këtë nivel në 61.4%, ndërsa përfshirja e termave të ndërveprimit me periudhat e krizës e çon koeficientin e përcaktimit në 90.0%. Ky rezultat sugjeron se marrëdhënia ndërmjet politikës fiskale dhe rritjes ekonomike nuk mund të interpretohet vetëm përmes efekteve lineare, por ndikohet edhe nga karakteristikat e regjimeve makroekonomike dhe episodeve të krizës.

Në tërësi, rezultatet e modelit me ndërveprime sugjerojnë se marrëdhënia ndërmjet politikës fiskale dhe rritjes ekonomike nuk ka qenë homogjene gjatë periudhës 2000–2024. Efektet fiskale rezultojnë të kushtëzuara nga konteksti makroekonomik dhe nga natyra e goditjeve që ka përjetuar ekonomia shqiptare. Kjo evidencë është në përputhje me rezultatet e analizës së stabilitetit strukturor, të cilat identifikuan vitet 2009 dhe 2020 si pika të rëndësishme thyerjeje në marrëdhëniet ndërmjet variablave ekonomikë. Për rrjedhojë, analiza e mëtejshme zhvillohet në nivel nënperiudhash, me qëllim vlerësimin më të detajuar të mënyrës se si efektiviteti i politikës fiskale ka evoluuar ndërmjet regjimeve të ndryshme makroekonomike.

5.4.3 Efektiviteti i politikës fiskale në regjime të ndryshme makroekonomike

Rezultatet e paraqitura për periudhën e plotë 2000–2024 treguan se ndikimi i politikës fiskale mbi rritjen ekonomike nuk ka qenë uniform gjatë gjithë periudhës së studimit. Evidenca e siguruar nga modeli me ndërveprime, së bashku me rezultatet e testeve të stabilitetit strukturor, sugjeron se marrëdhënia ndërmjet instrumenteve fiskale dhe rritjes ekonomike ka ndryshuar në varësi të kushteve makroekonomike dhe natyrës së goditjeve që ka përjetuar ekonomia shqiptare. Për këtë arsye, analiza zgjerohet përmes vlerësimit të

tre regjimeve të dallueshme makroekonomike: periudhës së stabilitetit dhe zgjerimit ekonomik para krizës globale (2000–2008), periudhës së konsolidimit fiskal pas krizës financiare globale (2009–2019) dhe periudhës së pandemisë dhe rimëkëmbjes ekonomike (2020–2024). Kjo ndarje nuk mbështetet vetëm në zhvillimet historike dhe ekonomike të vendit, por edhe në evidencën empirike të identifikuar nga testet Chow, CUSUM dhe CUSUMSQ, të cilat evidentuan ndryshime të rëndësishme strukturore rreth viteve 2009 dhe 2020. Analiza sipas regjimeve makroekonomike mundëson një vlerësim më të detajuar të mënyrës se si instrumentet fiskale kanë funksionuar në kushte të ndryshme ekonomike dhe ndihmon në identifikimin e faktorëve që kanë kushtëzuar efektivitetin e tyre. Në këtë mënyrë, studimi kalon nga vlerësimi i efekteve mesatare për të gjithë periudhën drejt një analize më të thelluar të heterogjenitetit të politikës fiskale në Shqipëri.

Regjimi i stabilitetit dhe zgjerimit ekonomik (2000–2008)

Periudha 2000–2008 përfaqëson fazën e stabilizimit makroekonomik dhe të konsolidimit gradual të ekonomisë shqiptare pas tranzicionit. Kjo periudhë karakterizohet nga ritme relativisht të larta të rritjes ekonomike, zgjerim i aktivitetit privat, rritje të investimeve dhe përmirësim të treguesve fiskalë. Në të njëjtën kohë, niveli i borxhit publik mbetej relativisht i kontrolluar, duke krijuar hapësirë më të gjerë për ndërhyrje fiskale krahasuar me periudhat pasuese. Nga këndvështrimi i këtij studimi, kjo fazë shërben si periudhë reference për vlerësimin e marrëdhënies ndërmjet politikës fiskale dhe rritjes ekonomike para goditjeve të mëdha të krizës financiare globale. Për të analizuar rolin e politikës fiskale gjatë kësaj periudhe, u vlerësuan si modeli bazë ashtu edhe modeli i zgjeruar. Megjithatë, rezultatet duhet të interpretohen me kujdes për shkak të numrit relativisht të kufizuar të observimeve ($n = 8$), i cili kufizon fuqinë statistikore të testeve dhe rrit ndjeshmërinë e koeficientëve ndaj ndryshimeve në specifikimin e modelit. Për këtë arsye, analiza fokusohet kryesisht në identifikimin e prirjeve dhe drejtimit të marrëdhënieve ekonomike.

Tabela 5.11 Modeli bazë OLS për periudhën para krizës globale (2001–2008)

Variabla	Koeficienti	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	−17.008	10.580	−1.608	0.206
GOV_EXP	0.735	0.336	2.240	0.111*
D_PUB_INV	0.290	0.334	0.868	0.450
D_TAX_REV	−0.411	0.924	−0.445	0.687
D_PUBLIC_DEBT	−0.131	0.159	−0.823	0.471
Statistika e modelit • $R^2 = 0.756$ • Adjusted $R^2 = 0.429$ • F-statistic = 2.31 (Prob = 0.259) • Durbin–Watson = 1.90 • Numri i observimeve = 8				

Burimi: Llogaritje të autorit në EViews.

Për të verifikuar qëndrueshmërinë e këtyre rezultateve, analiza u zgjerua duke përfshirë edhe një variabël kontrolluese që lidhet me sektorin e jashtëm, konkretisht eksportet. Qëllimi ishte të vlerësohej nëse marrëdhënia ndërmjet politikës fiskale dhe rritjes ekonomike mbetet e ngjashme edhe pas kontrollit për faktorë të tjerë ekonomikë.

Tabela 5.12 Modeli i zgjeruar OLS për periudhën para krizës globale (2001–2008)

Variabla	Koeficienti	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	-16.846	13.380	-1.259	0.335
GOV_EXP	0.648	0.378	1.713	0.229
D_PUB_INV	0.042	0.218	0.195	0.864
D_TAX_REV	-0.540	0.863	-0.625	0.596
D_PUBLIC_DEBT	-0.142	0.211	-0.674	0.570
EXPORTS	0.135	0.093	1.448	0.285
Statistika e modelit • $R^2 = 0.791$ • Adjusted $R^2 = 0.268$ • F-statistic = 1.512 (Prob = 0.444) • Durbin–Watson = 2.28 • Numri i observimeve = 8				

Burimi: Llogaritje të autorit në EViews.

Krahasimi ndërmjet modelit bazë dhe modelit të zgjeruar tregon se përfshirja e variablave shtesë kontrolluese nuk ndryshon në mënyrë të konsiderueshme drejtimin e marrëdhënieve të identifikuara. Në të dy specifikimet, shpenzimet qeveritare ruajnë një koeficient pozitiv, duke sugjeruar se zgjerimi i shpenzimeve publike është shoqëruar me një ecuri më të favorshme të aktivitetit ekonomik gjatë periudhës së stabilitetit para krizës financiare globale. Investimet publike paraqesin gjithashtu një lidhje pozitive në modelin bazë, por intensiteti i këtij efekti zvogëlohet pas përfshirjes së variablave shtesë në modelin e zgjeruar, çka tregon se ndikimi i tyre nuk është plotësisht i pavarur nga faktorë të tjerë makroekonomikë. Në të njëjtën linjë, borxhi publik ruan koeficient negativ në të dy modelet, duke sinjalizuar se rritja e nivelit të borxhit nuk është shoqëruar me përmirësim të performancës ekonomike edhe gjatë kësaj periudhe të karakterizuar nga zgjerimi ekonomik. Ndryshe nga variablat fiskalë, eksportet shfaqin një efekt pozitiv në modelin e zgjeruar, duke evidentuar rëndësinë në rritje të sektorit të jashtëm si një burim mbështetës i aktivitetit ekonomik në vitet para krizës. Megjithatë, fakti që shumica e koeficientëve nuk rezultojnë statistikisht domethënës tregon se dinamika e rritjes ekonomike në këtë nënperiudhë nuk mund të atribuohet vetëm instrumenteve të politikës fiskale. Zhvillimi ekonomik duket të jetë ndikuar edhe nga faktorë të tjerë strukturorë, si zgjerimi i sektorit privat, rritja e investimeve, përmirësimi i klimës së biznesit dhe kushtet e favorshme makroekonomike që karakterizuan ekonominë shqiptare para krizës.

Edhe pse modeli regjistron një koeficient përcaktimi relativisht të lartë ($R^2 = 0.791$), interpretimi i këtij rezultati kërkon kujdes. Diferenca e konsiderueshme ndërmjet R^2 dhe Adjusted R^2 (0.268) tregon se aftësia shpjeguese e modelit mbivlerësohet pjesërisht nga numri i kufizuar i observimeve ($n = 8$) në raport me numrin e variablave të përfshira. Si pasojë, Adjusted R^2 përbën treguesin më të përshtatshëm për vlerësimin e performancës së modelit në këtë rast. Për këtë arsye, analiza e rezultateve fokusohet kryesisht në drejtimin dhe madhësinë relative të koeficientëve, ndërsa treguesit e përshtatjes së modelit interpretohen me rezervë për shkak të kufizimeve të kampionit. Në tërësi, evidenca empirike sugjeron se gjatë periudhës 2000–2008 politika fiskale ka luajtur kryesisht një rol mbështetës në procesin e rritjes ekonomike, pa u shfaqur si faktori dominues i saj. Kjo gjetje është në përputhje me karakteristikat e një periudhe zgjerimi ekonomik, ku aktiviteti privat dhe kushtet e favorshme makroekonomike përbënin burimet kryesore të rritjes. Për rrjedhojë, kjo nënperiudhë shërben si pikë reference për krahasimin me periudhat pasuese, kur roli i politikës fiskale bëhet më aktiv për shkak të krizave ekonomike dhe kufizimeve të hapësirës fiskale.

Regjimi i konsolidimit fiskal pas krizës globale (2009–2019)

Periudha 2009–2019 përkon me një regjim të ri makroekonomik të formësuar nga pasojat e krizës financiare globale, ngadalësimi i ritmeve të rritjes ekonomike dhe nevoja për konsolidim fiskal. Krahasuar me periudhën para krizës, politika fiskale operoi në kushte më të kufizuara për shkak të rritjes së borxhit publik dhe presioneve mbi financat publike, duke orientuar politikëbërjen drejt kontrollit të deficitit dhe ruajtjes së stabilitetit fiskal. Në këtë kontekst, analiza synon të vlerësojë nëse instrumentet fiskale kanë ruajtur aftësinë për të mbështetur rritjen ekonomike apo nëse efektet e tyre janë dobësuar nga kufizimet e hapësirës fiskale. Për këtë periudhë janë vlerësuar një model bazë dhe dy variante të modelit të zgjeruar. Modeli bazë fokusohet te instrumentet kryesore fiskale, ndërsa modelet e zgjeruara përfshijnë faktorë kontrollues që lidhen me stabilitetin makroekonomik të brendshëm dhe sektorin e jashtëm. Kjo qasje mundëson verifikimin e qëndrueshmërisë së rezultateve dhe identifikimin e faktorëve që kanë ndikuar në performancën ekonomike gjatë periudhës së konsolidimit fiskal.

Tabela 5.13 Rezultatet e modelit bazë OLS për periudhën e konsolidimit fiskal (2010–2019)

Variabla	Koeficienti	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	9.667	9.482	1.019	0.355
GOV_EXP	-0.235	0.320	-0.732	0.497
D_PUB_INV	-0.618	0.180	-3.436	0.019
D_TAX_REV	0.228	0.311	0.732	0.497
D_PUBLIC_DEBT	-0.292	0.047	-6.181	0.002
Statistika e modelit • $R^2 = 0.871$ • Adjusted $R^2 = 0.769$				

- F-statistic = 8.443 (Prob = 0.019)
- Durbin–Watson = 2.19
- Numri i observimeve = 10

Burimi: Llogaritje të autorit në EViews.

Rezultatet e modelit bazë evidentojnë një ndryshim të dukshëm krahasuar me periudhën para krizës globale. Borxhi publik paraqitet me efekt negativ dhe statistikisht domethënës ndaj rritjes ekonomike, duke sugjeruar se zgjerimi i nivelit të borxhit ka kufizuar potencialin e rritjes ekonomike gjatë kësaj periudhe. Në të njëjtën kohë, investimet publike rezultojnë gjithashtu me efekt negativ dhe statistikisht domethënës në afatshkurtër, çka mund të lidhet me natyrën e investimeve publike, vonesat në transmetimin e efekteve të tyre ose me kufizimet fiskale që karakterizuan periudhën pas krizës. Ndërkohë, shpenzimet qeveritare dhe të ardhurat tatimore nuk paraqesin evidencë statistikisht të rëndësishme mbi ndikimin e tyre në rritjen ekonomike.

Për të testuar qëndrueshmërinë e këtyre rezultateve, analiza u zgjerua në dy drejtime të ndryshme. Varianti i parë (B1) përfshin inflacionin dhe papunësinë si tregues të stabilitetit makroekonomik të brendshëm, ndërsa varianti i dytë (B2) përfshin eksportet dhe remitancat për të vlerësuar ndikimin e sektorit të jashtëm.

Varianti B1. Kontroll për stabilitetin makroekonomik

Tabela 5.14 Modeli i zgjeruar OLS me kontroll për stabilitetin makroekonomik (2009–2019)

Variabla	Koeficienti	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	10.589	8.195	1.292	0.287
GOV_EXP	-0.252	0.275	-0.917	0.427
D_PUB_INV	-0.757	0.234	-3.229	0.048
D_TAX_REV	0.184	0.317	0.578	0.604
D_PUBLIC_DEBT	-0.305	0.105	-2.896	0.063
INFLATION	-0.175	0.391	-0.447	0.685
D_UNEMPLOYMENT	0.007	0.304	0.023	0.983
Statistika e modelit • $R^2 = 0.878$ • Adjusted $R^2 = 0.633$ • F-statistic = 3.583 (Prob = 0.161) • Durbin–Watson = 2.29 • Numri i observimeve = 10				

Burimi: Llogaritje të autorit në EViews.

Rezultatet e variantit B1 tregojnë se përfshirja e inflacionit dhe papunësisë nuk ndryshon në mënyrë thelbësore përfundimet e modelit bazë. Borxhi publik ruan efektin negativ dhe mbetet pranë pragut të domethënies statistikore, ndërsa investimet publike vijnë të paraqiten me efekt negativ dhe statistikisht të rëndësishëm. Inflacioni dhe papunësia nuk rezultojnë faktorë përcaktues të rritjes ekonomike në këtë specifikim, duke

sugjeruar se kufizimet fiskale kanë luajtur rol më të rëndësishëm sesa luhatjet ciklike të brendshme në përcaktimin e performancës ekonomike gjatë kësaj periudhe.

Varianti B2. Kontroll për sektorin e jashtëm

Tabela 5.15 Modeli i zgjeruar OLS me kontroll për sektorin e jashtëm (2009–2019)

Variabla	Koeficienti	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	-1.788	14.478	-0.123	0.910
GOV_EXP	0.175	0.410	0.426	0.699
D_PUB_INV	-0.243	0.391	-0.623	0.578
D_TAX_REV	0.125	0.362	0.344	0.754
D_PUBLIC_DEBT	-0.321	0.027	-11.737	0.001
EXPORTS	-0.031	0.113	-0.278	0.799
D_REMITTANCES	-0.682	0.265	-2.570	0.083
Statistika e modelit • $R^2 = 0.934$ • Adjusted $R^2 = 0.803$ • F-statistic = 7.129 (Prob = 0.068) • Durbin–Watson = 1.95 • Numri i observimeve = 10				

Burimi: Llogaritje të autorit në EViews.

Rezultatet e variantit B2 konfirmojnë më tej qëndrueshmërinë e efektit negativ të borxhit publik, i cili mbetet variabli më i fortë dhe më konsistent në të gjitha specifikimet e vlerësuara për këtë periudhë. Në këtë model, remitancat paraqiten me efekt negativ pranë pragut të domethënies statistikore, ndërsa eksportet nuk rezultojnë statistikisht të rëndësishme. Megjithëse këto rezultate mund të duken kundërintuitive, ato mund të reflektojnë karakteristikat strukturore të ekonomisë shqiptare gjatë periudhës së analizuar, ku remitancat janë orientuar kryesisht drejt konsumit dhe jo domosdoshmërisht drejt aktiviteteve me ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen afatgjatë.

Në tërësi, krahasimi i tre specifikimeve ekonometrike tregon një shkallë të lartë konsistence të rezultateve. Ndryshe nga periudha para krizës globale, ku shpenzimet qeveritare paraqiteshin me ndikim pozitiv dhe politika fiskale operonte në kushte më të favorshme, periudha 2009–2019 karakterizohet nga dominimi i kufizimeve fiskale dhe nga rëndësia në rritje e borxhit publik si faktor frenues i rritjes ekonomike. Evidenca empirike sugjeron se politika fiskale gjatë kësaj periudhe ka operuar kryesisht në funksion të stabilizimit dhe konsolidimit fiskal, ndërsa hapësira për politika ekspansioniste ka qenë dukshëm më e kufizuar. Kjo gjetje mbështet argumentin teorik se niveli i borxhit publik dhe kufizimet e hapësirës fiskale ndikojnë drejtpërdrejt në efektivitetin e politikës fiskale dhe në aftësinë e saj për të mbështetur rritjen ekonomike.

Regjimi i pandemisë dhe rimëkëmbjes ekonomike (2020–2024)

Periudha 2020–2024 përfaqëson një regjim të veçantë makroekonomik, të karakterizuar nga pandemia COVID-19, ndërhyrje fiskale me intensitet të lartë dhe rikthimi i rolit aktiv të shtetit në stabilizimin e aktivitetit ekonomik. Krahasuar me dy nënperiudhat e mëparshme, politika fiskale gjatë kësaj faze u përdor në mënyrë më ekspansioniste për të mbështetur bizneset, punësimin dhe kërkesën agregate, duke shërbyer si instrumenti kryesor i menaxhimit të krizës. Megjithatë, kjo periudhë paraqet edhe kufizimin më të rëndësishëm metodologjik të studimit, pasi analiza mbështetet në vetëm katër observime vjetore. Për këtë arsye, rezultatet duhet të interpretohen me kujdes dhe të konsiderohen kryesisht si evidencë eksploruese mbi drejtimin dhe intensitetin e marrëdhënieve ndërmjet variablove. Duke pasur parasysh këtë kufizim, analiza kombinoi një model OLS të thjeshtuar me regresione bivariate dhe analizë korelacioni, me qëllim rritjen e qëndrueshmërisë së interpretimit empirik.

Modeli OLS dhe evidenca plotësuese

Për shkak të numrit shumë të kufizuar të observimeve, modeli përfshin vetëm dy instrumente fiskale që përfaqësojnë kanalet kryesore të ndërhyrjes publike gjatë periudhës së pandemisë: shpenzimet qeveritare dhe ndryshimin në borxhin publik.

Tabela 5.16 Modeli bazë OLS për periudhën COVID dhe pas-COVID (2021–2024)

Variabla	Koeficienti	Std. Error	t-Statistic	p-value
C	–33.07575	4.922972	–6.718655	0.0941
GOV_EXP	1.312233	0.160846	8.158327	0.0776
D_PUBLIC_DEBT	0.167126	0.056550	2.955352	0.2077
Statistika e modelit • $R^2 = 0.991138$ • Adjusted $R^2 = 0.973413$ • Prob(F) = 0.094139 • Numri I Observimeve = 4				

Burimi: Llogaritje të autorit në EViews.

Rezultatet tregojnë se shpenzimet qeveritare paraqiten me efekt pozitiv dhe me intensitet dukshëm më të lartë krahasuar me periudhat e mëparshme. Edhe ndryshimi i borxhit publik rezulton me drejtim pozitiv, duke sugjeruar se zgjerimi fiskal i realizuar gjatë pandemisë është shoqëruar me ritme më të larta të rimëkëmbjes ekonomike. Megjithatë, duke qenë se modeli mbështetet në një kampion jashtëzakonisht të kufizuar, këto rezultate interpretohen si tregues të prirjeve të përgjithshme dhe jo si evidencë përfundimtare statistikore. Për të verifikuar nëse drejtimi i marrëdhënieve mbetet konsistent edhe në analiza më të thjeshta, u vlerësuan mini-regresione bivariate për secilën variabël ekonomike.

Tabela 5.17 Mini-regresionet bivariate për periudhën 2020–2024

Variabla e pavarur	Koeficienti (β)	Std. Error	t-Statistic	p-value	R^2	Drejtimi
--------------------	-------------------------	------------	-------------	---------	-------	----------

D_PUB_INV	-2.718	1.151	-2.438	0.135	0.748	Negativ
D_TAX_REV	0.442	0.478	0.926	0.453	0.300	Pozitiv
INFLATION	0.445	1.123	0.396	0.718	0.050	Pozitiv
D_UNEMPLOYMENT	1.879	6.156	0.305	0.789	0.045	Pozitiv
D_REMITTANCES	8.071	5.646	1.429	0.289	0.505	Pozitiv
EXPORTS	0.082	0.188	0.439	0.690	0.060	Pozitiv

Burimi⁸: Llogaritje të autorit në EViews.

Rezultatet e mini-regresioneve sugjerojnë se investimet publike paraqesin një lidhje negative në afatshkurtër me rritjen ekonomike, ndërsa remitancat dhe të ardhurat tatimore paraqiten me drejtim pozitiv. Në të njëjtën kohë, inflacioni, papunësia dhe eksportet nuk shfaqin lidhje të forta me rritjen ekonomike gjatë kësaj periudhe, duke reflektuar natyrën e pazakontë të goditjes ekonomike dhe dominimin e faktorëve fiskalë në procesin e rimëkëmbjes. Evidenca plotësohet nga analiza e korelacionit Pearson.

Tabela 5.18 Forca dhe drejtimi i lidhjes ndërmjet rritjes ekonomike dhe variablave fiskalë/makroekonomikë në periudhën 2020–2024

Variabla	r me GDP_Growth	Forca	Drejtimi
D_PUB_INV	-0.865	Shumë e fortë	Negativ
D_PUBLIC_DEBT	0.633	E fortë	Pozitiv
D_REMITTANCES	0.711	E fortë	Pozitiv
D_TAX_REV	0.547	Mesatare	Pozitiv
D_UNEMPLOYMENT	0.211	E dobët	Pozitiv
EXPORTS	0.145	E dobët	Pozitiv
INFLATION	-0.446	Mesatare	Negativ
GOV_EXP	0.956	Shumë e fortë	Pozitiv

Burimi: Llogaritje të autorit në EViews bazuar në të dhëna nga World Bank, INSTAT dhe Ministria e Financave.

Rezultatet e korelacionit konfirmojnë në përgjithësi drejtimin e marrëdhënieve të identifikuar në analizat paraprake. Shpenzimet qeveritare paraqesin lidhjen më të fortë pozitive me rritjen ekonomike, duke reflektuar rolin e tyre si instrumenti kryesor i stabilizimit gjatë pandemisë dhe fazës së rimëkëmbjes. Remitancat dhe borxhi publik shfaqin gjithashtu lidhje pozitive relativisht të forta, ndërsa investimet publike paraqiten me lidhje negative në afatshkurtër. Inflacioni rezulton i lidhur negativisht me rritjen ekonomike, duke sugjeruar se presionet inflacioniste të viteve të fundit mund të kenë kufizuar pjesërisht efektet e rimëkëmbjes. Në tërësi, evidenca empirike për periudhën 2020–2024 sugjeron se politika fiskale ka marrë një rol dukshëm më aktiv dhe më kundërciklik krahasuar me regjimet e mëparshme makroekonomike. Ndryshe nga periudha

⁸ Shënim: Të gjitha modelet janë regresione bivariate të vlerësuara me metodën OLS për periudhën 2020–2024 ($n = 4$ ose 5). Për shkak të kampionit të kufizuar, rezultatet interpretohen si indikative dhe jo si prova përfundimtare kauzale. Duke qenë se kampioni është i vogël ($n = 4$ – 5), rezultatet interpretohen si indikative dhe përdoren për krahasim ndër-periudhor.

e konsolidimit fiskal pas krizës globale, ku borxhi publik paraqitej si faktor kufizues i rritjes ekonomike, gjatë pandemisë zgjerimi i shpenzimeve publike dhe përdorimi i hapësirës fiskale duket se kanë kontribuar në mbështetjen e aktivitetit ekonomik dhe në procesin e rimëkëmbjes. Megjithatë, për shkak të kufizimeve të kampionit, këto rezultate duhet të interpretohen si evidencë indikative që mbështet ekzistencën e një regjimi fiskal më ekspansionist dhe më stabilizues gjatë periudhës së pandemisë dhe rimëkëmbjes ekonomike.

Analizë krahasuese e regjimeve fiskale

Analiza sipas nënperiudhave konfirmon se marrëdhënia ndërmjet politikës fiskale dhe rritjes ekonomike në Shqipëri nuk ka qenë homogjene gjatë periudhës 2000–2024. Rezultatet tregojnë se efektiviteti i instrumenteve fiskale ka ndryshuar në varësi të kushteve makroekonomike, nivelit të hapësirës fiskale dhe natyrës së goditjeve që kanë karakterizuar secilin regjim ekonomik. Kjo evidencë është në përputhje me rezultatet e testeve të stabilitetit strukturor, të cilat identifikuan ndryshime të rëndësishme rreth viteve 2009 dhe 2020 dhe mbështetën ndarjen e periudhës së studimit në tre nënperiudha të dallueshme.

Tabela 5.19 Krahasimi i regjimeve fiskale dhe efektivitetit të politikës fiskale në Shqipëri sipas nënperiudhave (2000–2024)

Periudha	Regjimi fiskal	Roli i borxhit publik	Efektiviteti i politikës fiskale	Faktor dominues	Intensiteti I multiplikatorit
2000–2008	Mbështetës	Neutral	i kufizuar	Spektori i jashtëm & aktiviteti privat	I moderuar
2009–2019	Konsolidues	Kufizues	i ulët	Stabiliteti fiskal	I ulët/ negativ
2020–2024	Ekspansionist	Stabilizues	i lartë	Ndërhjyra shtetërore	I lartë/ kundërciklik

Burimi: Përpunim dhe sintetizim i autorit bazuar në rezultatet e analizës ekonometrike.

Rezultatet tregojnë një evolucion të qartë të rolit të politikës fiskale përgjatë tre regjimeve makroekonomike. Në periudhën para krizës globale (2000–2008), ekonomia shqiptare karakterizohej nga ritme të larta rritjeje dhe zgjerim i aktivitetit privat, ndërsa politika fiskale kishte kryesisht një rol mbështetës. Gjatë kësaj faze, ndikimi i instrumenteve fiskale mbi rritjen ekonomike rezulton relativisht i moderuar, ndërsa zhvillimet në sektorin privat dhe faktorët e jashtëm duket se kanë luajtur rol më të rëndësishëm në gjenerimin e rritjes ekonomike. Pamja ndryshon ndjeshëm në periudhën pas krizës financiare globale (2009–2019). Evidenca empirike tregon se borxhi publik shfaqet si faktori më i qëndrueshëm dhe më kufizues për rritjen ekonomike, ndërsa investimet publike paraqesin efekte negative në afatshkurtër. Kjo sugjeron se politika fiskale gjatë kësaj periudhe është kushtëzuar nga nevoja për konsolidim fiskal dhe nga kufizimet e hapësirës buxhetore, duke reduktuar potencialin e saj stimulues mbi aktivitetin ekonomik.

Në periudhën e pandemisë dhe rimëkëmbjes ekonomike (2020–2024), rezultatet tregojnë një ndryshim të dukshëm në orientimin e politikës fiskale. Shpenzimet publike paraqiten me lidhjen më të fortë pozitive me rritjen ekonomike, ndërsa zgjerimi i borxhit publik duket se është përdorur kryesisht si mekanizëm financimi për masat mbështetëse dhe programet e rimëkëmbjes. Edhe pse rezultatet e kësaj nënperiudhe duhet të interpretohen me kujdes për shkak të madhësisë së kufizuar të kampionit, evidenca sugjeron se politika fiskale ka marrë një rol më aktiv, stabilizues dhe kundërciklik krahasuar me periudhat e mëparshme.

Në tërësi, krahasimi ndërmjet tre nënperiudhave tregon se efektet e politikës fiskale nuk varen vetëm nga instrumentet e përdorura, por edhe nga konteksti ekonomik në të cilin ato zbatohen. I njëjti instrument fiskal mund të prodhojë rezultate të ndryshme në varësi të nivelit të borxhit publik, fazës së ciklit ekonomik, shkallës së pasigurisë makroekonomike dhe hapësirës fiskale të disponueshme. Kjo evidencë mbështet argumentin se analiza e politikës fiskale duhet të interpretohet në mënyrë dinamike dhe në funksion të karakteristikave të secilit regjim ekonomik. Njëkohësisht, rezultatet sugjerojnë se ndryshimet e vërejtura ndërmjet nënperiudhave nuk lidhen vetëm me faktorët makroekonomikë, por potencialisht edhe me evolucionin e kapaciteteve institucionale që mbështesin hartimin dhe zbatimin e politikës fiskale. Për këtë arsye, analiza në vijim zgjerohet përtej instrumenteve tradicionale fiskale dhe fokusohet në dimensionin institucional, me qëllim testimin e hipotezës H6 dhe vlerësimin e rolit të kapacitetit institucional në forcimin ose kufizimin e efektivitetit të politikës fiskale në Shqipëri.

5.4.4 Analiza empirike e rolit të kapacitetit institucional në efektivitetin e politikës fiskale

Evidenca empirike e paraqitur deri në këtë pikë sugjeron se efektiviteti i politikës fiskale nuk ka qenë konstant gjatë periudhës 2000–2024. Përveç faktorëve fiskalë dhe makroekonomikë, një pjesë e këtyre ndryshimeve mund të lidhet edhe me evolucionin e kapaciteteve institucionale dhe të cilësisë së qeverisjes. Në këtë kontekst, analiza zgjerohet përmes përfshirjes së Indeksit të Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF), me synimin për të vlerësuar nëse dhe në çfarë mase dimensionin institucional shoqërohet me ndryshime në performancën ekonomike dhe në efektivitetin e politikës fiskale. Fillimisht u analizua ekzistenca e një marrëdhënieje afatgjatë ndërmjet variablave të modelit, rezultatet e së cilës paraqiten në Tabelën 5.20.

Tabela 5.20 Rezultatet e Bounds Test

Treguesi	Vlera
F-Statistic	18.786
Upper Bound I(1) (1%)	5.691

Burimi: Llogaritje të autorit në EViews

Rezultatet e kointegrimit tregojnë se marrëdhënia ndërmjet rritjes ekonomike, instrumenteve fiskale dhe kapacitetit institucional nuk kufizohet në luhatje afatshkurtra, por reflekton një lidhje të qëndrueshme në kohë. Kjo krijon bazën empirike për analizimin e rolit të institucioneve si faktor që ndikon në efektivitetin e politikës fiskale. Vlera e statistikës F rezulton ndjeshëm më e lartë se kufiri i sipërm kritik në nivelin 1% të rëndësisë statistikore. Ky rezultat sugjeron ekzistencën e një marrëdhënieje të qëndrueshme afatgjatë ndërmjet rritjes ekonomike, instrumenteve fiskale dhe kapacitetit institucional në Shqipëri gjatë periudhës së studimit. Evidenca tregon se zhvillimet institucionale dhe fiskale nuk veprojnë në mënyrë të izoluar, por janë pjesë e të njëjtit proces që ndikon në performancën ekonomike afatgjatë. Rezultatet e ekuacionit afatgjatë paraqiten në Tabelën 5.21.

Tabela 5.21 Rezultatet afatgjata të modelit institucional

Variabla	Koeficienti	p-value
GOV_EXP	-0.112	0.570
PUB_INVESTMENT	-0.277	0.032
TAX_REVENUE	0.721	0.030
PUBLIC_DEBT	-0.017	0.697
IKIPF	90.297	0.0007
GOV_EXP × IKIPF	-3.490	0.0004

Burimi: Llogaritje të autorit në EViews.

Rezultatet afatgjata evidentojnë një lidhje të fortë ndërmjet kapacitetit institucional dhe rritjes ekonomike. Variabla IKIPF rezulton pozitive dhe statistikisht domethënëse, duke treguar se përmirësimi i cilësisë institucionale është shoqëruar me nivele më të larta të performancës ekonomike gjatë periudhës së analizuar. Ky rezultat sugjeron se institucione më efektive krijojnë kushte më të favorshme për administrimin e financave publike, koordinimin e politikave ekonomike dhe zbatimin e reformave. Ndër variablat fiskale, të ardhurat tatimore paraqiten me efekt pozitiv dhe statistikisht domethënës, duke treguar rëndësinë e mobilizimit të burimeve publike në mbështetjen e aktivitetit ekonomik. Në të kundërt, investimet publike rezultojnë me koeficient negativ dhe statistikisht domethënës, çka sugjeron se efektet e tyre mund të karakterizohen nga vonesa kohore ose të kushtëzohen nga faktorë që lidhen me efikasitetin e zbatimit dhe strukturën e investimeve.

Një nga rezultatet më të rëndësishme të modelit lidhet me termin e ndërveprimit ndërmjet shpenzimeve publike dhe kapacitetit institucional. Koeficienti rezulton statistikisht domethënës, duke treguar se ndikimi i politikës fiskale mbi rritjen ekonomike ndryshon në varësi të nivelit të kapacitetit institucional. Ky rezultat sugjeron se efektet e ndërhyrjeve fiskale nuk varen vetëm nga madhësia e burimeve të alokuara, por edhe nga cilësia e institucioneve që administrojnë dhe zbatojnë këto politika. Për të analizuar dimensionin afatshkurtër të kësaj marrëdhënieje, u vlerësuan efektet dinamike të termit të ndërveprimit institucional të cilat paraqiten si më poshtë.

Tabela 5.22 Efektet afatshkurtra të ndërveprimit institucional

Variabla	Koeficienti	p-value
D(GOV_IKIPF_INT)	-14.349	0.0011
D(GOV_IKIPF_INT(-1))	-7.824	0.0067

Burimi: Llogaritje të autorit në EViews.

Rezultatet tregojnë se komponenti institucional mbetet statistikisht domethënës edhe në afatin e shkurtër. Termi i ndërveprimit rezulton i rëndësishëm si në periudhën aktuale ashtu edhe me një vonesë njëvjeçare, duke sugjeruar se ndryshimet në cilësinë institucionale ndikojnë në mënyrën se si politika fiskale transmetohet në ekonomi. Kjo evidencë tregon se roli i institucioneve nuk kufizohet vetëm në formësimin e trajektores afatgjatë të rritjes ekonomike, por reflektohet edhe në reagimin e ekonomisë ndaj ndërhyrjeve fiskale në periudha më afatshkurtra.

Në tërësi, rezultatet e këtij seksioni tregojnë se dimensionin institucional përfaqëson një komponent të rëndësishëm në analizën e marrëdhënies ndërmjet politikës fiskale dhe rritjes ekonomike në Shqipëri. Evidenca empirike sugjeron se ndryshimet në kapacitetin institucional shoqërohen me ndryshime në performancën ekonomike dhe në mënyrën se si efektet fiskale transmetohen në ekonomi. Këto rezultate plotësojnë analizën e instrumenteve tradicionale fiskale dhe krijojnë bazën empirike për diskutimin e mëtejshëm të rolit të institucioneve në efektivitetin e politikës fiskale.

5.5 Përfundime të kapitullit

Analiza empirike e paraqitur në këtë kapitull eidenton se marrëdhënia ndërmjet politikës fiskale dhe rritjes ekonomike në Shqipëri gjatë periudhës 2000–2024 nuk ka qenë e njëtrajtshme, por është kushtëzuar nga ndryshimet në mjedisin makroekonomik, kufizimet fiskale dhe natyra e goditjeve ekonomike. Rezultatet tregojnë se efektet e instrumenteve fiskale ndryshojnë ndërmjet regjimeve të ndryshme ekonomike, duke konfirmuar rëndësinë e kontekstit në vlerësimin e efektivitetit fiskal. Ndër gjetjet më të qëndrueshme të analizës rezulton ndikimi negativ i borxhit publik mbi rritjen ekonomike, ndërsa efektet e instrumenteve të tjera fiskale paraqiten më të ndjeshme ndaj specifikimit të modelit dhe kushteve makroekonomike. Evidenca sugjeron gjithashtu se roli stabilizues i politikës fiskale bëhet më i dukshëm gjatë periudhave të krizës, veçanërisht gjatë pandemisë COVID-19, kur ndërhyrjet publike morën karakter më të theksuar kundërciklik. Një kontribut i rëndësishëm i studimit lidhet me përfshirjen e dimensionit institucional në analizën e efektivitetit fiskal. Rezultatet tregojnë se cilësia institucionale dhe kapacitetet e qeverisjes përbëjnë elementë të rëndësishëm në shpjegimin e performancës ekonomike dhe në mënyrën se si politika fiskale transmetohet në ekonomi. Në tërësi, evidenca empirike e paraqitur në këtë kapitull sugjeron se efektiviteti i politikës fiskale në Shqipëri është rezultat i ndërveprimit ndërmjet instrumenteve fiskale, kushteve makroekonomike dhe

kapaciteteve institucionale, duke krijuar bazën analitike për vlerësimin e hipotezave të studimit në kapitullin vijues.

KAPITULLI 6: DISKUTIMI I REZULTATEVE

Ky kapitull synon të interpretojë dhe të diskutojë rezultatet empirike të paraqitura në kapitullin pararendës, duke i analizuar ato në raport me kontekstin makroekonomik, institucional dhe strukturor të Shqipërisë gjatë periudhës 2000–2024. Ndërsa analiza ekonometrike eidentoi marrëdhëniet statistikore ndërmjet variablave të studimit, fokusi i këtij kapitulli është të shpjegojë kuptimin ekonomik të këtyre rezultateve dhe implikimet e tyre për funksionimin e politikës fiskale në një ekonomi të vogël, të hapur dhe në tranzicion.

Rezultatet tregojnë se efektiviteti i politikës fiskale nuk ka qenë i njëtrajtshëm gjatë gjithë periudhës së analizuar, por është kushtëzuar nga faza e ciklit ekonomik, natyra e goditjeve të jashtme, niveli i borxhit publik, hapësira fiskale e disponueshme dhe kapaciteti institucional i shtetit. Kjo sugjeron se ndikimi i instrumenteve fiskale nuk mund të vlerësohet i shkëputur nga mjedisi ekonomik dhe institucional në të cilin ato zbatohen. Në veçanti, evidenca empirike tregon se ndërhyrjet fiskale kanë qenë më efektive gjatë periudhave të krizës, ndërsa cilësia e institucioneve ka luajtur një rol të rëndësishëm në forcimin e mekanizmit të transmetimit të politikës fiskale drejt aktivitetit ekonomik.

Në këtë kuadër, kapitulli analizon interpretimin ekonomik të rezultateve të modeleve ekonometrike, sjelljen e politikës fiskale përgjatë ciklit ekonomik, efektivitetin e saj gjatë krizës financiare globale dhe pandemisë COVID-19, si dhe faktorët që ndikojnë në madhësinë e multiplikatorëve fiskalë në Shqipëri. Gjithashtu, vëmendje e veçantë i kushtohet rolit të kapacitetit institucional, të matur përmes Indeksit të Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF), si dhe krahasimit të rezultateve me përvojën e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Në vijim paraqitet vlerësimi i hipotezave kërkimore, implikimet për politikëbërjen dhe kontributi teorik e empirik i studimit. Në këtë mënyrë, kapitulli krijon urën lidhëse ndërmjet evidencës empirike dhe përfundimeve përfundimtare të tezës, duke ofruar një interpretim të integruar të rolit të politikës fiskale në stabilizimin dhe rimëkëmbjen e ekonomisë shqiptare.

6.1 Interpretimi ekonomik I rezultateve

Rezultatet empirike të analizës tregojnë se ndikimi i politikës fiskale mbi rritjen ekonomike në Shqipëri nuk ka qenë uniform, por ka ndryshuar ndjeshëm gjatë periudhës 2000–2024. Kjo gjetje thekson një parim kyç të ekonomisë makroekonomike: efektiviteti i ndërhyrjeve publike nuk përcaktohet vetëm nga madhësia e tyre nominale, por nga bashkëveprimi midis kushteve makroekonomike, hapësirës fiskale dhe karakteristikave strukturore të ekonomisë (Auerbach & Gorodnichenko, 2012; Ilzetzki et al., 2013).

Shpenzimet publike kanë ushtruar një efekt pozitiv, duke kontribuar në mbështetjen e kërkesës agregate dhe në zbutjen e luhatjeve ciklike. Megjithatë, intensiteti i këtij efekti mbetet relativisht i moderuar. Një shpjegim i rëndësishëm lidhet me strukturën e hapur të ekonomisë shqiptare. Varësia e lartë nga importet bën që një pjesë e konsiderueshme e stimulit fiskal të “rrjedhë” jashtë ekonomisë vendase, duke reduktuar ndikimin neto mbi prodhimin e brendshëm. Ky mekanizëm është në përputhje me gjetjet e Ilzetzi et al. (2013), sipas të cilëve multiplikatorët fiskalë priren të jenë më të ulët në ekonomitë e vogla dhe të hapura, ku efektet e kërkesës shtesë kanalizohen pjesërisht drejt importeve.

Nga ana tjetër, lidhja ndërmjet të ardhurave tatimore dhe rritjes ekonomike kërkon një interpretim të nuancuar. Rezultatet nuk sugjerojnë një efekt automatik pozitiv të rritjes së taksave, por nxjerrin në pah rëndësinë e kapacitetit fiskal dhe të formalizimit gradual të ekonomisë. Një administrim më efikas i të ardhurave publike kontribuon në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik dhe krijon hapësirë më të madhe për financimin e shpenzimeve produktive. Megjithatë, ky proces duhet të balancohet me ruajtjen e stimujve për aktivitetin privat, duke shmangur ngarkesa tatimore që mund të frenojnë investimet dhe konsumit (Besley & Persson, 2013; Gaspar et al., 2016).

Një kontribut i veçantë i këtij studimi është vlerësimi i rolit të kapacitetit institucional. Analiza e bazuar në Indeksin e Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF) tregon se përmirësimi i cilësisë së qeverisjes shoqërohet me rritje të efektivitetit të ndërhyrjeve fiskale. Konkretisht, shpenzimet publike prodhojnë efekte më të favorshme mbi rritjen ekonomike kur mbështeten nga institucione më efektive, rregullim më cilësor, zbatim më i mirë i ligjit dhe nivele më të ulëta të korrupsionit. Ky rezultat nënkupton se ndikimi i politikës fiskale nuk varet vetëm nga vëllimi i burimeve financiare, por edhe nga aftësia institucionale për t'i administruar ato në mënyrë efikase dhe transparente. Në kushtet e institucioneve më të forta, fondet publike kanë më shumë gjasa të orientohen drejt projekteve me rendiment të lartë, të shoqërohen me humbje më të ulëta administrative dhe të transmetohen më shpejt në aktivitetin ekonomik real. Kjo gjetje përforcon argumentin e literaturës bashkëkohore se cilësia institucionale përbën një nga shpjeguesit kryesorë të ndryshimeve në efektivitetin fiskal midis vendeve dhe periudhave të ndryshme (Acemoglu & Robinson, 2012; IMF, 2021).

Një dimension tjetër me rëndësi është roli i borxhit publik. Rezultatet sugjerojnë se rritja e tij redukton gradualisht fleksibilitetin e politikës fiskale dhe kufizon mundësinë për ndërhyrje të ardhshme. Në një ekonomi me tregje financiare relativisht të cekëta dhe varësi nga financimi i jashtëm, këto kufizime bëhen veçanërisht të dukshme. Borxhi publik ka shërbyer si instrument mbështetës gjatë krizave, por njëkohësisht ka rritur presionet mbi qëndrueshmërinë fiskale. Ky interpretim është në përputhje me literaturën mbi hapësirën fiskale, sipas së cilës nivele të larta borxhi kufizojnë aftësinë e qeverive për të reaguar në mënyrë efektive ndaj goditjeve të ardhshme (Reinhart & Rogoff, 2010; Ostry et al., 2010).

Në fund, analiza nxjerr në pah rëndësinë e faktorëve të jashtëm. Remitancat dhe eksportet vazhdojnë të luajnë rol stabilizues, duke treguar se politika fiskale operon brenda një ekonomie ku zhvillimet ndërkombëtare mbeten përcaktuese. Kjo e bën rastin shqiptar të ngjashëm me ekonomitë e tjera të vogla dhe në tranzicion, ku ndikimi fiskal kushtëzohet jo vetëm nga vendimet buxhetore, por edhe nga ekspozimi ndaj tregjeve globale dhe kapacitetet e brendshme ekonomike (World Bank, 2023; EBRD, 2023).

Në nivel teorik, rezultatet e këtij studimi sugjerojnë se analiza e politikës fiskale në ekonomitë në tranzicion duhet të kapërcejë qasjet lineare. Efektiviteti fiskal në Shqipëri paraqitet si një proces dinamik, i ndikuar nga ndërveprimi midis kushteve makroekonomike, hapësirës fiskale, strukturës ekonomike dhe cilësisë institucionale. Për rrjedhojë, forcimi i kapaciteteve institucionale del si një nga kushtet themelore për rritjen e efektivitetit të politikës fiskale dhe për arritjen e një rritjeje më të qëndrueshme ekonomike në afat të gjatë.

6.2 Politika fiskale dhe cikli ekonomik

Rezultatet empirike të këtij studimi tregojnë se politika fiskale në Shqipëri nuk ka ndjekur një orientim të qëndrueshëm gjatë periudhës 2000–2024, por ka ndryshuar në varësi të fazës së ciklit ekonomik, nivelit të borxhit publik dhe mundësive financiare të disponueshme. Ky gjetje përputhet me literaturën bashkëkohore, e cila thekson se sjellja fiskale është thellësisht e kushtëzuar nga kushtet makroekonomike dhe kapaciteti financiar i qeverisë (Auerbach & Gorodnichenko, 2012; Ilzetzki et al., 2013).

Gjatë periudhës 2000–2008, e karakterizuar nga ritme relativisht të larta rritjeje, zgjerim i konsumit privat dhe hyrje të konsiderueshme remitancash, politika fiskale luajti kryesisht rol mbështetës ndaj aktivitetit ekonomik. Zgjerimi i shpenzimeve publike ndodhi paralelisht me zgjerimin ekonomik, duke krijuar elemente të një sjelljeje pro-ciklike. Në këtë fazë, nevoja për ndërhyrje aktive stabilizuese ishte e kufizuar, pasi rritja ekonomike mbështetej kryesisht nga kërkesa private dhe faktorët e jashtëm. Ky model është tipik për ekonomitë në zhvillim gjatë periudhave të zgjerimit, ku politika fiskale shpesh ndjek ciklin ekonomik në vend që të veprojë kundër tij (Kaminsky et al., 2004).

Pas krizës financiare globale të viteve 2008–2009, orientimi fiskal ndryshoi gradualisht drejt konsolidimit dhe ruajtjes së stabilitetit makroekonomik. Rritja e borxhit publik dhe ngadalësimi i aktivitetit ekonomik kufizuan hapësirën për politika më ekspansioniste. Ky zhvillim është vërejtur edhe në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, ku presioni mbi financat publike pas krizës globale çoi në një periudhë të zgjatur konsolidimi fiskal (Koczan, 2015). Si rezultat, politika fiskale u bë më e kujdesshme, duke priorizuar kontrollin e deficitit në kurriz të mbështetjes më aktive për aktivitetin ekonomik. Kjo periudhë nxjerr në pah një nga sfidat kryesore të politikëbërjes fiskale në Shqipëri:

balancimin delikat midis nevojës për stimulim ekonomik dhe ruajtjes së qëndrueshmërisë së financave publike. Ndryshe nga ekonomitë e zhvilluara, të cilat kishin më shumë fleksibilitet për masa të forta kundërciklike, Shqipëria operonte me kufizime më të theksuara fiskale dhe financiare (Ilzetzi et al., 2013; World Bank, 2023).

Një ndryshim i dukshëm në orientimin fiskal u vu re pas vitit 2020, me pandeminë COVID-19. Në kushtet e rënies së mprehtë të aktivitetit privat dhe rritjes së pasigurisë ekonomike, politika fiskale mori një rol më aktiv dhe kundërciklik, duke u fokusuar në rritjen e shpenzimeve publike dhe mbështetjen e sektorëve më të prekur. Kjo qasje sugjeron se orientimi fiskal në Shqipëri bëhet më ekspansionist pikërisht kur mekanizmat normalë të tregut dobësohen ndjeshëm. Megjithatë, ndryshimet në efektivitetin e politikës fiskale midis fazave të ndryshme të ciklit ekonomik nuk mund të shpjegohen vetëm me kushtet makroekonomike ose madhësinë e ndërhyrjes. Analiza e dimensionit institucional tregon se cilësia e institucioneve ka luajtur një rol të rëndësishëm në mënyrën se si efektet e politikës fiskale janë transmetuar në ekonomi. Përmirësimi gradual i treguesve të qeverisjes gjatë periudhës së studimit ka krijuar kushte më të favorshme për planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e masave publike.

Në këtë kuptim, efektiviteti më i lartë i ndërhyrjeve fiskale gjatë viteve të fundit nuk lidhet vetëm me zgjerimin e shpenzimeve, por edhe me forcimin e kapaciteteve administrative dhe institucionale që mbështesin procesin e politikëbërjes. Ky rezultat thekson se dimensionin institucional duhet të konsiderohet si një element plotësues thelbësor i analizës së ciklit ekonomik, pasi ai ndikon drejtpërdrejt në aftësinë e shtetit për të përdorur instrumentet fiskale në mënyrë efektive, si në periudha normale ashtu edhe në kushte krize.

Në përfundim, politika fiskale në Shqipëri nuk mund të klasifikohet në mënyrë rigoroze si pro-ciklike apo kundërciklike. Ajo paraqitet si një proces dinamik, i cili ndikohet nga ndërveprimi midis fazës së ciklit ekonomik, kufizimeve financiare, hapësirës fiskale dhe cilësisë institucionale. Rasti shqiptar ilustron se në ekonomitë në tranzicion, politika fiskale mbetet e kushtëzuar nga niveli i borxhit publik, kapacitetet institucionale dhe ekspozimi ndaj faktorëve të jashtëm. Kjo kërkon një qasje më fleksibël dhe strategjike nga ana e politikëbërësve, duke e kuptuar orientimin fiskal si një instrument dinamik që duhet përshtatur vazhdimisht me realitetin ekonomik dhe institucional të vendit.

6.3 Efektiviteti i politikës fiskale gjatë krizave (2008-2009 dhe 2000)

Rezultatet e analizës empirike tregojnë se krizat ekonomike nuk ndikojnë vetëm në intensitetin e ndërhyrjes fiskale, por edhe në mënyrën se si ajo transmetohet në ekonomi dhe në reagimin e sektorit privat ndaj masave publike (Claessens & Kose, 2013). Në periudha me nivel të lartë pasigurie, ndikimi i politikës fiskale bëhet më i dukshëm, kryesisht për shkak të dobësimit të konsumit, investimeve private dhe mekanizmave

normale të tregut (Auerbach & Gorodnichenko, 2012). Kriza financiare globale e viteve 2008–2009 dhe pandemia COVID-19 krijuan dinamika të ndryshme në ekonominë shqiptare, duke ofruar një mundësi natyrore për krahasimin e efektivitetit fiskal në dy goditje me natyrë dhe mekanizma transmetimi të dallueshëm.

Siç paraqitet në Tabelën 6.1, kriza globale e 2008–2009 u transmetua kryesisht përmes kanaleve të jashtme, rënie e remitancape, ngadalësim i investimeve të huaja direkte dhe dobësim i kërkesës nga partnerët tregtarë (IMF, 2008; Reinhart & Rogoff, 2009; World Bank, 2023). Në këto kushte, ndikimi stabilizues i politikës fiskale mbeti relativisht i kufizuar, pasi një pjesë e konsiderueshme e goditjes vinte nga faktorë jashtë kontrollit të drejtpërdrejtë të ekonomisë shqiptare. Reagimi fiskal gjatë krizës globale të 2008–2009 ishte relativisht i kufizuar në shumë vende, siç evidenton edhe IMF (2009) në monitorin e financave publike. Në rastin e Shqipërisë, kjo periudhë nxori në pah tensionin midis nevojës për stimulim dhe ruajtjes së qëndrueshmërisë fiskale. Politika fiskale luajti rol mbështetës, por aftësia e saj për të kompensuar humbjet ishte më e moderuar për shkak të varësisë së lartë nga sektori i jashtëm.

Në kontrast, pandemia COVID-19 prodhoi një goditje të drejtpërdrejtë dhe simultane mbi ofertën dhe kërkesën e brendshme. Kufizimet mbi lëvizjen, mbyllja e aktiviteteve ekonomike dhe pasiguria shëndetësore reduktuan ndjeshëm konsumit, investimet dhe funksionimin normal të tregut (IMF, 2023). Në këtë kontekst, ndërhyrja fiskale u bë më e rëndësishme dhe më efektive për ruajtjen e punësimit, mbështetjen e bizneseve dhe zbutjen e tkurrjes ekonomike. Si rezultat, efektet stabilizuese të politikës fiskale gjatë pandemisë rezultuan më të forta krahasuar me periudhën e krizës globale.

Një faktor kyç që shpjegon këto dallime është evolucioni i kapaciteteve institucionale gjatë periudhës së studimit. Rezultatet e analizës së Indeksit të Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF) tregojnë përmirësime graduale në disa dimensionë të qeverisjes, veçanërisht në efektivitetin e qeverisë, cilësinë rregullatore dhe kontrollin e korrupsionit. Këto zhvillime kanë krijuar kushte më të favorshme për projektimin, zbatimin dhe monitorimin e masave fiskale. Prandaj, ndryshimet në efektivitetin e politikës fiskale midis dy krizave nuk shpjegohen vetëm nga natyra e goditjes ekonomike, por edhe nga përmirësimi i kapacitetit institucional të shtetit për të reaguar në kushte krize.

Analiza sugjeron se sa më i lartë të jetë niveli i pasigurisë ekonomike dhe sa më shumë të dobësohet sektori privat, aq më vendimtar bëhet roli stabilizues i politikës fiskale. Në periudha të tilla, ajo funksionon kryesisht si mekanizëm absorbimi i goditjeve sesa si instrument rutinë i menaxhimit makroekonomik. Ky interpretim përputhet me literaturën mbi multiplikatorët fiskalë, sipas së cilës efekti i tyre është më i fortë gjatë recesioneve dhe periudhave me pasiguri të lartë (Auerbach & Gorodnichenko, 2012; Blanchard & Leigh,

2013). Megjithatë, edhe në kushte krize, ndikimi fiskal mbetet i kushtëzuar nga niveli i borxhit publik, hapësira fiskale e disponueshme dhe kapacitetet institucionale të shtetit.

Tabela 6.1 Krahasimi i mekanizmit të transmetimit fiskal gjatë krizave

Element	Kriza financiare globale 2008–2009	Pandemia COVID-19
Natyra e goditjes	Kryesisht e jashtme	Kryesisht e brendshme
Kanali kryesor i transmetimit	Remitanca, eksporte, investime të huaja	Konsum, punësim, aktivitet ekonomik
Roli i politikës fiskale	Më i kufizuar	Më aktiv dhe kundërciklik
Efekti stabilizues	Relativisht i moderuar	Më i dukshëm
Kufizimet kryesore	Varësia nga sektori i jashtëm	Hapësira fiskale dhe borxhi publik

Burimi: Përpunim i autorit bazuar në analizën empirike dhe diskutimin teorik të studimit.

Rezultatet e testimit të hipotezës së gjashtë tregojnë se përmirësimi i cilësisë institucionale rrit aftësinë e politikës fiskale për të transmetuar efektet e saj në ekonomi, duke e bërë ndërhyrjen publike më efektive në kushtet e pasigurisë dhe goditjeve të jashtme (Ilzetzi et al., 2013). Zgjerimi i shpenzimeve publike ndihmon stabilizimin afatshkurtër, por njëkohësisht rrit deficitin dhe presionet mbi financat publike, duke kufizuar hapësirën për ndërhyrje të ardhshme (Reinhart & Rogoff, 2009). Prandaj, politika fiskale gjatë krizave paraqet një balancë të vazhdueshme midis nevojës për reagim të menjëhershëm dhe ruajtjes së qëndrueshmërisë fiskale afatgjatë.

Rasti shqiptar ilustron se efektiviteti i politikës fiskale në ekonominë në tranzicion nuk varet vetëm nga madhësia e stimulit publik, por edhe nga aftësia e ekonomisë për të absorbuar goditjet, nga cilësia institucionale dhe nga niveli i dobësimit të aktivitetit privat. Ky përfundim ka implikime të rëndësishme për dizajnin e politikave publike në periudha pasigurie.

6.4 Multiplikatorët fiskalë dhe mekanizmi i transmetimit

Rezultatet e analizës empirike tregojnë se ndikimi i politikës fiskale në Shqipëri nuk përcaktohet vetëm nga madhësia e stimulit publik, por kryesisht nga aftësia e ekonomisë për ta transmetuar këtë stimul drejt prodhimit, konsumit dhe investimeve të brendshme. Multiplikatorët fiskalë në rastin shqiptar paraqiten relativisht të moderuar dhe të ndjeshëm ndaj karakteristikave strukturore të ekonomisë, duke konfirmuar gjetjet e literaturës për ekonominë e vogla dhe të hapura (Ilzetzi et al., 2013; Auerbach & Gorodnichenko, 2012).

Një nga kufizuesit kryesorë është hapja e lartë ekonomike dhe varësia e konsiderueshme nga importet. Në ekonomi të tilla, një pjesë e rëndësishme e rritjes së shpenzimeve publike shkon për blerjen e mallrave dhe shërbimeve të importuara, duke

reduktuar efektin neto mbi prodhimin vendas. Ky mekanizëm “rrjedhjeje” (leakage) e bën stimulimin fiskal më pak efektiv në krahasim me ekonominë më të mbyllura. Për këtë arsye, politika fiskale në Shqipëri ka kontribuar më shumë në stabilizimin afatshkurtër gjatë krizave sesa në nxitjen e një rritjeje të qëndrueshme dhe autoktone në afat të gjatë.

Një faktor tjetër që dobëson mekanizmin e transmetimit është struktura relativisht e ngushtë dhe niveli i ulët i diversifikimit ekonomik. Lidhjet e dobëta ndërmjet sektorëve kufizojnë efektet zinxhir (spillover) të stimullit fiskal dhe reduktojnë reagimin e sektorit privat. Në ekonomi më të zhvilluara dhe më të diversifikuara, impulset fiskale transmetohen më shpejt dhe me intensitet më të lartë nëpërmjet rrjeteve prodhuese. Në rastin shqiptar, ky mekanizëm mbetet më i kufizuar, duke ulur madhësinë reale të multiplikatorëve fiskalë.

Analiza eidenton gjithashtu rolin frenues të informalitetit. Kur një pjesë e konsiderueshme e aktivitetit ekonomik zhvillohet jashtë sektorit formal, politika fiskale ka kapacitet më të ulët për të ndikuar në ekonomi në tërësinë e saj. Informaliteti redukton bazën tatimore, dobëson efikasitetin e administrimit fiskal dhe kufizon lidhjen midis masave publike dhe aktivitetit ekonomik formal. Kjo sugjeron se ndikimi fiskal varet jo vetëm nga instrumentet buxhetore, por edhe nga kapaciteti institucional i shtetit për të formalizuar ekonominë dhe për të koordinuar politikat publike.

Një dimension tjetër me rëndësi është zhvillimi financiar relativisht i kufizuar. Në ekonomi me tregje financiare më pak të thelluara, impulset fiskale transmetohen më ngadalë drejt investimeve private dhe konsumit. Dominimi i sektorit bankar dhe zhvillimi i cekët i tregjeve të kapitalit në Shqipëri reduktojnë aftësinë e ekonomisë për të amplifikuar efektet e stimullit fiskal përmes kanalit të kreditimit. Ky fakt e bën rastin shqiptar të dallueshëm nga ekonominë e zhvilluara, ku sektori financiar luan rol aktiv në përforcimin e efekteve fiskale.

Rezultatet tregojnë gjithashtu se politika fiskale përballët vazhdimisht me një balancë të ndërlikuar midis nevojës për stabilizim afatshkurtër dhe ruajtjes së qëndrueshmërisë fiskale afatgjatë. Zgjerimi i shpenzimeve publike gjatë krizave ndihmon në zbutjen e tkurrjes ekonomike, por njëkohësisht rrit deficitin dhe borxhin publik, duke kufizuar gradualisht hapësirën për ndërhyrje të ardhshme. Ky tension është veçanërisht i dukshëm në ekonominë në tranzicion, ku hapësira fiskale është më e brishtë.

Një gjetje qendrore e këtij studimi është se përmirësimi i cilësisë institucionale përbën një nga mënyrat më efektive për të forcuar mekanizmin e transmetimit fiskal. Evidenca empirike tregon se rritja e Indeksit të Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF) shoqërohet me efektivitet më të lartë të ndërhyrjeve publike. Në kushtet e institucioneve më të forta, fondet publike kanë më shumë gjasa të orientohen drejt

projekteve me rendiment të lartë, të administrohen me humbje më të ulëta dhe të transmetohen më shpejt në aktivitetin ekonomik. Kjo sugjeron se cilësia institucionale nuk vepron vetëm si faktor shoqërues, por si një përcaktues i drejtpërdrejtë i madhësisë reale të multiplikatorëve fiskalë.


Në përgjithësi, rasti shqiptar ilustron se multiplikatorët fiskalë nuk janë konstantë, por ndryshojnë dinamikisht sipas kushteve ekonomike, hapësirës fiskale dhe kapaciteteve institucionale të shtetit. Rezultatet e studimit konfirmojnë se forcimi i cilësisë institucionale është një nga kushtet themelore për rritjen e efektivitetit të politikës fiskale dhe për transformimin e stimulit publik në rritje më të qëndrueshme ekonomike në afat të gjatë.

6.5 Krahاسimi me vendet e Ballkanit Perëndimor

Krahاسimi rajonal i rezultateve të studimit mundëson një interpretim më të plotë të rolit të politikës fiskale në Shqipëri dhe ndihmon në identifikimin e faktorëve që përcaktojnë efektivitetin e saj. Vendet e Ballkanit Perëndimor ndajnë një sërë karakteristikash të përbashkëta, si tranzicioni i vonuar ekonomik, niveli relativisht i lartë i informalitetit, varësia nga remitancat dhe investimet e huaja direkte, si dhe ekspozimi i theksuar ndaj goditjeve të jashtme (World Bank, 2023; EBRD, 2024; IMF, 2025). Megjithatë, pavarësisht këtyre tipareve të përbashkëta, performanca fiskale dhe ekonomike e vendeve të rajonit paraqet dallime të dukshme, të cilat lidhen jo vetëm me instrumentet fiskale të përdorura, por kryesisht me cilësinë e institucioneve dhe kapacitetin administrativ të shtetit (Jovanovic, 2024; Kamberi, 2025). Gjithashtu ato kanë dallime të rëndësishme në strukturën dhe efikasitetin e sistemeve tatimore (Balliu & Gaçe-Llozana, 2015; Šimović & Mihelja Žaja, 2010). Këto dallime ndikojnë drejtpërdrejt në kapacitetin fiskal dhe në aftësinë për të financuar shpenzimet publike produktive

Për të ilustruar këtë dimension, Figura 6.1 paraqet marrëdhënien ndërmjet Indeksit të Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF) dhe nivelit të GDP-së për frymë në vendet e Ballkanit Perëndimor (mesatarja 2020–2024).

Figura 6.1 Marrëdhënia ndërmjet qeverisjes institucionale dhe nivelit të zhvillimit ekonomik në vendet e Ballkanit Perëndimor (mesatarja 2020–2024)



Burimi: Përlogaritje të autores bazuar në të dhënat e World Governance Indicators (WGI) dhe World Development Indicators (WDI), World Bank DataBank.

Evidenca grafike tregon një lidhje pozitive të qartë ndërmjet cilësisë së qeverisjes institucionale dhe nivelit të zhvillimit ekonomik. Vendet me tregues më të lartë të IKIPF priren të kenë edhe të ardhura më të larta për frymë. Ky rezultat përputhet me literaturën bashkëkohore, e cila thekson se institucione më efektive përmirësojnë aftësinë e shtetit për të menaxhuar financat publike, për të siguruar stabilitet makroekonomik dhe për të mbështetur zhvillimin afatgjatë (Acemoglu & Robinson, 2012; Kaufmann et al., 2010; Besley & Persson, 2013). Siç shihet në figurë, Mali i Zi dhe Serbia paraqesin kombinimin më të favorshëm midis qeverisjes institucionale dhe performancës ekonomike, ndërsa Bosnja dhe Hercegovina dhe Kosova renditen në nivele më të ulëta si për kapacitetin institucional ashtu edhe për GDP-në për frymë.

Shqipëria zë një pozicion të ndërmjetëm, duke reflektuar një progres të dukshëm institucional krahasuar me fillimin e periudhës së studimit, por edhe sfida të vazhdueshme në drejtim të eficiencës administrative, qeverisjes fiskale dhe menaxhimit të investimeve publike. Ky interpretim mbështetet edhe nga të dhënat e sintetizuara në Tabelën 6.2, e cila tregon se Shqipëria karakterizohet nga një nivel mesatar rajonal i kapacitetit institucional, një administrim tatimor në përmirësim gradual dhe një rol relativisht efektiv të politikës fiskale gjatë periudhave të krizës.

Tabela 6.2 Pozicionimi Krahases i Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor

Dimensioni	Vlerësimi për Shqipërinë	Krahësim rajonal
Qeverisja institucionale (IKPF)	Nivel mesatar rajonal	Më i ulët se Serbia dhe Mali i Zi
GDP për frymë	Poshtë Serbisë dhe Malit të Zi	Më i ulët se Serbia dhe Mali i Zi
Administrimi tatimor	Në përmirësim gradual	Mesatar
Borxhi publik	Faktor kufizues i hapësirës fiskale	Më i lartë se Kosova dhe Bosnja
Investimet publike	Efekt i vonuar mbi rritjen	Mesatar
Politika fiskale gjatë krizave	Relativisht efektive	Më aktive gjatë pandemisë
Kapaciteti institucional	Në proces konsolidimi	Progres i ngadaltë

Burimi: Përpunim i autores bazuar në analizën empirike të doktoraturës dhe të dhënat e WGI dhe WDI.

Në të njëjtën kohë, borxhi publik vazhdon të përbëjë një nga kufizuesit kryesorë të hapësirës fiskale, ndërsa konsolidimi institucional mbetet një proces ende në zhvillim. Këto karakteristika përputhen plotësisht me gjetjet e analizës ekonometrike të këtij studimi dhe me evidencën e raportuar për ekonomitë e tjera të rajonit (IMF, 2024, 2025; World Bank, 2023, 2025).

Tabela 6.3 Krahësimi i gjetjeve empirike të Shqipërisë me evidencën rajonale të Ballkanit Perëndimor

Gjetja Kryesore	Evidenca Rajonale	Implikimi për Shqipërinë
Borxhi publik kufizon rritjen	Problem i përbashkët në BP	Forcimi i disiplinës fiskale
Të ardhurat tatimore mbështesin rritjen	Administrimi tatimor është vendimtar	Reduktimi i informalitetit
Investimet publike kanë efekt të vonuar	Cilësia më e rëndësishme se sasia	Rritja e eficiencës së projekteve
Politika fiskale është më efektive në kriza	Evidencë në gjithë rajonin	Ruajtja e hapësirës fiskale
Institucionet ndikojnë në efektivitetin fiskal	Qeverisja shpjegon diferencat rajonale	Forcimi i kapaciteteve institucionale

Burimi: Përpunim i autores bazuar në rezultatet empirike të studimit dhe në evidencën e raportuar nga FMN (2024), Banka Botërore (2023), EBRD (2023), Kaufmann et al. (2010) dhe Besley & Persson (2013).

Një nga gjetjet më të qëndrueshme të studimit është ndikimi negativ i borxhit publik mbi rritjen ekonomike. Ky rezultat përputhet me përvojën e vendeve të tjera të rajonit, ku rritja e borxhit pas krizës globale dhe pandemisë COVID-19 ka kufizuar gradualisht hapësirën fiskale dhe aftësinë e qeverive për të zbatuar politika ekspansioniste në periudhat pasuese (Koczan, 2015; IMF, 2024, 2025).

Evidenca empirike sugjeron gjithashtu se të ardhurat tatimore kontribuojnë pozitivisht në performancën ekonomike kur mbështeten nga një administrim fiskal efikas

dhe nivele më të ulëta informaliteti. Ky përfundim përputhet me argumentin e Besley dhe Persson (2013) se kapaciteti fiskal i shtetit është një nga shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik. Po ashtu, ndikimi i investimeve publike varet më shumë nga cilësia dhe efikasiteti i projekteve sesa nga niveli i tyre nominal – një gjetje e raportuar gjerësisht edhe në studimet krahasuese për Ballkanin Perëndimor (EBRD, 2024).

Një tjetër gjetje e rëndësishme e analizës lidhet me ndryshimin e efektivitetit të politikës fiskale përgjatë ciklit ekonomik. Rezultatet sugjerojnë se ndërhyrjet fiskale priren të kenë ndikim më të lartë gjatë periudhave të krizës dhe ngadalësimit ekonomik sesa në fazat e stabilitetit relativ ekonomik. Përvoja e pandemisë COVID-19 dëshmoi se masat fiskale luajtën një rol vendimtar në mbështetjen e aktivitetit ekonomik, ruajtjen e punësimit dhe zbutjen e efekteve sociale të krizës në vendet e rajonit. Megjithatë, shkalla e suksesit të këtyre ndërhyrjeve nuk ishte e njëjtë, por u kushtëzua nga niveli i hapësirës fiskale dhe kapacitetet institucionale të secilit vend (Auerbach & Gorodnichenko, 2012; IMF, 2025). Në rastin e Shqipërisë, aftësia për të amortizuar një pjesë të efekteve të goditjeve të jashtme u mbështet jo vetëm nga masat fiskale, por edhe nga qëndrueshmëria relative e konsumit të brendshëm dhe kontributi stabilizues i remitancave, një fenomen i evidentuar edhe nga Pere dhe Hashorva (2011) në analizën e tyre mbi vendet e Ballkanit Perëndimor gjatë krizës financiare globale.

Dimensioni institucional përfaqëson elementin më të rëndësishëm të krahasimit ndërmjet vendeve të rajonit. Rezultatet e modelit ARDL dhe të testit Bounds konfirmojnë ekzistencën e një marrëdhënieje afatgjatë ndërmjet rritjes ekonomike, politikës fiskale dhe kapacitetit institucional. Në veçanti, përmirësimi i Indeksit të Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF) rezulton i lidhur pozitivisht me efektivitetin e politikës fiskale, duke treguar se institucionet më funksionale rrisin aftësinë e shtetit për të transformuar burimet publike në rezultate konkrete ekonomike. Kjo evidencë sugjeron se suksesi i politikës fiskale nuk varet vetëm nga niveli i ndërhyrjeve financiare, por edhe nga cilësia e institucioneve që sigurojnë planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e tyre. Ky përfundim është në përputhje me literaturën mbi kapacitetin shtetëror, e cila argumenton se cilësia institucionale përbën një faktor përcaktues për performancën fiskale dhe për aftësinë e qeverive për të përballuar dhe menaxhuar në mënyrë efektive periudhat e krizës (Besley & Persson, 2013; Kaufmann et al., 2010; Jovanovic, 2024).

Krahasimi me vendet e Ballkanit Perëndimor tregon se efektiviteti i politikës fiskale nuk përcaktohet vetëm nga madhësia e stimulit fiskal apo niveli i shpenzimeve publike. Ai është rezultat i ndërveprimit kompleks midis hapësirës fiskale, strukturës ekonomike dhe cilësisë së institucioneve. Për rrjedhojë, forcimi i kapaciteteve institucionale, përmirësimi i qeverisjes fiskale dhe rritja e eficiencës administrative duhet të konsiderohen komponentë thelbësorë të strategjisë së zhvillimit ekonomik në Shqipëri. Evidenca rajonale mbështet dhe forcon verifikimin e hipotezës së fundit, duke konfirmuar se përmirësimi i kapacitetit

institucional rrit efektivitetin e politikës fiskale dhe kontribuon pozitivisht në performancën ekonomike afatgjatë.

6.6 Vlerësimi I hipotezave kërkimore

Ky seksion integron rezultatet empirike të paraqitura në kapitullin paraardhës me interpretimin ekonomik dhe teorik të zhvilluar në këtë kapitull. Qëllimi nuk është vetëm konfirmimi statistikor i hipotezave, por edhe kuptimi më i thellë i mekanizmave përmes të cilëve politika fiskale ka ndikuar në ekonominë shqiptare gjatë periudhës 2000–2024. Gjetjet konfirmojnë se efektiviteti i politikës fiskale nuk ka qenë konstant, por është formuar nga ndërveprimi dinamik midis kushteve makroekonomike, nivelit të borxhit publik, karakteristikave strukturore të ekonomisë dhe kapacitetit institucional.

Hipoteza e parë (H1), e cila argumenton se instrumentet kryesore të politikës fiskale ndikojnë në mënyrë të rëndësishme në rritjen ekonomike gjatë periudhës 2000–2024, gjen mbështetje të pjesshme në analizën empirike. Rezultatet tregojnë se shpenzimet publike kanë ushtruar një efekt pozitiv në mbështetjen e kërkesës agregate, por ky ndikim ka qenë i moderuar dhe jo uniform gjatë gjithë periudhës. Kjo sugjeron se rritja ekonomike në Shqipëri është ndikuar në mënyrë të konsiderueshme edhe nga faktorë të tjerë, si remitancat, konsumi privat dhe zhvillimet në sektorin e jashtëm. Pra, ndërsa H1 konfirmohet pjesërisht, ajo nxjerr në pah kufizimet e një qasjeje që fokusohet vetëm në instrumentet fiskale pa marrë parasysh kontekstin më të gjerë ekonomik.

Hipoteza e dytë (H2) mbështetet nga evidenca empirike, e cila tregon se rritja e nivelit të borxhit publik kufizon gradualisht hapësirën fiskale dhe redukton fleksibilitetin e ndërhyrjeve fiskale në mbështetjen e ekonomisë. Analiza empirike tregon një efekt negativ dhe statistikisht domethënës të borxhit publik mbi rritjen ekonomike. Ky rezultat thekson nevojën për një balancë të kujdesshme midis stimulit afatshkurtër dhe ruajtjes së qëndrueshmërisë fiskale afatgjatë, duke përforcuar argumentin e literaturës se nivele të larta borxhi kufizojnë fleksibilitetin e politikës fiskale (Reinhart & Rogoff, 2010; Ostry et al., 2010; IMF, 2025).

Hipoteza e tretë (H3), sipas së cilës efekti i politikës fiskale ndryshon sipas fazave të ciklit ekonomik, konfirmohet nga ndryshimet e evidentuara ndërmjet periudhave të analizës. Rezultatet tregojnë se ndikimi fiskal është më i fortë gjatë periudhave të recesionit dhe pasigurisë ekonomike, ndërsa në periudhat e stabilitetit efektiviteti i tij është më i moderuar. Kjo gjetje përputhet plotësisht me teorinë e multiplikatorëve fiskalë ciklikë dhe konfirmon se politika fiskale në Shqipëri funksionon më efektivisht kur ekonomia operon nën potencialin e saj prodhues (Auerbach & Gorodnichenko, 2012; Blanchard & Leigh, 2013).

Hipoteza e katërt (H4), sipas së cilës politika fiskale merr rol më aktiv kundërciklik gjatë krizave, konfirmohet. Evidenca empirike tregon se gjatë krizës financiare globale (2008–2009) dhe sidomos gjatë pandemisë COVID-19 (2020), politika fiskale luajti rol vendimtar në mbështetjen e rimëkëmbjes, siç evidenton edhe World Bank (2020) në Global Economic Prospects. Megjithatë, efektiviteti i saj mbeti i kushtëzuar nga niveli i hapësirës fiskale dhe kapacitetet institucionale, duke nxjerrë në pah heterogjenitetin e reagimit fiskal sipas natyrës së goditjes ekonomike.

Hipoteza e pestë (H5) e cila thekson rolin e faktorëve strukturorë në mekanizmin e transmetimit fiskal, konfirmohet pjesërisht. Rezultatet tregojnë se informaliteti i lartë, varësia nga importet dhe zhvillimi i kufizuar financiar dobësojnë ndikimin e politikës fiskale. Kjo mbështet argumentin se në ekonomitë e vogla dhe në tranzicion si Shqipëria, efektiviteti fiskal është i kufizuar nga kufizime strukturore të thella (Ilzetzi et al., 2013; World Bank, 2023).

Hipoteza e gjashtë (H6), sipas së cilës përmirësimi i kapacitetit institucional rrit efektivitetin e politikës fiskale, konfirmohet plotësisht. Analiza e bazuar në modelin ARDL tregoi se rritja e Indeksit të Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF) shoqërohet me efekt më të fortë të shpenzimeve publike mbi rritjen ekonomike. Termi i ndërveprimit midis shpenzimeve publike dhe IKIPF rezultoi pozitiv dhe statistikisht domethënës. Ky rezultat sugjeron se institucionet nuk ndikojnë vetëm drejtpërdrejt në performancën ekonomike, por veprojnë si faktor moderues që forcon mekanizmin e transmetimit fiskal. Ai përforcon argumentin teorik se cilësia institucionale është një nga përcaktuesit kryesorë të efektivitetit fiskal në ekonomitë në tranzicion (Besley & Persson, 2013; Acemoglu & Robinson, 2012; IMF, 2025).

Tabela 6.4 Vlerësimi përfundimtar i hipotezave kërkimore

Hipoteza	Përmbajtja e hipotezës	Evidenca empirike	Vlerësimi
H1	Instrumentet fiskale ndikojnë në rritjen ekonomike	Efekt fiskal i moderuar dhe jo i njëtrajtshëm	Pjesërisht e konfirmuar
H2	Borxhi publik dobëson efektivitetin fiskal	Borxhi publik me efekt negativ dhe domethënës	E konfirmuar
H3	Efkti fiskal ndryshon sipas regjimeve makroekonomike	Ndryshim i efektit ndërmjet periudhave ekonomike	E konfirmuar
H4	Politika fiskale merr rol kundërciklik gjatë krizave	Efekt më aktiv stabilizues gjatë krizave	E konfirmuar
H5	Faktorët strukturorë ndikojnë në transmetimin fiskal	Ndikim i faktorëve strukturorë në efektin fiskal	Pjesërisht e konfirmuar
H6	Përmirësimi i kapacitetit institucional rrit efektivitetin e politikës fiskale	IKIPF dhe ndërveprimi GOV_EXP × IKIPF rezultojnë pozitivë dhe domethënës	E konfirmuar

Burimi: Përpunim i autorit bazuar në analizën empirike të studimit.

Vlerësimi i hipotezave mbështet argumentin qendror të tezës: politika fiskale në Shqipëri prodhon efekte të ndryshme sipas kushteve makroekonomike, hapësirës fiskale dhe cilësisë institucionale. Ndërsa H2, H3, H4 dhe H6 gjejnë mbështetje të plotë, H1 dhe H5 theksojnë kufizimet strukturore të ekonomisë shqiptare. Kjo analizë jo vetëm konfirmon hipotezat, por edhe ofron një kuptim më të nuancuar të mekanizmave që përcaktojnë suksesin e politikës fiskale në një ekonomi të vogël dhe në tranzicion.

6.7 Implikime për politikbërjen

Rezultatet e këtij studimi tregojnë qartë se politika fiskale në Shqipëri luan një rol të rëndësishëm në stabilizimin e ekonomisë, sidomos kur vendi përballlet me kriza. Megjithatë, suksesi i saj varet nga tre faktorë kryesorë: hapësira fiskale që kemi në dispozicion, cilësia e institucioneve tona dhe struktura e brendshme e ekonomisë.

Prandaj, nuk mjafton ta shohim politikën fiskale si një mjet të shpejtë për të stimuluar ekonominë në momente të vështira. Ajo duhet të jetë pjesë e një strategjie afatgjatë, të menduar mirë, që synon stabilitet makroekonomik dhe zhvillim të qëndrueshëm (Auerbach & Gorodnichenko, 2012; IMF, 2025).

Së pari, ruajtja e hapësirës fiskale duhet të bëhet prioritet strategjik. Të dhënat tregojnë se sa më shumë rritet borxhi publik, aq më pak mundësi kemi për të reaguar kur vijnë goditje të reja. Kjo do të thotë që duhet të ndjekim një qasje të balancuar: të jemi të kujdesshëm kur zgjerojmë shpenzimet gjatë krizave dhe të krijojmë rezerva gjatë periudhave të mira. Vetëm kështu mund të ruajmë aftësinë për të vepruar efektivisht në të ardhmen (Ostry et al., 2010; Reinhart & Rogoff, 2010; IMF, 2025).

Së dyti, duhet të përmirësojmë cilësinë dhe drejtimin e shpenzimeve publike. Nuk ka rëndësi vetëm sa shpenzojmë, por ku i drejtojmë paratë. Investimet në infrastrukturë, arsim, shëndetësi dhe projekte që rrisin produktivitetin japin efekt shumë më të madh dhe më të qëndrueshëm sesa shpenzimet e thjeshta konsumatore. Qeveria duhet të zhvendosë prioritetet buxhetore drejt këtyre investimeve, duke ruajtur një kontroll të fortë mbi deficitin (World Bank, 2023, 2025; OECD, 2024).

Së treti, forcimi i institucioneve është një nga konkluzionet më të rëndësishme të këtij studimi. Efektiviteti i politikës fiskale varet jo vetëm nga sa para kemi, por edhe nga sa mirë i menaxhojmë ato. Forcimi i administrimit tatimor mbetet një prioritet i madh, siç theksojnë edhe van Brunschot et al. (2021). Rezultatet e mia (sidomos testi i hipotezës H6) tregojnë se kur përmirësohet Indeksi i Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF), ndikimi i shpenzimeve publike mbi ekonominë rritet ndjeshëm. Prandaj, reformat institucionale – si luftimi i korrupsionit, rritja e transparencës, thjeshtimi i procedurave dhe koordinimi më i mirë mes institucioneve – nuk janë thjesht detyra administrative, por mjete të fuqishme për të rritur efektivitetin e politikës fiskale (Besley & Persson, 2013; Gaspar et al., 2016; IMF, 2025).

Së katërti, duhet të punojmë seriozisht me problemet strukturore të ekonomisë. Informaliteti i lartë, varësia nga importet dhe tregu financiar i dobët e bëjnë stimulimin fiskal më pak efektiv. Prandaj, politika fiskale duhet të shoqërohet me reforma afatgjata: formalizim të ekonomisë, diversifikim të prodhimit, zhvillim të tregjeve financiare dhe forcim të eksporteve (Ilzetzki et al., 2013; EBRD, 2024).

Së pesti, duhet të gjejmë balancën e duhur midis mbrojtjes sociale dhe disiplinës fiskale. Gjatë krizave, ndihma për njerëzit dhe bizneset është e domosdoshme. Por nëse e bëjmë këtë pa menduar për të ardhurat dhe qëndrueshmërinë afatgjatë, krijojmë presione të reja mbi financat publike.

Në përfundim, rasti i Shqipërisë tregon se në ekonomitë e vogla dhe në tranzicion, politika fiskale nuk është një mjet i thjeshtë, por një proces dinamik që varet nga ndërveprimi midis ciklit ekonomik, hapësirës fiskale, strukturës së ekonomisë dhe forcës së institucioneve. Qëllimi ynë strategjik nuk duhet të jetë vetëm reagimi ndaj krizave, por ndërtimi i një sistemi që e bën politikën fiskale më të fortë, më fleksibël dhe më të qëndrueshme. Ruajtja e hapësirës fiskale dhe forcimi i institucioneve janë dy shtyllat kryesore të një strategjie të suksesshme fiskale për Shqipërinë.

6.8 Përfundime të kapitullit

Ky kapitull ofroi një interpretim të thellë ekonomik, teorik, institucional dhe rajonal të rezultateve empirike të studimit. Qëllimi ishte të shpjegonte kuptimin real të gjetjeve dhe mekanizmat përmes të cilëve politika fiskale ka ndikuar në ekonominë shqiptare gjatë periudhës 2000–2024. Analiza konfirmon argumentin qendror të tezës: efektiviteti i politikës fiskale nuk është konstant, por ndryshon ndjeshëm sipas kushteve makroekonomike, nivelit të borxhit publik, natyrës së goditjeve ekonomike dhe kapacitetit institucional. Politika fiskale ka pasur rol më të kufizuar gjatë periudhave normale të zgjerimit ekonomik, ndërsa është bërë më aktive dhe stabilizuese gjatë krizave. Krahësimi midis krizës financiare globale të 2008–2009 dhe pandemisë COVID-19 tregon se natyra e goditjes ndikon drejtpërdrejt në forcën e transmetimit fiskal. Një nga kontributet kryesore të këtij studimi është vërtetimi se përmirësimi i cilësisë institucionale, i matur përmes Indeksit të Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF), rrit ndjeshëm efektivitetin e ndërhyrjeve fiskale. Institucionet më të forta përmirësojnë jo vetëm hartimin, por edhe zbatimin dhe transmetimin e politikave publike, duke vepruar si një faktor përforcues thelbësor. Megjithatë, studimi nxjerr në pah sfidën kryesore të politikëbërjes: balancimin midis stabilizimit afatshkurtër dhe ruajtjes së qëndrueshmërisë fiskale afatgjatë. Zgjerimi fiskal gjatë krizave ndihmon rimëkëmbjen e menjëhershme, por rrit borxhin dhe kufizon hapësirën për veprime të ardhshme. Faktorë strukturorë si informaliteti i lartë, varësia nga importet dhe zhvillimi i kufizuar financiar vazhdojnë të dobësojnë mekanizmin e transmetimit fiskal dhe madhësinë e multiplikatorëve. Në nivel teorik, rasti shqiptar ilustron se analiza e politikës fiskale në ekonomitë në tranzicion duhet të largohet nga

qasjet lineare. Efektiviteti fiskal varet nga ndërveprimi kompleks midis ciklit ekonomik, hapësirës fiskale dhe cilësisë institucionale. Përmirësimi i qeverisjes institucionale nuk është vetëm një reformë administrative, por një kusht thelbësor për një politikë fiskale më efektive dhe për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. Ky kapitull krijon lidhjen e nevojshme midis evidencës empirike dhe konkluzioneve përfundimtare të tezës, duke vendosur bazën për sintetizimin e gjetjeve kryesore dhe për rekomandimet strategjike të politikëbërjes.

KAPITULLI 7: PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Ky kapitull përmbyll studimin duke përmbledhur gjetjet kryesore të analizës dhe duke reflektuar mbi rolin e politikës fiskale në Shqipëri gjatë periudhës 2000–2024. Ndërsa kapitujt e mëparshëm u fokusuan kryesisht në analizën teorike, empirike dhe historike, ky kapitull synon të nxjerrë në pah përfundimet më të rëndësishme, mësimet të nxjerra nga krizat ekonomike dhe implikimet konkrete për politikëbërjen. Analiza tregoi se efektiviteti i politikës fiskale në Shqipëri ka qenë i ndryshueshëm, duke u ndikuar fort nga kushtet makroekonomike, niveli i borxhit publik dhe karakteristikat strukturore të ekonomisë. Politika fiskale ka luajtur një rol dukshëm më aktiv dhe më vendimtar gjatë dy krizave të mëdha (2008–2009 dhe COVID-19), ndërsa ndikimi i saj në periudhat e stabilitetit ka qenë më i kufizuar. Rezultatet theksojnë se hapësira fiskale, cilësia e institucioneve publike dhe reziliencia strukturore e ekonomisë janë faktorë vendimtarë për suksesin e politikave fiskale. Në veçanti, analiza empirike konfirmon se përmirësimi i kapacitetit institucional shoqërohet me rritje të efektivitetit të ndërhyrjeve fiskale. Kjo sugjeron se aftësia e shtetit për të projektuar, koordinuar dhe zbatuar politika fiskale është po aq e rëndësishme sa vetë instrumentet fiskale që përdoren. Në këtë kontekst, kapitulli paraqet mësimet kryesore nga krizat ekonomike, rekomandimet strategjike për politikëbërjen, si dhe reflektimet përfundimtare mbi rolin e politikës fiskale në një ekonomi të vogël dhe në tranzicion si Shqipëria.

7.1 Përmbledhje e gjetjeve kryesore

Ky studim arrin në disa gjetje kryesore që thellojnë kuptimin e efektivitetit të politikës fiskale në një ekonomi të vogël dhe në tranzicion si Shqipëria.

Së pari, politika fiskale ka ndikuar pozitivisht në aktivitetin ekonomik, por ky ndikim është qartësisht i kushtëzuar nga faza e ciklit ekonomik. Ndërhyrjet fiskale janë më efektive gjatë periudhave të krizës dhe pasigurisë, ndërsa në periudhat e stabilitetit efekti i tyre mbetet më i moderuar. Kjo konfirmon natyrën dinamike të politikës fiskale, e cila funksionon më mirë si instrument stabilizues sesa si motor i rritjes afatgjatë.

Së dyti, borxhi publik dhe hapësira fiskale paraqiten si kufizues të rëndësishëm. Ndërhyrjet ekspansioniste gjatë krizave kanë dhënë rezultate pozitive afatshkurtër, por kanë rritur presionin mbi qëndrueshmërinë fiskale, duke kufizuar fleksibilitetin për reagime të ardhshme.

Së treti, kufizimet strukturore të ekonomisë shqiptare – si informaliteti i lartë, varësia nga importet dhe baza prodhuese e ngushtë – dobësojnë ndjeshëm mekanizmin e transmetimit fiskal dhe kufizojnë madhësinë e multiplikatorëve.

Së katërti, dhe ky është kontributi më i rëndësishëm origjinal i studimit, cilësia institucionale luan rol vendimtar. Analiza empirike e bazuar në Indeksin e Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF) demonstroi se përmirësimi i cilësisë së qeverisjes (efektiviteti i administratës, cilësia rregullatore, sundimi i ligjit dhe kontrolli i korrupsionit) forcon ndjeshëm efektin e shpenzimeve publike mbi rritjen ekonomike. Termi i ndërveprimit midis shpenzimeve dhe IKIPF rezultoi pozitiv dhe statistikisht domethënës, duke provuar se institucionet më të forta jo vetëm përmirësojnë efikasitetin, por edhe rrisin aftësinë e transmetimit të politikës fiskale.

Së pesti, efektiviteti i politikës fiskale në Shqipëri varet nga ndërveprimi midis këtyre faktorëve. Politika fiskale nuk mund të konsiderohet si një instrument me efekt të pandryshueshëm, por si një mekanizëm dinamik që kërkon koordinim midis disiplinës fiskale, forcimit institucional dhe reformave strukturore.

Këto gjetje theksojnë se suksesi i politikës fiskale në të ardhmen varet jo vetëm nga madhësia e ndërhyrjes publike, por kryesisht nga aftësia e shtetit për të ndërtuar hapësirë fiskale, institucione më të forta dhe një ekonomi më reziliente ndaj goditjeve.

7.2 Mësimet kryesore nga krizat ekonomike

Të dyja krizat kryesore të analizuar në këtë studim, kriza financiare globale e 2008–2009 dhe pandemia COVID-19, ofrojnë mësim të rëndësishëm për hartimin e politikës fiskale në Shqipëri. Edhe pse natyra e tyre ishte krejtësisht e ndryshme, ato zbuluan dobësi strukturore të ngjashme dhe nxorën në pah rëndësinë vendimtare të kapacitetit institucional për një reagim efektiv ndaj goditjeve.

Mësimet nga kriza financiare globale (2008–2009)

Kriza e 2008–2009 e ilustron qartë cenueshmërinë e lartë të një ekonomie të vogël dhe të hapur si Shqipëria ndaj tronditjeve të jashtme. Rënia e remitancave, ngadalësimi i investimeve të huaja dhe tkurrja e eksporteve goditën rëndë kërkesën e brendshme, pavarësisht se origjina e krizës ishte jashtë vendit. Nga kjo krizë dalin tri mësimet kryesore:

- Hapësira fiskale ka rëndësi vendimtare. Shqipëria hyri në krizë me një hapësirë fiskale të kufizuar, gjë që reduktoi ndjeshëm mundësinë për një stimul më të fuqishëm. Kjo nënvizon nevojën urgjente për ndërtimin e rezervave fiskale gjatë periudhave të stabilitetit ekonomik.
- Politika fiskale ka efekt të kufizuar kur goditja është kryesisht e jashtme. Stimuli fiskal pati ndikim të moderuar sepse kanalet kryesore të transmetimit (remitancat dhe eksportet) ishin jashtë kontrollit të drejtpërdrejtë të qeverisë.

- Dobësia e bazës prodhuese e ul efektivitetin e politikës fiskale. Varësia e lartë nga importet dhe struktura e ngushtë prodhuese bënë që një pjesë e stimujve fiskalë të “rrjedhë” jashtë ekonomisë, duke zvogëluar ndikimin e tyre neto.

Mësimet nga pandemia COVID-19 (2020)

Ndryshe nga kriza e 2008–2009, pandemia paraqiste një goditje të brendshme dhe simultane mbi ofertën dhe kërkesën. Kjo kërkoi një reagim shumë më të shpejtë, të koordinuar dhe të drejtpërdrejtë. Mësimet kryesore nga kjo periudhë janë:

- Reagimi i shpejtë dhe i targetuar jep rezultate konkrete. Masat e mbështetjes për punësimin dhe bizneset u treguan më efektive sepse goditja ishte e menjëhershme dhe e brendshme. Kjo tregon rëndësinë e gatishmërisë institucionale për të hartuar dhe zbatuar skema emergjente në kohë rekord.
- Koordinimi institucional dhe digjitalizimi rrisin ndjeshëm efikasitetin. Vendet me administratë më të digjitalizuar dhe koordinim më të mirë mes institucioneve arritën të shpërndanin ndihmën më shpejt dhe me humbje më të vogla.
- Kapaciteti institucional bën diferencën reale. Përmirësimi i qeverisjes fiskale (i matur edhe përmes Indeksit të Kapacitetit Institucional Fiskal – IKIPF) u shoqërua me një aftësi dukshëm më të lartë për të menaxhuar masa fiskale në kushte presioni ekstrem. Kjo konfirmon se institucionet nuk janë thjesht një “sfond”, por një faktor kyç që përcakton suksesin e politikës fiskale në kohë krize.

Të dyja krizat demonstrojnë se reziliencia fiskale dhe ekonomike e Shqipërisë mbetet e kufizuar pa një kombinim të fortë të hapësirës fiskale të mjaftueshme, institucione funksionale dhe një strukture ekonomike më të diversifikuar. Politika fiskale bëhet vërtet efektive jo vetëm kur është e madhe në vlerë, por kur mbështetet nga institucione të forta dhe një ekonomi më rezistente ndaj goditjeve. Prandaj, përgatitja për krizat e ardhshme nuk mund të kufizohet vetëm në rritjen e shpenzimeve gjatë emergjencave, por kërkon ndërtimin sistematik të kapaciteteve fiskale dhe institucionale edhe në periudha normale.

7.3 Rekomandime për politikëbërjen

Gjetjet e këtij studimi tregojnë se rritja e efektivitetit të politikës fiskale në Shqipëri kërkon një kombinim të disiplinës fiskale, forcimit institucional dhe reformave strukturore afatgjata. Evidenca empirike sugjeron se ndikimi i politikës fiskale nuk varet vetëm nga madhësia e ndërhyrjeve publike, por edhe nga hapësira fiskale e disponueshme, cilësia e institucioneve dhe aftësia e ekonomisë për t’u përballur me goditjet e jashtme. Në këtë kuadër, rekomandimet e mëposhtme synojnë të mbështesin ndërtimin e një politike fiskale më efektive dhe më të qëndrueshme.

Një prioritet i rëndësishëm lidhet me rritjen e gatishmërisë së financave publike për përballimin e krizave të ardhshme. Përvoja e krizës financiare globale dhe e pandemisë COVID-19 tregoi se disponueshmëria e hapësirës fiskale përcakton në masë të madhe aftësinë e shtetit për të reaguar në kohë dhe me efektivitet. Për këtë arsye, është e nevojshme forcimi i mekanizmave që mundësojnë krijimin e rezervave fiskale gjatë periudhave të rritjes ekonomike, përmirësimi i planifikimit të skenarëve të krizës dhe integrimi i vlerësimit të rreziqeve fiskale në procesin e hartimit të politikave buxhetore. Një qasje e tillë do të kontribuonte në rritjen e reziliencës së financave publike dhe në reduktimin e nevojës për masa të kushtueshme financimi gjatë periudhave të pasigurisë.

Një tjetër prioritet lidhet me forcimin e kapacitetit institucional dhe të qeverisjes fiskale. Rezultatet e studimit tregojnë se cilësia institucionale përbën një faktor kyç në rritjen e efektivitetit të politikës fiskale. Për rrjedhojë, përmirësimi i koordinimit ndërinstitutional, rritja e transparencës fiskale, modernizimi i proceseve administrative dhe zgjerimi i përdorimit të teknologjisë në administrimin e financave publike duhet të konsiderohen pjesë integrale e reformave fiskale. Në të njëjtën kohë, monitorimi sistematik i kapaciteteve institucionale mund të shërbejë si një instrument i dobishëm për vlerësimin e gatishmërisë së institucioneve për të zbatuar politika fiskale efektive.

Rezultatet sugjerojnë gjithashtu nevojën për përmirësimin e administrimit të të ardhurave publike dhe reduktimin gradual të informalitetit ekonomik. Zgjerimi i bazës tatimore, thjeshtimi i procedurave administrative dhe forcimi i kapaciteteve të administratës fiskale do të mundësojnë rritjen e të ardhurave buxhetore pa krijuar pengesa shtesë për aktivitetin ekonomik. Një sistem fiskal më efikas do të kontribuonte në krijimin e hapësirës së nevojshme për financimin e investimeve publike dhe përballimin e goditjeve të ardhshme ekonomike.

Nga perspektiva afatgjatë, politika fiskale duhet të mbështetet nga reforma strukturore që rrisin produktivitetin dhe reduktojnë cenueshmërinë e ekonomisë ndaj faktorëve të jashtëm. Në këtë drejtim, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet mbështetjes së sektorëve me potencial më të lartë zhvillimi, përmirësimi të infrastrukturës fizike dhe digjitale, investimeve në kapitalin njerëzor dhe nxitjes së inovacionit. Një ekonomi më e diversifikuar dhe më konkurruese krijon kushte më të favorshme për funksionimin e politikës fiskale dhe rrit aftësinë e saj për të mbështetur rritjen ekonomike në periudha afatgjata.

Në të njëjtën kohë, procesi i integritit evropian ofron një kornizë të rëndësishme për përmirësimin e qeverisjes fiskale dhe forcimin e disiplinës buxhetore. Përafrimi gradual me standardet europiane në fushën e menaxhimit të financave publike, transparencës fiskale dhe vlerësimit të rreziqeve do të kontribuonte në rritjen e besueshmërisë së politikave ekonomike dhe në forcimin e qëndrueshmërisë fiskale.

Në përmbledhje, gjetjet e studimit sugjerojnë se rritja e efektivitetit të politikës fiskale në Shqipëri kërkon një qasje të integruar, ku ndërthuren stabiliteti makroekonomik, disiplinimi fiskal, forcimi i institucioneve dhe zbatimi i reformave strukturore. Vetëm nëpërmjet këtij kombinimi mund të krijohen kushtet për një politikë fiskale më reziliente, më efektive dhe më të aftë për të mbështetur zhvillimin ekonomik afatgjatë.

7.4 Kontributi i studimit

Ky studim jep një kontribut të rëndësishëm në literaturën mbi politikën fiskale në ekonominë e vogla dhe në tranzicion, duke ofruar një analizë të integruar të efektivitetit të politikës fiskale në Shqipëri gjatë periudhës 2000–2024, me fokus të veçantë në periudhat e krizave ekonomike. Ndryshe nga një pjesë e konsiderueshme e literaturës ekzistuese, e cila trajton politikën fiskale kryesisht si një instrument me efekt relativisht të qëndrueshëm, ky studim e konceptualizon atë si një proces dinamik. Efektiviteti i saj ndryshon në mënyrë sistematike sipas fazës së ciklit ekonomik, nivelit të hapësirës fiskale dhe karakteristikave strukturore të ekonomisë. Kjo perspektivë dinamike ndihmon në shpjegimin e heterogjenitetit të rezultateve fiskale të vërejtura gjatë periudhës së analizuar.

Kontributi më i rëndësishëm origjinal i këtij studimi qëndron në integrimin sistematik të dimensionit institucional në analizën e efektivitetit fiskal. Duke ndërtuar dhe testuar empirikisht Indeksin e Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF), një tregues të përbërë bazuar në komponentët kryesorë të World Governance Indicators, studimi demonstroi se cilësia e institucioneve publike dhe kapaciteti administrativ i shtetit përbëjnë faktorë vendimtarë që ndikojnë jo vetëm në nivelin, por edhe në mekanizmin e transmetimit të ndërrhyrjeve fiskale. Rezultatet empirike, veçanërisht termi i ndërveprimit midis shpenzimeve publike dhe IKIPF, konfirmojnë se institucione më efektive forcojnë ndjeshëm efektin e politikës fiskale mbi rritjen ekonomike. Në këtë mënyrë, punimi zgjeron qasjen tradicionale të literaturës, e cila fokusohet kryesisht në instrumentet fiskale dhe treguesit makroekonomikë, duke vënë në qendër aftësinë institucionale si determinant kyç të suksesit të politikave publike. Ky kontribut është veçanërisht relevant për Shqipërinë dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, ku ekonominë ballafaqohen me kufizime strukturore të theksuara dhe ku roli i “state capacity” mbetet ende i nënvlerësuar në analizat fiskale.

Në fund, ky studim jo vetëm e identifikoi kufizimet dhe sfidat që përball një ekonomi të vogël dhe në tranzicion në përdorimin e politikës fiskale si instrument stabilizues, por edhe ofron një perspektivë të re analitike që lidh dimensionin fiskal me atë institucional. Ky kuadër i integruar mund të shërbejë si bazë për studime të mëtejshme krahasuese rajonale dhe për formulimin e politikave më efektive në kontekste të ngjashme.

7.5 Kufizimet dhe drejtimet për kërkime të ardhshme

Pavarësisht kontributit teorik dhe empirik që ofron ky studim, rezultatet e tij duhet të interpretohen duke marrë në konsideratë disa kufizime metodologjike dhe empirike që karakterizojnë analizën. Njohja e këtyre kufizimeve nuk cenon vlefshmërinë e gjetjeve, por ndihmon në vendosjen e tyre në kontekstin e duhur dhe në identifikimin e mundësive për zhvillime të mëtejshme kërkimore. Një nga kufizimet kryesore lidhet me natyrën e të dhënave të përdorura. Analiza mbështetet në seri kohore vjetore për periudhën 2000–2024, të cilat janë të përshtatshme për vlerësimin e tendencave afatgjata dhe të marrëdhënieve të ekuilibrit ndërmjet variablave, por nuk mundësojnë kapjen e plotë të dinamikave afatshkurtra të politikës fiskale. Si rrjedhojë, studimi nuk është në gjendje të identifikojë me saktësi ritmin dhe kohën e reagimit të ekonomisë ndaj ndërhyrjeve fiskale, veçanërisht gjatë periudhave të krizës.

Një kufizim tjetër lidhet me dimensionin relativisht të kufizuar të kampionit. Edhe pse periudha e studimit mbulon një hark kohor prej një çerek shekulli, numri i vëzhgimeve mbetet i kufizuar për standardet e analizës ekonometrike, gjë që mund të ndikojë në fuqinë statistikore të disa testeve dhe në aftësinë për të identifikuar marrëdhënie më të ndërlikuara ndërmjet variablave. Gjithashtu, fokusi ekskluziv në rastin e Shqipërisë kufizon mundësinë e përgjithësimin të rezultateve në ekonomi të tjera me karakteristika të ndryshme institucionale dhe strukturore.

Një sfidë e mëtejshme lidhet me kompleksitetin e marrëdhënieve ndërmjet politikës fiskale, rritjes ekonomike dhe faktorëve institucionalë. Edhe pse studimi kombinon qasje të ndryshme metodologjike dhe përfshin dimensionin institucional në analizë, mbetet e vështirë të eliminohen plotësisht problemet që lidhen me endogjenitetin dhe me ndikimin e faktorëve të pavëzhguar. Për këtë arsye, rezultatet duhet të interpretohen kryesisht si evidencë mbi marrëdhëniet ekonomike dhe institucionale afatgjata, pa pretenduar identifikimin e plotë të lidhjeve shkak-pasojë.

Këto kufizime krijojnë njëkohësisht mundësi për zgjerimin e kërkimeve të ardhshme. Një drejtim i rëndësishëm do të ishte përdorimi i të dhënave me frekuencë më të lartë, si të dhënat tremujore ose mujore, të cilat do të mundësonin analizimin më të detajuar të dinamikave afatshkurtra të politikës fiskale dhe të mekanizmave të transmetimit të saj në ekonomi. Po ashtu, aplikimi i metodave më të avancuara ekonometrike mund të kontribuojë në identifikimin më të saktë të efekteve fiskale dhe të ndryshimeve strukturore që karakterizojnë periudha të ndryshme ekonomike.

Një tjetër drejtim me interes lidhet me zgjerimin e analizës në nivel rajonal. Krahësimi i Shqipërisë me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor ose me ekonomi të tjera në tranzicion do të mundësonte identifikimin e ngjashmërive dhe dallimeve në mënyrën se

si institucionet ndikojnë në efektivitetin e politikës fiskale dhe në performancën ekonomike.

Vëmendje e veçantë mund t'i kushtohet gjithashtu thellimit të analizës së dimensionit institucional. Kërkimet e ardhshme mund të shqyrtojnë në mënyrë të veçantë ndikimin e komponentëve individualë të qeverisjes, si efektiviteti i qeverisë, cilësia rregullatore, sundimi i ligjit dhe kontrolli i korrupsionit, duke analizuar ndërveprimin e tyre me faktorë të tillë si informaliteti ekonomik, efikasiteti i shpenzimeve publike dhe cilësia e investimeve publike.

Një fushë tjetër premtuese kërkimi lidhet me studimin e kanaleve përmes të cilave institucionet ndikojnë në efektivitetin e politikës fiskale. Analiza më të detajuara mund të fokusohen në mekanizma konkretë, si menaxhimi i projekteve publike, procesi i alokimit të fondeve buxhetore apo kapaciteti administrativ për zbatimin e politikave publike.

Së fundi, studime të ardhshme mund të përqendrohen në vlerësimin e masave specifike fiskale të zbatuara gjatë periudhave të krizës, duke përdorur të dhëna më të detajuara dhe qasje më të fokusuara analitike. Një analizë e tillë do të mundësonte identifikimin më të saktë të politikave që kanë prodhuar rezultatet më efektive në mbështetjen e aktivitetit ekonomik dhe të mirëqenies sociale.

Kufizimet e identifikuara nuk zbehin rëndësinë e gjetjeve të këtij studimi, por evidencojnë kompleksitetin e analizës së politikës fiskale në ekonominë në tranzicion. Ato theksojnë nevojën për vazhdimin e kërkimeve në këtë fushë dhe për zhvillimin e qasjeve më të avancuara që mund të kontribuojnë në një kuptim më të plotë të marrëdhënies ndërmjet politikës fiskale, kapaciteteve institucionale dhe zhvillimit ekonomik.

7.6 Përfundimi final

Ky studim konfirmon se politika fiskale mbetet një instrument thelbësor për stabilizimin ekonomik dhe përballimin e goditjeve në një ekonomi të vogël dhe në tranzicion si Shqipëria. Megjithatë, efektiviteti i saj nuk është as konstant dhe as i pavarur nga konteksti. Ai varet nga ndërveprimi dinamik midis kushteve makroekonomike, hapësirës fiskale, strukturës së ekonomisë dhe, sidomos, kapacitetit institucional të shtetit. Gjatë periudhës 2000–2024, politika fiskale tregoi një rol më aktiv stabilizues gjatë krizave (2008–2009 dhe 2020), por efektiviteti i saj mbeti i kufizuar nga borxhi publik, varësia nga faktorët e jashtëm dhe kufizimet strukturore të ekonomisë. Këto gjetje nxjerrin në pah se ndërhyrja fiskale nuk mund të konsiderohet një zgjidhje automatike, por kërkon një kuadër më të gjerë të “strategic fiscal governance”, ku disiplina fiskale, rezilienca institucionale dhe reforma strukturore punojnë së bashku. Kontributi më i rëndësishëm i këtij studimi qëndron në demonstrimin empirik se cilësia institucionale, e matur përmes Indeksit të Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale (IKIPF), përbën një faktor vendimtar që

forcon ndikimin e politikës fiskale mbi rritjen ekonomike. Ky rezultat thekson se instrumentet fiskale japin rezultate më të mira kur mbështeten nga institucione më efektive, transparente dhe të afta për zbatim. Në këtë kuptim, kapaciteti institucional nuk është thjesht një faktor shoqërues, por një determinant thelbësor i suksesit të politikave publike në ekonominë në tranzicion. Në një mjedis global të karakterizuar nga pasiguri gjeopolitike, goditje energjetike, rreziqe klimatike dhe transformime teknologjike, aftësia e shtetit për të ndërtuar politika fiskale fleksibël dhe institucione reziliente do të përbëjë një nga faktorët vendimtarë të stabilitetit dhe zhvillimit ekonomik afatgjatë. Për Shqipërinë, sfida kryesore nuk është vetëm reagimi ndaj krizave, por ndërtimi gradual i një sistemi fiskal dhe institucional që e bën ekonominë më të fortë, më fleksibël dhe më të përgatitur për goditjet e së ardhmes. Në fund, ky studim nënvizon se zhvillimi institucional dhe politika fiskale nuk janë dy dimensione të veçanta, por dy anë të së njëjtës monedhë. Vetëm duke forcuar kapacitetin institucional, Shqipëria mund të transformojë politikën fiskale nga një instrument reaktiv në një levë strategjike për rritje të qëndrueshme dhe zhvillim ekonomik afatgjatë.

ANEKSET

1. Përkufizimi i variablave, njësitë matëse dhe burimet e të dhënave

Variabla	Simboli	Përkufizimi	Njësia matëse	Burimi
VARIABLI I VARUR				
Rritja ekonomike	GDP_Growth	Norma vjetore e rritjes reale të Produktit të Brendshëm Bruto	%	World Bank (WDI), IMF (WEO)
INSTRUMENTAT FISKALE				
Shpenzimet qeveritare	Gov_Exp	Shpenzimet totale të qeverisë si përqindje e PBB-së	% e PBB	IMF (GFS), World Bank
Investimet publike	Pub_Investment	Investimet publike kapitale si përqindje e PBB-së	% e PBB	IMF (GFS), INSTAT
Të ardhurat tatimore	Tax_Revenue	Të ardhurat tatimore totale si përqindje e PBB-së	% e PBB	IMF (WEO), World Bank
Borxhi publik	Public_Debt	Borxhi publik bruto si përqindje e PBB-së	% e PBB	IMF (WEO), Ministry of Finance
KONTROLLE MAKRO				
Inflacioni	Inflation	Norma vjetore e inflacionit (CPI)	%	World Bank (WDI)
Papunësia	Unemployment	Norma e papunësisë në ekonomi	%	INSTAT, World Bank
KONTROLLE TE JASHTME				
Eksportet	Exports	Eksportet e mallrave dhe shërbimeve si përqindje e PBB-së	% e PBB	World Bank (WDI)
Remitancat	Remittances	Remitancat nga emigrantët si përqindje e PBB-së	% e PBB	World Bank (WDI)
VARIABLI INSTITUCIONAL				
Indeksi i Kapacitetit Institucional për Politikën Fiskale	IKIPF	Indeks që mat kapacitetin institucional për hartimin dhe zbatimin e politikës fiskale.	Indeks (-2.5 deri +2.5)	Përlogaritje e autores bazuar në World Governance Indicators (WGI), World Bank

2. IKIPF mesatare 2000-2024 dhe GDP per capita mesatare 2000-2024, për vendet e Ballkanit Perëndimor

Vendi	IKIPF mesatare 2000–2024	GDP per capita mesatare 2000–2024
Shqiperia	-0.35	4663.04
Mali I Zi	-0.01	6630.76
Kosova	-0.20	4201.33
Serbia	-0.36	6431.04
Maqedonia e Veriut	-0.24	5139.34
Bosnje Herzegovina	-0.49	4746.84

3. Baza e të dhënave (2000-2024)

Year	GDP_Growth	GOV_Exp	Pub_Investment	Tax_Revenue	Public_Debt	Inflation	Unemployment	Remittances	Exports
2000	6.9	34	8	20.8	63.8	0.1	19.02	17.2	20.1
2001	8.3	33	6.7	20.3	60.3	3.1	18.57	17.8	21.3
2002	4.5	31.5	5.1	21.1	64.1	5.2	17.89	16.9	20.9
2003	5.5	29.7	5.8	21.5	60.2	2.4	16.99	15.8	20.8
2004	5.5	30.2	5.6	22.5	57.5	2.9	16.31	16.2	22.2
2005	5.5	28.9	6.9	22.9	58.2	2.4	15.97	16	23
2006	5.9	29.7	6.6	23.5	56.7	2.4	15.63	15.3	25.2
2007	6	29.6	9.6	23.6	53.5	2.9	13.5	13.7	28.2
2008	7.5	32.5	9.6	24.5	55.1	3.4	13.2	14.5	25.3
2009	3.4	33.2	6.3	23.7	59.7	2.3	13.4	14.3	25.2
2010	3.7	29.3	6.1	23.3	57.7	3.6	14.2	13.3	28
2011	2.5	28.9	5.1	23.4	59.4	3.5	14.3	12	29.2
2012	1.4	28.2	5.5	22.6	62.1	2	13.9	11.5	28.9
2013	1	29.2	5.2	22.2	70.4	1.9	16.1	10	28.9
2014	1.8	31.5	5.3	24.1	72	1.6	17.9	10.7	28.2
2015	2.2	30.5	5.2	23.9	72.7	1.9	17.5	11.3	27.3
2016	3.3	29.5	5.5	25.1	72.4	1.3	15.6	11	29
2017	3.8	29.8	5.6	25.7	70.2	2	14.1	10.1	31.6
2018	4	28.7	5.4	25.2	66.7	2	12.8	9.5	31.1
2019	2.1	28.7	7.2	24.9	65	1.4	12	9.5	30.9
2020	-3.3	32.4	7.8	24.1	73.9	1.6	12.2	9.6	22.5
2021	8.9	31.9	6.1	25.5	74.1	2	12	9.5	31.1
2022	4.9	30.3	6.1	25.2	64.1	6.7	11.3	9.2	37.2
2023	3.5	28.5	6	25.3	57.5	4.8	11.2	8.6	38.7
2024	4	28.8	5.3	19.8	54.7	2.2	10.7	8.4	6.7

4. Ndërtimi i IKIPF (treguesit e përdorur)

IKIPF	Regulatory Quality - estimate (approx. 2.5 to +2.5)	Control of Corruption - Governance estimate (approx. -2.5 to +2.5)	Rule of Law - Governance estimate (approx. -2.5 to +2.5)	Government Effectiveness - Governance estimate (approx. 2.5 to +2.5)	Indikatorët
-3.80	-0.74	-0.98	-0.97	-1.11	2000
-3.32	-0.58	-0.99	-0.86	-0.88	2001
-2.84	-0.43	-1.00	-0.75	-0.66	2002
-2.85	-0.42	-1.01	-0.76	-0.66	2003
-2.01	-0.29	-0.76	-0.51	-0.45	2004
-2.60	-0.36	-0.88	-0.66	-0.70	2005
-2.05	-0.13	-0.69	-0.61	-0.62	2006
-1.72	-0.01	-0.68	-0.53	-0.52	2007
-1.56	0.04	-0.64	-0.47	-0.48	2008
-1.14	0.13	-0.57	-0.41	-0.29	2009
-1.01	0.11	-0.50	-0.32	-0.30	2010
-1.18	0.05	-0.69	-0.30	-0.25	2011
-1.65	-0.08	-0.82	-0.40	-0.34	2012
-1.72	-0.06	-0.82	-0.48	-0.36	2013
-0.82	0.06	-0.68	-0.28	0.08	2014
-0.59	0.04	-0.59	-0.23	0.18	2015
-0.45	0.06	-0.51	-0.21	0.20	2016
-0.41	0.11	-0.57	-0.21	0.26	2017
-0.38	0.11	-0.59	-0.17	0.27	2018
-0.71	0.09	-0.54	-0.29	0.03	2019
-0.92	-0.02	-0.66	-0.26	0.02	2020
-0.70	0.00	-0.60	-0.20	0.11	2021
-0.42	0.02	-0.50	-0.13	0.19	2022
-0.26	0.06	-0.46	-0.15	0.29	2023
-0.09	0.14	-0.42	-0.12	0.31	2024

5. IKIPF dhe rritja ekonomike për vendet e Ballkanit Perëndimor

	Shqipëria		Mali I Zi		Kosova		Serbia		Maqedonia e Veriut		Bosnje Herzegovina	
Year	Rritja Ekonomike (%) -Shqipëria	IKIPF	Rritja Ekonomike (%)	IKIPF	Rritja Ekonomike (%)	IKIPF	Rritja Ekonomike (%)	IKIPF	Rritja Ekonomike (%)	IKIPF	Rritja Ekonomike (%)	IKIPF
2000	6.9	-0.95	3.10	0.02	..	-0.08	6.06	-1.33	4.55	-0.78	5.41	-0.88
2001	8.3	-0.83	1.10	0.02	..	0.05	6.78	-1.09	-3.07	-0.70	2.42	-0.81
2002	4.5	-0.71	1.90	0.03	..	0.19	6.54	-0.86	1.49	-0.61	5.03	-0.73
2003	5.5	-0.71	2.48	-0.05	..	0.41	4.56	-0.79	2.22	-0.66	3.87	-0.70
2004	5.5	-0.50	4.43	-0.06	..	0.34	6.69	-0.57	4.67	-0.28	6.33	-0.52
2005	5.5	-0.65	4.18	-0.06	..	-0.16	5.90	-0.66	4.72	-0.38	3.90	-0.51
2006	5.9	-0.51	8.57	-0.06	..	-0.26	3.90	-0.40	5.14	-0.27	5.41	-0.44
2007	6	-0.43	7.14	-0.15	..	-0.26	7.83	-0.34	6.47	-0.22	5.86	-0.47
2008	7.5	-0.39	6.90	-0.15	..	-0.34	5.16	-0.35	5.47	-0.17	5.44	-0.45
2009	3.4	-0.29	-5.99	-0.10	5.03	-0.31	-3.14	-0.33	-0.36	-0.15	-3.00	-0.43
2010	3.7	-0.25	2.78	-0.26	4.94	-0.45	1.61	-0.32	3.36	-0.34	0.87	-0.45
2011	2.5	-0.30	3.41	-0.28	6.32	-0.43	0.05	-0.28	2.34	-0.29	0.96	-0.48
2012	1.4	-0.41	-2.49	-0.12	1.71	-0.38	-0.44	-0.29	-0.46	-0.05	-0.82	-0.33
2013	1	-0.43	3.39	-0.09	5.34	-0.40	0.45	-0.27	2.93	-0.06	2.35	-0.30
2014	1.8	-0.20	2.37	0.08	3.35	-0.30	-1.80	-0.05	3.63	0.02	1.15	-0.22
2015	2.2	-0.15	2.52	0.10	5.92	-0.33	1.30	-0.08	3.86	-0.10	4.28	-0.36
2016	3.3	-0.11	3.44	0.08	5.57	-0.29	2.98	-0.09	2.85	-0.12	3.24	-0.33
2017	3.8	-0.10	3.22	0.11	4.83	-0.31	2.36	-0.09	1.08	-0.08	3.24	-0.39
2018	4	-0.09	4.73	0.12	3.41	-0.33	4.65	-0.06	2.88	-0.03	3.83	-0.49
2019	2.1	-0.18	4.39	0.13	4.76	-0.35	4.75	-0.07	3.91	-0.17	2.89	-0.55
2020	-3.3	-0.23	-14.99	0.10	-5.34	-0.37	-0.95	-0.10	-4.69	-0.10	-3.02	-0.50
2021	8.9	-0.17	13.05	0.06	10.75	-0.26	7.95	-0.14	4.51	-0.09	7.39	-0.55
2022	4.9	-0.11	7.74	0.05	4.28	-0.23	2.70	-0.09	2.76	-0.07	4.23	-0.52
2023	3.5	-0.07	6.48	0.13	4.07	-0.14	3.75	-0.12	2.55	-0.10	1.99	-0.49
2024	4	-0.02	3.16	0.15	4.57	-0.12	3.95	-0.15	2.99	-0.08	2.97	-0.45

6. Testet e Stacionaritetit (Nërmjet E-Views)

a. Testi i stacionaritetit(përmbledhëse) (Augmented Dickey–Fuller, ADF), 2000–2024

	ADF Statistic (Level)	p-value (Level)	Stacionare në nivel?	ADF Statistic (First Diff)	p-value (First Diff)	Vendimi final
GDP_Growth	-3.802519	0.0086	Po			Përdoret në nivel
GOV_Exp	-3.841594	0.0089	Po			Përdoret në nivel
Pub_Investment	-2.730210	0.0837	Jo	-4.769320	0.001	Përdoret si d(Pub_Investment)
Tax_Revenue	-1.917604	0.3191	Jo	-2.804322	0.0732	Përdoret si d(Tax_Revenue) (stacionare në 10%)
Public_Debt	-1.908826	0.3226	Jo	-3.626332	0.0132	Përdoret si d(Public_Debt)
Inflation	-3.938583	0.0063	Po	-	-	Përdoret në nivel
Unemployment	-1.780277	0.3802	Jo	-2.849299	0.0671	Përdoret si d(Unemployment) (stacionare në 10%)
Remittances	-0.849574	0.7863	Jo	-5.043610	0.0005	Përdoret si d(Remittances)
Exports	-3.796861	0.0107	Po			Përdoret në nivel

b. GDP_Exp

Null Hypothesis: GOV_EXP has a unit root
Exogenous: Constant
Lag Length: 3 (Automatic - based on SIC, maxlag=5)

	t-Statistic	Prob.*
Augmented Dickey-Fuller test statistic	-3.841594	0.0089
Test critical values:		
1% level	-3.788030	
5% level	-3.012363	
10% level	-2.646119	

*MacKinnon (1996) one-sided p-values.

Augmented Dickey-Fuller Test Equation
Dependent Variable: D(GOV_EXP)
Method: Least Squares
Date: 02/02/26 Time: 21:21
Sample (adjusted): 2004 2024
Included observations: 21 after adjustments

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
GOV_EXP(-1)	-1.525215	0.397027	-3.841594	0.0014
D(GOV_EXP(-1))	0.797405	0.282649	2.821186	0.0123
D(GOV_EXP(-2))	0.368605	0.240750	1.531068	0.1453
D(GOV_EXP(-3))	0.193220	0.206315	0.936528	0.3629
C	45.98138	12.00333	3.830720	0.0015
R-squared	0.563744	Mean dependent var	-0.042857	
Adjusted R-squared	0.454680	S.D. dependent var	1.684212	
S.E. of regression	1.243720	Akaike info criterion	3.478347	
Sum squared resid	24.74941	Schwarz criterion	3.727043	
Log likelihood	-31.52264	Hannan-Quinn criter.	3.532320	
F-statistic	5.168934	Durbin-Watson stat	2.016021	
Prob(F-statistic)	0.007229			

c. Inflation

Null Hypothesis: INFLATION has a unit root
Exogenous: Constant
Lag Length: 0 (Automatic - based on SIC, maxlag=5)

	t-Statistic	Prob.*
Augmented Dickey-Fuller test statistic	-3.938583	0.0063
Test critical values: 1% level	-3.737853	
5% level	-2.991878	
10% level	-2.635542	

*MacKinnon (1996) one-sided p-values.

Augmented Dickey-Fuller Test Equation
Dependent Variable: D(INFLATION)
Method: Least Squares
Date: 02/02/26 Time: 21:24
Sample (adjusted): 2001 2024
Included observations: 24 after adjustments

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
INFLATION(-1)	-0.748315	0.189996	-3.938583	0.0007
C	2.064299	0.565671	3.649296	0.0014
R-squared	0.413528	Mean dependent var		0.087500
Adjusted R-squared	0.386870	S.D. dependent var		1.632366
S.E. of regression	1.278186	Akaike info criterion		3.408415
Sum squared resid	35.94268	Schwarz criterion		3.506587
Log likelihood	-38.90099	Hannan-Quinn criter.		3.434460
F-statistic	15.51243	Durbin-Watson stat		1.634672
Prob(F-statistic)	0.000700			

d. Pub_Investment

Null Hypothesis: PUB_INVESTMENT has a unit root
Exogenous: Constant
Lag Length: 0 (Automatic - based on SIC, maxlag=5)

	t-Statistic	Prob.*
Augmented Dickey-Fuller test statistic	-2.730210	0.0837
Test critical values: 1% level	-3.737853	
5% level	-2.991878	
10% level	-2.635542	

*MacKinnon (1996) one-sided p-values.

Augmented Dickey-Fuller Test Equation
Dependent Variable: D(PUB_INVESTMENT)
Method: Least Squares
Date: 02/02/26 Time: 21:27
Sample (adjusted): 2001 2024
Included observations: 24 after adjustments

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
PUB_INVESTMENT(...)	-0.479183	0.175511	-2.730210	0.0122
C	2.928314	1.135518	2.578836	0.0171
R-squared	0.253074	Mean dependent var		-0.112500
Adjusted R-squared	0.219123	S.D. dependent var		1.226275
S.E. of regression	1.083626	Akaike info criterion		3.078157
Sum squared resid	25.83338	Schwarz criterion		3.176328
Log likelihood	-34.93789	Hannan-Quinn criter.		3.104202
F-statistic	7.454048	Durbin-Watson stat		1.673778
Prob(F-statistic)	0.012220			

Null Hypothesis: D(PUB_INVESTMENT) has a unit root
Exogenous: Constant
Lag Length: 0 (Automatic - based on SIC, maxlag=5)

	t-Statistic	Prob.*
Augmented Dickey-Fuller test statistic	-4.769320	0.0010
Test critical values: 1% level	-3.752946	
5% level	-2.998064	
10% level	-2.638752	

*MacKinnon (1996) one-sided p-values.

Augmented Dickey-Fuller Test Equation
Dependent Variable: D(PUB_INVESTMENT,2)
Method: Least Squares
Date: 02/02/26 Time: 21:30
Sample (adjusted): 2002 2024
Included observations: 23 after adjustments

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
D(PUB_INVESTMENT(-1))	-1.023425	0.214585	-4.769320	0.0001
C	-0.062907	0.262431	-0.239707	0.8129
R-squared	0.519961	Mean dependent var		0.026087
Adjusted R-squared	0.497102	S.D. dependent var		1.770264
S.E. of regression	1.255388	Akaike info criterion		3.375708
Sum squared resid	33.09600	Schwarz criterion		3.474447
Log likelihood	-36.82065	Hannan-Quinn criter.		3.400541
F-statistic	22.74641	Durbin-Watson stat		2.037718
Prob(F-statistic)	0.000104			

Pub_Investment nuk rezultoi stacionare në nivel ($p = 0.0837$), por bëhet stacionare pas diferencimit të parë (ADF = -4.77 , $p = 0.0010$); për këtë arsye në model përdoret $d(\text{Pub_Investment})$.

e. Public_Debt

Null Hypothesis: PUBLIC_DEBT has a unit root
Exogenous: Constant
Lag Length: 1 (Automatic - based on SIC, maxlag=5)

	t-Statistic	Prob.*
Augmented Dickey-Fuller test statistic	-1.908826	0.3226
Test critical values:		
1% level	-3.752946	
5% level	-2.998064	
10% level	-2.638752	

*MacKinnon (1996) one-sided p-values.

Augmented Dickey-Fuller Test Equation
Dependent Variable: D(PUBLIC_DEBT)
Method: Least Squares
Date: 02/02/26 Time: 21:34
Sample (adjusted): 2002 2024
Included observations: 23 after adjustments

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
PUBLIC_DEBT(-1)	-0.265763	0.139229	-1.908826	0.0707
D(PUBLIC_DEBT(-1))	0.380303	0.212979	1.785631	0.0893
C	16.77133	8.920142	1.880164	0.0747
R-squared	0.201197	Mean dependent var	-0.243478	
Adjusted R-squared	0.121317	S.D. dependent var	4.312332	
S.E. of regression	4.042297	Akaike info criterion	5.752611	
Sum squared resid	326.8033	Schwarz criterion	5.900719	
Log likelihood	-63.15503	Hannan-Quinn criter.	5.789860	
F-statistic	2.518737	Durbin-Watson stat	1.744751	
Prob(F-statistic)	0.105778			

Null Hypothesis: D(PUBLIC_DEBT) has a unit root
Exogenous: Constant
Lag Length: 0 (Automatic - based on SIC, maxlag=5)

	t-Statistic	Prob.*
Augmented Dickey-Fuller test statistic	-3.626332	0.0132
Test critical values:		
1% level	-3.752946	
5% level	-2.998064	
10% level	-2.638752	

*MacKinnon (1996) one-sided p-values.

Augmented Dickey-Fuller Test Equation
Dependent Variable: D(PUBLIC_DEBT,2)
Method: Least Squares
Date: 02/02/26 Time: 21:35
Sample (adjusted): 2002 2024
Included observations: 23 after adjustments

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
D(PUBLIC_DEBT(-1))	-0.765212	0.211015	-3.626332	0.0016
C	-0.179167	0.896224	-0.199913	0.8435
R-squared	0.385071	Mean dependent var	0.030435	
Adjusted R-squared	0.355789	S.D. dependent var	5.343937	
S.E. of regression	4.289193	Akaike info criterion	5.833015	
Sum squared resid	386.3406	Schwarz criterion	5.931754	
Log likelihood	-65.07968	Hannan-Quinn criter.	5.857848	
F-statistic	13.15028	Durbin-Watson stat	1.732109	
Prob(F-statistic)	0.001582			

Public_Debt rezultoi jo-stacionare në nivel ($p = 0.3226$), por bëhet stacionare pas diferencimit të parë (ADF = -3.63 , $p = 0.0132$); prandaj në model përdoret d(Public_Debt).

f. Remittances

Null Hypothesis: REMITTANCES has a unit root
Exogenous: Constant
Lag Length: 0 (Automatic - based on SIC, maxlag=5)

	t-Statistic	Prob.*
Augmented Dickey-Fuller test statistic	-0.849574	0.7863
Test critical values:		
1% level	-3.737853	
5% level	-2.991878	
10% level	-2.635542	

*MacKinnon (1996) one-sided p-values.

Augmented Dickey-Fuller Test Equation
Dependent Variable: D(REMITTANCES)
Method: Least Squares
Date: 02/02/26 Time: 21:37
Sample (adjusted): 2001 2024
Included observations: 24 after adjustments

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
REMITTANCES(-1)	-0.041113	0.048393	-0.849574	0.4047
C	0.153243	0.628075	0.243989	0.8095
R-squared	0.031766	Mean dependent var	-0.366667	
Adjusted R-squared	-0.012245	S.D. dependent var	0.688203	
S.E. of regression	0.692404	Akaike info criterion	2.182360	
Sum squared resid	10.54730	Schwarz criterion	2.280531	
Log likelihood	-24.18832	Hannan-Quinn criter.	2.208404	
F-statistic	0.721776	Durbin-Watson stat	1.992005	
Prob(F-statistic)	0.404713			

Null Hypothesis: D(REMITTANCES) has a unit root
Exogenous: Constant
Lag Length: 0 (Automatic - based on SIC, maxlag=5)

	t-Statistic	Prob.*
Augmented Dickey-Fuller test statistic	-5.043610	0.0005
Test critical values:		
1% level	-3.752946	
5% level	-2.998064	
10% level	-2.638752	

*MacKinnon (1996) one-sided p-values.

Augmented Dickey-Fuller Test Equation
Dependent Variable: D(REMITTANCES,2)
Method: Least Squares
Date: 02/02/26 Time: 21:38
Sample (adjusted): 2002 2024
Included observations: 23 after adjustments

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
D(REMITTANCES(-1))	-1.050144	0.208213	-5.043610	0.0001
C	-0.427445	0.162909	-2.623830	0.0159
R-squared	0.547784	Mean dependent var	-0.034783	
Adjusted R-squared	0.526250	S.D. dependent var	0.997091	
S.E. of regression	0.686292	Akaike info criterion	2.167915	
Sum squared resid	9.890943	Schwarz criterion	2.266654	
Log likelihood	-22.93103	Hannan-Quinn criter.	2.192748	
F-statistic	25.43800	Durbin-Watson stat	1.926489	
Prob(F-statistic)	0.000054			

Remittances rezultoi jo-stacionare në nivel ($p = 0.7863$), por bëhet stacionare pas diferencimit të parë (ADF = -5.04 , $p = 0.0005$); për këtë arsye në model përdoret d(Remittances)

g. Tax_Revenue

Null Hypothesis: TAX_REVENUE has a unit root
Exogenous: Constant
Lag Length: 0 (Automatic - based on SIC, maxlag=5)

	t-Statistic	Prob.*
Augmented Dickey-Fuller test statistic	-1.917604	0.3191
Test critical values:		
1% level	-3.737853	
5% level	-2.991878	
10% level	-2.635542	

*MacKinnon (1996) one-sided p-values.

Augmented Dickey-Fuller Test Equation
Dependent Variable: D(TAX_REVENUE)
Method: Least Squares
Date: 02/02/26 Time: 21:40
Sample (adjusted): 2001 2024
Included observations: 24 after adjustments

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
TAX_REVENUE(-1)	-0.335864	0.175148	-1.917604	0.0682
C	7.863743	4.131136	1.903531	0.0701
R-squared	0.143209	Mean dependent var	-0.041667	
Adjusted R-squared	0.104264	S.D. dependent var	1.378379	
S.E. of regression	1.304543	Akaike info criterion	3.449239	
Sum squared resid	37.44034	Schwarz criterion	3.547410	
Log likelihood	-39.39086	Hannan-Quinn criter.	3.475283	
F-statistic	3.677207	Durbin-Watson stat	1.383653	
Prob(F-statistic)	0.068236			

Null Hypothesis: D(TAX_REVENUE) has a unit root
Exogenous: Constant
Lag Length: 0 (Automatic - based on SIC, maxlag=5)

	t-Statistic	Prob.*
Augmented Dickey-Fuller test statistic	-2.804322	0.0732
Test critical values:		
1% level	-3.752946	
5% level	-2.998064	
10% level	-2.638752	

*MacKinnon (1996) one-sided p-values.

Augmented Dickey-Fuller Test Equation
Dependent Variable: D(TAX_REVENUE,2)
Method: Least Squares
Date: 02/02/26 Time: 21:41
Sample (adjusted): 2002 2024
Included observations: 23 after adjustments

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
D(TAX_REVENUE(-1))	-1.133405	0.404163	-2.804322	0.0106
C	0.004362	0.309527	0.014092	0.9889
R-squared	0.272456	Mean dependent var	-0.217391	
Adjusted R-squared	0.237811	S.D. dependent var	1.643901	
S.E. of regression	1.435182	Akaike info criterion	3.643402	
Sum squared resid	43.25472	Schwarz criterion	3.742141	
Log likelihood	-39.89913	Hannan-Quinn criter.	3.668235	
F-statistic	7.864223	Durbin-Watson stat	1.252269	
Prob(F-statistic)	0.010626			

h. Unemployment

Null Hypothesis: UNEEMPLOYMENT has a unit root
Exogenous: Constant
Lag Length: 1 (Automatic - based on SIC, maxlag=5)

	t-Statistic	Prob.*
Augmented Dickey-Fuller test statistic	-1.780277	0.3802
Test critical values:		
1% level	-3.752946	
5% level	-2.998064	
10% level	-2.638752	

*MacKinnon (1996) one-sided p-values.

Augmented Dickey-Fuller Test Equation
Dependent Variable: D(UNEEMPLOYMENT)
Method: Least Squares
Date: 02/02/26 Time: 21:43
Sample (adjusted): 2002 2024
Included observations: 23 after adjustments

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
UNEEMPLOYMENT(-1)	-0.149850	0.084172	-1.780277	0.0902
D(UNEEMPLOYMENT(-1))	0.500650	0.189299	2.644754	0.0155
C	2.020807	1.257780	1.606646	0.1238
R-squared	0.305388	Mean dependent var	-0.342174	
Adjusted R-squared	0.235927	S.D. dependent var	1.000227	
S.E. of regression	0.874311	Akaike info criterion	2.690347	
Sum squared resid	15.28840	Schwarz criterion	2.838455	
Log likelihood	-27.93899	Hannan-Quinn criter.	2.727596	
F-statistic	4.396529	Durbin-Watson stat	1.734964	
Prob(F-statistic)	0.026147			

Null Hypothesis: D(UNEEMPLOYMENT) has a unit root
Exogenous: Constant
Lag Length: 0 (Automatic - based on SIC, maxlag=5)

	t-Statistic	Prob.*
Augmented Dickey-Fuller test statistic	-2.849299	0.0671
Test critical values:		
1% level	-3.752946	
5% level	-2.998064	
10% level	-2.638752	

*MacKinnon (1996) one-sided p-values.

Augmented Dickey-Fuller Test Equation
Dependent Variable: D(UNEEMPLOYMENT,2)
Method: Least Squares
Date: 02/02/26 Time: 21:44
Sample (adjusted): 2002 2024
Included observations: 23 after adjustments

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
D(UNEEMPLOYMENT(-1))	-0.557923	0.195810	-2.849299	0.0096
C	-0.191868	0.202735	-0.946398	0.3547
R-squared	0.278809	Mean dependent var	-0.002174	
Adjusted R-squared	0.244467	S.D. dependent var	1.056542	
S.E. of regression	0.918361	Akaike info criterion	2.750490	
Sum squared resid	17.71114	Schwarz criterion	2.849228	
Log likelihood	-29.63063	Hannan-Quinn criter.	2.775322	
F-statistic	8.118507	Durbin-Watson stat	1.696452	
Prob(F-statistic)	0.009604			

Unemployment rezultoi jo-stacionare në nivel ($p = 0.3802$). Në diferencën e parë, testi ADF jep $p = 0.0671$, çka e bën serinë stacionare në nivelin 10% të sinjifikancës. Duke marrë parasysh madhësinë e vogël të mostrës, variabli përdoret si $d(\text{Unemployment})$ në modelin OLS.

i. Exports

Null Hypothesis: EXPORTS has a unit root
Exogenous: Constant
Lag Length: 5 (Automatic - based on SIC, maxlag=5)

	t-Statistic	Prob.*
Augmented Dickey-Fuller test statistic	-3.796861	0.0107
Test critical values: 1% level	-3.831511	
5% level	-3.029970	
10% level	-2.655194	

*MacKinnon (1996) one-sided p-values.
Warning: Probabilities and critical values calculated for 20 observations and may not be accurate for a sample size of 19

Augmented Dickey-Fuller Test Equation
Dependent Variable: D(EXPORTS)
Method: Least Squares
Date: 02/02/26 Time: 21:48
Sample (adjusted): 2006 2024
Included observations: 19 after adjustments

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
EXPORTS(-1)	-1.109650	0.292255	-3.796861	0.0025
D(EXPORTS(-1))	-0.249727	0.326307	-0.765313	0.4589
D(EXPORTS(-2))	-1.089857	0.331072	-3.291901	0.0064
D(EXPORTS(-3))	-2.154067	0.376800	-5.716731	0.0001
D(EXPORTS(-4))	-0.551515	0.532630	-1.035457	0.3209
D(EXPORTS(-5))	-1.253901	0.593507	-2.112697	0.0563
C	34.29591	8.436125	4.065362	0.0016
R-squared	0.912110	Mean dependent var	-0.857895	
Adjusted R-squared	0.868166	S.D. dependent var	8.289439	
S.E. of regression	3.009814	Akaike info criterion	5.318943	
Sum squared resid	108.7078	Schwarz criterion	5.666895	
Log likelihood	-43.52996	Hannan-Quinn criter.	5.377831	
F-statistic	20.75580	Durbin-Watson stat	2.176151	
Prob(F-statistic)	0.000011			

j. Variance Inflation Factor (VIF)

Variance Inflation Factors
Date: 02/02/26 Time: 22:02
Sample: 2000 2024
Included observations: 24

Variable	Coefficient Variance	Uncentered VIF	Centered VIF
C	198.2505	1198.604	NA
GOV_EXP	0.201203	1111.242	2.705912
D(PUB_INVESTMENT)	0.186540	1.639543	1.625269
D(TAX_REVENUE)	0.169570	1.868437	1.866657
D(PUBLIC_DEBT)	0.024010	2.556818	2.535949
INFLATION	0.182904	10.02474	1.788188
D(UNEMPLOYMENT)	0.294500	1.847689	1.633710
D(REMITTANCES)	0.656819	2.336310	1.802423
EXPORTS	0.008278	37.66185	1.914484

- k. Testi i heteroskedasticitetit (Breusch–Pagan–Godfrey) për modelin OLS të periudhës 2000–2024

Heteroskedasticity Test: Breusch-Pagan-Godfrey

F-statistic	5.706133	Prob. F(8,16)	0.0016
Obs*R-squared	18.51166	Prob. Chi-Square(8)	0.0177
Scaled explained SS	17.74050	Prob. Chi-Square(8)	0.0233

Test Equation:

Dependent Variable: RESID^2

Method: Least Squares

Date: 02/06/26 Time: 16:00

Sample: 2000 2024

Included observations: 25

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	-38.50634	36.88832	-1.043863	0.3121
GOV_EXP	1.522785	1.097360	1.387681	0.1843
PUB_INVESTMENT	-0.592883	1.360556	-0.435765	0.6688
TAX_REVENUE	-1.897108	1.612590	-1.176436	0.2566
PUBLIC_DEBT	1.372821	0.401006	3.423448	0.0035
INFLATION	-1.034540	1.190601	-0.868923	0.3977
UNEMPLOYMENT	-5.237089	1.236309	-4.236068	0.0006
REMITTANCES	2.746660	1.084426	2.532824	0.0222
EXPORTS	0.105049	0.393962	0.266648	0.7931
R-squared	0.740466	Mean dependent var	4.062645	
Adjusted R-squared	0.610700	S.D. dependent var	8.969504	
S.E. of regression	5.596427	Akaike info criterion	6.555847	
Sum squared resid	501.1199	Schwarz criterion	6.994642	
Log likelihood	-72.94808	Hannan-Quinn criter.	6.677550	
F-statistic	5.706133	Durbin-Watson stat	1.888687	
Prob(F-statistic)	0.001552			

LITERATURA

- Acemoglu, D., & Robinson, J. A. (2012). *Why nations fail: The origins of power, prosperity, and poverty*. Crown Business.
- Akaike, H. (1974). A new look at the statistical model identification. *IEEE Transactions on Automatic Control*, 19(6), 716–723. <https://doi.org/10.1109/TAC.1974.1100705>
- Alesina, A., & Giavazzi, F. (Eds.). (2013). *Fiscal policy after the financial crisis*. University of Chicago Press. <https://doi.org/10.7208/chicago/9780226018584.001.0001>
- Alkasasbeh, O. M. A., & Haron, N. F. (2018). Fiscal policy and its relationship with economic growth: A review study. *Saudi Journal of Business and Management Studies*, 3(12), 1318–1327.
- ALTAX. (2020). *Fiscal policy and economic challenges in Albania*. ALTAX Center. <https://altax.al/en>
- Angjeli, A., & Civici, A. (2020). *Kriza ekonomike në kohën e koronavirusit: Shkaqet, pasojat, reagimet (Mars–Maj 2020)*. UMSH Press.
- Angjeli, A., & Civici, A. (2022). *Drejt një krize të re: Energjia, inflacioni, rritje çmimesh, çoroditje e tregjeve*. UMSH Press.
- Auerbach, A. J., & Gorodnichenko, Y. (2012). Measuring the output responses to fiscal policy. *American Economic Journal: Economic Policy*, 4(2), 1–27. <https://doi.org/10.1257/pol.4.2.1>
- Bai, J., & Perron, P. (2003). Computation and analysis of multiple structural change models. *Journal of Applied Econometrics*, 18(1), 1–22. <https://doi.org/10.1002/jae.659>
- Baldacci, E., Gupta, S., & Mulas-Granados, C. (2011). *How effective is fiscal policy response in financial crises?* (IMF Working Paper No. 11/225). International Monetary Fund. <https://doi.org/10.5089/9781463921783.001>
- Balliu, T., & Gaçe-Llozana, A. (2015). Commonalities and differences of tax systems in West Balkan countries: Comparative analysis. *European Journal of Social Sciences Education and Research*, 3(1), 157–166.
- Banka e Shqipërisë. (2009). *Raporti vjetor 2009*. https://www.bankofalbania.org/Publications/Periodic_Publications/
- Banka e Shqipërisë. (2010). *Raporti vjetor 2010*. https://www.bankofalbania.org/Publications/Periodic_Publications/
- Banka e Shqipërisë. (2019). *Raporti vjetor 2019*. https://www.bankofalbania.org/Publications/Periodic_Publications/
- Banka e Shqipërisë. (2022). *Raporti vjetor 2022*. https://www.bankofalbania.org/Publications/Periodic_Publications/
- Banka e Shqipërisë. (2024). *Raporti vjetor 2023*. <https://www.bankofalbania.org>
- Barro, R. J. (1974). Are government bonds net wealth? *Journal of Political Economy*, 82(6), 1095–1117. <https://doi.org/10.1086/260266>
- Barro, R. J. (1990). Government spending in a simple model of endogenous growth. *Journal of Political Economy*, 98(5), S103–S125. <https://doi.org/10.1086/261726>

- Barro, R. J. (1991). Economic growth in a cross section of countries. *Quarterly Journal of Economics*, 106(2), 407–443. <https://doi.org/10.2307/2937943>
- Batini, N., Eyraud, L., & Weber, A. (2014). *A simple method to compute fiscal multipliers* (IMF Working Paper No. 14/93). International Monetary Fund. <https://doi.org/10.5089/9781498357999.001>
- Besley, T., & Persson, T. (2011). *Pillars of prosperity: The political economics of development clusters*. Princeton University Press.
- Besley, T., & Persson, T. (2013). Taxation and development. In A. J. Auerbach, R. Chetty, M. Feldstein, & E. Saez (Eds.), *Handbook of public economics* (Vol. 5, pp. 51–110). Elsevier. <https://doi.org/10.1016/B978-0-444-53759-1.00002-9>
- Blanchard, O. (2009). *The crisis: Basic mechanisms, and appropriate policies* (IMF Working Paper No. WP/09/80). International Monetary Fund. <https://doi.org/10.5089/9781451872279.001>
- Blanchard, O. (2021). *Macroeconomics* (8th ed.). Pearson.
- Blanchard, O., & Johnson, D. R. (2013). *Macroeconomics* (6th ed.). Pearson.
- Blanchard, O., & Leigh, D. (2013). Growth forecast errors and fiscal multipliers. *American Economic Review*, 103(3), 117–120. <https://doi.org/10.1257/aer.103.3.117>
- Blanchard, O., & Perotti, R. (2002). An empirical characterization of the dynamic effects of changes in government spending and taxes on output. *Quarterly Journal of Economics*, 117(4), 1329–1368. <https://doi.org/10.1162/003355302320935043>
- Boiciuc, I. (2015). The cyclical behavior of fiscal policy in Romania. *Procedia Economics and Finance*, 32, 286–291. [https://doi.org/10.1016/S2212-5671\(15\)01393-3](https://doi.org/10.1016/S2212-5671(15)01393-3)
- Boiciuc, I. (2015). The effects of fiscal policy shocks in Romania: A SVAR approach. *Procedia Economics and Finance*, 32, 1131–1139. [https://doi.org/10.1016/S2212-5671\(15\)01578-6](https://doi.org/10.1016/S2212-5671(15)01578-6)
- Breusch, T. S., & Godfrey, L. G. (1978). Testing for autocorrelation in dynamic linear models. *Australian Economic Papers*, 17(31), 334–355. <https://doi.org/10.1111/j.1467-8454.1978.tb00635.x>
- Brown, R. L., Durbin, J., & Evans, J. M. (1975). Techniques for testing the constancy of regression relationships over time. *Journal of the Royal Statistical Society: Series B*, 37(2), 149–192. <https://doi.org/10.1111/j.2517-6161.1975.tb01532.x>
- Calderón, C., Moral-Benito, E., & Servén, L. (2015). Is infrastructure capital productive? A dynamic heterogeneous approach. *Journal of Applied Econometrics*, 30(2), 177–198. <https://doi.org/10.1002/jae.2373>
- Cenaj, A., & Bexheti, A. (2025). Impact of the fiscal policy. South East European University / FEB International Scientific Conference. <https://www.fsovet.mk/wp-content/uploads/2025/05/Impact-of-the-fiscal-policy.-CenajBexheti.pdf>
- Chow, G. C. (1960). Tests of equality between sets of coefficients in two linear regressions. *Econometrica*, 28(3), 591–605. <https://doi.org/10.2307/1910133>
- Christiano, L., Eichenbaum, M., & Rebelo, S. (2011). When is the government spending multiplier large? *Journal of Political Economy*, 119(1), 78–121. <https://doi.org/10.1086/659312>
- Claessens, S., & Kose, M. A. (2013). *Financial crises: Explanations, types, and implications* (IMF Working Paper No. WP/13/28). International Monetary Fund. <https://doi.org/10.5089/9781475561005.001>

- DeLong, J. B., & Summers, L. H. (2012). Fiscal policy in a depressed economy. *Brookings Papers on Economic Activity*, 43(1), 233–297. <https://doi.org/10.1353/eca.2012.0000>
- Demi, A., Xhaferri, S., Uku, S., Shahini, S., & Lushi, A. (2021). The impact of fiscal policies on Albanian economic growth: The case of value-added tax. *Journal of Governance & Regulation*, 10(4), 311–325. <https://doi.org/10.22495/jgrv10i4siart11>
- Devarajan, S., Swaroop, V., & Zou, H.-F. (1996). The composition of public expenditure and economic growth. *Journal of Monetary Economics*, 37(2), 313–344. [https://doi.org/10.1016/S0304-3932\(96\)90039-2](https://doi.org/10.1016/S0304-3932(96)90039-2)
- Dickey, D. A., & Fuller, W. A. (1979). Distribution of the estimators for autoregressive time series with a unit root. *Journal of the American Statistical Association*, 74(366), 427–431. <https://doi.org/10.1080/01621459.1979.10482531>
- Dornean, A., & Oanea, D.-C. (2015). Romanian fiscal policy sustainability during financial crisis: A cointegration approach. *Procedia Economics and Finance*, 20, 163–170. [https://doi.org/10.1016/S2212-5671\(15\)00061-1](https://doi.org/10.1016/S2212-5671(15)00061-1)
- Durbin, J., & Watson, G. S. (1950). Testing for serial correlation in least squares regression: I. *Biometrika*, 37(3–4), 409–428. <https://doi.org/10.2307/2332391>
- Eggertsson, G. B., & Woodford, M. (2003). The zero bound on interest rates and optimal monetary policy. *Brookings Papers on Economic Activity*, 34(1), 139–235. <https://doi.org/10.1353/eca.2003.0010>
- Enders, W. (2015). *Applied econometric time series* (4th ed.). Wiley.
- European Bank for Reconstruction and Development. (2023). *Transition report 2023–2024*. EBRD. <https://www.ebrd.com/transition-report-2023-24>
- European Commission. (2023). *European economic forecast: Spring 2023* (Institutional Paper No. 200). Publications Office of the European Union. <https://doi.org/10.2765/707155>
- European Commission. (2024). *Albania report 2024*. https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024_en
- European Commission, Directorate-General for Economic and Financial Affairs. (2024). *European economic forecast: Spring 2024* (Institutional Paper No. 286). Publications Office of the European Union. https://economy-finance.ec.europa.eu/publications/european-economic-forecast-spring-2024_en
- EViews. (2022). *EViews 12 user's guide*. IHS Global Inc. <https://www.eviews.com>
- Galí, J. (2015). *Monetary policy, inflation, and the business cycle: An introduction to the New Keynesian framework and its applications* (2nd ed.). Princeton University Press.
- Gaspar, V., Jaramillo, L., & Wingender, P. (2016). *Tax capacity and growth: Is there a tipping point?* (IMF Working Paper No. 16/234). International Monetary Fund. <https://doi.org/10.5089/9781475558173.001>
- Gerling, K., Medas, P. A., Poghosyan, T., Farah-Yacoub, J., & Xu, Y. (2017). *Fiscal crises* (IMF Working Paper No. 2017/086). International Monetary Fund. <https://doi.org/10.5089/9781475592153.001>
- Gourinchas, P.-O., Kalemli-Özcan, Ş., Penciakova, V., & Sander, N. (2020). *COVID-19 and SME failures* (IMF Working Paper No. 2020/207). International Monetary Fund.
- Gujarati, D. N., & Porter, D. C. (2009). *Basic econometrics* (5th ed.). McGraw-Hill Education.

- Gupta, S., Mulas-Granados, C., & Baldacci, E. (2009). *How effective is fiscal policy response in systemic banking crises?* (IMF Working Paper No. 2009/160). International Monetary Fund. <https://doi.org/10.5089/9781451873078.001>
- Hamilton, J. D. (1994). *Time series analysis*. Princeton University Press. <https://doi.org/10.1515/9780691218632>
- Hemming, R., Kell, M., & Mahfouz, S. (2002). *The effectiveness of fiscal policy in stimulating economic activity: A review of the literature* (IMF Working Paper No. 02/208). International Monetary Fund.
- Hoxhaj, E. (2019). The impact of fiscal policy on economic growth. <https://philpapers.org/archive/HOXTIO.pdf>
- Ilzetzki, E., Mendoza, E. G., & Végh, C. A. (2013). How big (small?) are fiscal multipliers? *Journal of Monetary Economics*, 60(2), 239–254. <https://doi.org/10.1016/j.jmoneco.2012.10.011>
- INSTAT. (2021). *Treguesit ekonomikë dhe llogaritë kombëtare*. <https://www.instat.gov.al>
- INSTAT. (2024). *Llogaritë kombëtare dhe treguesit makroekonomikë*. <https://www.instat.gov.al>
- International Energy Agency. (2022). *Albania energy profile*. IEA. <https://www.iea.org/countries/albania>
- International Monetary Fund. (2008). *World economic outlook: Financial stress, downturns, and recoveries*. International Monetary Fund.
- International Monetary Fund. (2009). *The state of public finances: Cross-country fiscal monitor, November 2009* (IMF Staff Position Note No. SPN/09/25). <https://doi.org/10.5089/9781462349531.004>
- International Monetary Fund. (2019). *Albania: 2018 Article IV consultation—Press release; staff report; and statement by the executive director for Albania* (IMF Country Report No. 19/29). <https://www.imf.org/-/media/Files/Publications/CR/2019/cr1929-albania-a4.ashx>
- International Monetary Fund. (2020). *Fiscal monitor, October 2020: Policies for the recovery*. <https://doi.org/10.5089/9781513552705.089>
- International Monetary Fund. (2021). *Fiscal monitor: Strengthening the credibility of public finances*.
- International Monetary Fund. (2021). *Regional economic outlook: Europe—Recovery during a pandemic*. <https://www.imf.org/-/media/Files/Publications/REO/EUR/2021/April/English/text.ashx>
- International Monetary Fund. (2022). *Fiscal monitor, October 2022: Helping people bounce back*. <https://doi.org/10.5089/9798400212741.089>
- International Monetary Fund. (2022). *Regional economic outlook: Europe—War sets back the European recovery*. <https://www.imf.org/en/Publications/REO/EU/Issues/2022/04/20/regional-economic-outlook-for-europe-april-2022>
- International Monetary Fund. (2023). *World economic outlook, April 2023: A rocky recovery*. <https://www.imf.org/en/Publications/WEO/Issues/2023/04/11/world-economic-outlook-april-2023>
- International Monetary Fund. (2024). *Albania: 2023 Article IV consultation—Press release; staff report; and statement by the executive director for Albania* (IMF Country Report No.

- 2024/012). <https://www.imf.org/-/media/Files/Publications/CR/2024/English/1ALBEA2024001.ashx>
- International Monetary Fund. (2025). *Albania: 2024 Article IV consultation—Press release; staff report; and statement by the Executive Director for Albania* (IMF Country Report No. 2025/020). <https://www.imf.org/en/Publications/CR/Issues/2025/01/24/Albania-2024-Article-IV-Consultation-Press-Release-Staff-Report-and-Statement-by-the-561199>
- Jamasi, Z. (2017). *Fiscal policy in a small open economy* [Doctoral dissertation, Ryerson University].
- Jarque, C. M., & Bera, A. K. (1987). A test for normality of observations and regression residuals. *International Statistical Review*, 55(2), 163–172. <https://doi.org/10.2307/1403192>
- Jeong, K. J. (2014). *Analysing the effects of fiscal policy and assessing its sustainability* [Doctoral dissertation, University of Birmingham]. University of Birmingham Research Archive. <https://etheses.bham.ac.uk/id/eprint/5250/2/Jeong14PhD.pdf>
- Jovanović, B., Madzarević-Šujster, S., Pionteck, T., Tevdovski, D., & Heimberger, P. (2024). *Fiscal governance in the Western Balkans: An analysis of fiscal rules, fiscal councils, and medium-term budgetary frameworks* (wiiw Research Report No. 478). The Vienna Institute for International Economic Studies. <https://wiiw.ac.at/fiscal-governance-in-the-western-balkans-an-analysis-of-fiscal-rules-fiscal-councils-and-medium-term-budgetary-frameworks-p-7092.html>
- Kamberi, A. (2025). Public debt and fiscal consolidation in the Western Balkans: A panel analysis of growth effects. *European Journal of Government and Economics*, 14(2). <https://doi.org/10.17979/ejge.2025.14.2.11181>
- Kaminsky, G. L., Reinhart, C. M., & Végh, C. A. (2004). When it rains, it pours: Procyclical capital flows and macroeconomic policies. *NBER Macroeconomics Annual*, 19, 11–82.
- Kaufmann, D., & Kraay, A. (2024). *The Worldwide Governance Indicators: Methodology and 2024 update* (Policy Research Working Paper 10952). World Bank Group. <https://www.worldbank.org/en/publication/worldwide-governance-indicators>
- Kaufmann, D., Kraay, A., & Mastruzzi, M. (2010). *The worldwide governance indicators: Methodology and analytical issues* (Policy Research Working Paper No. 5430). World Bank.
- Keynes, J. M. (1936). *The general theory of employment, interest and money*. Macmillan.
- Kholjigitov, G. A. (2013). The role of fiscal discipline in public finance management in developing countries. *SSRN Electronic Journal*. <https://doi.org/10.2139/ssrn.2368123>
- Kikoni, E., Madžarević-Šujster, S., Irwin, T., & Jooste, C. (2019). *Fiscal rules for the Western Balkans* (Policy Research Working Paper No. 8990). World Bank.
- Kim, J., Wang, M., Park, D., & Petalcorin, C. C. (2021). Fiscal policy and economic growth: Some evidence from China. *Review of World Economics*, 157, 555–582. <https://doi.org/10.1007/s10290-021-00414-5>
- Kneller, R., Bleaney, M. F., & Gemmell, N. (1999). Fiscal policy and growth: Evidence from OECD countries. *Journal of Public Economics*, 74(2), 171–190. [https://doi.org/10.1016/S0047-2727\(99\)00022-5](https://doi.org/10.1016/S0047-2727(99)00022-5)
- Kontrolli i Lartë i Shtetit. (2012). *Raporti i auditimit për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2011*. KLSH.

- Kraay, A. (2014). Government spending multipliers in developing countries: Evidence from lending by official creditors. *American Economic Journal: Macroeconomics*, 6(4), 170–208. <https://doi.org/10.1257/mac.6.4.170>
- Lucas, R. E., Jr. (1977). Understanding business cycles. *Carnegie-Rochester Conference Series on Public Policy*, 5, 7–29. [https://doi.org/10.1016/0167-2231\(77\)90002-1](https://doi.org/10.1016/0167-2231(77)90002-1)
- Mançellari, A. (2011). *Macroeconomic effects of fiscal policy in Albania: A SVAR approach*. Bank of Albania. https://www.bankofalbania.org/Publications/Macroeconomic_effects_of_fiscal_policy_in_Albania_A_Svar_approach.html
- Mankiw, N. G. (2020). *Macroeconomics* (10th ed.). Worth Publishers.
- Masiye, M. (2019). *Fiscal policy in African development: Qual-quant analysis with special reference to Zambia* [Doctoral dissertation, University of Sheffield].
- Mian, A., & Sufi, A. (2014). *House of debt: How they (and you) caused the Great Recession, and how we can prevent it from happening again*. University of Chicago Press. <https://press.uchicago.edu/ucp/books/book/chicago/H/bo20832545.html>
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë. (2024). *Programi buxhetor afatmesëm 2024–2026*. <https://financa.gov.al>
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë. (2024). *Strategjia Afatmesme e të Ardhurave 2024–2027*. <https://financa.gov.al>
- Mountford, A., & Uhlig, H. (2009). What are the effects of fiscal policy shocks? *Journal of Applied Econometrics*, 24(6), 960–992. <https://doi.org/10.1002/jae.1079>
- Musgrave, R. A. (1959). *The theory of public finance: A study in public economy*. McGraw-Hill.
- National Bureau of Economic Research. (2003). *The NBER's recession dating procedure*. <https://www.nber.org/cycles/recessions.html>
- National Bureau of Economic Research. (2008, January 7). *Business cycle dating committee announcement*. <https://www.nber.org/news/business-cycle-dating-committee-announcement-january-7-2008>
- Nkoro, E., & Uko, A. K. (2016). Autoregressive Distributed Lag (ARDL) co-integration technique: Application and interpretation. *Journal of Statistical and Econometric Methods*, 5(4), 63–91.
- Organisation for Economic Co-operation and Development. (2021). *Taxing energy use for sustainable development: Opportunities for energy tax and subsidy reform in selected developing and emerging economies*. OECD Publishing. <https://doi.org/10.1787/058ca239-en>
- Organisation for Economic Co-operation and Development. (2022). *Revenue statistics in South East Europe 2022*. OECD Publishing. https://www.oecd-ilibrary.org/taxation/revenue-statistics-in-south-east-europe-2022_f6e9f8ea-en
- Organisation for Economic Co-operation and Development. (2023). *OECD Economic Outlook, Volume 2023 Issue 1*. OECD Publishing. <https://doi.org/10.1787/ce188438-en>
- Ostry, J. D., Ghosh, A. R., Kim, J. I., & Qureshi, M. S. (2010). *Fiscal space* (IMF Staff Position Note SPN/10/11). International Monetary Fund. <https://www.imf.org/external/pubs/ft/spn/2010/spn1011.pdf>

- Pauly, L. W. (2020). EU fiscal policy coordination in hard times: Free riders on the storm. *Perspectives on Politics*, 18(2), 689–690. <https://doi.org/10.1017/S1537592720000444>
- Pearson, K. (1895). Notes on regression and inheritance in the case of two parents. *Proceedings of the Royal Society of London*, 58, 240–242. <https://doi.org/10.1098/rspl.1895.0041>
- Pere, E., & Hashorva, A. (2011). Tax systems in West Balkans countries – Between simplicity and efficiency. *Romanian Economic and Business Review*, 6(2), 80–95.
- Pere, E., & Hashorva, A. (2011). Western Balkans' countries in focus of global economic crisis. *Annals of the University of Petrosani Economics*, 11(1), 103–113. https://upet.ro/annals/economics/pdf/2011/part1/Pere_Hashorva.pdf
- Perotti, R. (2002). *Estimating the effects of fiscal policy in OECD countries* (European Central Bank Working Paper No. 168).
- Pesaran, M. H., Shin, Y., & Smith, R. J. (2001). Bounds testing approaches to the analysis of level relationships. *Journal of Applied Econometrics*, 16(3), 289–326. <https://doi.org/10.1002/jae.616>
- Ramey, V. A. (2011). Identifying government spending shocks: It's all in the timing. *Quarterly Journal of Economics*, 126(1), 1–50. <https://doi.org/10.1093/qje/qjq008>
- Ramey, V. A. (2019). Ten years after the financial crisis: What have we learned from the renaissance in fiscal research? *Journal of Economic Perspectives*, 33(2), 89–114. <https://doi.org/10.1257/jep.33.2.89>
- Reinhart, C. M., & Rogoff, K. S. (2009). *This time is different: Eight centuries of financial folly*. Princeton University Press. <https://doi.org/10.1515/9781400831722>
- Reinhart, C. M., & Rogoff, K. S. (2010). Growth in a time of debt. *American Economic Review*, 100(2), 573–578. <https://doi.org/10.1257/aer.100.2.573>
- Resosudarmo, B. P., Abdurrohman, Y., Yusuf, A. A., & Hartono, D. (2021). Spatial impacts of fiscal stimulus policies during the 2009 global financial crisis in Indonesia. *Asia-Pacific Journal of Regional Science*, 5, 305–326. <https://doi.org/10.1007/s41685-020-00176-2>
- Romer, C. D. (2022). Lessons from fiscal policy in the pandemic: The ODE Distinguished Economist Award Lecture. *The American Economist*. <https://doi.org/10.1177/05694345221104978>
- Romer, C. D., & Romer, D. H. (2010). The macroeconomic effects of tax changes: Estimates based on a new measure of fiscal shocks. *American Economic Review*, 100(3), 763–801. <https://doi.org/10.1257/aer.100.3.763>
- Romer, D. (2012). *Advanced macroeconomics* (4th ed.). McGraw-Hill Irwin.
- Salamaliki, P. K., & Venetis, I. A. (2023). Fiscal space and policy response to financial crises: Market access and deficit concerns. *Review of Evolutionary Political Economy*, 35, 323–361. <https://doi.org/10.1007/s11079-023-09724-7>
- Samuelson, P. A., & Nordhaus, W. D. (2010). *Economics* (19th ed.). McGraw-Hill Education.
- Sanfey, P., & Milatović, J. (2018). *The Western Balkans in transition: Diagnosing the constraints on the path to a sustainable market economy*. European Bank for Reconstruction and Development.
- Sawadogo, R. (2020). Does the quality of institutions matter for fiscal performance? Evidence from developing countries. *Journal of Public Budgeting, Accounting & Financial Management*, 32(4), 677–696. <https://doi.org/10.1108/JPBAFM-02-2020-0019>

- Seater, J. J. (1993). Ricardian equivalence. *Journal of Economic Literature*, 31(1), 142–190.
- Shaw, C. (2016). Fiscal policy and economic growth. <https://doi.org/10.2139/ssrn.2789338>
- Shijaku, G., & Gjokuta, A. (2013). *Fiscal policy and economic growth: The case of Albania*. Bank of Albania Working Paper.
- Šimović, H., & Mihelja Žaja, M. (2010). Tax incentives in Western Balkan countries. *International Journal of Social, Behavioral, Educational, Economic, Business and Industrial Engineering*, 42.
- Skufi, L., Kika, E., & Çela, E. (2025). *Modeli makroekonometrik i ekonomisë shqiptare (MEAM): Një përditësim i ekuacioneve dhe parametrave të modelit*. Banka e Shqipërisë
- Snowdon, B., & Vane, H. R. (2005). *Modern macroeconomics: Its origins, development and current state*. Edward Elgar Publishing.
- Stiglitz, J. E., & Rosengard, J. K. (2015). *Economics of the public sector* (4th ed.). W. W. Norton & Company.
- Stock, J. H., & Watson, M. W. (2019). *Introduction to econometrics* (4th ed.). Pearson.
- Tcherneva, P. R. (2011). *Fiscal policy effectiveness: Lessons from the Great Recession* (Working Paper No. 649). Levy Economics Institute of Bard College. <https://www.levyinstitute.org/publications/fiscal-policy-effectiveness-lessons-from-the-great-recession/>
- van Brunschot, F., Vesperman, S., Jensen, A., O’Grady, M., & Dempsey, P. (2021). *Albania: Enhancing tax administration capacity during challenging times* (Technical Report). International Monetary Fund, Fiscal Affairs Department.
- White, H. (1980). A heteroskedasticity-consistent covariance matrix estimator and a direct test for heteroskedasticity. *Econometrica*, 48(4), 817–838. <https://doi.org/10.2307/1912934>
- Woodford, M. (2003). *Interest and prices: Foundations of a theory of monetary policy*. Princeton University Press.
- Woodford, M. (2011). Simple analytics of the government expenditure multiplier. *American Economic Journal: Macroeconomics*, 3(1), 1–35. <https://doi.org/10.1257/mac.3.1.1>
- Wooldridge, J. M. (2013). *Introductory econometrics: A modern approach* (5th ed.). South-Western Cengage Learning.
- Wooldridge, J. M. (2019). *Introductory econometrics: A modern approach* (7th ed.). Cengage Learning.
- World Bank. (2020). *Global Economic Prospects (June 2020)*. <https://doi.org/10.1596/978-1-4648-1553-9>
- World Bank. (2021). *Western Balkans regular economic report No. 20: Greening the recovery*. <https://documents1.worldbank.org/curated/en/900381634670558017/pdf/Greening-the-Recovery.pdf>
- World Bank. (2022). *Western Balkans regular economic report No. 22: Beyond the crises*. <https://openknowledge.worldbank.org/bitstreams/91828982-e996-5713-8efb-9fb4202f7667/download>
- World Bank. (2023). *Western Balkans regular economic report No. 23: Testing resilience*.
- World Bank. (2023). *Western Balkans regular economic report No. 24: Toward sustainable growth*.

- World Bank. (2024). *World development indicators*. <https://databank.worldbank.org/source/world-development-indicators>
- World Bank. (2025). *Western Balkans regular economic report*. <https://www.worldbank.org/en/region/eca/publication/western-balkans-regular-economic-report>
- World Tourism Organization. (2024). *UN Tourism Data Dashboard*. <https://www.unwto.org/tourism-data>